AGJENCIA E ZBATIMIT TË GJUHËS E RMV-së

Konferenca Shkencore Ndërkombëtare

TERMINOLOGJIA DHE ROLI I SAJ PËR NJOHJEN E GJUHËS PROFESIONALE

Kumtesat

Shkup, 2022

Botues: Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

Redaktor: Prof. dr. Ylber Sela

Këshilli shkencor:

Prof. dr. Valter Memisha

Prof. dr. Anila Omari

Prof. dr. Xhevat Lloshi

Prof. dr. Mimoza Kore

Prof. dr. Mustafa Ibraimi

Prof. dr. Berton Sulejmani

Prof. as. dr. Teuta Toska

Prof. as. dr. Izer Maksuti

Prof. as. dr. Xhafer Beqiraj

Dr. Elena Chiocchetti

Dr. Liljana Pandeva

Përkthyes nga maqedonishtja në shqip: Ermira Ajrullai, Monika Mitreva

Përkthyes nga anglishtja në shqip: Fitore Shaqiri

Korrektorë: Riza Ziberi, Lirim Shabani

Lektorimi i teksteve është bërë nga vetë autorët

Lektorimi i teksteve të përkthyera është bërë nga Lirim Shabani dhe Nebi Bilalli

Realizimi teknik dhe dizajni: Lirim Shabani

Shtypi: Grafo Prom, Manastir

Tirazhi: 300

Përmbajtja

Albina Pajo

Një vështrim përmbajtësor mbi marrëdhëniet e terminologjisë me gjuhësinë, gjuhësinë e aplikuar dhe me disiplina të ndryshme gjuhësore 1

Anton Pançev

Njësimi dhe përkthimi i disa termave në shqip sipas dispozitave të Traktateve me Greqinë dhe Bullgarinë 13

Elena Chiocchetti

Sfidat terminologjike në gjuhën gjermane si gjuhë e pakicës në Tirolin e Jugut: Shembulli i shëndetit dhe i sigurisë në punë 25

Evalda Paci

Çështje të terminologjisë shkencore në disa disiplina themelore të albanologjisë (vështrim diakronik dhe analitik) 48

Isa Mulaj, Ruzhdi Matoshi, Florin Aliu

Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe: gjendja, problemet detyrat 59

Izer Maksuti

Roli i terminologjisë profesionale në përkthimin e teksteve të specializuara 81

Juljana Kume, Sabri Hoxha

Veçori të terminologjisë së mjekësisë ligjore 104

Magdalena Anxhelika Shitov

Terminologjia dhe roli i saj në interpretim 151

Olger Brame

Çështje të shqipërimit të terminologjisë në shënimet gjuhësore të Aleksandër Xhuvanit 172

Teuta Sula

Terminologjia në klasifikimin lëndor të bibliotekës 184

Teuta Toska

Fjalorët terminologjikë: pasuri për t'u vlerësuar apo traditë për t'u mënjanuar? 195

Xhafer Beqiraj

Disa probleme të terminologjisë në gramatikën e shqipes 205

Zeqirija Ibrahimi

Terminologjia profesionale ndërmjet njësimit dhe përkthimit 213

SHTOJCË

Ali Pajaziti

Odiseja e shqipes në RMV: 1946-2021 226

Liljana Pandeva

Përkitazi me përmbledhjen 235

Mustafa Ibraimi

Botim me vlerë për dygjuhësinë në shtetet multikulturore 243

Valter Memisha

Fjalim me rastin e promovimit të studimit "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të përdorimit të gjuhëve të vitit 2019" 248

Albina Pajo

Një vështrim përmbajtësor mbi marrëdhëniet e terminologjisë me gjuhësinë, gjuhësinë e aplikuar dhe me disiplina të ndryshme gjuhësore

Abstrakt

Terminologjia është shkencë dhe si e tillë ajo është një fushë ndër dhe përtej disiplinare e dijeve që ka të bëjë me konceptet dhe atë çka ato përfaqësojnë (termat, simbolet), etj. Ajo mund të shihet si përmbledhje apo sistem termash që përfaqëson një sistem të tërë konceptesh të një fushe specifike, publikimi dhe promovimi i tyre në rrjetin e gjerë të përdoruesve të saj. Në këtë kumtesë do të veçojmë marrëdhëniet që ka terminologjia me disiplina të ndryshme gjuhësore, rolin dhe dobinë e saj në zhvillimin e tyre. Terminologjia është një shkencë që ndryshon dhe arsyeja e këtij ndryshimi lidhet me marrëdhëniet që terminologjia ka me shkencat e tjera, si: semantikën, leksikologjinë, leksikografinë etj. Kohët e fundit, terminologjia është parë më tepër si një set praktikash sesa një shkencë më vete, pavarësisht se ajo ka një qëllim të përcaktuar mirë, çka do të thotë se realizon nevojat shprehëse të përdoruesve të gjuhës në çdo fushë. Procese të tilla si kërkimet teorike, analiza dhe krijimi i termave, duhet ta përmirësojnë terminologjinë, e cila zë vend në shkencat që rrjedhin nga gjuha.

Fjalë çelës: *terminologji, gjuhësi, gjuhësi e aplikuar, disiplina gjuhësore, marrëdhënie*

Terminologjia është zhvilluar si një nevojë bazike e njeriut, ajo e të identifikuarit, etiketimit ose emërtimit të gjërave. Përkufizimi i saktë nuk është përcaktuar

qartë dhe pikëpamjet rreth terminologjisë si disiplinë shkencore, ndryshojnë nga njëra periudhë në tjetrën. Në shekullin XVIII- XIX, shkencëtarët e fushave të ndryshme u bënë hartuesit dhe drejtuesit e terminologjisë në përgjithësi. Ata vërejtën vështirësi në lidhje me diversitetin e formave dhe marrëdhënieve mes formave dhe koncepteve[1].

Kështu, gjatë shekullit XVIII e XIX vijoi zhvillimi i disa prirjeve të shfaqura qysh në Rilindje.

U vu re rëndësia gjithnjë e më e madhe që u jepej gjuhëve kombëtare të cilat u cilësuan si gjuhë të popujve e, si të tilla, shprehnin qenien dhe individualitetin historik e kombëtar. P.sh. Herderi mendonte se midis karakterit të gjuhës dhe kombit që e fliste atë, ekziston një lidhje e brendshme[2].

Në formimin e termave dhe koncepteve të fushave të ndryshme të dijes dhe shkencës, duhet thënë se gjuha dhe fjalët e saj përdoren jo në kuptimin e përgjithshëm, por në atë specifik, të veçantë, çka e bën shpjegimin konceptor të qartë, ekzakt dhe të dobishëm, me qëllim komunikimin efektiv midis profesionistëve të fushave të ndryshme të dijes dhe shkencës. Në qendër të këtij punimi do të jetë marrëdhënia e terminologjisë me gjuhësinë, gjuhësinë e aplikuar dhe komunikimin e specializuar.

Terminologjia me të drejtë është parë si një set praktikash që realizon ndërtimin e termave, sistemimin, koleksionimin dhe prezantimin e tyre dhe përmbush kështu, nevojat shoqërore duke zgjidhur komunikimin mes specialistëve në fusha të ndryshme të dijes, shkencës dhe teknikës. Duke qenë se kjo shkencë përmban një leksik të specializuar, të veçantë, ajo ka një lidhje të pandashme me gjuhësinë si megashkencë, si dhe me disiplinat e veçanta të saj. Nëse krahasojmë strukturën kuptimore të një fjale të zakonshme dhe të një termi, vërejmë se kuptimi i termit

1 M. T. Cabré; J. A. DeCesaris & J. C. Sager (1999). Terminology: theory, methods and applications. Amsterdam; Philadelphia: John Benjamins.

2 J. Lyons (2010). Hyrje në gjuhësinë teorike. Tiranë: Dituria, f. 38.

përgjithësisht paraqitet mjaft i ngushtë e i kufizuar. Sipas terminologut Agron Duro kjo shpjegohet me vlerën funksionale të termit si emërtim i specializuar në një fushë të caktuar të shkencës e teknikës, që shërben për të shënuar një nocion apo dukuri të vetme[3]. Sipas Dubus (1985), teoria e terminologjisë dhe praktika e krijimit të termave, çon në dy pikëpamje të ndryshme: Njëra pikëpamje tregon se terminologjia është një disiplinë e ndarë, ndërkohë që pikëpamja tjetër thotë se terminologjia është pjesë përbërëse e disiplinave të tjera[4]. Nga ana tjetër Sager (1990), nuk i jep terminologjisë një status të pavarur, e megjithatë, pranon se ajo ka baza teorike në të cilat është bazuar praktika terminologjike.[5] Si një shkencë shumëdisiplinore, terminologjia është e vendosur në kryqëzimin mes një numri të madh disiplinash gjuhësore. Ajo është e lidhur ngushtë me të gjitha fushat e dijes e kësisoj ajo është e pandashme nga konteksti social dhe shkencor në të cilin ajo përdoret.

Lidhja e terminologjisë me gjuhën, gjuhësinë e aplikuar

Terminologjia është ndikuar nga marrëdhëniet që ajo ka me gjuhësinë e aplikuar, duke u bërë kështu degë e saj. Sipas Wuster (1981), gjuhësia e aplikuar shkon përtej gjuhësisë, me qëllim grumbullimin e dijeve në gjuhësi, për t'i bërë ato të dobishme[6]. Gjuhësia është studimi i gjuhës në të gjitha dimensionet e saj, shtrirë në thellësi dhe gjërësi në të gjitha disiplinat. Në shekullin XX, gjuhëtarët strukturalistë, i përshkruajnë gjuhët specifike, duke nxjerrë në mënyrë indirekte përfundime mbi disa aspekte të sjelljes dhe tipologjive të ndryshme gjuhësore. Saussure mendonte se, gjuha në tërësinë e saj duhet parë në aspektin sinkronik,

3 A. Duro (1986). Prirja për specializim e mjeteve të shprehjes në terminologji. Gjuha Jonë, 1986, f. 58.

4 R. Dubus. (1985). Manuel Pratique de Terminologie (Vol. 2nd ed). Brossard Quebec Linguatech.

5 J. C. Sager (1990). A Practical Course in Terminology Processing (Vol.(2nd ed)). Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins.

6 E. Wuster.(1981).L'etude scientifique generale de la terminologie, zone frontaliere entre la linguistique, la logique, l'ontologie. In "L'informatique et les sciences des choses" (pp.60- 81).Rondeau & Felber. choses" (pp. 60-81). Rondeau & Felbe

si një sistem elementesh gramatikorë, fonologjikë dhe leksikorë, të cilat kanë marrëdhënie të ndërsjella me njëri-tjetrin. Për sa i përket sistemeve terminologjike të kësaj fushe e konkretisht termave gjuhësore, ai ishte i qartë në përcaktimin e tyre: sipas tij këto terma duhet të përkufizohen jo të shkëputura nga njëra-tjetra, por të lidhura ngushtë mes tyre, pasi vetëm kështu ato veprojnë në gjuhë. Sipas tij: "Gramatika studion gjuhën si sistem mjetesh të shprehjes; kur thuhet gramatikor thuhet sinkronik dhe domethënës, e meqë asnjë sistem nuk mund të jetë i gjallë në disa epoka përnjëherë, s'ka për ne "gramatikë historike", ajo që quhet kështu në të vërtetë është vetëm gjuhësia diakronike"[7]. Nga ana tjetër, gjuhëtarët gjenerativistë, u përqendruan në përshkrimin e aftësive gjuhësore, individuale dhe jo në përshkrimin e gjuhëve specifike. Gjenerativizmi, si drejtim gjuhësor e studioi gjuhën në aspektin sinkronik të saj, ndërtoi rregulla për ndërtimin e frazave dhe e pa gjuhën në aspektin semiotik. Zhvillimi i gjuhës dhe teoritë e sotme gjuhësore bazohen më së shumti te gjenerativistët. Aspekti pragmatik i gjuhës në funksion të komunikimit, ka bërë që një pjesë e gjuhëtarëve të mos përqendrohen në rregullat kryesore të strukturës së gjuhës, por në parimet e përgjithshme të saj. Si pasojë, interesi i tyre është drejtuar në praktikimin konkret e natyror të gjuhës. Gjuhësia e aplikuar e studion gjuhën si një strukturë e mjet komunikimi, si një rrugë për të zgjidhur nevojat komunikuese e informuese të shoqërisë. Rëndësia gjithnjë në rritje e shkencës së aplikuar ka luajtur një rol konkret në ndryshimin e sjelljes gjuhësore të folësve. Pragmatizmi është një tipar që dominon sjelljen gjuhësore. Kjo sjellje e re sociale dhe gjuhësore ka ndikuar edhe zhvillimin e fushave të tjera brenda gjuhësisë së aplikuar si mësimdhënia, gjuhësia e vlerësuar, leksikografia dhe terminologjia.

Padyshim, terminologjia si disiplinë, është një nga degët më të privilegjuara të gjuhësisë së aplikuar. Nga kjo pikëpamje ajo vërtet mund të klasifikohet si

7 F. de Saussure (2002). Kursi i gjuhësisë së përgjithshme. Tiranë: Dituria f. 152-154.

pjesë e shkencave të aplikuara, por që ka bërë një të vetme teorinë me praktikën. Ky fakt vihet re në ndërtimin e fjalorëve leksikorë, të cilët janë rezultatet më të fundit të saj[8]. Në këtë kontekst terminologjia lidhet ngushtë me leksikologjinë dhe leksikografinë dhe në këtë mënyrë qëllimi i terminografëve është emërtimi i koncepteve, duke u zhvendosur nga koncepti në term (i cili është një proces onomastik), kurse leksikografët fillojnë me fjalët duke e përkufizuar termin nga ana funksionale dhe semantike (i cili është një proces semasiologjik). E parë në këtë këndvështrim si terminologjia ashtu edhe leksikologjia vendosin fjalën në qendër të formimit të termit, por ato ndryshojnë në mënyrën se si sillen ndaj objektit të studimit, në metodologjinë që përdorin, në mënyrën se si i prezantojnë termat si dhe në plotësimin e kushteve që duhen për të ndërtuar një term të ri pavarësisht fushës së dijes e të shkencës. Terminologjia lidhet ngushtë edhe me logjikën. Ajo ndan me të një interes të përbashkët për konceptet, në dallim me semantikën, e cila është më së shumti e interesuar për marrëdhëniet emërtim-kuptim. Terminologjia është e interesuar për marrëdhëniet mes koncepteve dhe objekteve në botën reale, ndërsa logjicienët nëpërmjet një procesi përgjithësues abstrakt, kalojnë nga objekte të veçanta të botës reale, në hartimin e koncepteve përgjithësuese për një klasë të tërë objektesh. Terminologjia ndan me ontologjinë një interes të përbashkët për sa i përket natyrës së sendeve dhe marrëdhënieve të krijuara me botën reale. Në kundërshtim me marrëdhëniet e terminologjisë me logjikën, këto marrëdhënie nuk fillojnë nga ngjashmëria midis koncepteve, por nga konteksti dhe pozicioni i tyre në botën e vërtetë[9]. Terminologjia si sistem termash specifikë është pjesë përbërëse e çdo fushe të dijes, shkencës dhe veprimtarisë prodhuese, por gjuhësia ka për detyrë të bëjë identifikimin, përpunimin dhe kodifikimin e termave përkatës brenda një sistemi terminologjik. Sipas Duros,

8 G. Roger (1985). La science terminologique. In T. e.Traduction, f. 10-16.

9 T. M. Cabre (1998). Terminology, theory, methods. Amsterdam/Philaadelphia: John Benjamins Publishing Compa-ni, f. 7-12.

identifikimi i një terminologjie si sistem, bëhet i plotë dhe i qartë vetëm kur shihet në rastin e funksionimit të termave që e përbëjnë atë, si shënues të koncepteve të një fushe të veçantë të dijes[10]. Në këtë konstatim Duro sigurisht e ka fjalën për të gjitha sistemet terminologjike pavarësisht fushave të dijes dhe shkencës, duke treguar qartazi e duke i dhënë kësaj çështjeje një sfond gjuhësor, mbi të gjitha duke treguar realisht rolin që ka gjuha në sistemin e terminologjisë. Edhe studiuesja Hëna Pasho lidhur me këtë marrëdhënie shkon më tej duke theksuar se terminologjia si pjesë përbërëse e proceseve dhe funksioneve të degëve të ndryshme të veprimtarisë njerëzore, është mjaft e rëndësishme pasi merr pjesë në sintezën dhe përgjithësimin e dijes mbi thelbin e sendeve, dukurive dhe proceseve në natyrë dhe shoqëri dhe, si pjesë e gjuhësisë së zbatuar, çon përvojën e gjuhësisë në këto degë duke pasqyruar mënyrën sipas së cilës organizohen dhe saktësohen nocionet[11]. Parë në një këndvështrim historik e të shtrirë në kohë, vërehen disa përkufizime për terminologjinë, përvijuar sipas interesit të shkencëtarëve, të cilat sipas Tereza M Cabre përmblidhen si më poshtë[12]:

- për specialistët terminologë, terminologjia është një reflektim formal i organizimit konceptual të një fushe të caktuar dhe një nevojë e shprehjes special dhe komunikimit profesional.

- për përdoruesit e saj, pavarësisht fushës së dijes, terminologjia është një fushë ku vendosen njësitë komunikuese praktike, të cilat janë hartuar sipas kriterit ekonomik, preciz dhe të përshtatshëm, në shkencë, teknikë, dije dhe teknologji.

- për planifikuesit e gjuhës, terminologjia është një fushë që kërkon ndërhyrje përmes mekanizmave gjuhësorë, për të siguruar kuptueshmërinë e termave, efektivitetin e vlefshmërinë e tyre, vazhdimësinë e mbijetesën, të cilat mund të

10 A. Duro (2009). Termi e fjala në gjuhën shqipe. Tiranë: Sh. B. Fan Noli, f. 19.

11 H. Pasho (2003). Terminologjia tekniko-shkencore dhe vendi i saj në shqipen standarde. Tiranë, f. 287.

12 T. M. Cabre (1998). Terminology, theory, methods. Amsterdam/Philaadelphia: John Benjamins Publishing Company.

realizohen nëpërmjet procesit të modernizimit.

Për gjuhëtarët, terminologjia është një pjesë e fjalorit të gjuhës, e leksikut, që përcaktohet nga përmbajtja specifike e çështjes, temës dhe përdorimi pragmatik i saj.

Siç shihet nga përkufizimet e mësipërme, terminologjia si shkencë ndikon dhe shërben njëkohësisht në të gjitha fushat e dijes me leksikun specifik dhe përmbajtjen e larmishme konceptore.

Lidhur me këto përcaktime dallohen edhe dy grupe të mëdha përdoruesish të terminologjisë:

- Përdoruesit, të cilët e përdorin terminologjinë në komunikimin e drejtpërdrejtë ose të ndërmjetëm për qëllime shkencore e teknike.

- Terminologët, të cilët hartojnë fjalorë, ndërtojnë terma sipas fushave të caktuara të dijes duke ndihmuar kështu komunikimin e specializuar të komunitetit të shkencëtarëve, dijetarëve dhe teknicienëve.

Sipas nevojave të këtyre dy grupeve, përcaktohen edhe dy dimensionet e terminologjisë: dimensionin komunikativ dhe dimensionin gjuhësor, të cilat janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin.

Lidhja e terminologjisë me komunikimin dhe komunikimin e specializuar

Komunikimi është një proces që realizon bashkëveprimin ndërmjet njerëzve duke dhënë e duke marrë informacion. Komunikimi i specializuar ndryshon nga komunikimi i përgjithshëm në dy aspekte: në llojin e tekstit të shkruar e të folur që ai prodhon dhe në përdorimin e një terminologjie specifike. Pra, siç shihet, komunikimi i specializuar ka të bëjë me bashkëveprimin, dhënien e marrjen e informacioneve mes specialistëve të fushave të ndryshme të dijes, teknikës, shkencës etj. Në këtë

kontekst, kriteret që përdoren për të hartuar tekstet e specializuara, ndryshojnë krejtësisht me ato që përdoren në tekstet e një komunikimi të përgjithshëm. Në tekstet e specializuara, kriteret bazë të hartimit të tyre janë: konciziteti, saktësia dhe përshtatshmëria, ndërsa në tekstet e një komunikimi të përgjithshëm kriteret bazë janë origjinaliteti dhe shprehja e rrjedhshme. Një tekst i specializuar ose shkencor duhet të jetë konciz, pasi vetëm kështu shmanget mundësia e shtrembërimit të fakteve shkencore dhe informacionit. Ai gjithashtu, duhet të jetë i saktë për shkak të natyrës shkencore, termave teknikë, të cilat realizojnë lidhjen funksionale e të dobishme mes specialistëve të fushave të ndryshme. Rrjedhimisht, ai duhet të jetë i përshtatshëm për situatat komunikative për të cilat është prodhuar, në përputhje me nivelin e dijeve duke përfshirë në brendësi të tij ajo që është e nevojshme e duke lënë jashtë informacionin e tepërt. Sigurisht, që terminologjia luan një rol të rëndësishëm në hartimin e këtyre teksteve përmes tre proceseve:

- termat origjinalë që përdoren për të emërtuar një koncept të specializuar duhet të jenë koncizë.

- përdorimi i një termi të vetëm në vend të një fraze të tërë, ndihmon në saktësinë e dhënies së informacionit shkencor

- përdorimi i terminologjisë së standardizuar, është një nga mjetet efikase që specialistët e përdorin si sistem referimi në një fushë të caktuar.

Duhet thënë se çdo lloj teksti ka edhe karakteristika të përgjithshme edhe të veçanta, të cilat kanë të bëjnë me përdorimin specifik e të përgjithshëm të gjuhës. Kështu, tiparet e përgjithshme si të tekstit të specializuar, ashtu edhe të tekstit të përgjithshëm janë:

a. Në të dy tekstet përdoret i njëjti sistem grafik i shprehjes dhe i njëjti alfabet.

b. Në të dy tekstet përdoret i njëjti sistem fonologjik, njësitë fonologjike janë të njëjta në secilin rast.

c. Në të dy tekstet përdoret i njëjti sistem morfologjik.

d. Në të dy tekstet përdoren të njëjtat rregulla sintaksore për ndërtimin e frazave dhe fjalive.

Përsa u përket ndryshimeve gjuhësore që vërehen mund të themi se:

a. Fjalët që përdoren në tekstet e komunikimit të përgjithshëm janë më të lehta për t'u kuptuar se sa fjalët që përdoren në tekstet e komunikimit të specializuar.

b. Disa struktura dhe kategori gjuhësore shfaqin më tepër përdorim në tekstet speciale, shkencore, se sa në tekstet e përgjithshme, siç janë; strukturat morfologjike, që për nga ndërtimi bazohen në traditën greke dhe latine; shkurtimet dhe simbolet; emërtimet, bazuar në shprehjet foljore, etj.

c. Strukturë e hapur e fjalisë me pjesë nënrenditëse, për t'i dhënë fjalisë karakter shpjegues[13].

Për sa u përket ndryshimeve gjuhësore që vërehen mund të themi se:

a. Fjalët që përdoren në tekstet e komunikimit të përgjithshëm janë më të lehta për t'u kuptuar se sa fjalët që përdoren në tekstet e komunikimit të specializuar.

b. Disa struktura dhe kategori gjuhësore shfaqin më tepër përdorim në tekstet speciale, shkencore, se sa në tekstet e përgjithshme, siç janë ; strukturat morfologjike, që për nga ndërtimi bazohen në traditën greke dhe latine; shkurtimet dhe simbolet; emërtimet, bazuar në shprehjet foljore, etj.

c. Strukturë e hapur e fjalisë me pjesë nënrenditëse, për t'i dhën fjalisë karakter shpjegues[14].

Siç shihet, roli i terminologjisë në komunikim është mjaft i dobishëm. Veçanërisht në komunikimin e specializuar mes shkencëtarëve, përfaqësuesve të fushave të ndryshme të dijes, shkencës, teknologjisë etj. Zhvillimi i komunikimit

13 T. M. Cabre (1998). Terminology, theory, methods. Amsterdam/Philaadelphia: John Benjamins Publishing Compa-ni, f. 46-73.

14 T. M. Cabre (1998). Terminology, theory, methods. Amsterdam/Philaadelphia: John Benjamins Publishing Compa-ni, f. 46-73.

në masë, nga ana tjetër, lejon shtrirjen dhe përhapjen e terminologjisë me pasojë bashkëveprimin mes fjalorëve të përgjithshëm e të specializuar. Dita-ditës, termat specifikë në fusha të ndryshme, po bëhen pjesë e kulturës popullore si rezultat i përdorimit në masë të tyre. Zhvillimi i shkencës dhe i teknikës në ditët e sotme, është shoqëruar me një numër të madh konceptesh e fusha konceptuale të cilat, vazhdimisht nxjerrin nevojën e emërtimeve të reja. Qëllimi i terminologjisë është komunikimi ekzakt dhe efektiv që realizohet përmes profesionalistëve, të cilët kanë si prioritet të tyre përdorimin e gjuhës shkencore dhe teknike. Duhet thënë se, vetëm kohët e fundit, studimet terminologjike janë përmbledhur në një shkencë të vetme e pozicionuar brenda shkencave sociale dhe humane. Këto studime terminologjike janë në funksion të situatës dhe rëndësisë së kontekstit të komunikimit, me një gjuhë speciale dhe efikas. Pra, mund të themi se, roli i terminologjisë në komunikim është mjaft i dobishëm. Veçanërisht në komunikimin e specializuar mes shkencëtarëve, përfaqësuesve të fushave të ndryshme të dijes, shkencës, teknologjisë etj. Zhvillimi i komunikimit në masë, nga ana tjetër, lejon shtrirjen dhe përhapjen e terminologjisë me pasojë bashkëveprimin mes fjalorëve të përgjithshëm e të specializuar. Dita- ditës, termat specifikë në fusha të ndryshme, po bëhen pjesë e kulturës popullore si rezultat i përdorimit në masë të tyre. Zhvillimi i shkencës dhe i teknikës në ditët e sotme, është shoqëruar me një numër të madh konceptesh e fusha konceptuale të cilat, vazhdimisht nxjerrin nevojën e emërtimeve të reja. Qëllimi i terminologjisë është komunikimi ekzakt dhe efektiv që realizohet përmes profesionistëve, të cilët kanë si prioritet të tyre përdorimin e gjuhës shkencore dhe teknike.

Si përfundim, terminologjia ka lidhje të ngushta me fushat specifike të dijes, shkencës e teknikës e nuk ka një fund. Terminologjia është në shërbim të shkencës, teknologjisë dhe komunikimit. Specialistët e fushës, në përgjithësi terminologët,

punojnë së bashku për të bërë të mundur renditjen dhe standardizimin e koncepteve dhe termave në fusha të ndryshme. Zhvillimi aktual i terminologjisë është rezultat jo vetëm i bashkëpunimit të dijetarëve në të gjitha fushat, por edhe i zhvillimeve të teknologjisë dhe kërkesës gjithnjë në rritje të nevojës për komunikim të specializuar në gjuhë të ndryshme.

Bibliografia

A. Duro (1986). Prirja për specializim e mjeteve të shprehjes në terminologji. Gjuha Jonë, Tiranë.

A. Duro (2009). Termi e fjala në gjuhën shqipe. Tiranë: Sh. B. Fan Noli.

E. Wuster (1981). L'etude scientifique generale de la terminologie, zone frontaliere entre la linguistique, la logique, l'ontologie. In "L'informatique et les sciences des choses" (pp.60- 81). Rondeau & Felber.

F. de Saussure (2002). Kursi i gjuhësisë së përgjithshme. Tiranë: Dituria.

G. Roger (1985). La science terminologique. In T. e. Traduction.

H. Pasho (2003).Terminologjia tekniko-shkencore dhe vendi i saj në shqipen standarde, Tiranë.

J. C. Sager (1990). A Practical Course in Terminology Processing (Vol. (2nd ed)). Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins.

J. Lyons (2010). Hyrje në gjuhësinë teorike. Tiranë: Dituria.

R. Dubus (1985). Manuel Pratique de Terminologie (Vol. 2nd ed). Brossard Quebec Linguatech.

T. M. Cabre (1998). Terminology, theory, methods. Amsterdam/Philaadelphia: John Benjamins Publishing Company.

T. M. Cabré; J. A. DeCesaris & J. C. Sager (1999). Terminology: theory, methods and applications. Amsterdam; Philadelphia: John Benjamins.

Anton Pançev

Njësimi dhe përkthimi i disa termave në shqip sipas dispozitave të Traktateve me Greqinë dhe Bullgarinë[1]

Abstrakt

Traktatet e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Greqinë (nënshkruar më 12 qershor 2018) dhe me Bullgarinë (nënshkruar më 1 gusht 2017), detyrojnë institucionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut të pranojnë dhe të zbatojnë në sferën publike rregulla rreth përdorimit të termave "Maqedonia e Veriut" dhe mbiemrave përkatës. Këto dispozita janë përfshirë edhe në dokumente të ndryshme të BE-së, në të cilat kërkohet përdorimi i përpiktë i terminologjisë përkatëse që buron nga këto traktate. Termat prej gjuhës maqedonase sipas Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë së Veriut duhet të përkthehen në mënyrë të saktë edhe në shqip që të zbatohen në mënyrë të përpiktë dhe plotësisht detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e këtyre dokumenteve ndërkombëtare, sepse gjuha shqipe është gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky punim do të merret me analizën e këtyre termave të përfshirë në Traktatin për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim ndërmjet Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe në Traktatin e Prespës ndërmjet Republikës së Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, si edhe në dokumente të BE-së dhe do të propozohen përkthime në gjuhën shqipe.

Fjalë çelës: *Republika e Maqedonisë së Veriut, traktate, BE, shqip*

1 Ky punim është realizuar në kuadër të projektit "Bullgarët në Ballkanin Perëndimor (100 vite para dhe pas Traktatit të Njojit)", Fond "Hulumtime Shkencore" № КП-06-Н30/5

Hyrje

Çështja e gjuhës zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka shumë dimensione dhe në një mënyrë esenciale i prek edhe marrëdhëniet e vendit me Republikën e Bullgarisë. Dihet shumë mirë se Bullgaria i ka dhënë mbështetje aktive fqinjit të saj jugperëndimor për pavarësinë dhe stabilitetin shtetëror. Më 15 janar 1992, Sofja e njohu e para pavarësinë e Republikës së Maqedonisë, kurse në muajt në vijim ka ndihmuar për njohjen e saj nga vendet e tjera si Federata Ruse[2]. Pavarësisht politikës miqësore bullgare, udhëheqësit e Republikës së Maqedonisë kanë bërë përpjekje të vazhdueshme të shkaktojnë "debatin e gjuhës" ndërmjet dy vendeve. Më 14 prill 1994, gjatë vizitës së ministrit bullgar të arsimit ata refuzuan të nënshkruanin dokumentet zyrtare sipas formulimit të dakorduar paraprakisht dhe të zbatuar disa herë sa u përket gjuhëve zyrtare të të dyja vendeve[3]. Pas disa ditësh, presidenti Kiro Gligorov, gjatë vizitës së tij në Sofje, gjithashtu nuk i ka nënshkruar marrëveshjet e përpunuara dypalëshe, duke këmbëngulur për formulimin: "gjuhë bullgare dhe ajo maqedonase". Me këto veprime Republika e Maqedonisë këmbënguli në dokumentet dypalëshe, në mënyrë formale dhe zyrtare, të deklaro-hej mëvetësia e gjuhës së saj zyrtare në lidhje me bullgarishten dhe kështu u bllokua nënshkrimi i bazës juridike dhe kontraktuale të marrëdhënieve dypalëshe, që kishin hyrë gjatë periudhës pesëvjeçare të stagnimit. Opozita e atëhershme rreth VMRO-DPMNE i kuptoi pasojat negative për vendin e tyre për shkak të kësaj politike. Pas fitores zgjedhore në vjeshtën e vitit 1998, me pjesëmarrjen aktive të zëvendës ministrit të punëve të jashtme Boris Trajkovski, më vonë president i shtetit, u arrit pajtimi në lidhje me tekstin e dokumentit të përbashkët bazik, me të cilin u zgjidh mosmarrëveshja e gjuhës. Formulimi i dakorduar ishte për "gjuhët zyrtare të dy vendeve – gjuha

2 Георги Николов etj. За официалния език на Република Северна Македония, 2020, Sofje, f. 53.
3 Po aty.

bullgare, sipas Kushtetutës së Republikës së Bullgarisë, dhe gjuha maqedonase, sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë". Kështu u realizua Deklarata e Përbashkët e kryeministrave, nënshkruar nga Ivan Kostovi dhe Ljupço Georgievski, më 22 shkurt 1999, e cila zyrtarizoi dhe ngriti në një nivel më të lartë marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve në gati dy dekadat pasuese. Ajo u inkorporua edhe në Traktatin e miqësisë, fqinjësisë së mirë dhe të bashkëpunimit ndërmjet të dy vendeve, nënshkruar më 1 gusht 2017 në Shkup. Me këtë formulim, afirmuar dhe pranuar në mënyrë të përbashkët në dokumentet dypalëshe dhe shumëpalëshe, shfaqet respekti ndaj normës gjuhësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në cilësinë e saj juridike, që rrjedh nga Kushtetuta e vendit[4].

Marrëveshjet ndërmjet Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me gjuhën

Deklarata nga 22 shkurt 1999

Pikërisht me Traktatin e Prespës, RMV bën përpjekje që t'ia imponojë Bullgarisë formulimin për gjuhën, që mungon në Deklaratën e 22 shkurtit 1999, nënshkruar nga kryeministrat e atëhershëm L. Georgievski dhe I. Kostov, dhe rikonfirmuar me Memorandumin e përbashkët nga 22 janar 2008. Sipas këtyre dokumenteve, që pala maqedonase i ka nënshkruar dhe të cilat duhet t'i marrë në konsideratë, të gjitha dokumentet ndërmjet të dy vendeve duhej të nënshkruheshin në gjuhët zyrtare sipas Kushtetutave të tyre. Traktati i Prespës është marrëveshje ndërmjet RMV-së dhe Greqisë, dhe në asnjë mënyrë nuk e prek dhe nuk e detyron Bullgarinë. Për këtë arsye, gjendja, fiksuar në Deklaratën e vitit 1999 dhe në Memorandumin e vitit 2008, duhet të mbetet kështu, siç ishte vendosur, pa tejkalimin e kufijve zyrtarë[5].

4 Po aty, f. 54.

5 Спас Ташев etj. Бяла книга за езиковия спор между България и Република Северна Македония, 2021, Sofje, f. 16.

Traktati i miqësisë nga data 1 gusht 2017

Formulimi i klauzolës gjuhësore në Traktatin e miqësisë është në vijë të kësaj strategjie. Ai është nënshkruar në dy ekzemplarë në secilën prej gjuhëve zyrtare të palëve – në bullgarisht sipas Kushtetutës së Republikës së Bullgarisë, dhe në maqedonisht sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Kuadrat e Pozicionit në lidhje me zgjerimin e Bashkimit Evropian dhe me Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit: Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipëria[6]

- Republika e Maqedonisë së Veriut të deklarojë me një notë verbale deri te vendet anëtare të OKB-së se respektimi i ndryshimeve të bëra në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me Marrëveshjen e Prespës do të realizohet paralelisht me respektimin e përpiktë të Traktatit me Republikën e Bullgarisë në tërësinë e tij, përfshirë edhe sa i përket "klauzolës gjuhësore" të Traktatit;

- në këtë notë të thuhet se përdorimi i emrit të shkurtër, sipas Marrëveshjes së Prespës, i referohet vetëm subjektit politik Republika e Maqedonisë së Veriut, dhe jo sa i përket rajonit gjeografik Maqedonia e Veriut, një pjesë prej të cilit ndodhet në kufijtë e Bullgarisë;

- në lidhje me gjuhën të përdoret fraza "gjuhë zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Kur përdorimi i termit "gjuhë maqedonase" në dokumente dhe në pozicione të BE-së është absolutisht i nevojshëm, me një yll si fusnotë, duhet të sqarohet çdo herë – "sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut". Duhet të jetë qartë se norma gjuhësore, shpallur për gjuhë kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është lidhur me evolucionin e gjuhës bullgare dhe të të

6 Kuvendi i Republikës së Bullgarisë pranoi më 10 tetor 2019 "Deklaratë e Kuvendit të Dyzetë e Katërt Populllor në lidhje me Zgjerimin e Bashkimit Evropian dhe me Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Republikës së Shqipërisë", https://parliament.bg/bg/declaration/ID/157188, qasja e fundit më 6 tetor 2021.

folmeve të saj në republikën e dikurshme jugosllave pas kodifikimit të tyre pas vitit 1945. Asnjë dokument/deklaratë gjatë procesit të anëtarësimit nuk mund të shqyrtohet si njohje nga ana bullgare e ekzistimit të ashtuquajturën "gjuhë maqedonase", që është e veçantë nga bullgarishtja.

Këto kërkesa të Bullgarisë janë paraqitur dhe janë miratuar nga BE-ja në shumë dokumente (shih për shembull: Përfundime të Këshillit sa i përket zgjerimit dhe procesit të stabilizimit dhe të asociimit, 18 qershor 2019; Këshilli i Bashkimit Evropian, Luksemburg, 15 tetor 2019, 13155/19; Këshilli i Bashkimit Evropian, Bruksel, 17-18 tetor 2019, EUCO 23/19; Këshilli i Bashkimit Evropian, Bruksel, 1 korrik 2020, 8581/20, ENLARGEMENT − Accession negotiations with the Republic of North Macedonia).

Diskutimi i çështjes së gjuhës në takimet zyrtare

Gjatë takimeve të kryeministrit Zoran Zaev me presidentit Rumen Radev dhe me kryeministrin Stefan Janev më 17 qershor 2021, si edhe gjatë bisedimeve ndërmjet ministrave të punëve të jashtme Svetllan Stoev dhe Bujar Osmani, nga ana e Republikës së Maqedonisë së Veriut u shpreh gatishmëri për realizimin e këtyre angazhimeve:

- Në afate më të shkurtra kohore Shkupi të konfirmojë para OKB-së, në përputhje me nenin 11, p. 3 të Traktatit për fqinjësi të mirë, se emërtimi i shkurtër dhe i gjatë i vendit, i referohet vetëm subjektit politik "Republika e Maqedonisë së Veriut", por jo edhe të rajonit gjeografik "Maqedonia e Veriut", një pjesë prej të cilit ndodhet në kufijtë sovranë të Bullgarisë. Menjëherë pas dërgimit të kësaj Note Verbale, Bullgaria do të pushojë të insistojë për përdorimin vetëm të emrit të gjatë "Republika e Maqedonisë së Veriut", në BE dhe në organizatat ndërkombëtare;

- Republika e Maqedonisë së Veriut t'i përmbahet në mënyrë të përpiktë

klauzolës që është vendosur dhe është ratifikuar nga parlamentet e të dyja vendeve sa i përket gjuhës zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo klauzolë të gjejë realizimin përkatës në dokumentet zyrtare të Bashkimit Evropian[7].

Premisat shkencore

Nga pikëpamje formale "njohja" e "gjuhës maqedonase" nga Sofja zyrtare paraqet një çështje relativisht të lehtë (edhe pse kërkesa e Shkupit për "njohjen e gjuhës së tyre" është mjaft e çuditshme, sepse në të drejtën ndërkombëtare ky parim nuk ekziston dhe këto veprime tregojnë qartë politizimin e skajshëm të kësaj teme). Dikush mund të thotë se krijimi i një gjuhe të re mund të bëhet pa probleme nga çdo formë dialektore ose nga çdo të folme e ndonjë gjuhe. Një gjuhëtar i shkathët mund ta realizojë këtë "detyrë" për disa javë. Në këtë lidhje, ka mjaft argumente të pastra gjuhësore, të cilat mund të provojnë se "gjuha maqedonase" po ekziston. Midis bullgarishtes dhe gjuhës zyrtare të Republikës të Maqedonisë së Veriut në dekadat e fundit mund të vërehen dallime të ndryshme në fonetikë, në leksikë etj., kryesisht për shkak të serbizimit të qëllimshëm të normës letrare maqedonase nën presionin e Serbisë gjatë kohës jugosllave.

Por prapë se prapë, pse pala bullgare nuk pranon një situatë deri diku objektive në këtë rast? Përgjigja duhet kërkuar në tre drejtime.

Së pari, në kontekstin shkencor të krijimit të "gjuhës maqedonase", së dyti, në kontekstin e thellë historik dhe të identitetit, dhe, së treti, në kontekstin e të drejtave të njeriut. Krijimi i "gjuhës maqedonase" ka filluar zyrtarisht në fund të vitit 1944 dhe ka vazhduar në vitet pasuese me mjetet dhe veglat politike të Partisë komuniste të Jugosllavisë dhe të shtetit jugosllav (serb). Kështu "gjuha maqedonase" u krijua në mënyrë tepër artificiale me qëllim kryesor të largohej sa

7 "Qëndrimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme sa i përket perspektivës evropiane të Repubikës së Maqedonisë së Veriut", https://www.mfa.bg/bg/news/30248, qasja e fundit më 6 tetor 2021.

është e mundshme nga bullgarishtja[8]. Por ky fakt nuk është gjëja më e rëndësishme në këtë debat.

Së dyti, duke e kërkuar nga Bullgaria "njohjen zyrtare të gjuhës maqedonase", përfaqësuesit e Maqedonisë së Veriut thjesht pretendojnë ta "përvetësojnë" kulturën, shkrimin, letërsinë dhe në fund të fundit historinë bullgare nga Mesjeta deri shekullin e XX. Si e bëjnë? Po thonë se "gjuha maqedonase" paska ekzistuar që nga Mesjeta dhe letërsia bullgare, shkruar nga Shën Kliment Ohridski[9] dhe qindra shkrimtarë pas tij, i takonte "letërsisë dhe kulturës maqedonase"! Por të gjithë autorët prej kësaj zone, që kanë shkruar në ndonjë dialekt të bullgarishtes, nga Mesjeta, nga Rilindja, nga gjysma e parë e shek. XX, madje një pjesë edhe nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar, kanë deklaruar shumë qartë (shihet edhe në titujt e librave të tyre së paku)[10] që janë bullgarë dhe punojnë për kauzën kombëtare bullgare. Bullgaria dhe populli bullgar nuk mund të lejojnë që me njohjen e "gjuhës maqedonase", në këto rrethana dhe prapavija politike, të shkatërrohet historia dhe kultura bullgare.

Së treti, ka shkrimtarë dhe intelektualë nga Maqedonia e Veriut, si Venko Markovski, Mlladen Sërbinovski, Mile Nedellkovski etj., që shkruajnë në këtë normë, por e vlerësojnë si variant i bullgarishtes[11].

Çdo formulë për "gjuhën maqedonase" dhe për terminologjinë e saj duhet të bazohet mbi të vërtetat historike dhe kulturore, sepse standardizimi i një gjuhe është punë komplekse dhe zë vend të rëndësishëm në proceset historike dhe në identitetin e kombeve. Të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së

8 Shih p.sh. Спас Ташев etj. Бяла книга за езиковия спор между България и Република Северна Македония, 2021, Sofje, f. 57-80.

9 Për jetën dhe veprat e Shën Klimentit ka shumë burime të huaja – bizantine, perëndimore dhe sllave që gjithmonë e tregojnë karakterin e tij bullgar. Shih p.sh. H. Delehaye. Synaxarium Ecclesiae Constatinopolitanae. Propylaeum ad ASS. Novembris, Bruxelles, 1902, col. 255-256 – origjinali është në greqisht.

10 Shih shtojcat ku janë paraqitur kopertina nga veprat origjinale të vëllezërve Dimitër dhe Konstantin Milladinov, Kuzman Shapkarev dhe Jordan Haxhikonstantinov. Fotot janë marrë nga: Спас Ташев etj. Бяла книга за езиковия спор между България и Република Северна Македония, 2021, Sofje, f. 91, 103, 105.

11 Mlladen Sërbinovski: "I shkruaj librat e mi në formën zyrtare maqedone – një gjuhë që thjesht është njëri prej dialekteve të bullgarishtes". Në "Македонизмът и съвестта на писателя", gazeta "Trud", 27.11.2020.

Veriut duhet të kenë të drejta të barabarta politike dhe kulturore. Disa prej tyre që dëshirojnë ta quajnë gjuhën e tyre "maqedonisht", e kanë plotësisht këtë të drejtë. Por edhe këta prej tyre që dëshirojnë të njëjtin standard gjuhësor ta quajnë "bullgarisht", e kanë të njëjtën të drejtë. Politikanët prej të dy vendeve duhet të përpunojnë formulën e nevojshme politike dhe juridiko-kushtetuese. Nuk mund të pranohet ideja se kombet dhe gjuhët "krijohen" në data të caktuara, me vendime politike, nga njerëz, grupacione, parti ose institucione të caktuara

Është e pakuptueshme të mendohet se kombe dhe gjuhë "të reja" (pikërisht në Evropë) gjatë shekullit XX mund të jetësohen përmes ndarjes së kombeve dhe të gjuhëve të vjetra me histori mijëvjeçare. Gjithashtu edhe ideja se mund të barazohen shteti, kombi dhe gjuha ose më konkretisht, se kombi dhe gjuha janë "atribute të shtetit", është tepër e vjetruar në shekullin tonë. Derisa ideja se kombi dhe gjuha janë realitete politike, por jo etnologjike, çon deri në shtrembërime të rënda shkencore[12]. Ideja se kombi dhe gjuha duhet "të njihen" në të njëjtën mënyrë si njihet shteti, shkakton kriza me fqinjët dhe rrezikon pozicionet e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare[13].

Konkluzione:

Së pari, Republika e Maqedonisë së Veriut duhet t'i përmbushë detyrimet që burojnë nga traktatet dypalëshe me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian;

Së dyti, zhvillimi i shkencës duhet të jetë sipas rregullave shkencore dhe jo sipas ideologjive dhe qëllimeve politike;

Së treti, ka kaluar koha që të krijohen identitete përmes instrumenteve të politikës shtetërore. Në vend të parë duhet të jenë të drejtat e njeriut.

12 Македонски научен институт. Меморандум на МНИ-София във връзка с взаимоотношенията между Р България и Р Македония по повод на езиковия спор, 1997, Sofje, f. 3.
13 Po aty, f. 4.

Përfundime – përdorimi i termave të lidhura me emrin e shtetit në shqip

Termat prej gjuhës maqedonase sipas Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë së Veriut duhet të përkthehen në mënyrë të saktë edhe në gjuhën shqipe që të zbatohen në mënyrë të përpiktë dhe plotësisht, detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e këtyre dokumenteve ndërkombëtare, sepse gjuha shqipe është gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe pas një periudhe të shkurtër do të ketë statut plotësisht të barabartë me gjuhën e Maqedonisë së Veriut sipas Kushtetutës së shtetit.

Në shqip do të ishte mirë të përdoren format:

Republika e Maqedonisë së Veriut – forma e plotë;

R. Maqedonia e Veriut – me shkurtesë të fjalës së parë;

Maqedonia e Veriut – është e lejueshme për shkak të shkurtësisë.

Nuk është në rregull të përdoret:

Maqedonia – sepse ky emërtim përdoret për krahinën më të madhe gjeografike dhe në ndonjë mënyrë do t'i legjitimonte pretendimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi pjesët e Maqedonisë së Pirinit dhe të Maqedonisë së Egjeut, që ndodhen në Bullgari dhe në Greqi respektivisht.

Si të përpunohet mbiemri përkatës në shqip që buron nga emri i shtetit, pra Republika e Maqedonisë së Veriut?

Përdorimi i mbiemrit "maqedonas" duhet të jetë për emërtime të lidhura me historinë, me kulturën dhe me hapësirën e tërë krahinës gjeografike të Maqedonisë, që përfshinte territore që sot ndodhen edhe në Bullgari, edhe në Greqi. Në disa kontekste, përdorimi i këtij mbiemri për emërtime, që janë të lidhura vetëm me Republikën e Maqedonisë së Veriut (Republika e Maqedonisë, 1991-2018), do të krijonte përshtypje se mund të ketë pretendime mbi territore, personalitete, fakte

dhe dukuri historiko-kulturore që është në kundërshtim të plotë me të vërtetën historike;

Mbiemri i natyrshëm në raste të tilla, që e trajtojnë periudhën bashkëkohore, do të ishte "veriomaqedonas" që të mos ketë keqkuptime jo vetëm sa i përket prejardhjes së personaliteteve të caktuara, por edhe në marrëdhëniet ndërshtetërore.

Bibliografia

Георги Николов и други. За официалния език на Република Северна Македония. София, 2020.

Македонски научен институт. Меморандум на МНИ-София във връзка с взаимоотношенията между Р България и Р Македония по повод на езиковия спор. София, 1997.

Спас Ташев и други. Бяла книга за езиковия спор между България и Република Северна Македония, 2021, София.

Documents and Materials on the History of the Bulgarian People. Sofia, 1969.


Shtojcat:

1) "Këngë popullore bullgare" nga Dhimitër dhe Konstantin Milladinov, Zagreb, 1861.

2) "Përmbledhje nga urthësitë popullore bullgare" nga Kuzman Shapkarev, Sofje, 1891.

3) "Shkrimi bullgar" nga Jordan Haxhikonstantinov, Stambull, 1852.

Burimi: Спас Ташев etj. Бяла книга за езиковия спор между България и Република Северна Македония, 2021, Sofje, f. 91, 103, 105.


НАРОДНА БИБЛИОТЕКА

БЪЛГАРСКИ

НАРОДНИ ПѢСНИ

СОБРАНИ

ОТЪ

БРАТЬЯ МИЛАДИНОВЦИ

ДИМИТРІЯ И КОНСТАНТИНА


И ИЗДАНИ ОТЪ

КОНСТАНТИНА

ВЪ ЗАГРЕБЪ

ВЪ КНИГОПЕЧАТНИЦА-ТА НА А. ЯКИЧА.

1861.


СБОРНИКЪ

ОТЪ

БЪЛГАРСКИ НАРОДНИ УМОТВОРЕНИЯ.

ЧАСТЬ ПЪРВА.

ПРОСТОНАРОДНА БЪЛГАРСКА ПОЕЗИЯ

ИЛИ

БЪЛГАРСКИ НАРОДНИ ПѢСНИ.

ОТДѢЛЪ III

(Продължение)

КНИГА IV.

ПѢСНИ ИЗЪ ПОЛИТИЧЕСКИЙ ЖИВОТЪ.


Събралъ и издалъ

Ю. А. Шапкаревъ.

СОФИЯ.

Печатница на „Либералний Клубъ".

1891.


БОЛГАРСКА ПИСМЕННОСТЬ.

Не е право хладнокровіе
Да показуваме върху
Наше Славено-Болгарство.

" Цариградскій Вѣстникъ година В. число 82 пише отъ Ибраила 1852 Апр. 4. Что стуществуватe Болгарски Книгочіи? — камо ви обща грамматика.? — камо ви Словарь то естъ Рѣчникъ? та да есте похвалны отъ другія Славине." — Ето отвѣтъ. Мы Болгары имаме преполна и высокодостойна Слава, отъ другыя Славяне; и достойни са да отдаваятъ върху насъ честь, понеже сме ги дарувале писменность. — Мы Болгары имающе си кореньобытенъ и изобиленъ языкъ, това е наша грамматика, това е нашъ словарь. — Всекой кой дерзае да осуждава наше Болгарство, той е образъ Момусовъ кой заповѣдува мы

Elena Chiocchetti*

Sfidat terminologjike në gjuhën gjermane si gjuhë e pakicës në Tirolin e Jugut: Shembulli i shëndetit dhe i sigurisë në punë

Abstrakt

Në Tirolin e Jugut, Itali, gjermanishtja është një gjuhë zyrtare e pakicës, pranë gjuhës kombëtare - italishtes. Në këtë punim ne tregojmë që ende nuk është zhvilluar plotësisht terminologjia që ka të bëjë me fushën e shëndetit dhe të sigurisë në punë (SHSP) në këtë gjuhë të pakicave vetëm lokale. Ne japim shembuj të boshllëqeve terminologjike, të ndryshimeve të tepërta të termave dhe të përhapjes së pamjaftueshme të terminologjisë së SHSP-së në gjermanishten e Tirolit të Jugut. Ne pastaj përshkruajmë metodat e zhvillimit të terminologjisë që zbatohen në Tirolin e Jugut për të kundërshtuar këtë situatë, metoda të cilat mund të shërbejnë si një referencë për gjuhët e tjera të pakicave vetëm lokale. Duke pasur parasysh natyrën ndërdisiplinore të SHSP-së, ne merremi si me terminologjinë ligjore të lidhur me sistemin, ashtu edhe me terminologjinë në përgjithësi universale që u përket fushave të tjera, të tilla si mjekësia, inxhinieria, kimia etj. Kjo kërkon qasje të ndryshme: terminologjia që i përket shumicës së fushave normalisht i përket zonës gjermanishtfolëse dhe duhet të përdoret gjithashtu në Tirolin e Jugut. Sidoqoftë, terminologjia juridike lidhet gjithmonë me një sistem të veçantë ligjor. Prandaj, është e nevojshme që së pari të aplikohen metoda krahasuese ligjore për të përcaktuar se cilat terma të sistemeve juridike të huaja që flasin gjermanisht mund të përdoren edhe në Tirolin e Jugut ku zbatohet sistemi ligjor italian.

* Studiuese e lartë në Institutin e Gjuhësisë së Aplikuar, Eurac Research, në Bolzano, Itali

Fjalë çelës: *zhvillimi i terminologjisë, ndryshimi i termit, gjuha e pakicave, krahasimi ligjor, shëndeti në punë*

1. Hyrje

Për shkak të historisë së saj shoqërore dhe politike, Evropa është një kontinent ku shumë njerëz mund të përcaktohen si folës të gjuhëve të pakicave. Është vlerësuar se vetëm në Bashkimin Evropian, 40 deri në 50 milionë qytetarë flasin të paktën një nga 60 gjuhët rajonale dhe të pakicave (Pasikowska-Schnass 2016: 12). Në Evropë, Italia është ndër vendet me numrin më të madh të pakicave gjuhësore. Aktualisht, ekzistojnë dymbëdhjetë gjuhë të pakicave të njohura; folësit e tyre shtojnë deri në 4.5 për qind të popullsisë italiane (Palermo & Woelk 2011: 282), domethënë rreth 2.700.000 qytetarë italianë. Komunitetet e tjera janë ende duke luftuar për të arritur një njohje ligjore, p.sh. pakica e shpërndarë romishtfolëse.

Gjuhët e pakicave në Itali i përkasin një grupi të gjerë të familjeve gjuhësore, duke përfshirë familjet shqiptare, gjermane, greke, romane dhe sllave. Kontributi i tanishëm do të përqëndrohet në komunitetin e madh gjermanishtfolës që banon në provincën e Bolzanos në Italinë Veriore. Kjo krahinë autonome, e njohur përgjithësisht si Tiroli i Jugut, është shtëpia e mbi 320,000 gjermanishtfolësve vendas, që korrespondojnë me afërsisht 70% të popullsisë lokale (ASTAT 2020: 15).[2]

2. Regjimi gjuhësor në Tirolin e Jugut

Në Tirolin e Jugut, regjimi institucional i gjuhës është kryesisht dygjuhësh. Statuti i Autonomisë i Tirolit të Jugut (Dekreti Presidencial Nr. 670/1972) i jep gjuhës pakicë gjermane të njëjtin status me gjuhën kombëtare italiane në nivel

2 Në Tirolin e Jugut, 20,000 folës të tjerë i përkasin pakicës ladinfolëse. Ladin është një gjuhë autoktone e njohur zyrtarisht, e folur në pesë lugina të Dolomiteve. Numri i përgjithshëm i folësve, përfshirë ata që banojnë në dy krahina fqinje, vlerësohet të jetë rreth 30,000 (Istitut Cultural Ladin 2021). Punimi nuk do të merret më tej me këtë gjuhë retoromane. Për më shumë informacion mbi gjuhën dhe kulturën ladine shihni për shembull Pescosta 2010.

rajonal (neni 99), duke e bërë kështu gjermanishten një gjuhë zyrtare brenda zonës. Qytetarët që flasin gjermanisht kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre në marrëdhëniet me zyrat dhe organet e administratës dhe të gjyqësorit lokal (neni 100 paragrafi 1). I gjithë legjislacioni krahinor botohet në të dy gjuhët, emrat e vendeve janë zyrtarisht dygjuhëshe, gjykimet mund të bëhen në secilën gjuhë.

Ekzistojnë disa rregulla të hollësishme në lidhje me aktet juridike që duhet të jenë gjithmonë dygjuhëshe dhe të tjera që mund të shkruhen në njërën nga gjuhët zyrtare (neni 100 paragrafi 4). Në përgjithësi, në komunikimet dypalëshe dhe private, institucionet publike ndjekin parimin e 'përdorimit të veçantë të gjuhës', domethënë ata përdorin gjuhën e parapëlqyer nga qytetari specifik i adresuar (Palermo & Woelk 2005: 334). Gjykimet gjithashtu normalisht zhvillohen vetëm në një gjuhë, edhe pse gjykimet dygjuhëshe janë të mundshme (Ordine degli Avvocati 2014). Megjithatë, për legjislacionin krahinor dhe disa dokumente administrative zbatohet parimi i 'përdorimit të përbashkët të gjuhës' (Palermo & Woelk 2005: 333). Në këtë rast, versioni italian dhe gjerman i tekstit duhet të shtypen krah për krah dhe me të njëjtën madhësi fonti. Aktet ligjore të përfshira në këtë rregullore përfshijnë dokumente zyrtare administrative që synojnë publikun e gjerë (p.sh. planet e zhvillimit urban), dokumentet personale të destinuara për përdorim publik (p.sh. kartat e identitetit) dhe dokumentet zyrtare që adresojnë disa zyra administrative (p.sh. qarkoret) (Dekreti Presidencial Nr. 574/1988, Neni 4). Një regjim institucional dygjuhësor kërkon nevojën për staf që mund të zotërojë (gjithashtu) gjuhën e pakicës në komunikimin e tyre me shkrim dhe me gojë (Dekreti Presidencial Nr. 752/1976). Përveç kësaj, kërkon që e gjithë terminologjia e nevojshme të jetë e disponueshme jo vetëm në gjuhën kombëtare, por edhe në gjuhën e pakicës.

3. Gjuhët e pakicave dhe zhvillimi i terminologjisë

Nuk do të ishte e tepërt që dhe në rasë të kësaj trajtese, të citonim qoftë dhe për informacion disa terma-përveçime që për vetë përmbajtjen e këtij libri, i përafrohen duke u rrekur dhe ta përkufizojnë atë sa më afërsisht e saktësisht. Tradita gjegjëse me një përkatësi të qartë evropiane njeh disa të tilla, ndër të cilat edhe raste që vërtet i afrohen një modeli kompleks si ai i librit të Buzukut.[3]

Na ka përfshirë prej kohësh një argument i tillë dhe në rasë të trajtimit të historisë së vetë këtij libri, por dhe fillesave të dokumentimit të shkrimit shqip, që për sa e njohim deri më sot, dëshmohet me të tilla tekste, të një tematike të lidhur qartë me liturgjinë dhe ushtrimin e saj nëpërmjet manualesh, breviarësh e ritualesh. Vetë emërtimet që sapo cekëm janë pjesë e një leksikoni kompleks që me kohën ka njohur një përforcim në elemente të terminologjisë, por dhe zhvillime që studiohen gjerësisht në historinë e institucioneve të shekujve me të cilat lidhet

3 Shih në veçanti përkufizimin që jepet në lidhje me termin sakramentar apo libër sakramendesh në Enciklopedine Treccani, varianti i përpunuar online: Liber sacramentorum ose sacramentorium, në të cilin mblidhen lutjet e recituara nga shërbëtori gjatë meshës, është teksti më i rëndësishëm liturgjik i traditës së krishterë. Historia e këtij libri dhe ajo e prejardhjes së tij kryesore, misalit, ruan pasqyrimin e shumë transformimeve që ndikuan në liturgjinë eukaristike në mesjetën e hershme. Ndryshe nga sa besohej në të kaluarën, kanonizimi i ritit latin filloi mjaft vonë. Para kësaj faze, peizazhi fetar i Evropës së krishterë duket se karakterizohet nga një larmi e madhe tekstesh dhe praktikash rituale.

dhe konsolidimi i tyre.

Nuk është aspak rastësi që tashmë prej kohësh çështje të historisë së përvijimit të dukurive që kanë të bëjnë me përhapjen e librit të shtypur dhe përdorimin e tij si alternativë ndaj manuskripteve janë objekt disiplinash themelore për dijen e kulturën në nivele universitare, pasuniversitare dhe doktorale.

Në vetvete, arsyetimi si një disiplinë me vete e më tej e vlefshme për t'u studiuar në nivele të studimit universitar dhe pasuniversitar e një problematike të tillë vetiu kërkon dhe një terminologji të përshtatshme që duke ruajtur së pari tiparet universale të të qenit degë e një dijeje specifike që ka të bëjë me librin dhe historikun e përhapjes së tij në shekuj e vise të kulturës, në kontekstin tonë presupozon dhe disponimin e termave apo elementeve të shqipëruara natyrshëm, në të mirë të përforcimit të regjistrave specifikë për linja të veçanta studimore.

Të qenit universale e terminologjisë së mjaft fushave nuk përjashton dhe veçanësi apo inovacione që në rasa të veçanta reflektohen kur një gjuhë e caktuar i gjen natyrshëm mjetet e saj të pasurimit. Një diskutim i tillë nuk vlen vetëm për terminologjinë e një disipline unike si ajo e bibliofilisë, një prej objekteve që nxiti dhe përpilimin e kësaj trajtese nga ana jonë, por dhe për të tjera drejtime studimore, që në gjuhë të caktuara gëzojnë tradita fatlume dhe jetëgjata të receptimit dhe përdorimit të tyre.

Bibliografia

Barbieri E., *Guida al libro antico. Conoscere e descrivere il libro tipografico.* Le Monnier, Firenze, 2006.

Bertolo F.M., Cherubini P., Inglese G., Miglio L., *Breve storia della scrittura e del libro*, Carocci editore, Romë, 2004.

Bogdani P., *Cuneus prophetarum* (Çeta e profetëve), botim kritik përgatitur nga

A.Omari, ASHSH, Tiranë, 2015.

Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.

Contini G., *Breviario di ecdotica*, Einaudi, Torino, 1992.

Çabej E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, n.2, 1959.

Demiraj B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum,* Botime Françeskane, Shkodër, 2008.

Fuiano M., *La stampa nel Cinquecento: breve prospetto,* Librería Scientifica, 1967.

Paci E., *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe,* Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2017.

Pasquali G., *Storia della tradizione e critica del testo (1952),* Mondadori, Milano, 1974.

Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, L.O.P.Geuthner, Paris, 1932.

Sedaj E., *Bibla e përkthimet e saj në gjuhën shqipe,* Shtufi, Prishtinë, 1999.

Stoppelli P., *Filologia dei testi a stampa*, Il Mulino, Bologna, 1987.

Isa Mulaj* , Ruzhdi Matoshi** , Florin Aliu***

Terminologjia e ekonomisë në gjuhën shqipe: gjendja, problemet detyrat

Përmbledhje

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizoj gjendjen e terminologjisë së ekonomisë në gjuhën shqipe, dhe në bazë të problemeve që hasen, të sjell disa rekomandime në formë detyrash të cilat parashtrohen si të nevojshme për hulumtime të mëtejme në funksion të standardizimit të saj. Punimi është nisur nga hipoteza se terminologjia në fjalë është e pasur, por konstaton se hulumtimet shkencore dhe akademike në këtë drejtim janë shumë të kufizuara ose anashkaluar, duke krijuar zbrazëti në përdorimin e saj më të gjerë dhe unjësuar. Pavarësisht pranisë së termave të mëhershëm me origjinë nga gjuhët tjera, duket se mbajtja e tyre në përdorim është më e leverdishme se kalimi nga huazimet e një gjuhe me ndikim të kohës në tjetrën. Këto ndikime gjuhësore të cilat historikisht janë provuar se nuk janë të përjetshme, vetëm sa e kanë vështirësuar kuptimin e gjerë të kësaj terminologjie nga shumica e atyre që gjuhë amtare e kanë shqipen.

Fjalë çelës: *gjuha shqipe, terminologjia e ekonomisë, barbarizmat, unjësimi*

Hyrje

Me përjashtim të disa fjalorëve, qofshin ata shqip-shqip apo nga gjuhët tjera në shqip rreth terminologjisë së ekonomisë dhe disiplinave të saj, është vështirë të gjinden studime ose botime profesionale që e shtjellojnë problematikën dhe gjendjen e saj. Aq më tepër është shtuar lënia e saj pas dore me fillimin e ndryshimeve

* Instituti për Hulumtime dhe Analiza të Politikave Ekonomike, Prishtinë, Republika e Kosovës
** Fakulteti i Shkencave Politike, Kolegji UBT, Prishtinë, Republika e Kosovës
*** Fakulteti i Menaxhmentit, Biznesit, dhe Ekonomikës, Kolegji UBT, Prishtinë, Republika e Kosovës

të mëdha politike dhe ekonomike në hapësirat shqiptare gjatë viteve 1990-ta e deri më sot, ose siç njihet ndryshe, kalimi (tranzicioni) nga sistemi politik njëpartiak (monist) dhe ekonomia socialiste, në sistemin politik shumëpartiak (pluralist) dhe të ekonomisë së tregut. Një ndër faktorët kyç që ka ndikuar në mos interesimin në rritje për hulumtimin e kësaj problematike, është ndikimi i shumanshëm i globalizimit. Si në shumë gjuhë tjera, ndikimi më i madh ka ardhur nga gjuha angleze që përkon me zhvillimin e kapitalizmit, ekonomisë si shkencë e veçantë shoqërore, zbulimet e reja shkencore dhe (neo)kolonializmit. Të gjitha këto, në rrjedhat bashkëkohore, kanë sjellë fjalë të reja, përkthimi i dobët në gjuhën shqipe i të cilave shpesh nuk ndryshon nga fjalët burimore. Nëse dikush, qoftë shqiptar apo i huaj, mendon se me zëvendësime të mëdha në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe me terma dhe shprehje të huaja arrihet ndonjë përparim, atëherë kjo ishte dashur të ndodh sot. Janë dy pengesa serioze në realizimin e një projekti të tillë. Së pari, është vështirë të vërtetohet pse dhe si do të bëhej ky zëvendësim ose kalim. Së dyti, ithtarët e zëvendësimit nuk janë të gatshëm të punojnë në këtë drejtim, duke lënë dhe vështruar një gjendje të çrregulluar, ose as andej, e as këndej.

Gjithnjë e më tepër jemi dëshmitarë të premtimeve nga institucionet dhe pushteti nëpërmjet strategjive, planeve dhe politikave ekonomike ambicioze që kanë mbetur pa u zbatuar si duhet, e në të shumtën e rasteve kanë përfunduar në arkiva vetëm si dokumente prej letre. Problemi këtu është se hartimi i reformave dhe përgatitja e strategjive për zhvillim ekonomik nuk i analizon dhe merr për bazë sa duhet kushtet specifike sa do që ato përmenden shumë. Me kushte specifike, në mes tjerash, nënkuptohet gjuha dhe terminologjia me të cilën ekspertët dhe ekonomistët shkruajnë strategji, bëjnë plane, përgatisin raporte dhe komunikojnë me publikun. Ky punim nuk synon të plotësojë ndonjë boshllëk pasi

ende nuk ekziston një bazë së në çka mund të hyjë përmbajtja dhe analiza e tij. Përveç kontributit modest në krijimin e një baze fillestare në atë që është lënë pas dore, punimi bënë përpjekje për të nxitur hulumtime tjera, qoftë duke u bazuar në problemet e identifikuara dhe trajtuara, apo në segmente tjera që janë prekur vetëm sipërfaqësisht.

Qasja dhe metodologjia

Në trajtimin e kësaj teme, është përdorur qasja shumë dimensionale dhe e përgjithësuar. Në këtë kontekst, është filluar nga metoda e deduksionit, domethënë, mësimet nga gjuha shqipe dhe lëmi i ekonomisë nga këndvështrimi i përgjithshëm, pastaj paraqitja e hollësirave të veçanta dhe shembujve në mbështetje të përgjithësimit për gjendjen dhe problemet e terminologjisë së ekonomisë. Është vazhduar me sintezën, ku janë shfrytëzuar dhe kombinuar shumë elemente dhe burime nga e kaluara dhe e tashmja rreth terminologjisë së ekonomisë, me synimin për të krijuar diçka të re.

Burimet e shfrytëzuara për hulumtim kanë përfshirë një vistër botimesh duke filluar nga:

- botimet akademike (libra, punime dhe revista shkencore);
- masmediet (elektronike, shtypi, konferencat);
- fjalorët e terminologjisë së ekonomisë dhe disiplinave të saj, të shprehjeve të huaja - barbarizmave, dhe shqip-shqip;
- tekstet mësimore për ekonomi në arsimit të lartë;
- botimet qeveritare (ligjet, dokumentet, strategjitë, raportet);
- botimet dhe tekstet e përkthyera nga gjuhët tjera në gjuhën shqipe, sidomos të organizatave të huaja.

Literatura bazë e shfrytëzuar ka qenë ajo në gjuhën shqipe. Përkundër

vëllimit të madh të burimeve, në tekst janë përmendur vetëm disa më kryesore me qëllim për ta ruajtur përqendrimin në temën bosht. Po ashtu, nuk ka qenë aq e nevojshme që, për shumë terma të përmendur, të tregohen burimet e sakta nëpër fjalor të cilët janë shfrytëzuar dhe figurojnë vetëm si burim i literaturës në fund të punimit. Përkufizimet dhe domethëniet e disa termave janë bërë në rastet kur është vlerësuar si e nevojshme për të mos iu shmangur rrjedhës logjike të tekstit në analizën e problemit strukturor. Përpos gjuhës bazë, është shfrytëzuar edhe literaturë e kufizuar nga gjuhët tjera që kanë ndikuar në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe, kryesisht nga gjuha angleze.

1. Shqyrtime teorike

Në mungesë të një baze teorike paraprake për temën në fjalë, disa elemente të saj është dashur të krijohen nga burime dhe këndvështrime të ndryshme. Historikisht, studimi i gjuhës është shumë më i vjetër se studimi i ekonomisë. Studimi i së dytës si disiplinë e veçantë shkencore mendohet se fillon në vitin 1776 me veprën e Adam Smithit, *Pasuria e kombeve*. Zhvillimi i kapitalizimit dhe kolonializmit ekonomik anglez ka lënë gjurmë edhe në terminologjinë ekonomike të shumë gjuhëve. I ngjashëm ka qenë ndikimi më i kufizuar në terminologjinë e gjuhës së atyre kombeve që ishin nën sundimin e vendeve ose fuqive të kohës.

Tek shqiptarët, botimi i parë për ekonominë lajmërohet në Vjetarin e Vilajetit të Kosovës, por në gjuhën turke me titullin *Salname i Vilayet i Kosova (1878-1888)*, me të dhëna dhe ngjarje kryesore rreth zhvillimeve bujqësore dhe ekonomike (Fevziu, 2005:15). Vjetari kishte rëndësi të madhe kur dihet se Vilajeti i Kosovës me kryeqytet Shkupin, ishte më i madhi në territoret e banuara me shqiptarë me një sipërfaqe diku trefish më të madhe se territori i shtetit të sotëm të Republikës së Kosovës. Për njëmbëdhjetë vite, Vjetari kishte ofruar të dhëna të atilla që edhe

institucionet e sotme të statistikës i mbledhin si të domosdoshme me rëndësi të veçantë për analiza, udhëheqje, qeverisje dhe vendim marrje ekonomike. Të dhënat e Vjetarit ishin shumë të vlefshme meqenëse bujqësia ishte veprimtaria kryesore e ekonomisë dhe ka vazhduar të jetë e atillë në territoret e ish-Vilajetit të Kosovës edhe për një shekull pas. Gjuha zyrtare e asaj kohe (osmanisht/turqisht) në të cilën ishte shkruar Vjetari, ka lënë shumë barbarizma të cilët më vonë u bënë thuajse të standardizuar edhe në gjuhën shqipe. Emrat turk *battal* – tokë e lënë djerrinë; *byrek* – gatesë me petë të holluara, që mbushet brenda me mish të grirë, djathë, spinaq etj.; *dynym* – sipërfaqe prej 10 ari tokë ose 1 000m^2; *dyqan* – shitore ose objekt ku zejtari ushtron mjeshtërinë e vet; *tapi* – dokument zyrtar mbi pasurinë e patundshme (Ndreca, 2007) janë terma ekonomik që kanë përdorim të gjerë edhe sot e kësaj dite. Disa prej këtyre turqizmave kishin mbetur edhe në gjuhën serbo-kroate si *dulum*, *burek*, *duqan*.

Problemi i asaj kohe me botimet rreth ekonomisë në trojet shqiptare si ai i Vjetarit, ishin: i) mungesa e gjuhës së shkruar shqipe si gjuhë zyrtare, çka i bënte botimet në gjuhën turke të pakapshme për shumicën e popullsisë shqiptare; ii) mungesa e alfabetit të gjuhës shqipe; dhe iii) dhe periodiciteti i botimeve ose mos vazhdimi i mëtutjeshëm me punën e filluar. Alfabeti i gjuhës shqipe krijohet më 1908 në Kongresin e Manastirit. Me këtë u hap mundësia për fillimin e zgjidhjes së tri problemeve të cekura, por vetëm në një territor të kufizuar i banuar me shqiptarë – shtetit të Shqipërisë. Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe mbeti problem për pjesën më të madhe të shqiptarëve që ishin nën sundimin e ish-Jugosllavisë së parë (1918 – 1941), ku gjuhë zyrtare ishte serbo-kroatishtja. Jo vetëm që nuk kishte të dhëna dhe botime rreth ekonomisë në gjuhën shqipe, por bujqësia si veprimtaria kryesore e ekonomisë iu nënshtrua një reforme të shoqëruar me terror dhe spastrim etnik kundër shqiptarëve nga ish-Jugosllavia e parë. Ajo epokë

është e analizuar me shifra dhe hollësira në studimin e autorit Obradović (1981) si *Reforma agrare dhe kolonizimi i Kosovës (1918-1941).* Gjatë asaj periudhe, nuk mund të thuhet diçka me rëndësi për terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe as në Shqipëri, edhe pse mund të ketë pasur botime dhe të dhëna rreth ekonomisë, qoftë të përgjithshme apo të veçanta. Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore e këndej mund të flitet për terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Kjo periudhë do të jetë objekt i shqyrtimit në nëntitujt e mëvonshëm të këtij punimi.

Arsyeshmëria prapa një teorie ndërmjet gjuhës ose terminologjisë së ekonomisë dhe zhvillimit ekonomik qëndron në atë se, sa më e unjësuar dhe e kapshme për shumicën të jetë e para, ka gjasa ta lehtësoj edhe të dytën. Një studim i autorëve Byung-Yeon and Pirttilä (2006) konstaton se reformat ekonomike në shtetet e tranzicionit kanë gjasa të zbatohen më me sukses dhe të japin rezultate më të mira, nëse ato gëzojnë mbështetjen e shtresës së gjerë të popullsisë. Hausmann, Rodrik dhe Velasco (2005) kishin ardhur në përfundim se, shumica e ekonomistëve janë të pajtimit se suksesi i politikave dhe reformave ekonomike të bazuara në Konsensusin e Uashingtonit, varen shumë nga rrethanat dhe kushtet specifike të vendeve ku zbatohen. Duke e bazuar në këto dy studime që nuk janë të vetmet në këtë aspekt, atëherë nuk duhet anashkaluar faktin se Shqipëria, Kosova, dhe Maqedonia e Veriut zbatojnë reformat e Konsensusit të Uashingtonit. Për të pasur gjasa për sukses, reformat duhet të kenë mbështetje më të gjerë nga popullsia, e kjo varet deri-diku edhe nga terminologjia e ekonomisë si kusht specifik me të cilën pushteti dhe ekspertët komunikojnë me publikun. Sa më e fortë të jetë ndërlidhja (korrelacioni) ndërmjet kuptimit të terminologjisë së ekonomisë nga shumica dhe planet e pushtetit për reforma, aq më shumë kanë gjasa ato plane të realizohen në masë më të madhe.

Kur ndonjë dukuri, veprimtari, reformë bëhen të njohura, atëherë emërtimi burimor në një gjuhë amtare shpesh herë futet si term standard edhe në shumë gjuhë tjera. Të tilla janë, për shembull, edhe termat ekonomike që i hasim në gjuhën shqipe si biznes (anglisht *business*) – punë a veprimtari ekonomike/tregtare, afarizëm; kapital/ist/izëm (latinisht: *capitalis*) – vlerë materiale ose pasuri/pronar i pasurisë/sistem ekonomiko-shoqëror; kompani (frëngjisht: *compagnie*) – ndërmarrje industriale, tregtare a shërbyese; *laissez-faire, laissez-passer* (frëngjisht) – lejoni të bëjnë, le të shkojnë/politikë liberale ekonomike; privat (latinisht: *privatus*) – vetjak; perestrojka (rusisht: Перестройка) – ristrukturim, reformë ekonomike për ristrukturimin e ekonomisë së ish-Bashkimit Sovjetik; Konsensusi i Uashingtonit (anglisht: *The Washington Consensus*) pako e reformave për vendet e botës së tretë dhe të tranzicionit nga tri institucionet e Uashingtonit (Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, dhe Departamenti i Thesarit të SHBA-ve).

Shumë terma të huaj ose barbarizma në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe janë unjësuar në bazë të shpikjeve dhe kontributeve shkencore, siç janë: bilanc (latinisht: *bilanx/bilancis*) – peshojë me dy tasa, pasqyrë përmbledhëse e të ardhurave dhe shpenzimeve; robot (çekisht, polonisht: *robot*) – njeri/punëtor mekanik artificial, i fantazuar nga shkrimtari çek Karel Çapek më 1920; kompjuter (anglisht: *computer*) – makinë elektronike për llogaritje, "truri elektronik"; Inkotermat (anglisht: incoterms – ***In**ternational **Co**mmercial **Terms***) – termat ndërkombëtare të tregtisë; T.I.R. (frëngjisht: *Transport International Routier*) – transporti ndërkombëtar rrugor; lakorja e Filipsit (anglisht: *Philips Curve*) – matje e raportit ndërmjet normës së inflacionit dhe papunësisë; ekonomia sociale e tregut (gjermanisht: *Soziale Markwirtschaft)* etj.

Në shumicën e gjuhëve indo-evropiane dhe terminologjisë së tyre në shkencën e ekonomisë, pra edhe në gjuhën shqipe, gjendja e termave ose barbarizmave të

përmendur në dy paragrafët e mësipërm është në rregull dhe nuk paraqet ndonjë problem. Përkundrazi, këta dhe shumë terma tjerë vetëm sa e kanë lehtësuar komunikimin ndërmjet shteteve dhe popujve në marrëdhëniet e tyre ekonomike dhe tregtare.

2. Terminologjia gjatë socializmit në Shqipëri dhe ish-Jugosllavi

Socializmi i centralizuar në Shqipëri ka ndikuar në një lloj "pastërtie" të terminologjisë së ekonomisë në gjuhën shqipe nga barbarizmat si rezultat i izolimit politik dhe ekonomik ndaj botës. Kuptohet se me atë lloj pastërtie nuk synohej domosdo të zëvendësohen barbarizmat në përdorim për një kohë të gjatë me terma të ri në gjuhën shqipe ende të panjohur për publikun. Si përparësi e asaj periudhe mund të cilësohet korrektësia gjuhësore në botimet nga lëmi e ekonomisë, ku barbarizmat nuk kanë mundur të futen në masë të madhe, apo edhe në gjuhën e folur dhe të shkruar nëpër institucione arsimore dhe shtetërore pa e sqaruar domethënien e tyre, dhe pa e gjetur shqipërimin e duhur siç do të ndodhë më vonë gjatë tranzicionit.

Ngjashëm kishte ndikuar në terminologjinë e ekonomisë edhe socializmi vetëqeverisës në Kosovë pas decentralizimit të sistemit politik dhe ekonomik në ish-Jugosllavinë e dytë (Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë – RSFJ). Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe kishte qenë problem deri në fillim të vitit 1970 kur u themelua Universiteti i Prishtinës. Fakulteti ekonomik ekzistonte edhe më herët, mirëpo ligjëratat mbaheshin në dy gjuhë (shqip dhe serbo-kroatisht) ndërsa studentët vareshin shumë nga literatura ekonomike në gjuhën serbo-kroate ashtu sikur edhe shumica e pedagogëve të tyre që kishin studiuar kryesisht në Beograd dhe Zagreb. Përparimi i statusit të Kosovës në kuadër të federatës së ish-RSFJ, kishte ndikuar edhe në gjuhën shqipe dhe terminologjinë e ekonomisë.

Ishin demonstratat e studentëve shqiptarë më 1968 që i dhanë shtytjen kryesore përparimit të këtij statusi kur më 1974 Kosova u pranua si element përbërës dhe vendim marrës në federatë. Në anën tjetër, Serbia ishte e vendosur ta pengoj këtë status, ndërsa Josip Broz – Titon si kryetar i ish-RSFJ nuk e ka shqetësuar aq statusi i shqiptarëve derisa ai ka ardhur në përfundim se përparimi i të drejtave të shqiptarëve dhe kombeve tjera, sidomos në aspektin e përdorimit të gjuhës, është i domosdoshëm si kundërpeshë ndaj hegjemonisë serbe, prandaj edhe për mbrojtjen e karrierës së tij politike si kryetar me përkatësi të përzier etnike sllovene dhe kroate. Burimet e terminologjisë së ekonomisë në gjuhën shqipe në Kosovë sapo kishin filluar të identifikohen në botimet dhe përkthimet e teksteve universitare, kryesisht për nevojat e fakultetit ekonomik në Universitetin e Prishtinës. Botimet në shqip kanë qenë shumë të bazuara në tekstet serbo-kroate, gjë që vërehet edhe në përmbajtjen e literaturës në tekste dhe regjistrimin e burimeve të vënë në fund të botimeve. Mirëpo, terminologjia e përdorur, në përgjithësi ka qenë e qartë për gjuhën shqipe. Konstatim i ngjashëm vlen për tekstet e përkthyera nga serbo-kroatishtja në shqip. Shumica e sqarimeve në shqip për termat që janë treguar në Tabelën 1 të shtojcës së këtij artikulli, e kanë burimin në ato botime dhe përkthime në gjuhën shqipe. Shqipërimet e duhura kanë shkuar deri në atë masë sa tekstet universitare, si për shembull ai i autores Nikolajeviq-Teofanoviq (1980), ia humbin dyshimin lexuesit dhe studiuesit se është tekst i përkthyer nga ndonjë gjuhë, ose në rastin konkret, gjuhën (ish)serbo-kroate. Gjendje e ngjashme i ka karakterizuar edhe përkthimet tjera. Në gjuhën e folur përdoreshin shumë terma të gjuhës serbo-kroate, ndonëse kjo me tepër ka ndodhur jashtë sistemit zyrtar të terminologjisë së ekonomisë në gjuhën shqipe. Shembuj: *zadruga* – lloj kooperative bujqësore ose organizatë ekonomike rurale; *zavod* – ent; *k(r)ompir* – patate.

Gjatë sistemit socialist ka ekzistuar një bashkëpunim i kufizuar ndërmjet

Shqipërisë dhe Kosovës në lëmin e gjuhësisë dhe shkencave tjera, por nuk ka ndonjë tregues apo ngjarje të rëndësishme për bashkëpunim në terminologjinë e ekonomisë që ia vlen të shtjellohet. Rajonet tjera të banuara me shqiptarë në ish-RSFJ janë varur nga terminologjia e ekonomisë që përdoroj në Kosovë dhe institucionet arsimore të asaj kohe. Të metat e të dy sistemeve në kuadër të gjuhës së njëjtë në terminologjinë që po shqyrtohet, ishin: i) aftësia e kufizuar për t'i përcjellë, futur dhe unjësuar termat e ri nga shkenca dhe trendet e ekonomisë botërore (Shqipëria); dhe, ii) në Kosovë, si në rastin e parë (të Shqipërisë), plus, ndikimet e serbo-kroatishtes si gjuha kryesore e ish-Jugosllavisë, e cila i ka shtyrë shumë studiues shqiptarë të specializojnë në universitete më të mëdha (Beograd, Zagreb, Sarajevë, Lubjanë, dhe Shkup).

3. Gjendja dhe problemet e terminologjisë së ekonomisë gjatë tranzicionit dhe sot

Të metat gjatë socializmit në pranimin e termave të domosdoshëm bashkëkohorë si rezultat i zhvillimit dhe përparimit të shkencës ekonomike në nivel botëror, u eliminuan me "pushtimin" e shpejtë dhe të gjithanshëm pas hapjes shumë të madhe dhe të menjëhershme të Shqipërisë, Kosovës, dhe Maqedonisë së Veriut ndaj botës. Kësaj i ndihmoj më së shumti numri i madh i studiuesve shqiptarë të ekonomisë nëpër botë dhe ardhja e shumë organizatave të huaja, ku mbizotëroj ndikimi i gjuhës angleze. Sidoqoftë, këtu doli një problem i madh i hyrjes masive dhe të pakontrolluar të barbarizmave në gjuhën shqipe. Në mesin e faktorëve kryesor që kjo dukuri ende paraqet problem, janë: i) përkthimet tekstuale dhe të pa unjësuara, e në të shumtën e rasteve të dobëta, nga jo-profesionistët; ii) rritja e gatishmërisë nga studiuesit shqiptarë për të studiuar dhe shkruar punime shkencore dhe vepra rreth ekonomisë në gjuhët e huaja (sidomos angleze); iii) përparësia në punësim

dhe paga më të larta për ata që flasin dhe shkruajnë anglisht – shpesh herë kusht i domosdoshëm; dhe iv) ndikimi i masmedieve, kanaleve joformale të komunikimit dhe studimit.

Ekonomistët në përgjithësi nuk i kushtojnë aq rëndësi problemit të drejtshkrimit. Ata (mendohet në ekonomistët shqiptarë) së paku nuk do të duhej të shkonin në forma të skajshme në përdorimin e barbarizmave vetëm pse mendojnë se kolegët e tyre i kuptojnë, ndërkaq injorojnë termat e unjësuar në shqip që kuptohen nga shumica e lexuesve. Në shumë punime të autorëve nga Shqipëria (Instituti Alb-Shkenca, 2008), sektori i institucionit në të cilin autori është i punësuar ose i shoqëruar, shënohet si *departamenti i ekonomiksit*. Nuk ka kurrfarë arsyeje gjuhësore të futet në botimet zyrtare fjala e huaj departament me shumë kuptime edhe në lëmi tjera, për ta zëvendësuar fjalën e standardizuar në shqip *katedër* e cila veçanërisht kuptohet se ka të bëjë me fakultet. Mandej, nëse në vend të *ekonomikës* përdoret ekonomiks, atëherë përse *statistikës* nuk i thuhet statistiks?

Nxënësit e shkollave të mesme ekonomike dhe gjimnazeve janë mësuar shumë mirë për vite të tëra dhe e kanë kuptuar fjalën *lakore*. Kur ata bëhen studentë, në librat më të rëndësishme të fakultetit ekonomik siç janë mikro dhe makro ekonomia (Varian, 2000; Dornbusch dhe Fisher, 2000) si botime të njohura ndërkombëtare të përkthyera në Shqipëri, në mesin e shumë barbarizmave haset edhe emri *kurbë*. Studenti fillimisht hutohet duke menduar se çka qenka kjo kurba derisa të lexoj materien dhe të kuptoj së bëhet fjalë për lakoren. Disa, nëse nuk mund të thuhet shumica, ekspertë dhe profesorë të ekonomisë në Shqipëri dhe Kosovë shkojnë aq larg me shprehje që kuptohen shumë lehtë, të i zëvendësojnë me anglizma. Në vend të *parasë së gatshme* kanë futur termin *kesh*. Autorët nga Shqipëria janë më "origjinal" kur në punimet dhe shkrimet e tyre në gjuhën shqipe e shkruajnë *cash-i*. Në kontabilitet, në vend të keshi-t ose cash-it, *arka* ka qenë, është dhe do të

duhej të vazhdonte si term i standardizuar.

Një barbarizëm tjetër me shumë kuptime sipas konteksteve, është termi *aset/e*. Ekonomistët normal e kanë të vështirë ta kuptojnë këtë shprehje angleze nëse përdoret si e vetmuar. Fjalori voluminoz anglisht-shqip (Qesku, 2002) i terminologjisë së përgjithshme e shqipëron këtë term si "vlerë", "gjë e vyer" dhe "cilësi e shquar." Në terminologjinë e ekonomisë, një kuptim për *assets* është pasuria e ndërmarrjes. Kur i njëjti term përdoret në afarizmin bankar dhe kontabilitet si *assets and liabilities*, atëherë e ka kuptimin *kërkesat dhe obligimet* ose *aktiva dhe pasiva*. Fjalori ekonomiko-financiar deri më tani më i njohur në gjuhën shqipe i autorit Pano (2002), dhe i termave të përgjithshëm si ai i Gorani-t (2006) dhe autorëve tjerë, nuk e njohin termin *aset/e* në shqip. Nuk ka kurrfarë arsye që *fixed assets* ta përkthejmë në formë zhargoni si *asetet fikse* kur në shqip ekziston prej kohësh shprehja *mjete themelore*, *mjete bazë*, ose *mjete kryesore*.

Ekzistojnë edhe shprehje më të gjata si *Menaxhimi i resurseve humane*, ose tituj të teksteve universitare nga autorët Havolli (2003) dhe Kutllovci (2004) që kur shqipërohen si *Qeverisja e burimeve* (ose pasurive) *njerëzore*, kanë kuptim më të mirë. Nga vështrimi sipërfaqësor i veprave të këtyre autorëve dhe atyre që kanë studiuar ekonominë në gjuhën angleze, mund të konstatohet se autorët me njohuri më të kufizuara të gjuhës angleze kanë gjasa më të mëdha të përdorin më shumë barbarizma. Kjo hipotezë, megjithatë duhet të vërtetohet me vështrime dhe hulumtime të veçanta.

Termi aksion/e (letër me vlerë) duket i unjësuar, dhe përkundër se mund të kuptohet lehtë, nuk do të thotë se është i qartë në përdorim, sidomos në komunikimin dhe përkthimin në gjuhën angleze ku njihet si *share/s*. Janë jo të pakta rastet kur përkthyesit shqiptar të nivelit të përgjithshëm, e kanë përkthyer termin ekonomik të gjuhës shqipe aksion/e si action/s në gjuhën angleze në formë

të shkruar, dhe të folur në takime zyrtare. Sa herë që shitblerja e aksioneve është përkthyer në anglisht si *buying and selling of actions*, çdo herë ka krijuar një huti automatike tek anglishtfolësit se mos është fjala për ndonjë gabim në përkthim apo dalje nga tema. Kjo është një arsye e mjaftueshme që termi i standardizuar aksion/e, duhet të ndryshohet dhe të bëhet *fletëaksion/e*, i cili edhe ashtu ekziston por thuajse është duke u zhdukur nga përdorimi. Vetë etimologjia *fletë* dhe *aksion* në gjuhën shqipe, tregon se ky kombinim është term më natyral dhe i kuptueshëm për këtë letër me vlerë.

Në kuadër të problemit strukturor, gjendja duket se është më e ngatërruar me trendin e futjes së termave nga anglishtja dhe shqiptimin e tyre ashtu si janë në gjuhën burimore, pa u menduar dhe përpjekur aq të gjejnë shprehjet e duhura në shqip. Në Tabelën II është paraqitur një numër i tyre, si *brain drain/ gain, fiduciar, staf, ekuitet* etj. Përkundër se ka alternativa dhe zgjidhje për shqipërim dhe standardizim, në tekstin universitar të Ahmeti-t (2007) sqarohet gjerë e gjatë se çka është dhe si funksionon *ekuiteti* (anglisht: *equity*) por nuk ofron ndonjë term alternativ në shqip, si për shembull, kapitali aksionar, kapitali vetjak, ose pjesëmarrja në kapitalin aksionar (vërejtje: termi kapital aksionar mund të përdoret si i veçantë përkundër asaj që u tha më lartë për fletëaksionet). Edhe për barbarizmat tjerë, përpos atyre në Tabelat I dhe II, ekzistojnë ose mund të gjinden shprehjet përkatëse të standardizuara në shqip, mirëpo, papërgjegjësia e shumë akademikëve, profesorëve dhe studiuesve duan që me një udhë t'i kryejnë dy, tri apo më shumë punë – zhdukjen e disa shprehjeve në shqip me nga një fjalë të huaj.

Përdorimi i shkurtesave rreth organizatave të ndryshme të huaja dhe ndërkombëtare, nuk është aq problem sikur barbarizmat tjerë të trajtuar deri më tani, ndonëse edhe këtu ka vend për vërejtje të vogla. Disa organizata kanë emërtime shqip dhe shkurtesë në gjuhë të huaj: Programi i Kombeve të Bashkuara

për Zhvillim – UNDP, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID, Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar – DFID, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim – OECD, Bashkëpunimi Teknik Gjerman – GTZ, Instituti për Kreditimin e Rindërtimit – KfW etj. Pak më e ngatërruar duket gjendja me përdorimin, jo gjithmonë por shpesh dhe aty-këtu, e shkurtesës EU në vend të BE – Bashkësia Evropiane. BE duhet të jetë gjithmonë shkurtesë standarde sa herë që shkruhet ose flitet shqip. Një tjetër mospërputhje në kontekst të atyre që sapo u cekën, është kur emërtimit dhe shkurtesa për disa organizata janë shqip, bie fjala, Fondi Monetar Ndërkombëtar – FMN, Banka Botërore – BB, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim – BERZh. Mirëpo, vazhdon futja e disa shprehjeve origjinale të huaja edhe nëpër institucione shtetërore, pa e ditur domethënien e tyre, siç është *Task Force.* Nga emërtimi fitohet përshtypja se ka të bëjë me ndonjë njësi speciale ushtarake, çka në fakt ka të bëjë. Për nga përkufizimi, e ka kuptimin e një grupi të përkohshëm nën drejtimin e një udhëheqësi për arritjen e qëllimit të caktuar. Me fjalë tjera, është grup me detyra dhe mision të caktuar. Prandaj, përpos ushtrisë, termi *task force* në gjuhën angleze përdoret thuajse në çdo lëmi tjetër. Si i tillë ose në origjinal ka filluar të përdoret edhe në gjuhën shqipe, pa e ditur kuptimin e tij, madje as nga ata që mund të jenë pjesë e tij. Për shembull, *task forca* për luftimin e korrupsionit në Kosovë. Kuptimi dhe përkthimi më i përshtatshëm në gjuhën shqipe është *grupi punues,* ose edhe *ekipi i ekspertëve.*

Ndikimi i globalizimit ekonomik dhe gjuhës angleze ka bërë që shumë shtete, për interesa ekonomike, të përdorin emërtime dhe shkurtesa në anglisht. As Shqipëria dhe Kosova nuk qëndrojnë anash këtij ndikimi me adresat e faqeve të internetit dhe emërtimin zyrtar të disa institucioneve me shkurtesë anglisht si IPAK – Investment Promotion Agency of Kosova (Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë – APIK, megjithëse ky nuk është përkthim i duhur që

është në përdorim të gjerë nga mediat dhe pushteti) dhe ALBINVEST. Derisa kjo terminologji është e pranueshme për shkak të qëllimit që i shërben, problem të vogël ndoshta paraqesin emërtimet dhe shkurtesat e përdorura në Kosovë, ku gjuha shqipe e ka statusin e gjuhës zyrtare sikur anglishtja dhe serbishtja. Secili institucion i Republikës së Kosovës i ka emërtimet dhe shkurtesat në tri gjuhë; ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës (shqip), KAS – Kosovo Agency of Statistics (anglisht), dhe ASK – Agencija za Statistiku Kosova (serbisht), e kështu me radhë për të gjitha institucionet tjera. Në Kosovë, ndryshe nga shtetet tjera, mungon statusi ligjor i gjuhës kryesore. Ta zëmë, nëse investitorët e jashtëm ose turistët janë të interesuar për investime ose vizita si turist në Shqipëri, Serbi, Slloveni, Greqi, Arabi ata e dinë paraprakisht se cila është gjuha kryesore e këtyre shteteve me të cilën komunikon gati e tërë popullsia. Në bazë të kësaj logjike, duhet të sqarohet ose ndryshohet statusi ligjor i gjuhës shqipe në Kosovë prej gjuhës zyrtare në gjuhë kryesore ose të shtetit. Kjo do të ishte në dobi të madhe edhe për investitorët e huaj dhe turistët. Sa ia vlen në arenën ndërkombëtare të iu thuhet investitorëve dhe bizneseve se Kosova ka tri gjuhë zyrtare, ata të mësojnë njërën prej tyre (anglisht ose serbisht), ndërsa kur vijnë hasin mbi 90 për qind të popullsisë që flasin dhe komunikojnë shqip dhe shumica prej tyre nuk dinë anglisht dhe/ose serbisht që e kanë statusin ligjor të barabartë me shqipen?

Në përmbledhje të këtij nëntitulli, duhet theksuar se gjendja e tanishme e terminologjisë së ekonomisë në kontekst të asaj të mëparshme, në njërën anë ka sjellë disa përparësi dhe përfitime, ndërsa në anën tjetër edhe disa dobësi dhe humbje. Padyshim se mundësia më e madhe e thithjes së termave të ri bashkëkohorë të domosdoshëm, është përfitim. Hyrja masive e barbarizmave përmes përkthimeve të pa sqaruara dhe shqipëruara si duhet ose problemi i standardizimit, është dobësi dhe humbje. Po që se bëhet një krahasim i përgjithësuar, mund të konstatohet se

gjendja e tanishme në raport me atë të mëparshme është më e mirë në sasi, por më e dobët në cilësi. Si e tillë, terminologjia e sotme bëhet më e pakapshme për shumicën e njerëzve, prej nga rrjedhin vështirësi në realizimin e projekteve sipas planeve dhe zbatimin e reformave.

Ndërsa në përmbyllje, vërehet se problemet e terminologjisë së tanishme kanë shumë burime dhe shkaqe. Mungesa e studimeve, simpoziumeve shkencore, konferencave, punimeve dhe interesimit për hulumtime, mund të vlerësohet si problemi më madhor pse sot kemi një terminologji të ngatërruar dhe jo aq të standardizuar në shkencën e ekonomisë. Duke mos pasur mekanizma të duhur kontrolli, nuk është habi pse kemi një cilësi të pakënaqshme në arsimin e lartë të shoqëruar me korrupsion, plagjiaturë (kopjim), dhe kreativitet të kufizuar. Përkrahja e pamjaftueshme, ose edhe mospërkrahja financiare dhe morale nga ana e institucioneve dhe fondacioneve, ka rezultuar me përkushtim më të vogël në punën shkencore. I tërë ky zinxhir ka ndikuar në degëzimin e problemeve tjera siç janë, anashkalimi i qëllimshëm i termave të standardizuar në shqip, rënia e interesimit për lexim shkencor (me përjashtim të studentëve, pedagogëve dhe studiuesve), dhe ndërlidhja e dobët e gjuhësisë me ekonominë dhe rrjedhat e saj.

4. Vërejtje përmbyllëse dhe detyrat

Terminologjia e gjuhës shqipe ka filluar të unjësohet që nga momenti kur alfabeti është bërë i detyrueshëm, ndërsa ajo e ekonomisë pas Luftës së Dytë Botërore. Detyrimi në një formë është parakusht i unjësimit, si thjeshtëzim dhe lehtësim i përdorimit të terminologjisë. Nga analiza e gjendjes së terminologjisë së ekonomisë në gjuhën shqipe, u hasën disa probleme strukturore që kërkojnë zgjidhje. Një prej përfundimeve më kryesore është se gjuha shqipe nuk ka aq mungesë të termave ekonomike, porse burimi i problemit është i dyfishtë. Në

njërën anë, përdorimi i kufizuar i termave të njohur në shqip, dhe në anën tjetër, futja me apo pa qëllim i barbarizmave (pa llogaritur neologjizmat të cilët duhet të trajtohen dhe shqipërohen me kohë) nga studiuesit dhe ekonomistët. Rastin e dytë disa e pëlqejnë, ndoshta për t'u kamufluar tek një pjesë e publikut, studentët e tyre dhe lexuesit, se terminologjia e tyre ekonomike është shumë e përparuar, në trende bashkëkohore, dhe se kërkohen njohuri të mëdha për ta kuptuar. Nga ky përfundim, dalin disa detyra kryesore.

Detyra e parë padyshim është zhvendosja e trajtimit të lëndës nga fjalorët dhe përkufizimet, në një sistem hulumtimi të vazhdueshëm nga shumë këndvështrime. Nga kjo pastaj do të pasonin analizat për segmente të terminologjisë së ekonomisë, me çka do të mundësohej edhe botimi i fjalorëve të ri sipas problemeve të trajtuara në këtë punim, që do të ishin më të veçantë nga ata që kanë ekzistuar deri sot. Analizat më tutje do të duhej të nxisnin komente, kritika, mendime dhe diskutime, për t'u kthyer në sintezë të rekomandimeve për standardizimin e terminologjisë.

Detyra e dytë është ruajtja ose rritja e përdorimit të termave me domethënie të qartë në shqip përballë atyre të gjuhëve të huaja që në shikim të parë janë të pakapshëm për shumicën. Me radhë vjen detyra e shqipërimit të termave të ri, sidomos të atyre që vijnë nga ndikimi i globalizimit dhe përparimi i shkencës ekonomike. Mbajtja e vazhdimësisë dhe periodicitetit të rregullt të botimeve është detyrë tjetër me rëndësi të veçantë. Nëse është një punë e mirë në periudhë të caktuar kohore dhe është ndërprerë, atëherë asaj pune i zvogëlohet vlera nëse nuk vazhdohet dhe ndaj saj sillen përmirësime plotësuese.

Detyrë e parafundit nga ky punim, do të ishte nxitja dhe përkrahja e bashkëpunimit ndërmjet një numri veprimtarësh të përbërë nga ekonomistët, hulumtuesit e pavarur, albanologët, gjuhëtarët, pedagogët dhe studentët rreth terminologjisë së ekonomisë. Që të bëhet i mundur dhe funksional ky koalicion,

rekomandohet përkrahja financiare dhe morale nga institucionet shtetërore dhe fondacionet tjera. Përkrahja morale është sidomos e rëndësishme, edhe pse studiuesit ankohen se fjalët e mira dhe respekti për punën dhe ekspertizën e tyre nuk po mungojnë nga ata që do të duhej t'i përkrahnin edhe materialisht. Vlerësimi i drejtë i veprës dhe kontributit, ekspertizës, profesionalizmit dhe rëndësia që këto kanë për shoqërinë, janë përkrahje morale.

Rekomandimet për detyrat e parashtruara pak a shumë dihet se kujt i adresohen. Mbetet detyrë e re në hulumtimet tjera që këto rekomandime të zbërthehen më konkretisht dhe me adresa më të sakta. Rezultatet e pritura nga detyrat ekzistuese të propozuara, po që se do të realizoheshin, supozohet se do të kishin shumë efekte pozitive në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe, dhe atë në: i) ndaljen e bredhjes nëpër termat e gjuhëve të huaja sipas „nevojës" historike dhe eliminimin e shumë paqartësive; ii) terminologji më të unjësuar dhe komunikim më efikas; botime më profesionale dhe më të kuptueshme; iii) lehtësi më e madhe për zbatimin e strategjive dhe reformave ekonomike ose ndërlidhje më e mirë ndërmjet planeve në letër dhe rezultateve në terren; dhe, iv) krijimin e lehtësirave më të mëdha për studimin dhe përparimin e shkencës së ekonomisë tek shqiptarët si rezultat i terminologjisë më të unjësuar. Fare në fund, mbetet trajtimit i drejtshkrimit të gjuhës në temat dhe veprat nga ekonomia. Ky nuk ka qenë në mesin e qëllimeve kryesore të këtij punimi meqenëse më tepër është kompetencë e gjuhëtarëve, e më pak e ekonomistëve.

Bibliografi

Ahmeti, Skënder (2007), *Kontabiliteti financiar,* Universiteti Mbretëror Iliria, Prishtinë.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë (2002). *Fjalor i shqipes së sotme*, 2002, botimi

i dytë, Toena, Tiranë.

Black, John (1997), *A dictionary of economics,* New York: Oxford University Press.

Byung-Yeon, Kim and Pirttilä, Jukka. (2006), Political Constraints and Economic Reform: Empirical Evidence from the Post-communist Transition in the 1990s, *Journal of Comparative Economics*, Vol. 34, No. 3, pp. 446–466.

Demiraj, Shaban (1989), *Gjuha shqipe dhe historia e saj,* Prishtinë: Rilindja.

Dornbush, Rudiger dhe Fisher, Stanly (2000), *Makroekonomia,* [Përkthim i botimit të gjashtë (1994)], përkthyer nga Muço, Marta dhe Hadëri, Sulo, Tiranë: Dituria.

Fevziu, Blendi (2005), *Histori e shtypit shqiptar 1848-2005*, Tiranë: Onufri.

Gorani, Hajrullah (2006), *Leksikon i vogël ekonomik*, Prishtinë: Libri Shkollor.

Hausmann, Ricardo., Rodrik, Dani and Velasco, Andres (2005), *Growth Diagnostics*, John F. Kennedy School of Government, Harvard University: Cambridge, Massachusetts.

Havolli, Ymer, (2003), *Menaxhimi i resurseve humane*, Prishtinë: Riinvest.

Instituti Alb-Shkenca (2008), *Shkenca në shërbim të shoqërisë shqiptare*, Libri i përmbledhjeve nga takimi i tretë vjetor i Institutit Alb-Shkenca "IASH 2008", Tiranë: Erik.

Konini, Maksim. dhe Peçi, Ilia, (1997), *Fjalor ekonomik shqip-anglisht-gjermanisht*. Botimi i tretë, Tiranë: Civet.

Kutllovci, Enver (2004), *Menaxhimi i resurseve humane*, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik.

Ndreca, Mikel (2007), *Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe*, Tiranë: Toena.

Nikolajeviq-Teofanoviq, Radmila (1980), *Teoria dhe metodologjia e llogaritarisë*, [Përkthim i botimit të gjashtë (1978), përkthyer nga Dushi, Haki], Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.

Obradović, Milovan. (1981), *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941),*

Priština: Institut za Istoriju Kosova.

Pano, Aristotel. (2002), *Fjalor ekonomiko-financiar*, Tiranë: Albin.

Qesku, Pavli (2002), *Fjalor anglisht-shqip: English-Albanian Dictionary*, Tiranë: EDFA.

Varian, Hal. R. (2000), *Mikroekonomia: Trajtim modern*, [Përkthim i botimit të tretë, përkthyer nga Kule, Dhori. dhe Mançellari, Ahmet], Tiranë: Onufri.

SHTOJCË

Tabela 1: Termat të përdorur në shqip që janë huazuar nga anglishtja dhe/ose gjuhë tjera

Shprehja e duhur shqip	**Shprehja e huazuar në përdorim**	**Shprehja burimore e huazuar**
Burime/Pasuri njerëzore	Resurse humane	Human resources
Dërgesat/transferet monetare të emigrantëve	Remitanca	Remittances
Ekonomikë	Ekonomiks	Economics
Këshilli drejtues	Bordi i menaxhmentit	Management board
Konkurrim	Aplikim	Apply/Application
Lakore	Kurba	Curve
Para e gatshme/Arka	Kesh	Cash
Pasuri/Mjete/Kërkesa	Asete	Assets
Rendiment/Rezultat	Performancë/Autput	Performance/Output
Shoqatë afariste	Asociacion i biznesit	Business association
Fletëaksione	Aksione	Shares
Vendosje/Përndarje/Dedikim	Alokim	Allocation
Veprimtari	Aktivitet	Activity

Tabela 2: Termat rishtas të huazuar që nuk figurojnë në fjalorët e gjuhës shqipe si barbarizma

Shprehja e huazuar	Kuptimi në shqip dhe përdorimi i standardizuar	Burimi i huazimit në anglisht
Brain drain/gain	Varfërim/pasurim intelektual/ mendor	Brain drain/gain
Ekuitet	Kapital aksionar/vetjak	Equity
Fiduciar	Siguri/mirëbesim	Fiduciary
Piku	Kulminacioni/pika më e lartë	Peak
Stafi	Kuadri njerëzor/Personeli	Staff/ing
Staf miting	Mbledhja/kuvendi e/i personelit	Staff meeting
Task Force	Task Force	Grupi punues/Ekipi i ekspertëve
Ueb sajt	Faqe interneti	Web site

Izer Maksuti*

Roli i terminologjisë profesionale në përkthimin e teksteve të specializuara

Abstrakt

Tanimë është i njohur karakteri ndërdisiplinar i terminologjisë profesionale. Njohja dhe zotërimi i saj nga përkthyesit e specializuar është domosdoshmëri.

Qëllimi i kësaj kumtese është të trajtojë rëndësinë e terminologjisë profesionale në tërë procesin e përkthimit të teksteve të specializuara.

Kohëve të fundit gjithnjë e më shumë tekste që hartohen, janë tekste të specializuara dhe një pjesë e mirë e tyre përkthehen edhe në gjuhë të ndryshme. Përkthimi i teksteve të specializuara kërkon njohje të dijes profesionale dhe të terminologjisë profesionale.

Do përmendim këtu edhe nevojën që kanë përkthyesit e specializuar për mjetet ndihmëse. Ndër ta janë edhe glosarët që shpesh hartohen nga specialistët e fushës dhe nga vetë përkthyesit e specializuar. Ky punim ka për qëllim që në mënyrë të përmbledhur dhe të thjeshtëzuar të ofrojë të dhënat më thelbësore të kësaj fushe si ndihmesë për përkthyesit e specializuar.

Fjalë çelës: *Terminologjia profesionale, përkthime të specializuara, dije profesionale, glosar, leksiku terminologjik, terminologjizimi.*

* Prof. dr. Izer Maksuti, profesor në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren izer.maksuti@uni-prizren.com, dhe mësimdhënës në departamentin e gjermanistikës, Universiteti i Tetovës. E-Mail: izer.maksuti@unite.edu.mk

Hyrje

Që si fëmijë përmes gjuhës njohim botën dhe marrim dije, ndërsa si të rritur gjatë ballafaqimit të përditshëm me fusha të ndryshme të jetës, duke njohur dhe ushtruar profesione të ndryshme, përmes gjuhës profesionale kuptojmë e marrim dije profesionale.

Duhet theksuar rolin e terminologjisë në komunikimin ndërgjuhësor dhe ndërkombëtar, si dhe ndikimin e formave të komunikimit në sistemin terminologjik të çdo gjuhe.

Terminologjitë e gjuhëve të mëdha si anglishtja, frëngjishtja, spanjishtja, gjermanishtja janë më të pasura dhe më të detajuara, se ato të gjuhëve të vogla, në rastin tonë e gjuhës shqipe dhe maqedonishtes. Kjo është pasojë e zhvillimeve të vonshme e të pamjaftueshme të leksikografisë, terminografisë dhe të hulumtimit metaleksikografik.

Përkthyesi gjatë procesit të përkthimit duhet të identifikojë fushën shkencore pjesë e së cilës është teksti. Gjatë këtij procesi tepër i rëndësishëm është të kuptuarit e terminologjisë në tekstet e specializuara dhe përshtatja e saktë e saj në gjuhën në të cilën përkthejmë.

Rreth objektit të hulumtimit të fushës së terminologjisë dhe të terminografisë

Terminologjia është tërësia e termave të një fushe shkencore. Shkenca e terminologjisë merret me njohjen, krahasimin dhe dokumentimin e nocioneve profesionale dhe emërtimin e tyre në një gjegjësisht në më shumë gjuhë.

Pjesë e terminologjisë janë edhe mënyra e formimit të nocioneve, përkufizimi i tyre dhe studimi i sistemit terminologjik, si dhe përpunimi, administrimi dhe përhapja e terminologjisë. Shënimi dhe përkufizimi i nocioneve të një disipline të

caktuar, si dhe normimi dhe standardizimi janë punë shtesë të saj.[2]

Te terminologjia përfshihet gjuha dhe dija profesionale si dhe komunikimi i specializuar. Ajo luan një rëndësi të madhe në institucionet publike dhe private, si dhe në arsim e shkencë. Një përdorim i duhur i terminologjisë mënjanon problemet gjatë komunikimit, lehtëson lexim-kuptimin e teksteve, përmirëson gjuhën e sipërmarrjes (Corporate language), mundëson shfrytëzim më të mirë të potencialit të dijes profesionale. Sidomos në një mjedis shumëgjuhësh, terminologjia dhe puna terminologjike janë të patjetërsueshme për sigurim të cilësisë në mësimdhënie dhe në punën kërkimore-shkencore. Në funksion të gjithë kësaj kërkohet një bashkëpunim i ngushtë i terminologëve dhe specialistëve të lëmit përkatës.

Duke qenë të vetëdijshëm për këto zhvillime të këtyre disiplinave e shohim si domosdoshmëri të kohës që edhe për gjuhën shqipe të ketë studime e përkujdesje të tillë institucionale, pasi po ashtu jemi të mendimit sikurse prof. Lafe:

"se probleme kryesore të zhvillimit të gjuhës shqipe në ditët tona, ashtu si dhe për gjuhë të tjera, janë problemet e fjalorit dhe të terminologjisë"[3].

Po në këtë punim të profesor Lafes për rëndësinë e terminologjisë, gjemë sqarimet e duhura:

"se terminologjia ka aspektin konceptor dhe aspektin gjuhësor. Aspekti konceptor ka të bëjë me ndërtimin e sistemeve të koncepteve të një fushe të shkencës; aspekti gjuhësor me shënimin e këtyre koncepteve nëpërmjet fjalëve më të përshtatshme. Ndërtimi i sistemeve konceptore të një shkence është punë e specialistëve të asaj shkence (p.sh. është punë e gjuhëtarëve të ndërtojnë sistemet e klasifikimit të tingujve, të fjalëve, të fjalive etj.). Caktimi i shprehjes gjuhësore sa më të përshtatshme për këto koncepte është punë e përbashkët e gjuhëtarëve dhe e specialistëve të fushës përkatëse. Terma të veçantë shpesh krijohen nga

2 Shih për më shumë në: Arntz, Rainer/Picht, Heribert/Mayer, Felix (2009) *Einführung in die Terminologiearbeit.* Hildesheim: Olms.

3 Lafe, 2013, 350.

studiues të ndryshëm, por terminologjia si sistem termash është përgjithësisht krijim kolektiv"[4].

Terminografia është një prej degëve të terminologjisë, e cila merret me përshkrimin e termave si dhe me hartimin e produkteve terminologjike: fjalorë terminologjikë, norma, data baza etj.[5] Njohuritë e nocioneve, termave si dhe dokumentimi i tyre në bazat e të dhënave të terminologjisë janë ndër parakushtet kryesore për përkthimet e specializuara.

Për këtë duhet që të përdoret edhe teknologjia më e fundit në fushë të translatologjisë.

Sipas njërit prej specialistëve më të njohur në këtë fushë, Peter Sandrini[6] profesor në Universitetin e Insbrukut, Austri, si pjesë e "parakushteve më të domosdoshme të përkthimit të specializuar janë njohuritë në vijim: bazat e të dhënave teknike, teknologjia e tekstit specifike për përkthim, menaxhimi i projekteve të përkthimit, menaxhimi i terminologjisë, menaxhimi i korpusit profesional, Translation-Memory-Technology –TMT = (Teknologjia për memorizimin e translacionit), mjete për lokalizim dhe përkthimi automatik/makinerik".[7]

Shkollimi i përkthyeseve në fushë të terminologjisë është një nga prioritetet dhe parakushtet për përkthime cilësore, pasi cilësia e përkthimit ndërlidhet me cilësinë e punës terminologjike.

Terminologjia profesionale, leksiku terminologjik dhe terminologjizimi

Leksik i specializuar (technical vocabulary), përbëhet prej termave të cilët përdoren vetëm në gjuhën profesionale (technical language). Ky lloj leksiku

4 Lafe, 2013, 349.
5 Chiocchetti, Elena/Ralli, Natascia ed. 2013, 71-73 ff.
6 http://www.petersandrini.net/publist.html
7 Sandrini 2016, 169; https://www2.uibk.ac.at/downloads/trans/publik/fachuebersetzen2016.pdf (19.09.2021)

kërkon një zgjerim të vazhdueshëm, pasi edhe drejtimet profesionale pësojnë një zhvillim të pandërprerë. Vazhdimisht ekziston një nevojë e gjetjes dhe përdorimit të emërtimeve, termave të ri, si p.sh. në fushën e kimisë kemi tanimë rreth 10 milionë fjalë.

Pjesë e *leksikut terminologjik* janë fjalët me përdorim vetëm në një fushë profesionale, profesionalizmave, pra fjalëve të njëkuptimshme që përdoren në një profesion të caktuar.

Terminologjizimi ndodh kur emërtime, fjalë që përdoren në gjuhën e përditshme, pësojnë një zgjerim apo ngushtim semantik, pra kemi kufizime kuptimore. Fjalët e zakonshme marrin kuptime të ngushta terminologjike. P.sh. *grup, kthesë, nxehtësi, sasi, vesh* etj. në gjuhën profesionale të fizikës, matematikës kanë kuptime të ngushta. Ky proces i terminologjizimit haset thuajse te çdo gjuhë profesionale.

Krijimi i termave të ri ndikon edhe në strukturën dhe funksionin e fjalorëve terminologjikë. E kemi të njohur faktin se fjalorët si mjet ndihmës gjatë leximkuptimit të teksteve, shpesh i zhgënjejnë përdoruesit, meqë nuk përmbushet pritshmëria e tyre, pasi nuk gjejnë emërtimet dhe termat e kërkuar. Edhe gjatë procesit të hartimit të tekstit në gjuhën në të cilën përkthejmë, fjalorët e ndryshëm rrallë përmbushin pritjet e përdoruesit.

Puna terminologjike dhe përkthyesit e specializuar

Për punën terminologjike[8] me rëndësi thelbësore janë sqarimi e kuptimi i tre nocioneve bazë: **objekti** (object), bëhet fjalë për gjësende konkrete, me të cilat kemi të bëjmë, apo duam të flasim ose tema e gjendje faktike abstrakte, apo edhe veprime; **nocioni** (term), nocioni shënjon idenë, parafytyrimin që kanë njerëzit për objektet. Nocionet me ndihmën e tipareve, cilësive karakteristike, mund të

8 Shih për më tepër këtë doracak për fushën e punës terminologjike: https://termcoord.eu/wp-content/uploads/2018/12/kuedes_empfehlungenfuerdieterminologiearbeit2003.pdf (22.11.2021)

përshkruhen dhe përkufizohen njëri nga tjetri; dhe **emërtimi** (designation), për të folur e shkruar mbi objektet dhe nocionet, na duhen mjete gjuhësore, këto paraqitje gjuhësore të nocionit në terminologji i quajmë emërtime apo terma. Bashkëveprimi i nocionit dhe termit në punën terminologjike është thelbësor.

Përcaktimi, përshkrimi dhe lëvrimi i terminologjisë kërkon bashkëpunimin e ngushtë të terminologëve, terminografëve dhe të specialistëve të lëmit përkatës[9]. Kjo mundëson përpunimin sistematik, vlerësimin, si dhe përzgjedhjen e mbledhjen në mirëbesim të terminologjive. Në kuadër të një projekti tematik terminologjik, në rastin më ideal terminologët bashkëpunojnë që në fillim me specialistët e fushës përkatëse[10].

Sipas standardeve të njohura të punës terminologjike janë disa hapa të punës dhe faza të realizimit të projekteve terminologjike. Dallohen këto hapa të punës terminologjike:

- Planifikimi (Sqarimi i qëllimeve, resurseve, organizimit, kohës, kostos etj.);

- Mbledhja, hulumtimi dhe vlerësimi (i terminologjisë, bibliografisë, burimeve; strukturimi i nocioneve si dhe renditja e emërtimeve);

- Përpunimi dhe shënimi i të dhënave (Shënimi i njësive në të gjithë gjuhët; hartimi, përcaktimi i përkufizimeve, shënimeve plotësuese, kontekseve);

- Kontrolli i cilësisë dhe vlerësimi (vlerësimi metodik, kontrollimi i respektimit të rregullave metodike; vlerësimi i korrektësisë gjuhësore);

- Përfundimi, publikimi dhe përkujdesja (Publikimi i tërësisë së të dhënave, data bazat, publikimet e fushës etj.; sigurimi i cilësisë, aktualizimi i rregullt i të dhënave, pasurimi e zgjerimi; hulumtimi i problemeve të standardizimit);

- Rikontrollimi i përdorimit të terminologjisë (Puna sipas parimeve të

9 Shih materialin mbi fushën e terminologjisë: Terminology Starter Guide, http://www.terminorgs.net/downloads/TerminOrgs_StarterGuide_V2.pdf (19.09.2021)

10 Shih të dhëna të dobishme për këtë temë: How to create a terminology database or glossary, https://quicksilvertranslate.com/5546/terminology-database/

përcaktuara; kontrollim i vazhdueshëm i përdorimit)[11].

Çfarë është përkthimi i specializuar? Nocioni "përkthim i specializuar"

"Përkthimi i specializuar" është përkthimi profesional i teksteve shkencore dhe të specializuara nga një përkthyes/e, ose specialist i fushës, i cili përveç kompetencës translatorike (të fushë së përkthimit), ka edhe dijen profesionale dhe përvojën në fushën e lëmit përkatës.

Me këtë nocion nuk nënkuptojmë vetëm përkthimin e teksteve nga fusha e teknikës, fizikës, biologjisë, kimisë, juridikut, ekonomisë, si dhe të shkencave humane si pedagogji, psikologji, filozofi, sociologji etj., por mund t'i emërtojmë edhe tekstet e llojit të veçantë të përpunimit dhe ofrimit të informacionit e të dhënave.

Me dekada, në kuadër të gjuhësisë së tekstit dhe tipologjisë së tekstit, ka studime, kategorizime e teori të ndryshme, megjithatë nuk ka ende kufij të ngurtë në mes teksteve të letërsisë së bukur dhe teksteve të specializuara. Madje disa dallime janë jo aq të qëndrueshëm, si p.sh. një roman historik mund të duket e të jetë tepër i ngjashëm me një tekst të specializuar të historisë.

Rëndësia e zhargonit profesional dhe teksteve të specializuara shtohet gjithnjë e më shumë, me këtë edhe përkthimi i specializuar, pasi përmes tij tejkalohen barriera gjuhësore, profesionale dhe kulturore. Për të marrë dije profesionale sa më aktuale në një lëmë të caktuar, duhet të përdorim edhe tekste që janë hartuar edhe në gjuhë tjera të mëdha botërore. Edhe pikërisht këtu përkthimi i specializuar luan një rol të veçantë.

Në këtë rast përkthyesi është ndërmjetësues dhe bartës i komunikimit

11 Krh. fq. 7-8, http://radt.org/images/veroeffentlichungen/Basiswisssen%20-RaDT2013-16s_ebook.pdf, http://radt.org/images/veroeffentlichungen/Basiswisssen-engl%20-RaDT2014-12s-rz.pdf (21.12.2021)

ndërgjuhësor e ndërkulturor profesional. Për atë është shumë e rëndësishme që ai të kuptojë drejt tekstet e specializuara, për këtë parakusht është kompetenca e duhur, dija profesionale, njohja e terminologjisë etj. Në rastin ideal do të ishte zgjidhja e duhur po të gjenden për çdo tekst të specializuar përkthyes të specializuar, të cilët janë ekspert të specializuar për lëmin e tyre specifik. Përkthimet e specializuara më së miri bëhen nga ata që e kanë gjuhë amtare, gjuhën në të cilën duhet të përkthehet.

Këtu kemi të bëjmë me një komunikim të specializuar ndërgjuhësor dhe transkulturor, me qëllimin kryesor që të dhënat dhe dija profesionale të bëhet e njohur dhe bartet edhe në gjuhë tjera për njerëz të fushës profesionale dhe laikë.

Kjo kërkon tejkalimin e vështirësive të komunikimit për shkak të gjuhëve, fushave dhe kulturave të ndryshme kombëtare.

Në gjuhë të ndryshme kemi kultura të ndryshme të përkthimit të teksteve të specializuar, dallime në formën dhe strukturën e komunikimit, të cilat janë barriera dhe shkaktojnë vështirësi në procesin e përkthimit. Këto dallime të infrastrukturës së komunikimit janë ngarkesë shtesë dhe kërkojnë nga përkthyesit që të përdorin terma të ri, dhe sistem tjetër terminologjik, si dhe përshtatje të llojeve të teksteve.

Përkthimet e specializuara, janë një lloj i veçantë i përkthimeve dhe si i tillë edhe përkthimi i specializuar merret si komunikim i specializuar ndërgjuhësor. Si për çdo përkthim edhe në këtë rast thelbësorja është "skoposi" = qëllimi dhe funksioni që plotëson përkthimi.

Disa karakteristika të teksteve të specializuara

Këto tekste karakterizohen nga disa tipare. Që në shikim të parë e bëjmë dallimin se a kemi të bëjmë me një tekst letrar apo të specializuar. Këto tekste kanë një

titull përmbajtjesor, tematik, të gjatë, shpesh me një nëntitull. Pra, për dallim nga beletristika dhe tipat tjera të teksteve, tekstet e specializuar kanë një gjuhë tjetër të qartë dhe ekzakte, një zhargon profesional. Tipare tjera janë edhe strukturimi i qartë, transparenca, abstraksioni, gjuha formale dhe e pa personalizuar. Mjetet dhe ndikimet estetike këtu nuk kanë rëndësi.

Përveç mjeteve të natyrshme gjuhësore si fjalët, fjalëformimet, fjalitë, te tekstet e specializuara ka edhe elemente tjera të gjuhës artificiale. Këtu bëhet fjalë për një sistem tjetër të shenjave, shkurtesave, formulave matematikore, barazimeve, numrave, tabelave, diagrameve, fotografive, hartave etj., të cilat sidomos në tekstet teknike janë bartës primarë të informacionit. Këto tekste për të qenë edhe më të kuptueshëm, ndahen edhe në kapituj, nënkapituj, paragrafë dhe kanë një ndërtim tjetër sintaksor. Pra, këto tekste qëllimisht hartohen në një gjuhë profesionale dhe me një stil funksional, i cili është përplot me terma, fjalë të huaja nominalizime, kompozita. Autori këtu para së gjithash mundohet që lexuesit t'ia sqarojë, përshkruajë dhe bëjë sa më qartë dhe të kuptueshme përmbajtjen e tekstit. Pra, që nga fillimi dihet se për cilin grup lexuesish është hartuar teksti. Qëllimi i tekstit është sqarimi përmes formulimeve shumë të qarta dhe fjalive të shkurta, shpesh kemi një përdorim të fjalëve tema.

Disa vështirësi gjatë procesit të përkthimit të teksteve të specializuara

Të përmendim këtu disa pengesa e kurthe gjatë përkthimit. Këtu bëjnë pjesë: Informacioni i munguar, kuptimet e shumta të fjalës (në çfarë kontekst është përdorur) përmes fenomeneve të **interferencës** (më shumë në fushën e leksikut, sidomos në rrafshin e idiomave dhe lokucioneve), mund të përkthehet gabimisht. Edhe **ndërkombëtarizmat** (veçmas në ortografi), **miqtë e rrejshëm**, si p.sh.

“librari” në shqip “dyqan ku shiten libra” dhe “library” në anglisht “bibliotekë”, janë pengesa e ngatërresa gjatë këtij procesi të përkthimit.

Këtu hyjnë edhe automatizmat (sjelljet e pavullnetshme dhe pavetëdijshme, të automatizuara), terminologjia e fushave të ndryshme, llojet e ndryshme të tekstit; formimet e reja të fjalëve, fjalët e huaja, më së shumti anglicizmat etj.

Problemet e përkthimit ndahen në tre grupe: si probleme kulturore (konvencionale), ata me specifika gjuhësore dhe probleme situativë (pragmatikë).

Në grupin e problemeve **kulturore** (konvencionale) bëjnë pjesë përkthimi i emrave të përveçëm, emërtimeve, emrat e vendeve, nocioneve, si të ushqimeve, festave, veshjeve, institucioneve, njësive matëse etj. Në raste të tilla, pasi kemi veçori të ndryshme kulturore për çdo fjalë secili folës mund të mendojë e parafytyrojë diçka tjetër për arsye të ndikimit të tij kulturor.

Probleme të **specifikave gjuhësore** janë kryesisht ata që vijnë nga dallimet në mes të dy sistemeve gjuhësore. Këtu bëjnë pjesë edhe përshtatja e metaforave, lojës së fjalëve, apo figurave tjera retorike. Shpesh në raste të tilla zgjidhjet janë individuale, përmes kreativitetit gjuhësor.

Te problemet **situatave (pragmatike)** janë po aq me rëndësi rrethanat (situatat) në të cilat teksti origjinal ose i përkthyer do të lexohet. Vendi dhe rrethanat e kohës duhet të përshtaten ose sipas nevojës të sqarohen. Po ashtu tipografia, lejaut, si dhe shenjat e shkrimit të kulturave të ndryshme të shkrimit mund të shkaktojnë probleme gjatë përkthimit.

Çka duhet që të di një përkthyes, për përkthimet profesionale të specializuara?

Së pari kërkohet njohja e mirë e të dy gjuhëve, të asaj nga e cila përkthejmë (shpesh është gjuhë e huaj) dhe të gjuhës në të cilën përkthejmë (shpesh është

gjuha amtare). Përkthyesi i specializuar duhet të ketë njohje të mirë jo vetëm të të dy gjuhëve, por edhe dije të fushës profesionale, njohuri të specializuara. Duhet të njihen veçoritë e zhargonit profesional, të përkthimit dhe të teksteve të specializuara, si dhe kompetencat që duhet të ketë një përkthyes i specializuar. Por dihet se askush nuk është njohës 100 përqindësh i gjuhës, as i asaj amtare. Profesioni i përkthyesit të specializuar në ditët e sotme është profilizuar në vetëm disa fusha të specializimit të ngushtë[12].

Shpesh teksti origjinal i hartuar në gjuhën nga e cila përkthejmë nuk është në nivelin e duhur gjuhësor. Pra, kemi mangësi gjuhësore të teksteve origjinale. Ndër kompetencat kryesore të përkthyesit të specializuar mbeten: dija specifike profesionale, kompetenca mbi terminologjinë e fushës shkencore, si dhe njohja e nocioneve, termave të lëmit përkatës. Përvoja ndër vite, vetëdija dhe vetëbesimi janë tipare tjera që kërkohen nga një përkthyes.

Thelbi i komunikimit në fushën e specializuar nuk është gjuha e specializuar dhe sistemi i saj kompleks më vete – termat profesional, zhargoni profesional, tekstet e specializuar, stili profesional, llojet e teksteve të specializuara etj., por para së gjithash forma e komunikimit të specializuar që ka të bëjë më shumë me riprodhimin, reprezentimin, paraqitjen dhe përdorimin e dijes së specializuar.

Sfida e përkthyesve sot është *nevoja e përditësimit të dijes* dhe *domosdoshmëria e kompetencës translatorike*, si dhe zotërimi i kompetencës translatorike. **Kompetenca translatorike** përfshin **kompetencën gjuhësore** në radhë të parë zotërimin e gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj (gjuhës së parë dhe gjuhës së dytë), njohjes së mirë jo vetëm të gjuhës në të cilën përkthejmë, por edhe të asaj nga e cila përkthejmë; **kompetencën profesionale** (njohjen e zanatit), metodologjinë e përkthimit (teknikat, strategjitë etj.); **njohjen e terminologjisë** për fushat që përkthejmë, si dhe

12 Shih për të mësuar më shumë ueb faqen e një zyre të përkthyesve të specializuar, https://www.translatorsfamily.com/for-clients/when-do-you-need-a-specialist-translator/, https://www.truelanguage.com/technical-translation-services/, https://www.unker.com/de/fachuebersetzungen.

thellimi i njohurive në fusha terminologjike, të llojeve të ndryshme të teksteve[13].

Mjetet ndihmëse të përkthyesit (të specializuar)

Për ndonjë vështirësi gjatë procesit të përkthimit mënyra më e shpejt për të gjetur zgjidhje është një konsultim me specialistin e fushës. Në rastin ideal, ai gjen kohë për të shfletuar tekstin, më pas i sqaron përkthyesit specifika të temës, përshkruan se për çka bëhet fjalë, deshifron shkurtesat e rralla dhe të panjohura (specifikë kjo e teksteve të specializuara), sqaron termat e domosdoshëm për të kuptuar tekstin, rekomandon fjalorë dhe leksikonë enciklopedikë, e këshillon po ashtu që të përdorë disa tekste paralele të fushës përkatëse[14].

Eksperti ka një perceptim tjetër ndaj këtij procesi dhe këshilla e tij është që ju nuk ka nevojë ta kuptoni tekstin, pasi ju duhet vetëm ta përktheni! Pas kësaj përkthyesi duhet të vazhdojë i vetëm procesin e përkthimit. Është e rekomandueshme që të nisë të hartojë një listë terminologjie me terma që hasen më së shumti në ato tekste të fushës. Për përpunimin e kësaj liste terminologjie përkthyesit i nevojitet shpesh më shumë vepra referimi: fjalorë një dhe dygjuhësh, fjalor shpjegues, leksikonë dhe enciklopedi, si dhe tekste paralele dhe korpus. Po ashtu mund të përdoren edhe fjalorët elektronik online dhe përkthimi makinerik, por duhet provuar saktësia e tyre[15]. E kemi të njohur faktin që përkthyesit shpesh ishin hartuesit e parë të fjalorëve, pasi e dinin vlerën e tyre, si mjete ndihmëse në proces të proces të përkthimit dhe mësimit të gjuhëve.

Përmbledhja e termave dhe hartimi i një liste terminologjie[16] mbetet ende njëra prej mjeteve ndihmëse për të kuptuar dhe përgatitur një përkthim të specializuar.

13 Maksuti, 2020, 35.

14 Shih për më shumë: Translation tools and workflow, http://publications.europa.eu/resource/cellar/63e44619-f502-4a9e-87a1-90b1f29d474b.0003.02/DOC_1

15 What is a Termbase? A central repository, like a database, containing approved terminology. https://www.trados.com/solutions/terminology-management/termbase.html (21.12.2021)

16 Creating a terminology list from your existing translations, http://docs.translatehouse.org/projects/translate-toolkit/en/latest/guides/creating_a_terminology_list_from_your_existing_translations.html

Pas kësaj hapi i radhës i përkthyesit të specializuar është riprodhimi i tekstit origjinal në gjuhën në të cilën përkthen. Gjatë këtij procesi shpesh nuk e kemi të lehtë të gjejmë fjalorët e duhur terminologjikë, aktual dygjuhësh. Pasi edhe po të gjejmë, shumica prej tyre janë të vjetruar. Edhe te ribotimet e fundit shpesh nuk bëhet fjalë për botime të aktualizuara dhe të plotësuara.

Për këtë arsye në raste të tilla të patjetërsueshme janë veprat referuese në gjuhën në të cilën përkthejmë, fjalorët shpjegues, fjalorët terminologjikë dhe enciklopedikë të fushës, leksikonë, tekstet paralele, si dhe fjalorët elektronikë, data bazat terminologjike[17] etj.

Vendet dhe kombet e mëdha punojnë me dekada në hartimin e bazave të të dhënave multilinguale për fusha të ndryshme: teknikë, teknologji, mjekësi, inxhinieri, drejtësi, ekonomi, administratë etj. Projekte të tilla të data bazave terminologjike janë të njohura si: MultiTerm, TermIng, InterActive Terminology for Europe (IATE)[18] etj.

Përkthyesi sipas nevojës, gjatë përkthimit të teksteve të specializuara duhet të mbështetet nga specialisti i fushës. Pra përkthyesi nuk është i vetmi faktor në procesin e përkthimit! Përkthyesit gjatë procesit të përkthimit kanë shpesh nevojë të përdorin mjete ndihmëse dhe t'u referohen atyre.

Përdorimi i fjalorëve të specializuar në këtë rast është më i nevojshëm, pasi termat profesional nuk mund t'i gjejmë në fjalorët e zakonshëm. Po ashtu është e nevojshme njohuria për fjalorët, tipologjinë, strukturën dhe përdorimin e tyre, si të shtypur po ashtu edhe elektronik.

Sidomos gjatë procesit të përkthimit të teksteve të specializuara *tekstet paralele* janë një ndihmesë tepër e dobishme. Si tekste paralele mund të përdoren të

17 Translating with termbases, https://docs.sdl.com/813470/838681/trados-studio-2021-sr1/translating-with-termbases

18 https://www.thulb.uni-jena.de/Datenbanken+und+Register+der+Europ%C3%A4ischen+Union.html; https://edz.bib.uni-mannheim.de/www-edz/pdf/EU_Datenbanken.pdf

gjithë tekstet e ngjashëm, në të cilët trajtohen tema të njëjta apo të ngjashme. Përdorimi i tyre rekomandohet në një sasi të madhe, madje shpesh është tepër i domosdoshëm. Ata na ofrojnë jo vetëm leksikun dhe terminologjinë e ngjashme dhe ekuivalente, por si tekste mund t'i marrim si shembuj për formën e ndërtimit, modelet sintaksore dhe të fjalëformimit. Si fjalorët e specializuar ashtu edhe tekstet paralele na ndihmojnë kryesisht të mënjanojmë paqartësitë dhe pasiguritë gjatë procesit të përkthimit, sidomos në faqen e bartjes së kuptimit dhe hartimit të tekstit në gjuhën në të cilën përkthejmë. Për këtë arsye përkthyesit e specializuar duhet të kenë edhe njohuri mbi terminologjinë si shkencë, përcaktimin e termave, për të bërë përkthimin e tyre në gjuhën në të cilën përkthejnë.

Diskutime dhe përfundimi

Një gjuhë që ka terminologjinë (e fushave të ndryshme) të normëzuar dhe standardizuar, përveç që "sjell lehtësi në qarkullimin e dijeve shkencore, veçanërisht në sistemin arsimor në gjuhën shqipe në të gjitha shkallët në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni e më gjerë"[19], ndihmon edhe në procesin e përkthimit të teksteve të specializuara nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe. Pra, jo rastësisht kërkohet nga të gjithë njësimi i terminologjisë dhe kjo shihet si një ndër detyrat parësore jo vetëm e gjuhësisë mbarë-shqiptare, por e të gjithë disiplinave shkencore që lëvrohen dhe ushtrohen nga shqiptarët kudo që janë, qoftë në tri a katër shtetet e rajonit apo edhe në diasporë.

Dallimet e terminologjisë së gjuhës shqipe, mungesa e normimit, njësimit dhe standardizimit bëhen ndër vështirësitë kryesore në procesin e përkthimit të teksteve të specializuara. Pasi këto dallime, variante të ndryshme të terminologjisë, shkalla e mosnjohjes së tyre, shkaktojnë pengesa dhe huti në drejtkuptimin dhe drejtpërdorimin e termave të fushave të ndryshme. Sidomos në gjuhën e

19 Lafe et al. 2014, 6.

dokumenteve ligjore vërehen një mal dallimesh në mes përdorimit në Shqipëri dhe në Kosovë, por edhe në RMV, megjithëse shqipja e Shqiptarëve të Maqedonisë, është më e përafërt me atë të Kosovës, edhe pse këto tri dekadat e fundit ka një zhvillim më vete dhe një ndikim më të madh nga maqedonishtja. Për këtë arsye kërkohet planifikimi dhe zhvillimi i terminologjisë profesionale. Në këtë proces kompleks bënë pjesë edhe krijimi i resurseve dhe korpuseve gjuhësore si dhe hartimi i fjalorëve terminologjikë, të cilët mbeten ndër mjetet kryesore ndihmëse të përkthyesve të specializuar.

Korpuset shërbejnë ndër të tjera edhe si mjete ndihmëse të përkthyesve të specializuar. Korpuse të tillë kanë më shumë vlerë kur janë dy e më shumëgjuhësh. Përkthyesi i specializuar, pas përvojës së gjatë të ushtrimit të zanatit, bëhet njohës i fushës dhe në mungesë të termave në gjuhën në të cilën përkthen krijon emërtime të reja, pasi kështu:

"përkthyesi vihet në rolin e krijuesit "të detyruar", i cili "natyrshëm" e pa u vonuar, duke përcjellë folësin njëkohësisht, fjalët e të cilit është duke i përkthyer, në ndikimin e rreptë të kufizimit të kohës, nga fjalori mendor (angl. mental lexicon) i tij nxjerr termin më të mirë të mundshëm në situatën e caktuar"[20].

Një ndihmesë e madhe për përkthyesit e specializuar në vendin tonë, sidomos për përkthime të teksteve të specializuara nga fusha e drejtësisë, administratës publike, ekonomisë, politikës etj., janë korpuset paralele. Një korpus i tillë paralel maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht do të ishte një thesari i vërtetë dhe ndër mjetet kryesore ndihmëse edhe i përkthyesve të specializuar.

Siç thamë procesi i analizës dhe kuptimit të teksteve të specializuara është më kompleks, kërkon zotërim të mirëfilltë të dy gjuhëve, dije të thelluar profesionale të fushës përkatëse, si dhe njohje të terminologjisë përkatëse.

Profesioni i përkthyesit, në këtë botën tonë të vogël shqiptare, Ballkanin

20 Kabashi, 2021, 66.

Perëndimor, po bëhet gjithnjë e më i kërkuar, por jo edhe aq i lakmuar, meqë siç përmendëm disa herë më lart, zhvillimi i leksikografisë dhe terminografisë shqiptare nuk është në hap me kohën, produktet leksikografike dhe terminografike, si ndër mjetet kryesore ndihmëse, nuk janë as përafërsisht të mjaftueshme në punën e përditshme të përkthyesve tanë.

Si përfundim dëshiroj të jap kontributin tim modest në kuadër të diskutimeve të deritanishme për çështje të terminologjisë së gjuhës shqipe.[21]

Për të ndryshuar këtë gjendje, e diktuar nga zhvillimet e pjesës së dytë të shek. XX, kriza, lufta dhe "tranzicioni" i stërzgjatur, vështirësitë e procesit të gjatë të demokratizimit të shoqërisë sonë gjatë dy dekadave të këtij fillim-shekulli, do duhet të ndjekim zhvillimet pozitive të vendeve perëndimore. Pra, sikurse atyre edhe neve, si dhe procesit të mbrojtjes e zhvillimit të gjuhës sonë i duhen organizim e mbështetje institucionale[22]. Këtu bëjnë pjesë jo vetëm themelimi e regjistrimi formal i shoqatave, forumeve, këshillave, instituteve etj., por mbështetja, financimi, planifikimi dhe funksionimi i mirëfilltë i tyre. Në këto dy dekadat e fundit ka pasur përpjekje për organizim e veprime të përbashkëta për terminologjinë, por pa mbështetje institucionale nga të tre shtetet dhe pa ekzistencën e institucioneve të duhura nuk mund të arrihen suksese[23].

Për atë e rekomandueshme në këtë rast do ishte themelimi e funksionimi institucioneve të mëposhtme, si:

1. **Shoqata e Përkthyesve Shqiptarë** (Shqip., RKS, RMV etj.)[24];

E dimë që tanimë ka shoqata të përkthyesve në shtetet e hapësirës shqipfolëse, por me interes do të ishte të ketë bashkëpunim më të frytshëm në mes tyre. Për atë mbase do të ishte më i dobishëm themelimi dhe funksionimi i një shoqate

21 Shih kontributin e profesor Emil Lafe botuar në AKTET VI, 4: 347-351, 2013, Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca.

22 Shih: Kranebitter 2021, 171 ff.

23 Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së, https://apj.gov.mk/, që nga themelimi më 2019 ka punuar, për nevoja të veta edhe në këtë drejtim; shih: Fjalorin terminologjik kontekstual interpretues VERBIS (www.verbis.gov.mk).

24 Shih si model: www.dbue.de, www.astti.ch, www.universitas.org.

mbarëkombëtare të përkthyesve shqiptarë, për koordinim më të lehtë e më efikas të bashkëpunimit në mes Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit.

2. **Këshilli i Terminologjisë së Gjuhës Shqipe** (Shqip., RKS, RMV etj.)

Ky Këshill do përbëhej prej ekspertëve të fushave të ndryshme për të mbështetur zhvillimin e terminologjisë në hapësirën shqipfolëse. Këshilli do të mblidhte dhe përfaqësonte organizata, shoqata, institute, si dhe institucione arsimore, të drejtësisë, ekonomisë, teknikës e teknologjisë, industrisë, turizmit etj., të cilat merren me terminologjinë. Ndër qëllimet kryesore do të ishin edhe koordinimi dhe këshillimi, si dhe organizimi i konferencave (vjetore), simpoziumeve (dyvjetore), punëtorive për të zgjidhur probleme të fushës profesionale të komunikimit. Do duhej të kërkohet mbështetja edhe e Komisioneve të vendeve pjesëmarrëse të UNESCO-s, si dhe përkrahja e institucioneve të tilla në vendet perëndimore[25].

3. **Instituti i Normimit të Terminologjisë** (Shqip., RKS, RMV etj.);

Ndër qëllimet kryesore të funksionimit të këtij instituti do të ishte organizimi i punës së komisioneve të normimit të terminologjisë, rëndësia e gjuhëve profesionale për të gjithë procesin e normimit, si dhe veglat e punës terminologjike, praktika e përkthimit dhe leksikografia. Ky institut do të kishte autorizimin e një institucioni normëzues për gjuhën shqipe, me këtë do të plotësonte vakumin ekzistues, si pasojë e mungesës së një institucioni të tillë në botën shqiptare për gjuhën shqipe.[26] Përfaqësues të Komisionit të Normimit të këtij instituti do të përfaqësonin në rrafsh ndërkombëtar (ISO) kërkesat që ndërlidhen me gjuhën shqipe[27].

Nga këto tri organe dhe me mbështetje tjetër shtetërore e private, do mundësohej ngritja dhe mirëmbajtja e një **Portali i Terminologjisë së Gjuhës Shqipe**.

Ai portal i terminologjisë ofruar në internet, do të ishte vendi i duhur për të

25 Shih si model: www.rdt.org; www.dttev.org.

26 Një institut të tillë, me gjithë kontributin që japin, nuk mund ta zëvendësojnë as "Drejtoria e Standardizimit" pranë Ministrisë së Ekonomisë, e as "Drejtoria e Përkthimit" pranë Ministrisë së Integrimeve.

27 Shih si model: www.nat.din.de.

drejtuar pyetje mbi çështje terminologjike[28].

Duke përfunduar rikujtojmë se është në natyrën e punës së përkthyeseve të specializuar që të përkthejnë lloje të ndryshme të teksteve në përditshmërinë e ushtrimit të zanatit të tyre.

Pasi tekstet që hartohen viteve të fundit, gjithnjë e më shumë janë të specializuara, për atë edhe përkthimet dhe përkthyesit janë dhe duhet të jenë të specializuar.

Gjithsesi gjatë procesit të përkthimit nuk bëjmë vetëm përkthimin e nocioneve dhe termave, por duhet të përfshimë tërësinë e tekstit.

Për atë përkthyesit e specializuar duhet të kenë edhe njohuri mbi terminologjinë si shkencë, përcaktimin e termave, për të bërë përkthimin e tyre në gjuhën në të cilën përkthejnë.

Dallimet e terminologjisë në gjuhën shqipe, mungesa e normimit, njësimit dhe standardizimit, si dhe mungesa e produkteve leksikografike e terminografike aktuale, voluminoze e të nivelit të duhur, si mjete ndihmëse të punës, bëhen ndër vështirësitë kryesore në procesin e përkthimit të teksteve të specializuara.

Bibliografia

Albrecht, Jörg (2005) *Übersetzung und Linguistik*. Tübingen: Narr.

Arntz, Rainer/Picht, Heribert/Mayer, Felix (2009) *Einführung in die Terminologiearbeit.* Hildesheim: Olms.

Baker, Mona (Ed.), (2001) *Routledge encyclopedia of translation studies.* London: Routledge.

Barkowski, Hans/Krumm, Hans-Jürgen (Hrsg) (2010) *Fachlexikon Deutsch als Fremd- und Zweitsprache*. Tübingen: Narr UTB.

Budin, Gerhard ed. (1996) *Mehrsprachigkeit in der Fachkommunikation*. Wien: TermNet (IITF, Infoterm)

28 Shih si model: www.termportal.de.

Chiocchetti, Elena/Ralli, Natascia ed. (2013) *Guidelines for collaborative legal/ administrative terminology work.* Bolzano/Bozen: Eurac. https://cordis.europa.eu/docs/projects/cnect/7/270917/080/deliverables/001-D33Guidelinesforcollaborativelegaladministrativeterminologywork.pdf (21.11.2021)

Fachsprachen: *ein internationales Handbuch zur Fachsprachenforschung und Terminologiewissenschaft***. =** *Languages for special purposes***/Hoffmann, Lothar; Kalverkämper, Hartwig u. Herbert Ernst Wiegand (Ed.): Verlag: Berlin, de Gruyter. (Handbücher zur Sprach- und Kommunikationswissenschaft; Bd. 14), Halbbd. 2. 1999.**

Felber, Helmut/Budin, Gerhard (1989) *Terminologie in Theorie und Praxis.* Tübingen: Narr Verlag.

Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe – Probleme dhe detyra (Konferencë shkencore). Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Tiranë, 2009.

Kabashi, Besim (2021) *Ndërtimi i korpuseve paralele për nxjerrjen e terminologjisë së gjuhës shqipe*. Në: KONFERENCA shkencore ndërkombëtare për ditën ndërkombëtare të gjuhës amtare. "*Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV*". Shkup, 2021. Botues: AGJENCIA E ZBATIMIT TË GJUHËS E RMV-së, fq. 62-70.

Kranebitter, Klara (2021) *Puna terminologjike në Tirolin e Jugut, Itali dhe Sistemi i Informacionit për terminologjinë juridike „bistro"*. Në: KONFERENCA shkencore ndërkombëtare për ditën ndërkombëtare të gjuhës amtare. "*Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV*". Shkup, 2021. Botues: AGJENCIA E ZBATIMIT TË GJUHËS E RMV-së, fq. 169-192.

Kautz, Ulrich (2002) *Handbuch Didaktik des Übersetzens und Dolmetschens*. München: Iudicum.

Koller, Werner (2011) *Einführung in die Übersetzungswissenschaft*. Tübingen: Francke.

Lafe, Emil (2013) *Terminologjia si veprimtari ndërdisiplinore dhe mundësitë e bashkëpunimit të Alb-Shkencës*. Në: AKTET VI, 4:347-351.

Lafe, Emil/Caka, Nebi/Duro, Agron/Rizaj, Musa (2014) *Terminologjia profesionale si veprimtari ndërdisiplinore dhe detyrat e Alb-Shkencës*. Shkup: ANAS, nr. 3-4, fq. 5-10. (online: ResearcheGate)

Link, Elisabeth/Schaeder, Burkhard (1989) *Fachsprache der Lexikographie*. Në: Hausmann F.J./Reichmann O./Wiegand H.E./Zgusta L. (Hgg.) *Wörterbücher - Dictionnaries - Dictionnaires. Ein internationales Handbuch zur Lexikographie*. Bd. 1. Berlin-New York, fq. 312-322.

Lušicky, Vesna/Wissik Tanja (2015) *PROCEDURAL MANUAL ON TERMINOLOGY Translation-Oriented Terminology Work*. https://www.sep.gov.mk/data/file/Preveduvanje/Procedural_Manual_on_Terminology_final_version.pdf (21.11.2021)

Maksuti, Izer (2020) Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të përkthimit-Rreth domosdoshmërisë së përkthimit. Në: Përmbledhja e kumtesave të tryezës shkencore ◎Sfidat e përkthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut◎, mbajtur më 30.09.2019, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit, organizuar nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, Shkup 2020, fq. 30-38.

Nord, Christiane (1993) *Einführung in das funktionale Übersetzen*. Tübingen/Basel: UTB Francke (UTB 1734)

Pasho, Hëna (2017) *Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe*. Tiranë: ASA.

Pllana, *Gani (2017) Formimi i terminologjive teknike shqipe mbi bazën e leksikut të përgjithshëm. Tiranë: QSA.*

Reiss, Katharina (2000) *Grundfragen der Übersetzungswissenschaft.* Wien: WUV.

Sandrini, Peter (ed.)(1999) *Übersetzen von Rechtstexten. Fachkommunikation im Spannungsfeld zwischen Rechtsordnung und Sprache*. Tübingen: Narr (FFF Forum zur Fachsprachenforschung 54)

Sandrini, *Peter (2010) Fachliche Translation. Në: Maliszewski, J. (Ed.): Diskurs und Terminologie beim Fachübersetzen und Dolmetschen. Discourse and Terminology in Specialist Translation and Interpreting. Frankfurt a.M.: Peter Lang, fq. 31-51.*

Sandrini, Peter (2016) *Fachübersetzen*. Teil II, Translatorische Tätigkeiten, fq. 158-181, https://www2.uibk.ac.at/downloads/trans/publik/fachuebersetzen2016.pdf

Snell-Hornby, Mary/Hönig, Hans G./Kußmaul, Paul/Schmitt, Peter A. (Hrsg.) (1999) *Handbuch Translation*. Tübingen: Stauffenburg.

Stolze, Radegundis (1999) *Die Fachübersetzung. Eine Einführung.* Tübingen: Narr Studienbücher.

TERMINOLOGJIA NË SHKENCAT E LIGJËRIMIT. Përmbledhje e materialeve të konferencës shkencore ndërkombëtare "Terminologjia në shkencat e ligjërimit", mbajtur në Elbasan, më 13 mars 2012. Elbasan 2014.

Tupja, Edmond (2007) *Këshilla një përkthyesi të ri*. Tiranë: Onufri.

Wüster, *Eugen (1991) Einführung in die allgemeine Terminologielehre und terminologische Lexikographie. Bonn: 3. Auflage. Romanistischer Verlag.*

Burime nga interneti

Das Phänomen der terminologischen Variation als Herausforderung für Übersetzer. Ein Beitrag zur IATE-Datenbank der EU, https://termcoord.eu/wp-content/uploads/2021/03/Masters-thesis-Segers.pdf

IATE (**I**nter**a**ctive **T**erminology for **E**urope) the EU's terminology database https://iate.europa.eu/home (19.09.2021)

https://de.textmaster.com/lexio-das-interaktive-uebersetzungsglossar/ (19.09.2021)

https://www.loctimize.com/de/loesungen/ (19.09.2021)

www.rdt.org (21.12.2021)

www.dttev.org (19.09.2021)

http://bistro.eurac.edu/ (19.09.2021)

Fjalor terminologjik kontekstual interpretues maqedonisht-shqip - VERBIS (www.verbis.gov.mk). 21.12.2021

GD Übersetzung. (2015). IATE Handbook. Brüssel/Luxemburg: Europäische Union.

http://publications.europa.eu/resource/cellar/e0770e72-afa1-4971-8824-6190512537dc.0007.02/DOC_1

ISO (2016). ISO/TC 37 Terminology and other language and content resources. http://www.iso.org/iso/home/standards_development/

ISO 1087-1. (2000). Terminology work – Vocabulary – Part 1: Theory and application. Genf: International Organization for Standardization.

Terminologiepolitik der Europäischen Union: Grundzüge und Problematik, https://www2.uibk.ac.at/downloads/trans/publik/venturelli.pdf

Juljana Kume*, Sabri Hoxha*

Veçori të terminologjisë së mjekësisë ligjore[1]
(Vështrim leksiko-terminologjik i njësisë njëfjalëshe) (Pjesa e parë)

Hyrje

Gjuha e specialitetit të *mjekësisë ligjore* përdoret për të *përkufizuar koncepte, shenja, dëmtime dhe vuajtje të veçanta të njeriut*, përfshirë po ashtu ekzaminime vlerësuese dhe hetuese të kufomave gjatë praktikës mjeko-ligjore, kështu, pavarësisht se nga e kanë origjinën këto terma apo fushën ku specifikisht veprojnë, vlerësohen kryesisht të karakterit mjekoligjor.

Terminologjia e mjekësisë ligjore nga ana e përbërjes së njësive emërtuese leksikore njëfjalëshe apo togfjalëshave në gjendjen dhe nivelin e zhvillimit të saj është një *sistem termash* që i përgjigjet *një sistemi konceptesh* të fushës përkatëse të dijes, mirëfunksionimi i së cilës mundësohet nga ndërlidhja e ngushtë me disa fusha të shkencës dhe të teknikës. Kjo shtresë terminologjike e ngushtë, por e thellë nga vetë natyra e saj e ndërveprimit me fusha të tjera të dijes, është mëvetësuar dhe zhvilluar gjatë rrjedhës së shekujve në bazë të zhvillimit të koncepteve në bashkëveprim të ngushtë e të drejtpërdrejtë me shkenca të tjera, si p.sh.: të gjitha fushat dhe nënfushat e mjekësisë *(anatomi patologjike, imazheri, teknikat laboratorike, endokrinologji, gastrohepatologji, kardiologji, neurologji, psikiatri),* psikologji, fusha juridike *(penale dhe civile),* kriminalistika, gjithashtu, e pasur me elemente terminologjike nga fusha e kimisë, biologjisë, fizikës, matematikës, si dhe rezistencës materiale, etj. Skematikisht lidhjen e kësaj fushe ndërdisplinore

* Studimi terminologjik Veçori të terminologjisë së mjekësisë ligjore është punuar në bashkëpunim me ekspertin e fushës në mjekësi ligjore prof.dr. Sabri Hoxha, profesor në Kolegjin Iliria, Prishtinë, njëkohësisht titullar lëndësh në disa prej universiteteve publike dhe private në Republikën e Shqipërisë.

me fusha të tjera do e skiconim si më poshtë (fig. 1):

Duke u nisur nga përcaktimi që prof. Agron Duro i bën termit dhe fjalës në ligjërimin e specializuar: *Identifikimi i një terminologjie si sistem mund të bëhet i plotë, vetëm kur shihet në rrafshin e funksionimit të termave, që e përbëjnë atë, si shënues të koncepteve të një fushe të veçantë të dijes*.[2] Kështu që, leksiku terminologjik i një fushe të veçantë dije identifikohet brenda kufijve të caktuar në përputhje me sistemin konceptor të fushës përkatëse … pra, *për të identifikuar elementet e rrafshit të shprehjes (termat) kërkohet që të nisemi gjithnjë nga elementet e përmbajtjes (nga koncepti). Si bazë e identifikimit të termave të sistemit bëhen kështu konceptet*.[3] Prej këtij përkufizimi teorik nis rrugëtimi hulumtues i zbërthimit *analitik leksiko-terminologjik*, *formë* dhe *përmbajtje* në praktikën mjekësore ligjore, duke ndjekur hap pas hapi e proces pas procesi synimin kryesor: *evidentimin*, *mbledhjen* dhe *zbërthimin morfologjiko-semantik* të termave njëfjalëshe dhe togfjalëshe në fushën përkatëse, *rrugën e shtegtimit t*ë *termit t*ë *huazuar ose hulumtimin e zhvillimeve përshkallëzuese në paradigmën leksiko-semantike* që kanë marrë termat e huazuar nga shkencat e tjera speciale të ndërlidhura me të, me qëllimin që të japë një ndihmesë në plotësimin e detyrave themelore që dalin para çdo terminologjie, sikurse edhe para terminologjisë së mjekësisë ligjore, e cila përbën dhe qëllimin kryesor të punimit. Pra, ky artikull synon të parashtrojë një përmbledhje të ngjeshur studimore të një punimi të gjatë terminologjik në fushë të mjekësisë ligjore, hartuar si parashtesë e nevojshme në funksion të hartimit të një *fjalori terminologjik shpjegues-ilustrues të unifikuar në fushë të shkencave ekzakte të hetimit*, që do të jetë vijimësi e "Fjalorit të Mjekësisë ligjore" me autorë Sokrat Meksi, Lutfi Alia.[4]. Hulumtimi do të udhëhiqet pikërisht nga ky fjalor i parë i termave bazë në fushë të mjekësisë ligjore në vendin tonë, i botuar nga

2 Agron Duro, Termi dhe fjala në gjuhën shqipe (në rrafshin e formës dhe të përmbajtjes), "Termi dhe fjala në ligjërimin e specializuar", Qendra e Studimeve Albanologjike; Instituti i gjuhës dhe i letërsisë, 2009, Tiranë, f. 19.

3 Po aty, "Leksiku terminologjik i një fushe të veçantë dije", f. 17.

4 Sokrat Meksi, Lutfi Alia, Fjalor i Mjekësisë ligjore, Botim i Drejtorisë së Arsimit Shëndetësor, 1984, Tiranë.

Drejtoria e Arsimit Shëndetësor, Tiranë, më 1984, që ka sjellë një varg ndihmesash të rëndësishme në shqipërimin, njësimin dhe zhvillimin e terminologjisë shqipe në lëm të mjekësisë ligjore; si dhe nga një varg punimesh shkencore (studimore, leksikografike) me shtrirje mbarëkombëtare e ndërkombëtare[5].

Zhvillimet e vrullshme demokratiko-pluraliste, ligjore, ekonomike e sociale që kanë ndodhur në vendin tonë pothuajse gjatë katër dekadave pas botimit të këtij fjalori të parë "Fjalor i Mjekësisë ligjore" (1984), kanë bërë të nevojshme që terminologjia e specializuar në fushë të mjekësisë ligjore të përpunohet më tej në disa aspekte. Këto ndryshime (politiko-socio-ekonomike) kanë çuar paralelisht në rritjen e shkallës së problematikave, kriminalitetit dhe aksidenteve të të gjitha llojeve, situata këto që kërkojnë trajtime të ndryshme socio-psiko-mjekoligjore në përputhje me legjislacionin aktual dhe që normalisht pasqyrohen në termësin e fushës përkatëse në ndërlidhje të ngushtë ndërdisiplinore me fushat e tjera të shkencës. E tërë kjo risi termash, konceptesh, metodash teknologjike e bëjnë të nevojshëm ndërmarrjen e hartimit të një fjalori të ri më të zgjeruar e plotësuar me shpjegime të hollësishme përshkallëzuese dhe ilustrime me synimin e gjithëpërfshirjes së *termave bazë të mjekësisë ligjore dhe shkencave të ndërlidhura* në mbarëvajtjen e saj për një përparim të mëtejshëm në unifikimin dhe standardizimin e terminologjisë së kësaj fushe.

Pra, ky artikull shpërfaqur nën optikën përmbledhëse të analizimit të tipologjive terminologjike me shkallë dendurie më të lartë përdorimi në fushë të mjekësisë ligjore, përqendrohet veçanërisht *në zbërthimin e termformave njëfjalëshe* (me

5 Bashkim Çuberi, "Mjekësia Ligjore", Botim i dytë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, 1975, Tiranë.
Bardh Çipi; Spiro Çipi, "Manual i Mjekësisë Ligjore", 2015, Botimet Klean.
Flamur Blakaj; Sokrat Meksi "Mjekësia Ligjore", Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, 2019.
Sabri Hoxha; Agim Ramadani "Mjekësia Ligjore", 2015, botim i Universitetit shtetëror të Tetovës.
Shyqyri Subashi, , Termat e patologjisë (me shpjegime), 2004, ILAR.
Giusti Giusto, Dizionario di Medicina legale e scienze affini, 2004, CEDAM.
Bell Suzanne, Dictionary of Forensic Science, Oxford University Press.
Dhimitër Haxhimihali, Dritan Topi, Eduard Andoni *Fjalor i termave bazë të kimisë* (shqip-anglisht, anglisht-shqip) (FTBK), botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Seksioni i shkencave natyrore dhe teknike, 2019, Tiranë.

parashtesim, prapashtesim, pjesëzave fjalëformuese, kompozita), në *evidentimin e larmisë së nuancave kuptimplotë/ zgjatimeve semantike* të fituara nga veprimi në fushën përkatëse, *grupimeve sinonimike (dysorëve)* shpesh fjalë të krijuara nga leksiku i gjuhës amtare / fjalë të huaja (përfshirë edhe ndërkombëtariza). D*ykuptimësia* e termave, e shkaktuar nga polisemia, sinonimia ose homonimia, edhe pse në një fushë fort të specializuar, krijon çorientim në unifikim të termave, në të kuptuarin ose përdorimin e përpiktë të domethënies apo nuancës semantike të termit qoftë në komunikimin ndërmjet njerëzve, por madje edhe ndërmjet vetë specialistëve të një fushe[6]. Referuar dysorëve sinonimike, në ruajtje të linjës së *njëkuptimësisë*, sipas parimeve themelore të terminologjisë, në punim termat trajtohen, përpunohen sipas kritereve përkatëse terminografike për të siguruar paraqitje sa më të saktë shkencërisht të strukturës kuptimore të çdo njësie, por njëkohësisht për t'i dhënë përparësi përgjithësisht si dominuese fjalës shqipe veçanërisht në ato raste kur çiftet konkurruese shpërfaqin barasvlefshmëri semantike ose ekuivalencë *fjalë shqipe* / *fjalë e huaj* (p.sh.: termi sinonimik dytësor të jepet pranë termit parësor pas shënimit "ose", ndërsa te zëri i termit sinonimik dytësor vendoset shënimi "shih" që të çon te termi parësor, p.sh.: **dështim/i, -et** (përkufizimi: *ndërprerja e shtatzënisë në çfarëdo periudhe të saj, që sjell si pasojë vdekjen e produktit* ...) *ose* **abort/i, -et**, krahas me abort/i, -et shih dështim/i, -et). Trajtimi i termave mjekësorë ligjorë qofshin njësi njëfjalëshe apo togfjalëshe (veçanërisht lidhje sintagmatike dygjymtyrëshe) në studimin përkatës synon të ndjekë dy linja kryesore: a. *linjën kuptimore* (motivimin semantik) dhe b. *linjën morfologjike* (motivimin strukuror).

Si përfundim është e rëndësishme të nënvizojmë se e gjithë kjo punë ndërmarrëse kërkimore-studimore ka filluar duke pasur si qëllim domosdoshmërinë e hedhjes së bazave, skicimit dhe analizimit të lëndës terminologjike në fushën

6 Agron Duro, Fjalori i termave themelorë të mekanikës, Parathënia, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave RSH, Seria: Terminologjia tekniko-shkencore 31, Shtëpia botuese "Shkenca", 2002, Tiranë.

përkatëse me qëllimet e lartpërmendura, për t'i ardhur në ndihmë profesionistëve ekspertë mjekoligjorë, mjekëve dhe punonjësve të tjerë të mjekësisë, kriminalistëve, ekspertëve të fushave bashkëvepruese me atë mjekoligjore, prokurorëve, gjyqtarëve, oficerëve të policisë gjyqësore, punonjësve të policisë, avokatëve dhe juristëve të tjerë. Gjithashtu, fjalori mendohet se do i shërbejë studiuesve të terminologjisë shqipe, qytetarëve të thjeshtë, pra gjithë atyre që ligjërojnë e shkruajnë shqip dhe që dëshirojnë të përdorin termat e fushës përkatëse në forma të standardizuara.

Zhvillimi

Ndërlidhja e mjekësisë ligjore me termat specialë të shkencave të tjera të dijes

Terminologjia e mjekësisë ligjore nga ana e përbërjes së njësive emërtuese leksikore apo togfjalëshe në gjendjen dhe nivelin e zhvillimit të saj është një sistem termash që i përgjigjet një sistemi konceptesh të fushës përkatëse të dijes. Përsa i përket lidhjes së ngushtë me fushën bazë të shkencës së mjekësisë së përgjithshme si dhe veçanërisht disa disiplinave mjekësore, ky leksik mëvetësohet dhe identifikohet si leksik i një fushe të veçantë të dijes, kur zakonisht njësitë emërtuese të kësaj disipline pasqyrojnë sistemin kompleks të *dy ose tri kategorive konceptore* bazë "mjekësi", "drejtësi", "kriminalistikë" si dhe "ekzaminime laboratorike të disa llojeve [7]" … etj., të cilat mbulojnë një shumësi të madhe konceptesh që trajtojnë dukuri, procese etj.

Nisur nga konceptimi i dy, tre ose shumëfishtë i fushës së mjekësisë ligjore si veprimtari praktike dhe si fushë dije, pra edhe si praktikë edhe si nënfushë shkencore e mjekësisë që bashkëvepron paralelisht me fusha të shkencave të tjera, mund të shohim përkatësisht edhe leksikun e saj si tërësi emërtimesh që pasqyrojnë

7 Ekzaminimet e ekspertit mjeko-ligjor përfshijnë ekzaminimet biologjike, toksikologjike, histopatologjike, të superpozimit etj. **Shih më poshtë figurën 1**. të lidhjes skematizuese të Mjekësisë ligjore me shkencat e dijes, që mundësojnë funksionimin normal të fushës përkatëse shumëdisiplinare.

konceptet përgjegjëse që i përkasin veprimtarisë praktike dhe mjekësisë ligjore si fushë dije ndërdisiplinare. Kështu, sikurse do të vëmë re dhe më poshtë, leksikun e kësaj disipline ndërdisiplinare do ta veçonim në shtresëzime, veçanërisht të mirëfillta të fushës dhe në ato të huazuara nga fushat e tjera të dijes (në ndarje sipas fushave leksiko-terminologjike-semantike, që mundësojnë funksionimin e kësaj disipline me ndërthurje komplekse elementesh). Më poshtë ilustrojmë me shembuj disa prej termave të fushave kryesore me të cilat mjekësia ligjore bashkëvepron:

Nga **fusha e drejtësisë** ndeshemi shpesh me termat njësi dhe termat togfjalësh si më poshtë: *aktakuzë, dëshmi, dëshmitar, prokurori, sanksion, vetëgjyqësi, alibi, bashkëfajtor, zgjidhje martese, dispozitë, ndërgjegje juridike, person juridik, shkelje e rregullave nga punonjësit e shëndetësisë, shpërdorim detyre, lidhje shkakësore, marr në pyetje, mbrojtje e nevojshme,* etj.

Gjithashtu, terma togfjalësh me bërthamë të përbashkët kolative nga *fusha juridike* p.sh.:

penal/e: *vepër penale, dënim penal, rrezikshmëri shoqërore e veprës penale, moshë për përgjegjësi penale*, etj.

kod-i: *kod penal, kod civil, kod i procedurës civile, kod i punës*; etj.

krim huazuar nga fusha kriminalistike, por me përdorim po aq të shpeshtë dhe në fushën juridike: *krim kundër jetës, krim kundër shëndetit, krim në ushtrimin e detyrës,* etj.

Në lidhje me fushën e hetimit kriminal mund të themi që kjo disiplinë mbështetet tek termat e formuara në kohë më të reja. Në të vërtet, leksiku lidhur me inspektimin juridik, si në shqip edhe në gjuhë të tjera të Evropës ka huazuar njësi apo togfjalësha kryesisht në formë kalkesh. Shumë terma dhe shprehje nga gjuha angleze janë përkthyer sipas strukturës së kësaj gjuhe edhe në gjuhë të tjera, mjafton të sjellim si shembull termin në anglisht *crime scene*; në shqip: *skena e krimit*;

italisht: *scena del crimine*. Më poshtë, terma të tjerë të fushës së hetimit kriminal, me rreze përdorimi edhe në fushë të mjekësisë ligjore, falë të cilave mundësohet dhe bashkëveprimi i ndërthurur midis tyre, p.sh.:

Njësia term togfjalësh me bërthamë të përbashkët njësinë **krim**: *ana objektive e figurës së krimit, vend i krimit, skena e krimit, objekt i krimit, subjekt i krimit,* etj.

Njësia term togfjalësh me bërthamë të përbashkët njësinë **armë***: armë e ftohtë, armë zjarri, shkrehje arme,* etj.

Njësia term togfjalësh me bërthamë të përbashkët njësinë **qitje**: *distancë e qitjes, drejtim i qitjes, faktorët plotësues të qitjes, flakë e qitjes, largësi e qitjes,* etj.

Njësia term togfjalësh me bërthamë të përbashkët termin togfjalësh **vend i ngjarjes***: këqyrje e kufomës në vendin e ngjarjes, rregull i këqyrjes së vendit të ngjarjes, stad statik i këqyrjes së vendit të ngjarjes, stad dinamik i këqyrjes së vendit të ngjarjes,* etj.

Njësia term me përdorim në lëm të balistikës[8], *veprim çpues i predhës, mjet mbretës, mjet i mprehtë, karakiri, kama,* etj.

Sikurse u tha më lart, përveç lidhjes së Mjekësisë ligjore me disiplina të tjera mjekësore, veçanërisht me *anatominë patologjike, imazherinë* dhe *shkencave laboratorike,* gjithashtu, kjo fushë bashkëvepron ngushtë edhe me fushën e *kimisë, biologjisë* veçanërisht *biologjisë molekulare* dhe *fizikës.* Kështu që pjesë integrale e punës komplekse të mirorganizuar të ekspertit mjekoligjor është gjithashtu veprimtaria laboratorike mjeko-ligjore, e cila është në funksion të ekspertimit mjeko-ligjor ku kryhen analizat biologjike, toksikologjike, histopatologjike, fotografike etj., duke përdorur një sërë aparaturash, reagentësh dhe metodikash të veçanta që i nevojiten ekspertit për t'u dhënë zgjidhje çështjeve që i parashtrohen nga organet e hetuesisë. Tërësia e veprimtarisë së tij pasqyrohet në terminologjinë me anë të së cilës vepron dhe pasqyron punën e realizuar, ku përfshihen terma të bashkëveprimit të ngushtë

8 Termi **Balistikë** (greq. Ballo - hedh), shkenca që studion metodat tekniko-shkencore të ekzaminimit të armëve të zjarrit, të municionit dhe objekteve që kanë gjurmë qitje. Balistika mjekoligjore studion dëmtimet e shkaktuara nga veprimi i armëve të zjarrit dhe lëndëve plasëse (plumbi, saçma, copat metalike etj.) mbi indet e organizmit.

e të ndërthurur të fushave të lartpërmendura, bashkëveprim që ndryshe njihet me termin e njësuar *analizë kimiko-mjeko-ligjore*. Pikërisht, në këtë proces analize përfshihen një kategori e konsiderueshme termash nga fushat e kimisë, biologjisë dhe fizikës si më poshtë:

Nga fusha e **kimisë**: njësia **acid** si bërthamë e përbashkët e termave togfjalësh: *acid acetik (CH3COOH); acid cianhidrik (HCN); acid karbolik; acid klorhidrik (HCl); acid nitrik (HNO3); acid oksalik (CHCOOH); acid sulfurik (H2SO4),* etj.

Njësia **alkool**: *alkool etilik (C2H5OH), alkool metilik (CH3OH); alkool amilik (C5H11OH), etilenglikol (alkool diatomik CH2OH-CH2OH),* etj.

Terma të tjerë: *amoniak, arsenik, akontin, alergjen, alkal, alkaloid, atropinë, barbituratet, bazofili, cianur i kaliumit, dikloretan (CH2Cl-CH2Cl), doping, fenol, formalinë, gaz karbonik (CO2), gaz sulfhidrik (H2S), granozan, kalomel, oksid karboni, sublime (HgCl2), sulfhemoglobinë, tetraetil plumbi (Pb(C2H5)4),* etj.

Nga fusha e **biologjisë** dhe **fizikës:** *balsam kanadez, diatomet, dimorfizëm, fluroshencë, gjen, heptaglobinë, hematinat, hemoglobinë, hemokromogjen, kërpudhë helmuese, kokainë, kromozom, kromatinë seksuale, luminishencë, opium, oksihemoglobinë, strikninë,* etj.

Nga tërësia e termave me të cilat mjekësia ligjore bashkëpunon kemi mundur të veçojmë disa terma të mirëfilltë të fushës së mjekësisë ligjore, në veçanti ndërmjet atyre që i referohen pjesës së "Tanatologjisë dhe shpërbërjes së kufomës". Pikërisht, referuar vetëm kësaj pjese të hetimit në mjekësinë ligjore janë të pranishëm kryesisht terma me origjinë klasike (gjuha latine dhe greke), të cilët ndeshen vetëm në fushë të mjekësisë ose më saktë të mjekësisë ligjore. Në gjuhën e mjekësisë në të gjitha fushat e saj, shpeshherë paralelisht termit në latinisht ose greqisht ndeshet edhe termi përkatës i shqipëruar. Përdorimi i termave në gjuhët klasike të mësipërme lejon të krijohen forma të shkurtra gjuhësore me përmbajtje konceptesh

kuptimore komplekse (të ndërthurura) dhe me jetëgjatësi, duke qenë më pak subjektivë ndaj ndryshimeve të tipit semantik. Termat e këtyre gjuhëve qëndrojnë të pandryshueshëm, por me kalimin e kohës me domosdoshmërinë e përshtatjes me zhvillimet e vazhdueshme shkencore është e mundur të krijohen edhe terma të rinj ose pse jo të përshtaten nga ana kuptimore e tyre edhe në gjuhën shqipe, ku realisht në disa prej tyre ekziston termi korrespondues në gjuhën shqipe, p.sh.:

Algor mortis (gr. algor, lat. mortis – shq. *ftohje kufomës*), **Livores mortis** (lat. Livores mortis – shq. *njollat e kufomës*) dhe **Rigor mortis** (lat. Rigor mortis – shq. *shtangësia e kufomës*) të tria i përkasin fushës semantike të *fenomeneve kufomore* dhe mbiemrit lat. **post-mortem**, që përdoret shpesh në përbërje të togfjalëshve si p.sh.: shq. *ekzaminimi post-mortem*; ang. post-mortem examination. Gjithashtu, fazë përbërëse e **tanatologjisë** (gr. thanatos-vdekje + logos-shkencë) d.m.th e *fenomeneve post-mortem* që në shqip në gjuhën speciale të fushës përkatëse përfshihen në kategorinë e *fenomeneve kufomore të hershme* janë edhe fazat e **Hipostazës**[9] (gr. hypo – shq. paksim + lat. stasis – shq. *ndalim, qëndrim*), **Stazës**[10] (lat. Stasis – shq. *ndalim, grumbullim*) dhe **Imbibicionit**[11] (lat. Imbibitio – shq. *ngopje, thithje),* të cilat janë tri fazat e krijimit të njollave kufomore (**Livores mortis**). Terma të tjerë nga gjuha latine që i përkasin disa tematikave të tjera të mjekësisë në përgjithësi përfshirë dhe fushës së mjekësisë ligjore janë: **Contusio Cerebri** – e njohur në shqip me termin togfjalësh *shembje e trurit*; **Vernik Kazeoz** (lat. Vernix – pomadë + caseum - gjizë) – e njohur në shqip me termin togfjalësh *material i yndyrshëm që mbulon*

9 Sabri Hoxha; Agim Ramadani, *Mjekësia Ligjore*, botim i Universitetit shtetëror të Tetovës, 2015, f. 346-348. **Hipostazë** (gr. hypo-paksim + stasis-ndalim, qëndrim), *faza e parë e krijimit të njollave kufomore*. Shkaktohet nga veprimi i ligjeve të rëndesës duke e dërguar gjakun (nga pesha e vet) të kalojë në pjesët e poshtme të trupit të kufomës. Shfaqet zakonisht 2-3 orë pas vdekjes dhe zgjat deri 10-12 orë…

10 Sabri Hoxha; Agim Ramadani, *Mjekësia Ligjore*, botim i Universitetit shtetëror të Tetovës, 2015, f. 346-348.

Stazë (lat. stasis-ndalim, grumbullim). Ndalim, qëndrim në vend të një lëngu që normalisht qarkullon, p.sh. gjakut. Stadi i dytë i njollave kuformore. Zhvillohet 10-12 orë pas vdekjes dhe vazhdon 24-36 orë…

11 Sabri Hoxha; Agim Ramadani, Mjekësia Ligjore, botim i Universitetit shtetëror të Tetovës, 2015, f. 346-348. **Imbibicioni** (lat. imbibitio-ngopje, thithje). **Faza e tretë** e njollave kufomore, që lidhen me procesin e ngopjes masive të indeve nga gjaku i hemolizuar, që përzihet me limfën dhe lëngun brenda dhe jashtë qelizor. Zhvillohet 24-36 orë pas vdekjes (ndonjëherë edhe pas 48 orësh)…

tërësisht ose pjesë të veçanta të foshnjës së porsalindur. Vlerësohet si shenjë që vërteton porsalindjen e foshnjës… .; **Abiosis** (lat. abiosis – *humbje e aftësisë për të jetuar*) në shqip me termin togfjalësh *ind ose organ në gjendje të pa jetë.*

Analizimi tipologjik i termformave njëfjalëshe në mjekësinë ligjore

Analizimi i termësit sipas tipologjive ka ndjekur linjën e grupimit/skematizimit sipas burimit të termit, si dhe sipas mënyrave e rrugëve më prodhimtare të krijimit të termave: parashtesa, prapashtesa, kompozita dhe pjesëza fjalëformuese në përbërje të njësive terma njëfjalëshe.

Gjatë analizimit dhe bashkërendimit të termave në fushën përkatëse, duke shfrytëzuar veçorinë që termi është *dyfish sistemor*: edhe si *element i sistemit terminologjik*, po ashtu edhe si *element i sistemit gjuhësor*, ndërton terma sipas lidhjeve fjalëformuese që janë në bazë të dy grupimeve: a. në grupimin e fjalëve në çerdhe fjalëformuese që ka në bazë të njëjtën morfemë rrënjore dhe b. në grupimin e fjalëve në kategori dhe tipe në bazë të përdorimit të ndajshtesave.

Grupimet e lartshënuar ose e thënë ndryshe mikrosistemet leksikore-fjalëformuese/ termformuese, gjatë ndërtimit të termave shënojnë koncepte të reja, ku një pjesë e tyre shërbejnë si bazë për krijimin e njësive të tjera terminologjike, i ilustrojmë me shembuj si p.sh.: *ekspert, ekspertim, ekspertizë; dëmtoj, dëmtim, i dëmtuar; dënoj, dënim, i dënuar; nekrozë, nekropsi, nekrobiozë,* etj. Ndërkaq, sikurse u tha më lart, fusha e mjekësisë ligjore është e pasur me togfjalësha termformues. Karakteristikë e termave njëfjalëshe në terminologjinë mjekësore është se shumica prej tyre janë të ndërtuara me një parashtesë, prapashtesë, elemente fjalëformuese (kryesisht me origjinë nga gjuha *latine dhe greke*, ku midis tyre nuk mungojnë edhe ato terma, të cilat formohen me mjete dhe sipas gjedheve fjalëformuese të shqipes, vetëm me një kuptim të caktuar, kryesisht të motivuara brenda fushës së dijes

përkatëse.

Dukuria e ndajshtesëzimit dhe e përbërjes, përdoret për të krijuar terma të rinj dhe për të garantuar kuptimshmërinë e tyre përmes dekodifikimit të ndajshtesave teke dhe të rrënjëve ku janë të përfshira, p.sh.: *hipo/stazë* (dukuria e post-mortem); *hipo/ksemi; hipo/mnezi;* në mbështetje të parafjalës *hypo-* e cila në përgjithësi ka kuptimin e "nën, poshtë, pak, të pamjaftueshmërisë" apo të parafjalës *hiper-* "mbi, të mjaftueshmërisë, mbingopjes" p.sh.: *hiper/termia; hiper/mnezi*, etj. tregojnë se sa gjerë është përdorur kjo mundësi për ta forcuar e, njëherësh, për ta nxjerrë në pah karakterin sistemor të terminologjisë.

Nga analizimi i hollësishëm i termave me përdorim në mjekësinë ligjore do të vihet re se, shumica e tyre ka **bazë *nominative (emërore)*, pasi duke u mbështetur në kriterin e fushës dhe të kuptimit, këtë funksion të termit mund ta kryejnë mjaft mirë vetëm *termat emra*** p.sh.: *këqyrje* (por jo këqyr ose i këqyrur); *thyerje* (jo thyej ose i thyer); *pështymë* (jo pështyj ose i pështyrë), etj. (shih shembujt e shumtë në tekst). Ndërkaq, pjesët e tjera të ligjëratës, termat mbiemra, ndajfolje dhe shumë rrallë folje, mund të dalin si terma zakonisht në lidhjet leksiko-sintaksore (togfjalësha) atëherë kur të ndihet në mënyrë të qartë aftësia specifike përcaktuese e tyre p.sh.: *psikiatri ligjore, emboli yndyrore, emfizemë kufomore,* etj.

a. Formime me para, prapashtesa dhe kompozime nga brumi i shqipes

Në kristalizimin e sistemeve konceptore si dhe në përsosjen e sistemeve terminologjike çon futja e termave në gjuhën shqip, të cilët i bëjnë sistemet terminologjike më homogjene dhe si rrjedhim sistemet konceptore më të tejdukshme dhe më të kapshme për specialistët e *gjuhës shkencore-teknike* e në përgjithësi për çdo shqipfolës. Pra, sikurse do të ilustrohet dhe më poshtë, njësitë me *para-* dhe *prapashtesim të shqipes*, e bëjnë sistemin jo vetëm më të kuptueshëm, por

edhe më të lidhur e më të motivueshëm. Më prodhimtare në formimin e termave - fjalë dalin dy mënyra: *ndajshtesimi* dhe *kompozimi*. Në formimet ndajshtesore janë më aktive *parashtesat* dhe *prapashtesat* e mëposhtme të shqipes:

parashtesa pas-: pastraumatike, etj.

parashtesa për-: përdredhje, përplasje, përgatitje, përgjegjshmëri, përngjitje, përthithje, përshtatshmëri, përdhunshme, etj.

parashtesa re-: reabilitim, reaksion, reaminacion, etj.

parashtesa sh-, -zh: shmangie, shpërdorim, shqetësim, zhvarrosje, etj.

parashtesa mohuese ose të kundërkuptimshme mos-, pa-, jo-: mosdhënie, moskallëzim, paaftësi (seksuale), pakujdesi, pavlefshmëri (e martesës), pamoralshëm, etj.

parashtesa ndër-: *ndërgjegje, ndërlikim, ndërprerje,* etj.

prapashtesa -je: *ngrirje, mpiksje, zhytje, prerje, thyerje,* etj.

prapashtesa -im: *ndërlikim, helmim – intoksikim, inkarcerim, inokulim, koagulim, kalbëzim, identifikim (i personit),* etj.

prapashtesa -s, -ës: *martesë, fejesë, fiksues,* etj.

prapashtesa -os, -or, -to, -tor: *laborator, (sekret) mjekësor, (seksiologji) ligjore, teori racore, emboli gazore, emboli yndyrore, dhjamosje dyllore, qarkullim rrugor,* etj.

prapashtesa -t(ë): *rrjetë (qelbësuese), (vdekje) e shpejtë, armë e ftohtë,* etj.

prapashtesa -ak, -ar, -arak(e): *dëshmitar, gjyqtar, (bashkëjetesë) e ndaluar, (portert i) përshkruar,* etj.

prapshtesa -si*: mjekësi, drejtësi, fatkeqësi, aftësi, (ndërk. biopsi, asfiksi,* etj). **prapashtesa -shëm / -shme:** *(vepër e) turpshme, (vdekje) e natyrshme, i motivueshëm, i pamoralshëm,* etj.

prapashtesa -zëm: *virilizëm, botulizëm, mazoshizëm, fabizëm, dimorfizëm (terma ndërkombëtare që kanë zënë vend në shqipe),* etj.

Formime me kompozim (të mirëfillta nga brumi i shqipes me tejdukshmëri konceptore të lartë të elementeve përbërës (me motivim të lartë) janë shumë pak p.sh.:

vetë-: *vetëvrasje, vetëdëmtim, vetëgjyqësi, vetëmbrojtje,* etj.

bashkë-: *bashkëfajtor, bashkëjetesë*, etj.

b. Terma njëfjalëshe me parashtesim[12] me burim nga gjuhët e huaja

Më poshtë disa nga parashtesat dhe pjesëzat fjalëformuese me origjinë nga gjuha greke dhe latine që ndeshen më dendur në termësin e mjekësisë ligjore:

a-:, an-: parashtesë që shprehin "mungesë, mohim, heqje, kundërvënie". Këto parashtesa kanë kuptim të njëjtë, veçse para pjesëve fjalëformuese që fillojnë me bashkëtingëllore fillojnë me **a-,** kurse para atyre që fillojnë me zanore vendoset **an-** p.sh.: **abiosis** (gr. a + bios "jetë") ind ose organ pa jetë; **anizokori** "(gr. an + isos "barabartë" + kore "bebja e syrit") hapja jo e barabartë e të dyja bebeve të syrit"; etj.

ana-: parashtesë që tregon "diçka të kundërt, një lëvizje prapa", … p.sh.: **anaerob** "(gr. an + aer "ajër" + bios "jetë") mikroorganizma anaerobe që jetojnë e rriten në mjedise në mungesë të oksigjenit të lirë" etj.

anti-: parashtesë që shpreh "kundërvënie", p.sh.: **antigjen** "(gr. anti + genere "ndodh") lëndë e huaj për një organizëm me natyrë proteinike ose komplekse protein-polisakarid, me peshë molekulare të lartë, e cila kur injektohet në organizimin e njeriut ose të kafshës nxit prodhimin e antitrupave specifikë me të cilët reagon", etj.

ab-: parashtesë që tregon "mohim", p.sh.: **abstinencë** "(lat. Abs "nga" + teneo

12 Shpjegimet etimologjike të parashtesave dhe pjesëzave me burim nga gjuha greke janë marrë nga Fjalori i gjuhës së re greke, me autor Jorgo Babinjoti, me shpjegime sipas përdorimit të saktë …; Universiteti i Athinës, Qendra e Leksikologjisë, Botimi i dytë, Athinë 2002; si dhe Niko Gjini, Fjalor greqisht-shqip, Botim i Universitetit të Janinës, Janinë, 1993; si dhe konsultuar me Fjalorin terminologjik Termat e patologjisë (fjalor shpjegues i termave) me autor Shyqyri Subashi, 2004, ILAR 2004.
Shpjegimet etimologjike të parashtesave dhe pjesëzave me burim nga gjuha latine u jemi referuar botimeve Terminologjia latine (dy vëllime) me autor Kosta Qirjazati, si dhe Eliana Paço, Gjuha latine *& Terminologjia mjekësore Greko-Latine*, Tekst mësimor për studentët e stomatologjisë, Ufo Press, 2007.

"përmbahem") sindromë që karakterizohet me ndijime të padurueshme, nga shqetësime fizike e psikike, që lind pas ndërprerjes së mjekimit me narkotikë"; **abduksion** "(lat. Abductio "largim, mënjanim") shih. Autopsy", etj.

apo-: parashtesë që i jep termit kuptimin "e ndarjes, e largimit" p.sh.: **apopleksi "**(gr. apoplexia "paralizë, goditje") hemorragji e menjëhershme me prishje të ndërtimit anatomik të një organi. Shpesh është si shkak i vdekjes së papritur dhe të menjëhershme", etj.

auto-: parashtesë që u jep termave kuptimin e "vetëpjesëmarrjes", p.sh.: **autopsi "**(gr. auto + opsis "këqyrje") këqyrja e kufomës për gjetur shkakun e vdekjes"; etj.

de-: parashtesë që tregon "zhbërjen e një strukture", p.sh.: **deflorim** "(lat. defloratio – de "heqje" + flos "lule") çvirgjërim"; etj.

dia-: parashtesë që shpreh "një proces të kryer nëpërmjet apo me anë të", p.sh.: **dializë "**(gr. dialysis "shpërbërje, ndarje") metodë që përdoret për të nxjerrë me anën e osmozës përbërësit mikromolekularë (difuzion i njëanshëm). Ky proces kryhet me ndihmën e një membrane gjysmëpërshkruese, që ka aftësi të lejojë kalimin e substancave mikromolekulare dhe të joneve, por pengon makromolekulat …"; etj.

dis-: parashtesë që shpreh "çrregullim, shqetësim, vështirësi", etj., p.sh.: **distopi** "(gr. dis "çrregullim" + topos "vend") vendosje e parregullt e organeve, ndryshim i vendit të tyre të zakonshëm"; **disfori**; **distrofi**, etj.

eu-: parashtesë që tregon "entuziazëm, gëzim", etj., si p.sh.: **eufori** "(gr. eu "mirë" + fora "pasion, shpërthim") humor i ngritur, gjendje e lartë shpirtërore"; **eutanazi** "(gr. eu "mirë" + thanatos "vdekje"); etj.

en-, em-: parashtesë që jep kuptimin "në, brenda në", si p.sh.: **enkop "**(gr. en "prej" + cope "goditje") quhet tronditje e kafkës (kontuzion) nga traumat ose goditjet me mjete të forta mbretëse"; **emboli** "(gr. embolion "gjë e futur e rrasur"); etj.

ek-: parashtesë që shpreh kuptimin "nga, prej, nga jashtë", p.sh.: **ekzumim** "(lat. ek + humus "tokë, dhe"), nxjerrja e kufomës nga varri për kryerjen e ekazminimit mjekoligjor.", etj.

eks- (ex): parashtesë që shpreh zhvillimin në pjesën e jashtme të një strukture, që zhvillohet nga jashtë ose që nxjerr diçka jashtë, p.sh.: **ekstazë "**(gr. eks "jashtë" + stasis "ndalje, gjendje"), etj.

epi-: parashtesë që shpreh zhvillimin e një patologjie mbi një strukturë të caktuar p.sh.: **epistaksis "**(gr. epi + staksis), hemorragji nga hundët"; **epidural,** etj.

im-, in-: parashtesë që shkruhet në mënyra të ndryshme sipas shkronjave që e pasojnë atë[13]. … p.sh.: **imobilizim** "(lat. immobilisatio "i palëvizshëm") vendosje në pozicion të palëvizshëm me anë të allçisë i kockave të thyera për t'i ngjitur"; etj.

hiper-: parashtesë që i jep termit kuptimin se diçka është "e tepërt, mbi normë, jashtë masës" p.sh.: **hipermnezi** "(gr. hyper "tepër", mbi + mneme "kujtesë") fuqizim patologjik ndaj kujtesës"; etj.

hipo-: parashtesë që i jep termit kuptimin e të qenët "nën, poshtë, që është më pak, që është nën normë", p.sh.: **hipostazë** "(gr. hypo "paksim + stasis "ndalim, qëndrim") faza e parë e krijimit të njollave kufomore. Shkaktohet nga veprimi i ligjeve të rëndesës duke e dërguar gjakun (nga pesha e vet) të kalojë në pjesët e poshtme të trupit të kufomës." ...; **hipoksemi** "(gr. hypo "ulje" + oxygenium + haemia"gjak"), etj.

kon-: parashtesë që i jep termit kuptimin "lat. e të qenit a të bërit bashkërisht, me", p.sh.: **konfabulacion** "(lat. con "me" + fabula "përrallë") halucinacione të kujtesës, trillime të kujtesës, …", etj.

meta-: parashtesë që i jep termit një numër kuptimesh si "gr. pas, më tej, më tutje në kohë dhe në hapësirë, nëpërmjet, me anë të, ndryshim i paraqitjes nga një

13 **im-, in-:** parashtesë që shkruhet në mënyra të ndryshme sipas shkronjave që e pasojnë atë. Ajo shkruhet il- para gërmës l-; im- para gërmës b-, m-, dhe p-; ir- para gërmës r dhe shkruhet in- në të gjitha rastet e tjera. Këto parashtesa kanë kuptimin e "mohimit, mungesës, apo që shpreh të qenurit brenda diçkaje"

gjendje në tjetrën", p.sh.: **metamorfozë, metastazë, metapneumonik,** etj.

para-: parashtesë që përdoret në termat, që tregojnë "ekzistencën e një procesi në afërsi të një organi ose indi, si dhe të një procesi të ngjashëm, jo identik me një tjetër", p.sh.: **parafreni** "(gr. para "afër" + fren "gjykim") formë e skizofrenisë që karakterizohet me mungesë të degradimit intelektual për një kohë të gjatë"; **paralizë, paramimi** "(gr. para "afër" + mimia "shprehje e fytyrës"); **paranoid** "(gr. para "afër" + noo "kuptoj, mendoj" + eidos "lloj"); etj.

pre-: parashtesë që u vihet termave për t'i dhënë kuptimin e të "qenët përpara në kohë dhe në hapësirë", p.sh.: **presenilitet "**(lat. pre "para" + senium "pleqëri, parapleqëria") parapleqëri"; **pretencë**, etj.

retro-: parashtesë që i jep termit kuptimin e "zhvillimit të një dëmtimi prapa në kohë dhe në hapësirë", p.sh.: **retrograd** "(lat. retro "prapa" + gradus "shkallë"), që shkon prapa që i përket ngjarjeve të mëparshme, retrosternal", etj.

sub-: parashtesë që i jep termave kuptimin e "vendosjes së një dëmtimi patologjik nën një formacion apo strukturë të caktuar, ose të një dëmtimi që zhvillohet më pak se i shprehur zakonisht" p.sh.: **subdural, subkutan, subakut, subdiagnozë,** etj.

trans-: parashtesë që jep kuptimin "tej për tej, andej", p.sh.: **transplant, transkutan, transfuzion, transverticizëm** "(lat. trans "nëpërmjet" + vertire "me vesh"), ... etj.

uni-: parashtesë që i jep termit kuptimin e të qenët "një, një tek", p.sh.: **unicelular, unilateral,** etj

c. Kompozime me elemente të prejardhura nga gjuhë të huaja (me kombinime të përziera)

bio-: pjesëz fjalëformuese, e cila duke u përdorur me një term të përbërë, i jep atij kuptimin e "jetës ose që i përket jetë" p.sh.: **biomanekin** "(gr. bio "jetë" + fr.

mannequin "kukull"); **biopsi "**(gr. bio + opsi "shikim"), etj.

cian-: pjesë fjalëformuese që i jep termit kuptimin e "ngjyrës blu", p.sh.: **cianozë "**(gr. cyanos "mavijosje, blu e errët")"; **cianhidrik**, **cianmethemoglobina,** etj.

elektro-: pjesa e parë fjalëfomuese e termave të përbërë që ka kuptimin e "rrymës, së përcjelljes së elektricitetit", p.sh.: **elektrografi** "(lat. electro "rrymë elektrike" + gr. grapho "vizatoj, shkruaj"), metodë laboratorike ekzaminimi që përdoret në praktikën mjekoligjore. …; **elektroshenjë**; **elektrotraumë**, etj.

hema-: pjesa e parë ose e ndërmjetme e termave që i jep atyre kuptimin e "gjakut" p.sh.: **hematomë** "(gr. haima "gjak" + omo "fryerje"), grumbullimi i kufizuar i gjakut në indet e shkrifta dhe në një hapësirë të formuar si pasojë e traumës". ... **hematoporfirinë; hemokromogjen**; **hemolizë**; **hemostazë, kefalhematomë, oksihemoglobinë, sulfhemoglobinë, hematoid, karboksihemoglobinë,** etj.

hist-: element fjalëformues që shpreh kuptimin e indit, p.sh.: **histologjik, histogjenetik,** etj.

homo-: pjesa e parë e terma të përbëra që jep kuptimin "i njëjtë, i ngjashëm" p.sh.: **homocidomani "**(lat. homo "njeri" + caedo "vras" + mania "dëshirë"), dëshira e sëmurë për të vrarë njerëz"; **homoseksualizëm**, etj.

hetero-: pjesë e termave të përbërë i jep kuptimin i të qenët "tjetër, i të qenët ndryshe, që ka tjetër formë ose trajtë, i dytë, i dyfishtë" p.sh.: **heterokromi** "(gr. hetere "tjetër" + chromo "ngjyrë") ngjyrë e ndryshme, jo normale e një indi, organi", etj.

hidro-: pjesa e parë e termave të përbërë që jep kuptimin e "ujit, që i përket ujit ose që ka lidhje me ujin", p.sh.: **hidrodinamik** "(gr. hydro "ujë" + dhinamia "forcë, fuqi")", **hidrostatik**, etj.

neo-: pjesa e parë e termave që jep kuptimin e "të qenët i ri ose i riformuar" p.sh.: **neonat** "(gr. neo "i ri" + lat. nato "i lindur") fëmija i sapo lindur"; **neogjenezë,**

neoformacion, etj.

nekr-: pjesë fjalëformuese që shpreh kuptimin "gr. nekros "i vdekur, e vdekjes, që ka vdekur", p.sh.: **nekrobiozë** "(gr. nekros "i vdekur" + bios "jetë") proces i veçantë patologjik që karakterizohet me ndryshime distrofiko-degjenerative, që paraprijnë nekrozën"; **nekropsi** "autopsi"; **nekrozë** "proces patologjik, që përfaqësohet me vdekjen e një pjese të organizmit të gjallë..."; **nekrosadizëm**, etj.

kario-: term që përcakton diçka në lidhje me "bërthamën e qelizës ose që i takon asaj" p.sh.: **kariotip** "(gr. karyon "bërthamë, arrë" + tip); **kariolizë**, etj.

krio-: pjesë fjale që i jep termit kuptimin e "të ftohtit, e ngrirjes" p.sh.: **krioskopi** "(gr. krio "i ftohtë" + scopia "shikoj"), metoda e përcaktimit të masës molekulare të substancave të tretura sipas pikës së ftohjes së tretësit"; **kriostat**, etj.

kripto-: pjesë e termit që shpreh "zhvillimin e padukshëm e të fshehtë të një procesi patologjik" p.sh.: **kriptomnezi** "(gr. krypto "i fshehtë, jo i dukshëm" + mneme "kujtesë"); **kriptogjen**, etj.

oligo-: pjesë e një termi të përbërë, që i jep kuptimin e "të qenët i pakët, i vogël në numër" , p.sh.: **oligospermi** "(gr. oligos "i vogël, i pakët" + spermia "farë")"; **oligofreni "**(gr. oligo + freno "mendje, gjykim"), etj.

mikro-: pjesë e parë e termave të përbërë që shpreh "përmasat e vogla të një lezioni ose sasitë e pakta të një lënde të grumbulluar", p.sh.: **mikroelementë** "(gr. mikros "i vogël, i pakët"), **mikrofotografi; mikrotom** "(gr. micros "i vogël" + tomos "prerje"), aparaturë e laboratorit të histopatologjisë që shërben për prerjen e seksioneve të holla indore nga materiali i derdhur në parafinë …"; etj.

pan-: pjesë e një termi të përbërë, që shpreh përfshirjen në tërësinë e një procesi patologjik, në tërësinë e një organi ose një indi "gr. pan "që përfshin gjithçka, që i takon së tërës", p.sh.: **pankardit, panarterit**, etj.

pato-: pjesa e parë e termave me kuptimin "sëmundje ose vuajtje" (gr. patho),

p.sh.: **patologji, patogjen**, etj.

somn-: pjesa e parë e kuptimeve të përbëra që ka kuptimin e "gjumit, ose të bërit një veprim në gjumë", p.sh.: **somniloki** "të folurit në gjendje gjumi"; **somnolencë** "gjendje e përgjumur", etj.

septi-: pjesa e parë e kuptimeve të përbëra që ka kuptimin e kalbjes "gr. sepsis "kalbje", p.sh.: **septicemi "**(gr. sepsis "kalbje" + haima "gjak") shfaqet me hyrjen, shumëzimin dhe qarkullimin e mikrobeve në gjak. ..."; **septikopiemi** "(gr. septicopyaemia: sepsis + pyon "qelb" + haima "gjak" - qelbëzim i gjakut), etj.

tanato-: pjesa e parë e kuptimeve të përbëra që ka kuptimin "e vdekjes" p.sh.: **tanatogjenezë** "(gr. thanatos "vdekje" + genesis "krijim"), studimi i mekanizmave dhe ecurisë të proceseve të vdekjes"; **tanatologji** "(thanatos "vdekje" + logos "shkencë"), shkenca që merret me studimin e fenomeneve të vdekjes", etj.

…

-cid: pjesa e dytë e kuptimeve të përbëra që i jep termit kuptimin e "prerjes, vrasjes", p.sh.: **baktericid, suicid,** etj.

-logji: element fjalëformues si pjesë e dytë e kuptimeve të përbëra "gr. logos "shkencë", p.sh.: **deontologji "**(lat. deos "detyrë" + logos "shkencë") shkenca mbi detyrimin mjekësor, ku futen detyrat dhe të drejtat e punonjësve të mjekësisë…"; **osteologji**; **entomologji "**(gr. entomon "insekt" + logos "shkencë"), **endokrinologji, biopsikologji, toksikologji, traseologji** , etj.

-**globinë:** pjesë përbërëse e termave që do të thotë "sferë", p.sh.: **haptaglobinë, methemoglobinë,** etj.

-**gjeneziz:** pjesë e termave të përbërë që do të thotë "krijim, formim, prejardhje, shfaqje dhe zhvillim i diçkaje" (gr. genesis), p.sh.: **tanatogjenezë, patogjenezë, embriogjenezë**, etj.

-gjene: pjesë e termave të përbërë që i jep atyre kuptimin "që lind, që rrjedh,

që e ka prejardhjen ose origjinën" (gr. -gene), p.sh.: **jatrogjen** "(gr. iatros "mjek" + genere "me formu"), **alergjen** "substanca që kur takohen me idetë e organizmit krijojnë një reaksion specifik"; **antigjen, aglutinogjenet**, etj.

-**metri, -kloni:** pjesa e dytë e termave të përbërë që i jep atyre kuptimin gr. **metron** "masë, matje", p.sh.: **livorometri** "(lat. livro "njollë mavi" + gr. metron "masë"), ekzaminimi i njollave kufomore me ndihmën e një dinamometri"; **antropometri "**(gr. anthropos "njeri" + metreo "matje"), **logokloni** "(gr. logos "fjalë" + kloneo "tund, lëkund"), etj.

-mnezi: pjesa e dytë e termave të përbërë që i jep atyre kuptimin "**mneme - kujtesë": kriptomnezi** "gabim i kujtesës"; **amnezi** "(gr. amnesia "harresë")"; **anamnezë** "(gr. anamnesis "kujtesë"), etj.

-tipi: pjesa e dytë e termave të përbërë, p.sh.: **stereotipi** "njëllojshmëri në veprime, në mendime, në të folur", etj.

-grafi: pjesa e dytë e termave të përbërë, p.sh.: **keraunografi "**(gr. kreaun "rrufe" + grapho "shkrim"), figura e rrufesë e stamposur në trupin e njeriut nga goditja e rrufesë", **kromatografi**; **rentgenografi,** etj.

-fag: pjesë e një termi të përbërë që mban kuptimin "me ngrënë", p.sh.: **sakrofag** "lloj insekti që shkatërron kufomat duke ngrënë indet e buta"; **lipofag,** etj.

-**fakt:** element fjalëformues që shpreh kuptimin "e bërjes së diçkaje", etj., p.sh.: **artefakt** "produkt artificial, jo i natyrshëm, i zakonshëm. Në praktikën mjekoligjore artefakte krijohen gjatë ndotjes së lëndëve të përdorura për ekzaminim kimikoligjor me ndotje të tjera helmuese", etj.

-**fili:** element fjalëformues që shpreh kuptimin "e dëshirës", p.sh.: **herontofili** "(gr. heron "pleqëri" + filia "dëshirë"); **pedofili**; **zoofili**, etj.

-mani: element fjalëformues që shpreh kuptimin "e pasionit", p.sh.: **dipsomani "**(gr. dipsa "etje" + lat. mania "pasion"), kriza periodike të dëshirës për të përdorur

pije alkoolike deri në dehje"; **narkomani; kleptomani** "(gr. klepto "vjedh" + mania "pasion"); **piromani "**(gr. pyros "zjarr" + mania "dëshirë"), etj.

-**morf / morf-:** (gr. morph) pjesë fjalëformuese që shpreh kuptimin e formës, me një formë të caktuar, p.sh.: **amorf, izomorf, heteromorf, polimorf,** etj.

-**pati; -fobi, -freni, - fazi:** pjesë fjalëformuese që shprehin kuptimin "gr. pathos - vuajtjes", "gr. fobos - frikë", "frehos - shpirt, mendje, gjykim", p.sh.; **oligofreni** "(gr. oligo "i vogël" + freno "mendje, gjykim"), përfshin një grup sëmundjesh, që kanë si cilësi të përbashkët prapambetjen mendore të lindur ose të fituar vitet e para të jetës"; **zoofobi**; **zhargonofazi**; **skizofreni; sensopati; nozofobi; hebefreni**, etj.

-skopi: pjesë fjalëformuese që i jep termit kuptimin "gr. scope – të të parit, vrojtimit, ekzaminimit, studimit", p.sh.: **daktiloskopi, diafanoskopi** "(fr. diaphane "i tejdukshëm" + scopia "shikoj"), teknikë ekzaminimi kriminalistiko-mjekoligjore me anë të së cilës përcaktohen ndryshimet në thyerjet e kockave të kafkës për të përcaktuar nëse janë krijuar gjatë jetës ose pas vdekjes"; **krioskopi, spektroskopi, makroskopi, mikroskopi, laringoskopi, otoskopi, cistoskopi**, etj.

-traumë: pjesa e dytë fjalëformuese e njësive të përbëra që i jep termit kuptimin "gr. trauma "plagosje", p.sh.: **barotraumë** "(gr. baros "shtypje" + trauma "plagosje"); **mototraumë**, etj.

-trofia: pjesë përbërëse e një termi që shpreh çdo gjë që i përket "ushqimit ose lidhet me të", p.sh.: **distrofi, hiptrofi, atrofi**, etj.

Lidhja sistemore e fjalës term (njëfjalëshe) me fjalën e përgjithshme (nga ligjërimi i zakonshëm tek ai special)

Shqyrtimi i termësit në lëmin e mjekësisë ligjore si nga ana e *formës* dhe e *përmbajtjes* na mundëson të zbulojmë disa pika lidhëse dhe veçori dalluese me leksikun e përgjithshëm ose jotermat. Një numër jo i pakët i njësive njëfjalëshe të

fushës përkatëse duke qenë të njëjta nga forma e jashtme me fjalët e zakonshme ose gjuhët e specialiteteve të tjera, si dhe duke u lidhur kuptimisht me to, vënë në lidhje të drejtpërdrejt leksikun terminologjik me leksikun e përgjithshëm ose leksikun e specialiteteve të tjera, shpesh nga fondi leksikor i shqipes. Zakonisht, ky lloj shtresëzimi përbën pjesën e leksikut terminologjik bazë të atyre fushave të dijes (si matematika, fizika, kimia, etj.), që shërbejnë si themel i fushave të tjera terminologjike. Sikurse vumë re dhe më lart, terma (njëfjalëshe) të ngritur mbi bazë e fjalëve të zakonshme bëhen bosht për ndërtimin e njësive të tjera terminologjike të përbëra, të togfjalëshave terminologjikë.

Më konkretisht, brenda kufijve të leksikut të mjekësisë ligjore, vërehen dendur fjalë të zakonshme me frekuencë të lartë përdorimi në ligjërimin përditshëm, ku jo pak prej tyre edhe me origjinë edhe nga gjuhët speciale (veçanërisht me ato fusha të dijes me të cilat mjekësia ligjore bashkëvepron) ngrihen si terma të fushës përkatëse me të njëjtën shenjë, por shpesh me ngarkesë konceptuale (kuptim) të modifikuar ose me zgjerim të nuancës kuptimore. Akademiku J. Thomai, vë theksin tek pohimi shkencor, sipas të cilit: *vetë terminologjia në pjesën më të madhe shqipërohet me njësi të leksikut të përgjithshëm të ligjërimeve të folura popullore ose me krijime të reja me mjete fjalëformuese të njohura; është pranuar tashmë se fjalorët shpjegues të përgjithshëm 60-70% e fjalësit përbëhet nga terma; formimi arsimor në shkollë e me tekste mësimore e ka terminologjinë shkencore në themel të vet; studimet shkencore po e zgjerojnë gjithnjë e më shumë rrethin e lexuesve, sikundër po shtohen edhe artikujt shkencorë popullorë në shtyp e në radio-televizion. Këto rrethana e të tjera po e bëjnë edhe ligjërimin e përgjithshëm, të themi "me libror, më shkencor, më terminologjik"*[14].

Kjo aftësi termformuese kushtëzohet nga *potencialiteti semantik i vetë fjalës mbi të cilën ngrihet termi njëfjalësh* dhe në radhë të dytë të vetë *fjalës term që e trashëgon*

14 Jani Thomai, *Studime për gjuhën shqipe IV, Leksikografi*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, 2017, Tiranë, f. 200.

këtë aftësi. Këto karakteristika i japin mundësi çdo njësie terminologjike që të hyjë në marrëdhënie leksiko-sintaksore të shumta sipas koncepteve korresponduese në fushë të mjekësisë ligjore. Shfaq interes ballafaqimi me FGJSSH '80 të disa prej njësive të përdorura me frekuencë të lartë në termësin e mjekësisë ligjore, si p.sh.: njësia *provë*, si term me rrezeshtrirje si në ligjërimin e zakonshëm ashtu edhe në disa fusha të shkencës dhe teknikës, e cila hyn si gjymtyrë përbërëse në strukturën e 10 togfjalëshave në fushë specifike, që normalisht si njësi emërtuese pranohen si terma më vete si *prova e mëlçisë për glikogjen, prova e notimit të mushkërisë, prova e veshit, prova e lindjes gjallë të foshnjës (prova Bush-Haberd), prova për matjen e sasisë së alkoolit (prova Popov),* etj. Në FGJSSH '80 njësia përfaqësuese *prov*ë përfshihet në brendalidhjen leksiko-sintaksore duke iu shtuar strukturës paradigmatiko-semantike veçanërisht në trajtën e sintagmave (kryesisht togfjalëshave dygjymtyrësh) si njësi të mëvetësishme me përkufizimin përkatës shkencor, p.sh.: *prova e mbledhjes* (mat.) "Veprimi me të cilin vërtetojmë se një llogaritje është e përpiktë. Prova e zbritjes, e shumëzimit, e pjesëtimit". Gjithashtu, me përkufizimin përkatës edhe *provë bindëse* ose *provë lëndore* (drejt.) "e dhënë që sillet për të vërtetuar, për të mbrojtur ose për të hedhur poshtë diçka; dëshmi, fakt, argument"; *provë laboratorike, provë e fortësisë* (lab.) "copë e vogël që merret nga diçka për analizë a për eksperiment; që bëhet për të marrë të dhëna për diçka ose për ta vërtetuar atë".

Nga sa më lart, gjatë shqyrtimit të fjalësit të vjelë nga fusha përkatëse (afërsisht 1.400 njësi terma nga këto rreth 600 njësi njëfjalëshe) ndarja e kuptimeve brenda një sistemi terminologjik ka të bëjë fillimisht me marrëdhëniet e drejtpërdrejta, në të cilën hyn shenja si term me objektin e dijes si njësi emërtuese speciale e tij në përputhje të plotë me kufijtë e prerë semantikë, si dhe mundësia që shfaqin disa prej termave me zbërthimin e mëtejshëm në vartësi të lidhjeve

me të cilat hyjnë këto kuptime me kuptime të tjera brenda një tjetër sistemi të caktuar terminologjik. Kështu që strukturën semantike të *fjalës term* me ndarjet e mëtejshme të kuptimeve në fushë të mjekësisë ligjore mund ta përfytyrojmë si një strukturë të gjerë semantike speciale, brenda së cilës mund të zbërthehen disa lloj kuptimesh me veçori specifike për secilën prej tyre, si më poshtë në paraqitjen skematike:[15] (referuar dhe përshtatur klasifikimit që prof. A. Duro i bën *njësive termave njëfjalëshe*) kuptime terminologjike të pasqyruara në strukturën semantike të fjalës dhe të shprehura nga fjalët terma në fusha të ndryshme të dijes (homonime). Pra, në fjalorët terminologjikë, disa kuptime pasqyrohen nëpërmjet shenjave të njëjta, veçimi i këtyre kuptimeve veçmas nga njëri-tjetri është më se i domosdoshëm. Në një kuadër të gjerë të disa fushave terminologjike, kuptimet e shprehura të *fjalës-term* zbërthehen më tej: **shenjë** (anat.) "njollë e vogël a pikë, me ngjyrë të ndryshme nga pjesa tjetër e lëkurës e zakonisht pak më e ngritur, që ka njeriu në fytyrë ose në trup" - **shenjë** (krim./drejt.) "shenjat e gishtërinjve" - **shenjë** (gjuh.) "shenjat e pikësimit" - **shenjë** (gjest./ fiziol.) "lëvizje që bëjmë me kokë, me duar, me sy etj." - **shenjë** (mjek. ligj.) transferimi semantik nga ligjërimi i përgjithshëm "tregues i veçantë, në bazë të të cilit mund të njohësh ose të përcaktosh diçka" tek ai i specializuar > mjek. ligj. Pikërisht, kjo e fundit lidhet me domosdoshmërinë e ndarjes së këtyre kuptimeve nga njëri-tjetri normalisht edhe brenda së njëjtës fushë terminologjike dhe këtë e dëshmojnë kuptimet terminologjikisht të përcaktuara, të cilat lidhen me kuptimet e gjymtyrës bazë (të përcaktuar) të togfjalëshave terminologjikë, që kanë funksionin e termave të mirëfilltë (termave njëfjalësh). Pikërisht, **n**ë **l**ë**m t**ë **mjekë**s**is**ë **ligjore,** termi *shenjë* si bërthamë e përbashkët kolative me njësitë përcaktuese krijon afërsisht *9 lidhje leksiko-sintaksore* shumë të rëndësishme për funksionin semantik sipas fushës

15 Agron Duro, *Terminologjia si sistem*, Panteon 2001, f. 41.

përkatëse (mjekësi ligjore) p.sh.: *shenjë e Bernardit*[16]*; shenjë e fillimit të kalbëzimit, shenjë protektori, shenjë e sybardhit*[17]*, shenjë stampimi, shenjë e traumave automobilistike, shenjë Sabinsk*[18], etj.

Kuptime të dyzuara që bashkëjetojnë në simbiozë i ndeshim relativisht shpesh në përbërje jo vetëm të termave njëfjalëshe, por edhe në përbërje të lidhjeve leksiko-sintaksore në fushë të mjekësisë ligjore. Pra, në këto raste kemi të bëjmë me fjalë apo terma të huazuara si nga ligjërimi i zakonshëm, ashtu edhe nga ligjërime të tjera të specializuara**, p.sh.:** termi që shpreh kuptimin përkatës veçohet si i tillë në një fushë të caktuar të dijes si tek *njollë* (fjalë e zakonshme.) - *njollë* (term) "njolla të kufomës; njolla të Lareshës"; *mbyllje* (fjalë e zakonshme) – *mbyllje* (term) "mbyllje e rrugëve të frymëmarrjes me trupa të huaj"; *mbytje* (fj. e zak.) - *mbytje* (term) "mbytje me duar, mbytje me lak, etj..."; *kohë* (fj. e zakon.) - *kohë* (term) "kohë dëmtimi, kohë e vdekjes", etj. Po ashtu, *dhunim, kanosje, konflikt, përplasje, përgjegjshmëri, qime, rrahje, rrethanë, shmangie, varje*, etj.

Jo në pak raste, këto njësi njëfjalëshe të ligjërimit të zakonshëm modifikojnë kuptimin e tyre në togfjalëzimin me një term të fushës së mjekësisë ligjore (kjo pikë do të trajtohet hollësishëm në pjesën e dytë, vijimësi e këtij punimi "Termat togfjalësh në mjekësinë ligjore"). Nga ky rregull, bëjnë përjashtim disa terma togfjalësh me lidhje dygjymtyrëshe me burim dhe denduri përdorimi në ligjërimin e zakonshëm p.sh.: *aftësi për punë, mbrojtje e nevojshme, radhë e dëmtimeve, shpërdorim detyre, shkelje e rregullave, vepër e turpshme, …* etj. Kuptimi i këtyre togfjalëshave zbulohet nga kuptimi i fjalëve me përdorim të zakonshëm dhe shumëkuptimësia e tyre thyhet kur njësia togfjalëshe me njëkuptimësinë e saj lidhet me fushën

16 **Shenjë e Bernardit**, nga *Fjalori i mjekësisë ligjore*, 1984. Provë e sekretimit nga kanali i qafës së mitrës, përdoret në ekspertimet mjekoligjore të përckatimit të virgjërisë dhe të lidhjeve seksuale të grave. f. 213.

17 **Shenjë e sybardhit** (syri i maces), nga *Fjalori i mjekësisë ligjore*, 1984. Shenjë e vdekjes që formohet nga shtypja me gisht e kokërdhokut të syrit (anash bebes së syrit) në të cilën krijohet një thellim në trajtë grope si syri i maces. f. 214.

18 **Shenjë Sabinsk**, nga Fjalori i mjekësisë ligjore, 1984. Konstantohet në autopsitë e personave të vdekur nga asfiksia e përgjithshme. Shenja shprehet me anemi të shpretkës, ndërsa organet e tjera shfaqin stazë. f. 214.

përkatëse dhe identifikohen në ato raste kur përdoret në kuadër ose brenda gjuhës së specialitetit të mjekësisë ose mjekësisë ligjore. Në raste të tilla vetë fusha ku përdoret termi shërben si kontekst për të dalluar kuptimin e tij e nuk lind nevoja për të krijuar fjalë të veçanta për çdo fushë *(shih shembujt më sipër).* E kundërta e këtij grupimi janë disa njësi njëfjalëshe të gjuhëve speciale me burim (nga shqipja ose të huazuara nga gjuhë të tjera) që ndeshen dendur në termësin e mjekësisë përfshirë dhe atë ligjore dhe që njëkohësisht dallohen për denduri të lartë përdorimi në ligjërimin e përditshëm të individëve që përdorin një regjistër të mesëm ose që kanë dije në fushat e përafërta ose ndryshe që përdorin fjalë të një niveli të kulturuar, p.sh.: *frakturë, eufori, ekstazë, impuls, inskenim, kolaps, moskallëzim, paranoid, patologji, pederasti, periodizim, reabilitim, reaksion, sanksion, steriotip, trajektore, traumë, agoni, agravim, akt, aktakuzë, alibi, aspirim, dehidratim, delir,* etj.

Nga sa më lart, mbështetur në pohimet e studiuesve elitarë albanologë në specialitetet leksikografi dhe terminografi, theksojmë se edhe në termësinë e mjekësisë ligjore si kriter parësor për identifikimin e fjalës apo togfjalëshit term duhet të pranohet *fusha e përdorimit* dhe *kuptimi i tij*. Sikurse sollëm provat e mësipërme, *identifikimi i fjalës* në bazë *të fushës së dijes* është i një *rëndësie parësore*, jo vetëm për veçimin e tij nga fjala e zakonshme, por edhe të vetë *fjalës term* nga termat e tjerë të përfaqësuar nga e *njëjta shenjë*.

Megjithatë, më konkretisht, vlen të theksojmë duke mbështetur e përforcuar idenë se, lidhja e *fjalës term* pas një fushe të vetme të dijes nuk është kushti i vetëm dhe parësor i identifikimit të saj, pikërisht si në rastin e termave në fushë të mjekësisë ligjore, ku termi shihet në një rrafsh të gjerë në lidhje edhe me sistemet e tjera terminologjike. Në kuadër të fushës, e rëndësishme është që çdo kuptimi i përgjigjet një term dhe çdo term shënon një kuptim. Fusha shumëdisiplinare e mjekësisë ligjore zotëron një numër të konsiderueshëm termash, që janë me

origjinë ose i përkasin fushave të tjera të shkencës dhe teknikës. Analizimi i hollësishëm i kuptimeve terminologjike të njësive me frekuencë të lartë përdorimi në fjalësin e mjekësisë ligjore na jep mundësi që të depërtohet më thellë në ndarjet më të përpikta të strukturave përkatëse semantike në një rrafsh më të gjerë në lidhje edhe me sistemet e tjera terminologjike, pasi këtë gjë, sikurse përmendëm më sipër, e lejon vetë natyra e fushës ndërdisiplinare. Sjellim më poshtë disa shembuj të termave të përbashkët, kryesisht huazimesh terminologjike në fushë të mjekësisë ligjore p.sh.: *entomologji* **(bio. > mjek. ligj.)** shkenca që studion insektet, ndërkaq *në praktikën e mjekësisë ligjore* haset dendur gjatë ekzaminimit të kufomave të kalbëzuara dhe shërben si shenjë provuese për të përcaktuar kohën, kushtet, mënyrën e vdekjes, si dhe të procesit të kalbëzimit [19]; *elektrotraumë* veprimi për një kohë të shkurtër i elektricitetit teknik dhe atmosferik, që shkaktojnë vdekjen e personit[20]; *formalinë* **(kim. > mjek. ligj.)** tretësirë ujore 40% e formaldehidit, që shkakton mpiksjen e albuminave për ruajtjen e indeve gjatë autopsisë[21]; *kondesor* **(kim./ mek. > mjek. ligj.)** (lat. condensus) aparaturë e veçantë e mikroskopit optik e përbërë nga thjerrëza të ndryshme, që ka për funksion të konvergojë rrezet ndriçuese mbi preparatin[22]; *konfabulacion* **(psikol. > mjek.)** (lat. confabula) halucinacione të kujtesës, trillime të kujtesës[23]; *krioskopi* **(kim. > mjek. ligj.)**(gr. kryos "i ftohtë" + scopeo "shoh") metoda e përcaktimit të masës molekulare të substancave të tretura sipas pikës së ftohjes së tretësit[24]; *logorea* **"(gr. logos "fjalë" + rea "rrjedhje")** e folur e eksituar, pa ndërprerje, p.sh.: në dehjet alkoolike të gradës së mesme"[25]; *parafreni* **(psik. > mjek.ligj.**) (gr. para "afër" + fren "gjykim") formë e skizofrenisë që karakterizohet me mungesë të degradimit intelektual për një kohë

19 Sokrat Meksi, Lutfi Alia Lufti, *Fjalor i mjekësisë ligjore*, Botim i Drejtorisë së Arsimit shëndetësor, Tiranë, 1984, entomologji, f. 66.
20 Po aty, elektrotraumë, f. 64.
21 Po aty, formalinë, f. 77.
22 Po aty, kondesor, f. 120.
23 Po aty, konfabulacion, f. 120.
24 Po aty, krioskopi, f. 124.
25 Po aty, logorea, f. 132.

të gjatë[26]; *plankton* **(biol. > mjek. ligj.)** (gr. plancton "bredhës që qëndron pezull, i varur") tërësia e organizmave shumë të vogla me origjinë bimore e shtazore, të cilat gjenden në ujërat e ëmbla dhe të kripura dhe që prania e tyre në organet e kufomës përbën një nga shenjat më të rëndësishme të mbytjeve në ujë[27]; *sensopati* **(psik. > mjek. ligj**.) (lat. sensus "perceptim" + gr. pathos "patologji") emërtimi i përgjithshëm i llojeve të ndryshme të prishjes së veprimtarisë perceptuese[28]; *strikninë* **(biol. > mjek. ligj.)** helm, alkaloid bimor që ndodhet në farat e bimës Strychnos nux vomica, në disa bimë të familjes leguminoze, etj.[29]; *antiseptik* **(kim. > mjek. ligj.)** (gr. anti "kundër" + sepsis "qelbëzim"), lëndë kimike që pengon rritjen, zhvillimin ose shkatërrimin e mikroorganizmave[30]; *demencë* **(psik. / mjek. > mjek. ligj.)** (lat. dementio: de "pa" + mens "mendje, arsye") ulje e intelektit dhe pjesëve të tjera përbërëse të veprimtarisë psikike, si pasojë e veprimit të faktorëve të ndryshëm dëmtues në trupin e njeriut,[31] etj.

Referuar sa më lart, në rastin e termave në fushën përkatëse, dalim në përfundimin se, kusht parësor duhet konsideruar *kuptimi bosht i termit* të dhënë në përkufizim, përderisa edhe në fusha të tjera ai përdoret me të njëjtin kuptim, normalisht shpesh shoqëruar me zgjatime të nuancave kuptimore në përshtatje me fushën përkatëse (mjekësi ligjore), por gjithnjë duke e mbajtur të lidhur kuptimin pas një fushe të vetme zanafillëse, sikurse më lart *strikninë* me kuptimin "helm, alkaloid bimor që ndodhet në farat e bimës Strychnos nux vomica,..." është termi i biologjisë, i përdorur në *fushë të kimisë, mjekësisë dhe asaj ligjore.* Shumë prej këtyre termave me origjinë nga specialitetet të tjera të shkencës, në fushë të mjekësisë ligjore, boshti konceptual i tyre lidhet ngushtë me *veprimin, procesin, reaksionin/ rezultatin në organizmin njerëzor,* pra kemi shtrirje/zgjatim semantik si produkt i

26 Po aty, parafreni, f. 170.
27 Po aty, plankton, f. 178.
28 Po aty, sensopati, f. 204.
29 Po aty, striktinë, f. 211.
30 Po aty, antispektik, f. 20.
31 Po aty, demencë, f. 40.

veprimit, që ky alkaloid bimor ndikon në organizmin human duke çuar deri në vdekje; e vërtetuar në autopsi nga shenjat e përgjithshme të asfiksisë "mungesës së ajrit gjatë procesit të frymëmarrjes", por ndonjëherë edhe evidentimit të kristaleve të striktinës në përmbajtjen e stomakut[32]. Pra, ky term merr një tjetër vlerë dhe rëndësi duke e ngritur atë deri në shkallën e domosdoshmërisë së përfshirjes si term me funksion specifik edhe në fushë të mjekësisë ligjore. Në këtë mënyrë **çdo term i lidhur pas çdo kuptimi të fiksuar e të qëndrueshëm, fiton pavarësi brenda caqeve të fushës së dijes ku vepron, duke u pranuar si i njëkuptimshëm**.

Pasqyrimi sipas kriterit *përkufizues-shpjegues* në lidhje sistematike i njësisë term në kontekstin ose fjalorin e mjekësisë ligjore synon të përfshijë spektrin e plotë semantik duke filluar nga kuptimi specifik i qëndrueshëm ose zanafillës që ka mundësuar depërtimin dhe ka ngulur rrënjë në fushën përkatëse deri tek zgjerimi dhe zhvillimi semantik i njësisë sipas funksionit, mekanizmit, hetimit ose këqyrjes, metodikës, faktorëve etj. Të gjitha këto specifikime të hollësishme me larmi semantike brenda kufijve sipas karakterit të fushës (mjek. ligj.) vijojnë me kombinime të njësisë përfaqësuese bazë me njësitë e tjera leksikore që bashkëlidhen në lidhje togfjalësore dy ose tri-gjymtyrëshe. Sipas një këndvështrimi të ngushtë brenda kufijve të fushës lidhja në sistem paradigmatike-sematike do të ndjekë strategjinë konceptore përshkallëzues si më poshtë. Lidhja sistematike e njësisë "djegia" bëhet semantikisht nga e përgjithshmja drejt specifikes (si në rastet kur njësia përfaqësuese i përket përdorimit ose ligjërimit të përgjithshëm, ashtu edhe kur buron nga gjuhë të specialiteteve të tjetra):

Djegi/e,-a *em. f.* (*kuptimi i përgj. nga ligjërimi i zakonshëm nga FGJSSH '80*) Veprim sipas kuptimeve të foljeve DJEG, DIGJEM. I vë zjarrin diçkaje a e hedh në zjarr dhe e bëj shkrumb e hi, e shkatërroj, e asgjësoj a e prish në zjarr; e dëmtoj diçka me zjarr a me një send shumë të nxehtë, e shkrumboj. *Djeg drutë (barin, kashtën). I dogjën*

32 Bardhyl Çipi, Spiro Çipi, *Manual i Mjekësisë ligjore*, 2015, Tiranë, Klean Shpk., f. 596.

shtëpinë. Djeg me benzinë. Djeg në zjarr (në flakë). E dogji fare. I dogjën kufomat. Dogji flokët (vetullat). Dogji këmishën (fustanin, pantallonat). E dogji rrobën me hekur. FGJSSH '80.

Djegi/e,-a *em. f.* (*kuptimi bosht i njësisë në përshtatje me fushën* p.sh.: Veprimi lokal i temperaturave të larta shkakton djegien me pasojë dëmtim të indeve. Ajo ndodh nga veprimi mbi trupin e njeriut të energjisë termike ose llojet e tjera të energjisë fizike që shndërrohen në energji termike[33]).

Djegi/e,-a *em. f.* (përkufizimi: *llojet e djegies në mjekësinë e përgjith. ose dermatologji, me funksion edhe në mjek. ligjore*) pasqyruar në lidhje brendatogfjalësore: *djegie termike* (përfshihen flaka, lëngu i nxehtë, avulli ...); *djegie kimike* (nga veprimi i acideve të fort, nga bazat alkaline, kripërat e disa metaleve të rënda); *djegie nga energjia rrezatuese* (rrezet ultraviolet, radiacioni jonizues)[34];

Djegi/e,-a *em. f. (*përkufizimi: *shkallët e saj në mjekësinë e përgjith. ose dermatologji me funksion edhe në mjek. ligjore)* pasqyruar në lidhje brendatogfjalësore: *djegie e shkallës së parë* (skuqja dhe enjtja); *djegie e shkallës së dytë* (formimi i flluskave); *djegie e shkallës së tretë* (nekroza e lëngshme dhe e thatë); *djegie e shkallës së katërt* (karbonizimi)[35].

Djegi/e,-a *em. f.* (përkufizimi: *llogaritja e sipërfaqes së djegur*) Në këqyrjen e kufomës përveç përcaktimit të shkallës së djegies (sipas sistemit me katër shkallë të përcaktuar më lart) në praktikë përllogaritet sipërfaqja e djegur. Për këtë tek njeriu i rritur veprohet në këtë mënyrë, duke u përdorur rregulla e nëntëshes që paraqitet si vijon: koka: 9% (7+2 qafa); një gjymtyrë e sipërme: 9% (krahu përafërsisht 3%, parakrahu 3% dhe dora 3%); kraharori: 9%; barku: 9%; shpina: 9%; regjioni lumbal dhe gluteal: 9 %; një gjymtyrë e poshtme: 18% (kofsha 9%, kërciri 6% dhe këmba

33 Po aty, f. 327.
34 Sokrat Meksi, Lutfi Alia, *Fjalor i Mjekësisë ligjore*, Botim i drejtorisë së arsimit shëndetësor, 1984, Tiranë, f. 50.
35 Po aty, f. 50.

3%); regjioni perineal dhe organet gjenitale të jashtme: 1%. Në kufomat e fëmijëve të moshave 0-4 vjeç, llogaritja e sipërfaqes së djegies ka disa dallime, sidomos tek koka që zë një përqindje më të madhe.[36]

Djegi/e,-a *em. f.* (përkufizimi: *çështjet mjekoligjore të subjekteve të djegura*) Problemet mjekoligjore që kërkojnë zgjidhje në rastet e këqyrjes së individëve apo kufomave të djegura janë: *përcaktimi i mjetit djegës; identifikimi i viktimës; përcaktimi i djegies së kufomës për sa gjalli ose pas vdekjes; kërkimi i dëmtimeve kriminale*, etj.[37]

Djegi/e,-a *em. f.* (përkufizimi: *shpjegime të përcaktimit të mjetit djegës*) Përcaktimi i mjetit djegës bazohet në veçoritë e djegies sipas mjeteve të ndryshme: 1. Flaka shkakton të gjitha shkallët e djegies, meqenëse ajo vepron jo me të njëjtën fuqi në të gjithë sipërfaqen e trupit. 2. Objektet e nxehura shkaktojnë djegie të shkallës së tretë dhe të katërt me kufi të caktuar dhe trajta të ngjashme me atë të mjetit të përdorur. 3. Lëngjet në vlim shkaktojnë djegie të shkallës së tretë me mbetje të gjurmëve të dëmtimit në lëkurën përreth dhe asnjëherë nuk shkaktojnë djegie të shkallës së katërt. 4. Avujt e nxehtë shkaktojnë djegie të ngjashme me ato të lëngjeve në vlim.[38] 5. Djegiet kimike zakonisht nuk shoqërohen me formim flluskash, por në varësi të substancës mund të marrin ngjyrën e tyre. 5. Djegie nga radiacioni atomik, krahas dukurive të përgjithshme e të jashtme të djegies apo karbonizimit, diagnostikohen dhe me ekzaminime biofizike, radiokimike, etj.[39]

Djegi/e,-a *em. f.* (përkuf.: *identifikimi i viktimës*) Rastet kriminale të fshehjes së një krimi tjetër me anë të djegies, sidomos në ato raste duke e karbonizuar kufomën. Për këtë qëllim, duhet të merren për bazë veçoritë e pjesëve të skeletit dhe të dhëmbëve që i qëndrojnë më shumë djegies dhe mbeturinat e veshjes dhe të sendeve vetjake të viktimës, përdorim i metodave të ndryshme të antropologjisë

36 Bardhyl Çipi, Spiro Çipi, *Manual i Mjekësisë ligjore*, 2015, Tiranë, Klean Shpk., f. 333.
37 Po aty, f. 334.
38 Po aty, f. 334.
39 Sokrat Meksi, Lutfi Alia, *Fjalor i Mjekësisë ligjore*, Botim i drejtorisë së arsimit shëndetësor, 1984, Tiranë, f. 51.

dhe odontologjisë mjekoligjore, të analizë së ADN-së, etj. Djegia e plotë ndodh zakonisht kur qëndron për një kohë të gjatë në një vend të mbyllur si p.sh. furra …. Në raste të tilla duhet të kërkohet hiri, për të gjitha mbeturinat kockore në të.[40]

Djegi/e,-a *em. f.* (përkuf.: *përcaktimi i djegies së kufomës për së gjalli ose pas vdekjes*) Ekzaminimi në djegiet për së gjalli bazohet në disa shenja karakteristike: mungesa e dëmtimit të lëkurës dhe e grumbullimit të blozës në palët e kapakëve të syve që formohen instinktivisht gjatë mbylljes së syve për t'u mbrojtur nga zjarri. Prania e flluskave të lëkurës që formohen në shkallën e dytë të djegieve. Grumbullimi i blozës në mukozën e rrugëve të sipërme të frymëmarrjes. Prania e oksidit të karbonit në gjak, që përbën një nga gazet që formohen nga zjarret, i cili thithet me anën e frymëmarrjes nga viktima që ndodhej e gjallë në vendin e ngjarjes. [41]

Djegi/e,-a *em. f.* (përkuf.: *format mjekoligjore të dëmtimeve nga djegiet).* Rastet aksidentale (fatkeqësitë), më rrallë vetëvrasje dhe vrasje. Rastet e fatkeqësisë (aksidentale) ndeshen në jetën e përditshme si rezultat i pakujdesisë së viktimës ose personave përreth. Raste të tjera djegiesh aksidentale ndodhin gjatë zjarreve të mëdha, të katastrofave ajrore dhe automobilistike, që shoqërohen me karbonizim masiv të trupit. Vetëvrasjet kryhen zakonisht nga të sëmurët psikikë, të cilët e djegin veten duke u hedhur në zjarr, pasi janë lagur më parë me benzinë apo vajgur. Vrasjet me anë e djegieve ndodhin më shpesh tek personat që nuk mund të mbrohen si fëmijët, pleqtë, të sëmurët dhe të dehurit. Zakonisht kjo lloj vrasje kryhet me spërkatjen e turpit me lëndën djegëse gjatë kohës që viktima është duke fjetur dhe i vihet zjarri, ose i hidhet vaj i valuar në kokë apo brenda në vrimën e veshit. Nganjëherë djegia mund të bëhet me qëllim që të fshihet një krim i kryer me mënyra të tjera ... Djegia e kufomave mund të kryhet edhe në mënyrë ligjore nga shërbimet funerale në furra të veçanta që quhen krematoriume[42]

40 Bardhyl Çipi, Spiro Çipi, *Manual i Mjekësisë ligjore*, 2015, Tiranë, Klean Shpk., f. 334.
41 Po aty, f. 335.
42 Po aty, f. 336.

Njësia **djegi/e-a** ndërkaq është e përfshirë në mikrosistemin e njësisë **dëmtim/e,-t** si hallkë specifikuese në kategorinë e llojeve të dëmtimeve, pra në lidhje të mbivendosur hierarkikisht nga koncepti i përgjithshëm i njësisë **dëmtime-t** > drejt atij më specifik (dukuria e hiperonimisë) p.sh.:

Dëmtim-i/-et *em. m.* (përkufiz. i përgj.)

Dëmtuar (i/e) *mb.*

Dëmtim i lehtë *togfj.*

Dëmtim i parëndësishëm *togfj.*

Dëmtim i rëndë *togfj.*

Dëmtim-e/t mekanike

dëmtime nga mjetet mbretëse

dëmtime mekanike mbretëse sipas lokalizimit

dëmtime të kokës dhe të shpinës

dëmtime të skalpit

dëmtime të fytyrës

dëmtime të trurit

dëmtime nga mjetet prerëse

dëmtime nga mjetet çarëse

dëmtime nga zvarritja

dëmtime nga ngjeshja

dëmtime nga rrëzimi

dëmtime nga shkelja

Dëmtime nga armët e zjarrit

dëmtime nga armët e gjahut

dëmtime nga armët jotipike

dëmtime të shkaktuara nga shpërthimi i lëndëve të ndryshme plasëse,

municioneve, minave, granatave, etj.

Dëmtime nga faktorë fizikë

Dëmtime nga energjia termike

- **dëmtime nga temperaturat e larta (djegia) shih Djegia**

- dëmtime nga djegia ose dëmtime nga veprimi lokal i temperaturave të larta

- dëmtime nga temperaturat e ulëta ose dëmtime nga veprimi lokal i temperaturave të ulëta (ngrirja)

Dëmtime nga energjia elektrike

dëmtime nga elektriciteti teknik

dëmtime nga elektriciteti atmosferik (rrufeja)

Dëmtime nga energjia barometrike

Dëmtime nga energjia rrezatuese

Dëmtime nga zhurma dhe llojet e tjera të energjisë së vibracioneve (dridhjeve)

Dëmtime nga substancat drogë

dëmtime nga substancat narkotike

dëmtime nga substancat psikotrope

Dëmtime të dhëmbëve

dëmtime të dhëmbëve nga faktorët mekanikë

dëmtime të dhëmbëve nga faktorët termikë

dëmtime të dhëmbëve nga faktorët kimikë

Dëmtime të kufomës nga qëndrimi në ujë

Shumëkuptimësia, sinonimia dhe antonimia

Një nga tiparet dhe funksionet më të rëndësishme të termit është *njëkuptimësia.* Terminologët, ndërkaq, përforcojnë idenë se, *njëkuptimësia* që lidhet brenda

një fushe të caktuar dhe fushave të afërta me të, është *njëkuptimësi relative*[43], jo vetëm sipas fushave ku vepron termi apo gjuhëve speciale, por njëkohësisht edhe në kohështrirjen vepruese të tij, sepse termat nga të njëkuptimshëm mund të bëhen me kalimin e kohës në të shumëkuptimshëm. Kështu që jo të gjithë termat karakterizohen nga ky tipar i rëndësishëm i njëkuptimësisë, duke pranuar njëkohësisht shumëkuptimësinë e shfaqur nën ndikimin e gjuhës letrare apo ligjërimit të zakonshëm.[44] Edhe pse shumëkuptimësia e fjalëve shkakton vështirësi, kjo dukuri nga sa kemi analizuar deri tashmë fjalësin e mjekësisë ligjore, ndeshet veçanërisht tek elementet e huazuara nga ligjërimi i zakonshëm ose gjuhët e tjera speciale me të cilën kjo fushë ndërdisiplinare bashkëvepron. Në përgjithësi në fjalësinë përkatës kanë prirje të shumëkuptimshmërisë disa emra të veprimit me burim nga leksiku i shqipes, *terma-emra foljorë* me prapashtesat **-im** dhe **-je**, që edhe në praktikën përkatëse përdoren për të emërtuar procesin dhe rezultatin e veprimit dhe që fjalësi i kësaj fushe është shumë i pasur p.sh.: *shkripëzim; mospërmbajtje, mospajtim, shtypje, shembje, dëmtim, hollim, rëndim, goditje, riaftësim, çrregullim, fryrje, kalbëzim, ndërprerje, ndërlikim, ndrydhje, vrasje, rrahje, thyerje, shkatërrim, helmim, mbytje*, etj.

Më rrallë ndeshet kjo dukuri në përbërjen e termave emra abstraktë dhe terminoelementeve (lidhjeve brendatogfjalësore të termave) ku krahas kuptimit të përgjithshëm zhvillohet një variant i veçantë më specifik (ose anasjelltas nga e veçanta tek e përgjithshmja) i këtij kuptimi sipas fushës ku vepron p.sh.: *kanal, kimi* (për kimi ligjore), *morfologji* (termi ka kaluar edhe në gjuhësi), *alkool* (kim > në mjekësi ligjore me gjithë llojet e tij, ka kaluar edhe në ligjërimin letrar), etj. p.sh.: fjala-term *kanal* (FGJSSH '80) përdoret për të emëruar a. *Hendek i thellë e i gjerë, që*

43 Hëna Pasho, *Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe*, "Vështrim mbi disa shfaqje të shumëkuptimësisë, të sinonimisë dhe të antonimisë në terminologjinë e ekonomisë", Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botimet Albanologjike, 2017, Tiranë, f. 174-175.

44 Shih po aty.

është hapur për të ujitur, për të kulluar tokat, për të mbledhur ujërat etj.; shtrat i gjerë që është hapur për të lidhur dy lumenj ose dy dete. Kanal ujitës (kullues, ujëmbledhës). Kanal i lundrueshëm. Kanal nëntokësor rrjedhë uji nën tokë ose hapësirë ku kalon nafta, gazi, etj. b. në një kuptim më konkret **në anatomi** emërton *pjesë të një organi, në trajtë gypi të ngushtë me dredha, ku zakonisht kalojnë lëndë të ndryshme në organizëm. Kanali i ushqimit. Kanali i jashtëqitjes. Kanalet e lotëve. Kanali i tëmthit. Kanali i veshit. Ngushtimi i kanalit.* Ndërkaq, po aq specifike në fushë të **mjekësisë ligjore** dhe njëkohësisht në kriminalistikë përdoret termi teknik *kanal i plagës* "rruga që bën predha ose copat e saj në trupin e njeriut, në vazhdim të vrimës së hyrjes në plagë". Terma me origjinë nga *leksiku i përgjithshëm* evidentohen jo pak, veçanërisht në lidhje brendatogfjalësore, p.sh.: *rregull* (fj. përgj.) > mjek. ligj. *rregull i këqyrjes së vendit të ngjarjes*; *rrjedhë* (fj. përgj.) > mjek. ligj. *rrjedhë gjaku* "gjurmë gjaku që rrjedhin nga plagët duke formuar në sipërfaqe trajta të përkulura ose gjatësore"; *shkak* (fj. përgj.) > mjek. ligj. *shkak vdekje,* etj., (shih më poshtë termat togfjalësh).

Sinonimet terminologjike në fushë të mjekësisë ligjore janë një dukuri jo fort e rrallë. *Çiftet sinonimike* që dallohen lehtësisht janë të përbërë nga *një term ndërkombëtar me origjinë nga gjuhët e huaja*, veçanërisht ato *klasike (latinisht, greqisht*), ndërkaq tjetri nga leksiku amtar i shqipes ose fjalëformimit nga brumi i shqipes, shpesh *kalke*. Pra, *termat dysore/sinonime* shfaqen në përdorimet paralele të termit shqip krahas termit të huaj ose përdorimit të termit të huaj krahas termit shqip, duke na dhënë *çifte sinonimike* të njësive njëfjalëshe si më poshtë: shq. *kundërtrup - antikorp*; shq. *helmim - toksikim* (lat. intoxicatio) "çrregullim i shëndetit nga veprimi i helmeve"; shq. *frymëmarrje* – lat. *aspirim*; shq. *përshtatshmëri* – lat. *adaptim*; shq. *riaftësim, ripërshtatshmëri - reabilitim*; shq. *mbytje - asfiksi*; shq. *zhvarrosje - ekzumim*; shq. *rëndim - agravim*; shq. *kudrambrojtje - anafilaksi*; shq. *ënjtje - edemë* (grumbullim i një sasie të madhe lëngjesh në qelizat dhe në kapilarët ndërqelizorë të organizmit);

shq. *çrregullim* ose *shqetësim i brendshëm - disfori*; shq. *bllokim* (i një arterieje ose vene) - *emboli*; shq. *fshehje - disimulim* (lat.) *e kundërta simulim*; shq. *fryrje - emfizemë* (kufomore); shq. *thyerje* – lat. *frakturë*; shq. *pamje e jashtme e njeriut - habitus*; shq. *shkripëzim - halisteresis* (gr. hals "kripë" + steresis "heqje, largim"); shq. *mospërmbajtje* ose *paaftësi për të mbajtur - inkontinencë* (lat.); shq. *goditje, krizë - insult* (lat. *insultus – atak, goditje*) *çrregullim i menjëhershëm i qarkullimit të gjakut në tru që mund të jetë i karakterit hemorragjik ose ishemik*; shq. *shkallë ose sektor në sistemin e organeve varëse - instancë*; shq. *mospajtim, papajtueshmëri - inkompatibilitet* (lat. incompatibilitas) *ndodh në transfuzionet e gjakut me grupe të ndryshme*; shq. *mpiksje - koagulim;* shq. *gjendje e rëndë - kolaps* (lat. Collapsus "i dobësuar, i rënë"); shq. *përbërje - konsistencë* (lat. Consistere "përbërje"); shq. *grumbullim, bashkim - konglomerat* (lat. Conglomeratus "grumbullim"); shq. *pamje e përgjithshme - konfiguracion* (lat. Configuratio "figurë, pamje"); shq. *shpronësim - konfiskim* (lat. Confiscatio "shpronësoj"); shq. *përdredhje ose nxjerrje nga vendi i kyçit - luksacion*; shq. *shtypje - kompresim* (lat. Compressio "shtypje, ngjeshje"); shq. *dëmtim, shembje e përgjithshme e organizmit pa dëmtime të dukshme me sy të lirë - kontuzion* (lat. Contusio "shembje, goditje, tronditje"); shq. *vendim - verdikt,* shq. *mbrojtës - protektor,* shq. *parapleqëri - presenilitet,* shq. *zbutje ose hollim - kolikuacion;* shq. *helmim i gjakut - sepsis,* shq. *prapavajtje - retrograd;* shq. *ndalim i hemoragjisë – hemostazë,* shq. *përngjitje – aglutinim,* etj. Kësaj liste u bashkëlidhen edhe *dysorët sinonimikë* pa korrespondente fjalëformuese nga brumi i gjuhës shqipe (me origjinë nga gjuhët e huaja). Këto njësi kanë zënë vende në terminologjinë përkatëse, si pjesë organike e termësit, p.sh.: gr. *nekropsi* – gr. *autopsi* (autopsi me denduri përdorimi edhe në ligjërimin e zakonshëm (FGJSSH '80); *onanizëm – masturbacion*; *bertranizëm* "ka marrë emrin nga i sëmuri Bertan (psikopat) që vuante nga ky lloj perversioni seksual" – *nekrosadizëm*; etj.

Po ashtu, nga krahasimi i sinonimeve të huaja me FGJSSH '80, vërë re shumë

pak terma (sinonime të jashtme) nga fusha e mjekësisë kanë depërtuar në leksikun letrar të shqipes (FGJSSH '80) p.sh.: *autopsi* (mjek. > lek. letrar); *asfiksi* (mjek. > lek. letrar) zgjeruar semantikisht në 2. fig. *ndërprerje a vështirësi e madhe që krijohet në një degë prodhimi dhe që pengon zhvillimin e lirë të saj.* (FGJSSH '80); si *dhe viktimë – i dëmtuar* (dysorë sinonimikë njësi të leksikut letrar (FGJSSH '80), etj. Si dhe shumë terma nga fusha të tjera të shkencës, të huazuara nga mjekësia ligjore[45] me të cilat ajo bashkëvepron dhe që kanë depërtuar edhe në fjalorin letrar të shqipes (referuar FGJSSH '80) p.sh.: *konglomerat* (gjeo. > mjek. ligj.) "grumbullimi mekanik i thërrmijave të ndryshme ose i organeve" (shih: FGJSSH '80); *konfiskim* (ekon. > mjek. ligj.) "marrja pa shpërblim e pasurisë a pronës një të dënuari me vendim gjyqi" (shih: FGJSSH '80); *instancë (*zyrt., drejt. > mjek. ligj.) "shkallë e veçantë në një tërësi organesh shtetërore, administrative, e një procesi gjyqësor etj., që ka në dorë zgjidhjen e një çështje" (shih: FGJSSH '80). Nga shembujt e mësipërm, por edhe nisur nga përvoja rezultatdhënëse e terminologëve pararendës, mbështesim pohimin më se të vërtetuar, se terminologjia teknike-shkencore është *element përbërës i rëndësishëm për pasurimin e fondit leksikor të gjuhës shqipe.*

Gjithashtu, shkak për krijimin e termave sinonime bëhen emërtimi i shkurtuar i objektit, dukurisë, veprimit, krahas emërtimit të plotë në lidhjet brendatogfjalësore të gjata (disa gjymtyrëshe), p.sh.: *thyerja e kockave të gjata - thyerja e kockave të gjata të gjymtyrëve; traumë pas vdekjes - traumë e shkaktuar pas vdekjes; plagë me armë zjarri - radhë e plagëve me armë zjarri; hemorragji e trurit - hemorragji nën cipat e holla të trurit,* etj.

Gjuha e mjekësisë ligjore zotëron një tërësi formash sinonimike, ku zakonisht sikurse theksuam më lart, njëra prej njësive të *çiftit apo dubletit sinonimik* është term ndërkombëtar, i huazuar kryesisht nga gjuhët klasike (latinishtja dhe greqishtja)

45 Lidhur me huazimet terminologjike të mjekësisë nga fusha të tjera të shkencës dhe teknikës shih më sipër tek III. Lidhja sistemore e fjalës term (njëfjalëshe) me fjalën e përgjithshme (nga ligjërimi i zakonshëm dhe ai special).

dhe që e shndërron postulatin e terminologjisë së formuluar nga E. Vyster "për një terminologji të përpunuar" nga barazia *një term - një koncept* në *një koncept - disa terma* d.m.th. një grup termash që i referohen një koncepti, objekti apo subjekti të vetëm të fushës së mjekësisë ligjore. Referuar teorikisht studimeve të prof. Agron Duros, në lidhje me *vargjet dysorë*, i cili me profesionalizëm e orienton studiuesin/ekspertin/përdoruesin te *mbizotëruesi/dominanti sinonimik*, duke i dhënë përgjithësisht përparësi termave më të përshtatshëm dhe në veçanti fjalëformimeve të shqipes, pikërisht në rastet e dendurisë së madhe të përdorimit ose për vlera cilësore të njohura shënuese e shprehëse të termit në gjuhën shqipe, por pa e tepruar asnjëherë me purizmin. Për njësimin dhe kodifikimin e terminologjisë, pohon prof. Duro, merret për bazë jo vetëm qëndrueshmëria, shkalla e ngulitjes së termit, por në radhë të parë **cilësia** e tij. ... ***Cilësia*** *e termit del pikërisht si faktori kryesor që e bën bartësin e gjuhës shkencore-teknike të shkëputet më lehtë nga termi i dikurshëm (i vjetër). Sa më e lartë të jetë cilësia e termit aq më lehtë përqafohet ai dhe aq lehtë hiqet dorë prej termit të vjetër të papërshtatshëm. Prandaj gjatë ndërtimit të termave të rinj, i duhet kushtuar vëmendje e veçantë aftësisë fjalëformuese të tyre, formës, lehtësisë së shqiptimit, harmonizimit të kompleksitetit tingullor, etj., duke e parë çdo term jo si një njësi të veçuar, por si pjesë përbërëse të një sistemi në zhvillim*[46].

Përmbledhtazi si rezultat i konceptimeve të punimeve shkencore të dijetarëve vendas dhe huaj më me zë në trajtimin e termit, në përshtatje me leksikun e specializuar ku po hulumtojmë, dalim në përfundime të vlefshme dhe për studimin tonë: përdorimi i sinonimeve "për të thyer monotoninë ose për të mënjanuar përsëritjen" nuk ka vend në terminologji, ku kërkohet qartësia dhe *njëkuptimësia*. Madje, disa studiues praninë e sinonimeve në sistemet terminologjike e mohojnë kategorikisht, pasi komprometon terminologjinë. *Formimet dysorë*, duke ngarkuar

46 Agron Duro, "Terminologjia si sistem", C. Njësimi i terminologjisë, Panteon 2001, Tiranë, f. 100, si dhe konceptim i ngjeshur nga gjithë kreu Mundësitë pontenciale të shqipes për pasurimin e terminologjisë, f. 91-100.

sistemin terminologjik, cenojnë marrëdhëniet *koncept - term*, gjithashtu dëmtojnë ngulitjen e konceptit pas një emërtimi të vetëm për të krijuar një njësi të vetme organike. Zakonisht, në këto dysorë, fjala shqipe merret si fjalë e zakonshme, kurse shenja e huaj si term. Shpesh, *kjo kundërvënie është rrjedhojë e iluzionit të specialistëve, të cilëve u ngjan si term vetëm shenja e huaj. Teorikisht, fjala në shqip mund të luajë rolin e termit, përderisa ajo përmban kuptimin e plotë shkencor dhe emërton të njëjtin objekt si edhe termi i huaj*[47] p.sh.: *kundërtrup – antikorp; helmim – toksikim; frymëmarrje – aspirim; riaftësim, ripërshtatshmëri – reabilitim; mbytje - asfiksi; zhvarrosje - ekzumim; kudrambrojtje - anafilaksi; bllokim* (i një arterieje ose vene) - *emboli; fshehje - disimulim; fryrje - emfizemë* (kufomore), etj. Këto njësi, normalisht ekzistojnë si lidhje ndërmjet termave me koncepte të njëjta, të dëmshme për terminologjinë e fushës përkatëse, por me kalimin e kohës në kufijtë e kontekstit shkencor me ndërhyrjen e vetëdijshme të përdoruesve në praktikën mjeko-ligjore, si dhe nën ndikimin e procesit të vazhdueshëm të përpunimit të terminologjisë, sikurse ka ndodhur edhe me fusha të tjera, gradualisht do të fillojnë të dobësohen ose të rrallohen, ku do të fitojë njëri prej termave, *më i përshtatshmi*, që duke u pajtuar me normën gjuhësore të shqipes, do të njësohet e standardizohet pikërisht termi më i përshtatshëm, pra më dominues.

Ndryshe nga dy dukuritë e mësipërme kuptimore, *dukuria e antonimisë*, karakterizohet për lidhje sistemore të koncepteve, pra për një terminologji të zhvilluar në sistem, ku në fjalësin e mjekësisë ligjore ndeshim raste të çifteve antonimike p.sh.: *vlefshmëri – pavlefshmëri e martesës*; *i moralshëm – i pamoralshëm; i motivueshëm – i pamotivueshëm; aftësi – paaftësi seksuale; kujdesi – pakujdesi; virgjërim – çvirgjërim; i lehtë – rëndë* (p.sh.: për dëmtim i lehtë, dëmtim i rëndë); *i ligjshëm – i jashtëligjshëm* (p.sh.: për mjekim), *dhënie – mosdhënie ndihme; formim – deformim; hidratim – dehidratim; simulim – disimulim; kalcifikim – dekalcifikim; hipotermi –*

47 Po aty.

hipertermi; hipomnezi – hipermnezi, infanticizëm aktiv – infanticizëm pasiv; subdiagnozë, subakut – superdiagnozë, superakut, etj. *Çiftet antonimike* në terminologji shfaqen më të natyrshme, jo vetëm për karakterin sistemor të tyre, por këto krijojnë lidhje të reja duke bërë që të shtohen kuptimet terminologjike në strukturën kuptimore të fjalës p.sh.: në gjuhë mbiemri *i shpejtë* ka si antonim *i ngadaltë*, ndërkaq që ky mbiemër në lidhje togfjalësore terminologjike të konceptit "vdekje" shfaqet në *vdekje e shpejtë* " që ndodh brenda disa sekondash apo minutash nga veprimi i dhunës" që nga ana konceptuale, praktike në gjuhën e specializuar të mjekësisë ligjore ka si antonim mbiemrin *e rremë* ose *klinike* tek togfjalëshat: *vdekje e rreme* "letargjia" ose *vdekje klinike* "gjendje minimale e veprimtarisë jetësore pas ndalimit të plotë të qarkullimit të gjakut ose frymëmarrjes"; po ashtu edhe për togfjalëshat *vdekje e përdhunshme* "shkaktohet nga veprimi në organizëm i faktorëve të dhunshëm siç mund të jenë: traumat e ndryshme, vdekjet nga dëmtimet me armë zjarri, me armë të ftohta, aksidentet automobilistike" për nga ana konceptuale në praktikën mjekoligjore mund të ketë si antonim *vdekje e natyrshme* "ndodh në pleqëri të thellë" ose *vdekje e papritur* "ndodh menjëherë papritur, brenda disa sekondash ose minutash pas shfaqjes së sëmundjes (quhet dhe *vdekje në ecje*)"

Përfundime:

Termësi i mjekësisë ligjore, ndryshe nga disiplinat e tjera të shkencës dhe teknikës pasqyron gërshetimin e lidhjeve të shumëfishta ndërdisiplinare të shkencave mjekësore me termat e disa shkencave bazë të dijes. Nisur nga vetë natyra e ndërlidhur me disa disiplina, në të mbizotërojnë huazime nga fusha të tjera terminologjike, me rikuptimësim të tyre në lëm të mjekësisë ligjore, përfshirë këtu edhe terma nga ligjërimi i zakonshëm.

Leksiku i kësaj fushe ngrihet mbi bazën e gjuhës shqipe dhe është pasur me mjaft

elemente ndërkombëtare, kryesisht nga gjuhët klasike (latinishtja dhe greqishtja), duke mbajtur lidhje të ngushtë me leksikun e përgjithshëm të shqipes dhe me ngritjen në nivelin e termave të shumë fjalëve prej tij, si dhe mbajtjen e lidhjeve gjithashtu me shumë fusha të tjera të dijes, si me fushën *juridiko-penale*, fushën e *hetimit*, me elemente nga fusha e *biologjisë, kimisë, fizikës, matematikës, rezistencës materiale* etj.; pa lënë mënjanë gjithashtu, lidhjen e ngushtë dhe integrale me të gjitha fushat e mjekësisë, veçanërisht me *mjekësinë anatomikopatologjike, mjekësinë interne, imazherinë dhe teknikat laboratorike* etj.

Analizimi i termave në fushë mjekësisë ligjore na lë të kuptojmë atë çka është fort e rëndësishme për terminologjinë, se term nuk quhet vetëm ajo njësi që është e lidhur pas një fushe të vetme të dijes, term vazhdon të quhet njësia edhe atëherë kur shfaqet njëherazi në kompleksin e lidhjeve të saj me sisteme të tjera terminologjike. Sipas rregullave terminologjike të hartimit të fjalorëve shpjegues terminologjikë edhe *termësi në lëm të mjekësisë ligjore*, analizuar në lidhje paradigmatiko-semantike konsideron si kusht parësor *kuptimin bosht të termit të dhënë në përkufizim*, përderisa edhe në fusha të tjera ai përdoret me të njëjtin kuptim, normalisht shpesh shoqëruar me zgjatime të nuancave kuptimore në përshtatje me fushën përkatëse ku depërton, por gjithnjë duke e mbajtur të lidhur kuptimin pas një fushe të vetme zanafillëse. Kështu, **çdo term i lidhur pas çdo kuptimi të fiksuar e të qëndrueshëm, fiton pavarësi brenda caqeve të fushës së dijes ku vepron, duke u pranuar si i njëkuptimshëm**.

Termat si njëfjalësh por edhe ata togfjalësh përkatësisht ato dygjymtyrëshe (që do të trajtohen si vijimësi e këtij punimi, në pjesën e dytë të tij), në praktikën mjeko-ligjore përbëjnë bazën e terminologjisë dhe zënë vendin parësor si nga përmbajtja e ngarkesës konceptore ashtu edhe nga denduria e korpusit të termave, ku të dy llojet pranohen si terma themelorë me bazë *nominative (emërore),* pasi duke

u mbështetur në kriterin e fushës dhe të kuptimit, këtë funksion të termit mund ta kryejnë mjaft mirë vetëm *termat emrat.*

Dukuria e ndajshtesëzimit dhe e përbërjes është një nga mënyrat fjalëformuese më frekuente në *praktikën mjekoligjore*, që përdoret për të krijuar terma të rinj dhe për të garantuar kuptueshmërinë e tyre. Dekodifikimi i ndajshtesave teke, pjesëve fjalëformuese (kryesisht nga gjuha greke dhe latine) dhe rrënjëve në përbërje të termave e bëjnë sistemin jo vetëm më të kuptueshëm, por edhe më të lidhur e të motivueshëm. Në praktikën mjekoligjore përkrah termave me origjinë nga gjuhët klasike, të cilat lejojnë të krijohen forma të shkurtra gjuhësore me përhapje ndërkombëtare me përmbajtje konceptesh kuptimore komplekse (të ndërthurura) dhe me jetëgjatësi, duke qenë më pak subjektivë ndaj ndryshimeve të tipit semantik; ndeshen gjithashtu dysorët sinonimikë të termave të formuara nga gjuha amtare duke shfrytëzuar mënyrat dhe mjetet e ndryshme të fjalëformimit si ndajshtesimi (parashtesimi, prapashtesimi), kompozimi, togfjalëzimi dhe rikuptimësimi i fjalëve të leksikut special e të përgjithshëm. Fjalët e leksikut të zakonshëm vihen në lidhje të drejtpërdrejt me leksikun terminologjik, duke i vënë vetes si mision përforcimin e fytyrës dhe origjinalitetit kombëtar të njësuar të termave edhe në lëm të mjekësisë ligjore.

Bibliografia

BELL Suzanne, *Dictionary of Forensic Science*, Oxford University Press.

BLAKAJ Flamur, MEKSI Sokrat *Mjekësia Ligjore*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, 2019.

ÇIPI Bardhyl, ÇIPI Spiro, *Manual i Mjekësisë Ligjore*, Botimet Klean, 2015.

ÇUBERI Bashkim, *Mjekësia Ligjore*, Botim i dytë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë, 1975.

DURO Agron, *Sistemet terminologjike në gjuhën e shkencës dhe të teknikës*, Studime filologjike, nr. 4, Tiranë, 1984.

DURO Agron, *Termi dhe fjala në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.

DURO Agron, *Terminologjia si sistem*, Panteon, 2001, Tiranë.

DURO Agron, *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme*, Studime filologjike, nr. 4, 1982.

DURO Agron, "Pasqyrimi i termave me strukturë togfjalëshi në fjalorët terminologjikë të shqipes", Leksikografia shqipe, *Trashëgimi dhe prespektivë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Konferencë shkencore, Tiranë 3 dhjetor 2004. Botuar Tiranë, 2005.

FJALORI I SHQIPES SË SOTME (FGJSSH), 1980.

FJALORI SINONIMIK I GJUHËS SHQIPE, Tiranë, 2004.

GIUSTI Giusto, *Dizionario di Medicina Legale e scienze affini*, CEDAM.

HOXHA Sabri, HOXHA Flamur, *Mjekësia Ligjore dhe Kriminologjia*.

HOXHA Sabri, RAMADANI Agim, *Mjekësia Ligjore,* botim i Universitetit shtetëror të Tetovës.

MEKSI Sokrat, ÇIPI Bardhyl, *Mjekësia Ligjore.*

MEKSI Sokrat, LUTFI Alia, *Fjalor i Mjekësisë ligjore*, Botim i Drejtorisë së Arsimit Shëndetësor, Tiranë, 1984

PROKO-JAZEXHIU Vilma, *Leksiku terminologjik i agronomisë në gjuhën shqipe,* Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2012.

PASHO Hëna, *Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe,* Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2017.

LEKA Ferdinand, *Udhëzues,* Për përpunimin e terminologjisë tekniko-shkencore, Akademia e Shkencave e RPSSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i terminologjisë dhe i kulturës së gjuhës, Tiranë, 1983.

LEKSIKOGRAFIA SHQIPE, *Trashëgimi dhe prespektiv*ë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Konferencë shkencore, Tiranë, 3 dhjetor 2004, Tiranë 2005.

Seria e fjalorëve terminologjikë në fushë të mjekësisë: *Terminologjia tekniko–shkencore. Fjalor i termave të anatomisë (shqip-latinisht-frëngjisht-rusisht),* Tiranë 1985, 253 f.; *Fjalor i termave të histologjisë dhe të embriologjisë (shqip-latinisht-frëngjisht-rusisht),* Tiranë 1986, f. 441.; *Fjalor i termave të obstetrikës dhe gjinekologjisë (shqip-latinisht-anglisht-frëngjisht-rusisht),* Tiranë 1987, f. 443; *Fjalor i termave të së drejtës (shqip-frëngjisht-rusisht),* Tiranë, 1986, f. 496.

QIRJAZATI Kosta, *Terminologjia latine* (në dy vëllime)

SUBASHI Shyqyri, *Termat e patologjisë* (fjalor shpjegues i termave), ILAR 2004.

UKA, Njazi, "Fjalori i Drejtësisë".

THOMAI Jani, *Studime për gjuhën shqipe IV, Leksikografi,* Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017.

THOMAI Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Botimet TOENA, 2006.

Accademia della Crusca > Lingua in rete > Lingue speciali. Online: http://www.accademiadellacrusca.it/lingue_speciali.shtml (konsultuar më)

CARIONI, VERONICA, Breve introduzione alla terminologia. Online: http://www.farum.it/intro_terminologia/index.php (konsultuar)


DE MAURO T. (a cura di), Grande dizionario italiano dell'uso - GRADIT, UTET, 1999-2000.

MAGRIS M., MUSACCHIO M. T., REGA L., SCARPA F., *Manuale di terminologia, Aspetti teorici, metodologici e applicativi,* Hoepli, 2002.

FELBER H., *Terminology Manual*, Infoterm-UNESCO, 1984.

Figura 1

SKEMA E LIDHJES NDËRDISIPLINORE TË SHKENCËS SË MJEKËSISË LIGJORE ME SHKENCAT E TJERA TË DIJES



Magdalena Anxhelika Shitov

Terminologjia dhe roli i saj në interpretim

Për të folur për terminologjinë si shkencë, së pari duhet të përkufizohet gjuha e përgjithshme dhe ajo profesionale. E përgjithshme është gjuha që e flasin të gjithë folësit, pavarësisht nga profesioni i tyre. Ajo përbëhet nga fjalë të njohura të përgjithshme të cilat janë polisemike dhe bëhen monosemike në varësi të kontekstit në të folur ose në të shkruar, ndërkaq lidhen edhe me kuptimin njohës nga pranuesi. Gjuhët profesionale i referohen një fushe të caktuar dhe e rregullojnë fjalorin, duke e lehtësuar kështu komunikimin e ndërsjellë të ekspertëve. Përparimi i shoqërisë çon në krijimin e gjuhëve profesionale të cilat u nënshtrohen rregullave gramatikore, leksikore dhe fonetike të gjuhës së përgjithshme. Ato ndryshojnë nga gjuhët e përgjithshme për shkak të organizimit specifik të fjalisë (plotësia, mbyllja e strukturave të fjalisë dhe kryesisht fjalitë shprehëse), nga vazhdimi i një teme në tërë tekstin (dhe ndarja e temës-remës), nga prirja e përdorimit të shpeshtë të konstruksioneve pasive dhe të formave të foljeve jovetore, nga përdorimi i mënyrës dëftore, nga koha e tashme dhe veta e tretë), si dhe nga përdorimi i kallëzuesit foljor (modal) me infinitiv (VESE 1990: 45).

Pavarësisht dallimeve, nuk është e mundur të vihet një kufizim i qartë midis gjuhës së përgjithshme dhe gjuhëve profesionale, sepse shumë elemente në gjuhën profesionale bëjnë pjesë edhe në gjuhën e përgjithshme dhe anasjelltas. Njëkohësisht, gjuha profesionale po bëhet më e qasshme edhe për folësit joprofesionalë, duke përfshirë medien, internetin, revistat profesionale dhe emisionet televizive të cilat sjellin temat profesionale më afër publikut të gjerë. Ky zhvillim vihet re në faktin se ndryshe nga disa dekada më parë, sot një numër i vogël i njerëzve nuk i njohin

termat *virus, inkubacion, infuzion, lazer, stent, gjykatë administrative, prokurori, pandemi, imunizim* e të tjerë, të cilat nëpërmjet determinologjisë janë bërë pjesë e gjuhës së përgjithshme edhe pse kjo nuk nënkupton se të gjithë ata që i kanë dëgjuar e dinë saktësisht se çka nënkuptojnë dhe si përdoren.

HOFMAN (1985: 53) përkufizon gjuhët profesionale si

Fachsprache – das ist die Gesamtheit aller sprachlichen Mittel, die in einem fachlich begrenzbaren Kommunikationsbereich verwendet werden, um die Verständigung zwischen den in diesem Bereich tätigen Menschen zu gewährleisten.[1]

(citat sipas STOLZE 1999: 22)

Gjuhët profesionale krijohen nëpërmjet ndikimeve normative të përdoruesve të cilët kanë njohuri të gjerë për temën e cila është dominuese në profesionin e tyre dhe përpiqen ta përmirësojnë vazhdimisht komunikimin midis ekspertëve në fushat e tyre të specializimit, duke e përshtatur gjuhën profesionale me nevojat.

Në normën DIN 2342 gjuha profesionale përkufizohet si:

Fachsprache ist der auf eindeutige und widerspruchsfreie Kommunikation im jeweiligen Fachgebiet gerichtete Bereich der Sprache, dessen Funktionieren durch eine festgelegte Terminologie entscheidend unterstüzt wird. Anmerkung: Der Kernbereich der Sprache, an dem alle Mitglieder einer Sprachgemeinschaft teilhaben, wird als Gemeinsprache bezeichnet. [2]

(citat sipas ARNC etj. 2004:10)

Në formë analoge në ndarjen në gjuhë të përgjithshme dhe në atë profesionale, dallojmë përkthimin profesional kundrejt përkthimit të përgjithshëm, megjithëse

1 Gjuha profesionale - është tërësia e të gjitha mjeteve gjuhësore të përdorura në një fushë komunikimi që mund të kufizohet profesionalisht për të ofruar mirëkuptim mes njerëzve që punojnë në atë fushë. (në maq. nga M.A.SH.)

2 Gjuha profesionale është fusha e gjuhës që synon komunikimin njëkuptimor dhe jo kontradiktor në një fushë të caktuar profesionale, funksionimi i së cilës mbështetet me autoritet nga terminologjia e vendosur. (në maq. nga M.A.SH.)

në rastin e interpretimit në konferencë, interpretuesi çdoherë do të jetë në rrethin profesional, duke pasur parasysh që çdo konferencë është profesionale në vetvete dhe ka fushë profesionale të caktuar tematike. Kështu që çdo interpretim nëpër konferenca mund të ndërlidhet me komunikimin profesional transkulturor. SANDRINI (2005: 34) thotë:

Fachliche Translation versteht sich nicht allein als Translation von fachsprachlichen Texten, was man als ein Hyponym von Translation allgemeiner Texte auffassen könnte, sondern vor allem als integrativer Teil einer transkulturellen Fachkommunikation, wodurch ihr große Verantwortung für einen funktioniernenden transkulturellen Dialog im Fachbereich zukommt.[3]

Me zhvillimin e vazhdueshëm të gjuhëve profesionale krijohen edhe terma të reja dhe kështu arrihet deri te paraqitja e neologjizmave, e sinonimeve, e polisemive dhe e homonimeve për shkak të përdorimit të termave të njëjtë në më shumë gjuhë profesionale. Nevojën e termave të rinj VESE (1990: 44) e shpjegon me ndikimin kombëtar dhe ndërkombëtar, gjithnjë në rritje, në fushat e shoqërisë në jetën e secilit njeri, me nevojën në rritje për informim të vazhdueshëm, me komunikimin midis njerëzve profesionit, me lëvizshmërinë më të madhe gjeografike dhe shoqërore, si dhe me horizontin më të gjerë të arsimimit të pjesëmarrësve në komunikimin profesional. Për t'iu shmangur kaosit terminologjik, nga shek. XX është bërë **standardizimi**, me siguri pasi që kjo periudhë karakterizohet me përparim të madh teknologjik dhe arritje të rëndësishme shkencore, ndaj lindi nevoja për të emërtuar arritjet, shpikjet, lëndët dhe procedurat e reja, si dhe emërtimi i unifikuar global. Në vitin 1906, Komisioni Elektroteknik Ndërkombëtar[4] filloi shqyrtimin e terminologjisë elektroteknike. Gjashtë vite më

3 Përkthimi profesional nuk konsiderohet vetëm si përkthim i teksteve profesionale, që mund të konsiderohet si hiponim i përkthimit të teksteve të përgjithshme, por mbi të gjitha pjesë përbërëse e komunikimit profesional ndërkulturor i cili i kushton rëndësi të madhe funksionimit të dialogut ndërkulturor në fushën profesionale. (në maq. nga M.A.SH.)

4 International Electrotechnical Commission (IEC)

vonë, në Gjermani u themeluan nënkomisione profesionale për terminologjinë në kuadër të komisioneve profesionale të Komisionit Gjerman për Norma[5]. Në vitin 1926 u themelua Federata Ndërkombëtare e Shoqatës së Standardizimit, e cila si institucion ka pasur për qëllim të caktojë rregulla për krijimin e termave të rinj që kërkonin ligjshmëri në strukturën e terminologjive ekzistuese me të cilat shënohet fillimi i zhvillimit të normave për parimet terminologjike. Katër vite më vonë parimet e terminologjisë janë hulumtuar në Austri, Gjermani, Çekosllovaki dhe në Bashkimin Sovjetik. Në vitin 1946 është themeluar institucioni që është pasardhës i ISA-së, e quajtur Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit[6], e cila në vitin e gjashtë të ekzistencës së saj themeloi Komisionin Teknik për Çështje Terminologjike me titull: 37 Parimet dhe koordinimi i terminologjisë[7]. Paralelisht me ISO-në, punën e saj e kryen edhe IEC-ja nëpërmjet Komisionit të saj Teknik 1, e detyruar për koordinimin e aktiviteteve të ndërlidhura me terminologjinë. Në vitet e 60-ta të shek. XX parimet terminologjike u hulumtuan në lëvizje të plotë, kurse në fillim të viteve të 70-ta hulumtimet çuan deri në krijimin e disiplinave të reja – **shkenca e terminologjisë.** Ajo filloi të zhvillohet në Austri, në Gjermani, në Çekosllovaki dhe në Bashkimin Sovjetik në vitet e 30-ta të shek. XX, ndërkaq në Europën Veriore dhe në Kanada u përhap 30 ose 40 vjet më vonë dhe është marrë me çështjet themelore të terminologjisë (ARNC 1998: 82).

Detyra kryesore e saj është shqyrtimi i marrëdhënieve midis termave, midis termave dhe nocioneve dhe midis vetë nocioneve, duke u përpjekur të zhvillojë parime dhe terminologji të unifikuar, si dhe të vendosë bazat për zhvillimin e tyre të mëtejmë sistematik. Për herë të parë terminologjia si shkencë u përkufizua nga inxhinieri Ojgen Vister (1898–1977), ndërkaq vepra e tij e publikuar në vitin 1931 me titullin Internationale Sprachnormung in der Technik, besonders

5 Deutscher Normenasuschuss (DNA)
6 International Organization for Standardization (ISO)
7 ISO/TC 37 Terminology Principles and Coordination

in der Elektrotechnik[8] llogaritet si gurë themeli i kësaj shkence. Në vitin 1952, Visteri vazhdon punën e tij si udhëheqës i ISO-së. Gjashtëmbëdhjetë vjet më vonë shkroi veprën The Machine Tool, an Interlingual Dictionary of Basic Concepts e cila paraqet fjalor frëngjisht-anglisht të organizuar sistematikisht me terma të standardizuar me pjesën shtesë të gjuhës gjermane dhe shërben si model për fjalorët e ardhshëm teknik. Qëllimet e Viserit ishin që të eliminonte shumëkuptimësinë drejtë standardizimit të terminologjisë që të krijohet mjet efikas për komunikim, që të binden të gjithë përdoruesit e gjuhëve teknike për përfitimet nga termat e standardizuar, që të rregullohet terminologjia si disiplinë për të gjitha qëllimet praktike dhe t'i jepet statusi i shkencës.

Në Die allgemeine Terminologielehre[9] nga viti 1979 Visteri e përkufizon shkencën e terminologjisë si shkencë që merret me hulumtimin e bazave të terminologjisë, d.m.th. me termat dhe me sistemin e tyre dhe e ndanë në shkencë të përgjithshme të terminologjisë të përkufizuar si fushë kufitare midis shkencës së gjuhës, të logjikës, të ontologjisë, të shkencave të informacionit dhe të atyre shoqërore, dhe në veçanti kërkon të hulumtojë bazat e parimeve dhe të metodave të terminologjisë së përgjithshme, dhe të shkencës së veçantë të terminologjisë e përcaktuar si shkencë që kërkon të hulumtojë bazat e parimeve dhe të metodave terminologjike të fushave profesionale individuale ose të gjuhëve.

Shkenca e terminologjisë si disiplinë shkencore merret me bazat teorike të pikëpamjes së termave të orientuar në mënyrë parashkruese, ku interesi i saj vendoset së pari në veçoritë e përgjithshme të termave, si dhe ato veçori të termave nga fushat individuale profesionale ose gjuhët profesionale. Konsiderohet si disiplinë e pavarur shkencore, e cila ndikohet pak a shumë teorikisht dhe

8 Standardizimi ndërkombëtar i gjuhës në teknologji, dhe veçanërisht në inxhinieri elektrike. (në maq. nga M.A.SH.)

9 Shkenca e përgjithshme e terminologjisë (në maq. nga M.A.SH.)

metodologjikisht nga kërkimi i gjuhëve profesionale, teoria e shkencës, shkenca e informacionit, informatika dhe disiplina të tjera. (ARNC etj. 2005: 114,115). Ajo bazohet jo vetëm në shkencën e përgjithshme të terminologjisë, por edhe në logjikën e të kuptuarit, domethënë, përfaqësimi konjunktivë i termave në varg horizontal dhe vertikal dhe luan rol në trajnimin e punëmarrësve të rinj dhe përkthyesve të fushave profesionale, dhe kohët e fundit edhe trajnimi i gazetarëve dhe ekspertëve të komunikimit (ARNC 1998: 79).

Pas vitit 1990, shkenca e terminologjisë është lidhur me shkencat e tjera dhe çoi në krijimin e disiplinave të reja si socioterminologjia, teoria e komunikimit të terminologjisë dhe terminologjia sociokonjunktive. Në kontekstin e terminologjisë, duhet përmendur **veprimtaria terminologjike**, pa të cilën fjalori profesional nuk do të mund të rritej fare në mënyrë të organizuar. Ajo përfshin standardizimin e terminologjive ekzistuese kombëtare dhe përpilimin e tyre, si dhe harmonizimin e tyre reciprok. Realisht, veprimtaria terminologjike paraqet zbatim praktik të njohurive dhe metodave të shkencës së terminologjisë, brenda të cilave fjalori i fjalëve profesionale zhvillohet dhe përpunohet. HOFMAN (1985: 24) përkufizon detyrat e veprimtarisë terminologjike në mënyrën vijuese:

[...] strebt die Terminologiearbeit zunächst einmal nach Klarheit über das Wesen der Begriffe, nach der Abgrenzung von Begriffsinhalt und Begriffsumfang sowie nach einer grundsätzichen Bestimmung der Verhältnisse von Begriff und sprachlichen Zeichen.[10]

Ajo merret me përgatitjen e sistemit njëgjuhësor ose shumëgjuhësor të termave dhe përfshin standardizimin e terminologjive ekzistuese kombëtare dhe krijimin e terminologjive të reja, si dhe harmonizimin e tyre reciprok. Rezultati i veprimtarisë terminologjike është terminologjia shkencore e arritur

10 […] Puna terminologjike synon fillimisht për qartësinë e thelbit të termave, për dallimin ndërmjet përmbajtjes dhe vëllimit të termit, si dhe për përcaktimin e përgjithshëm të marrëdhënieve ndërmjet termit dhe shenjës gjuhësore. (në maq. nga M.A.SH.)

me përkufizimin e parimeve të fjalorit profesional, vetitë e saj themelore dhe specifike, elementet e përbashkëta dhe të ndryshme të shkencës dhe gjuhës, gjendjen reale të emërtimit të termave, parimet e vlerësimit të specifikimit, përparësitë edhe pas zbulimit të specifikave, rishikimin e historisë dhe nxitjen e zhvillimit të fjalorit profesional (ARNC, 2008: 78). Veprimtaria terminologjike përfshin hulumtimin, përcaktimin e nocioneve dhe titujve në më shumë gjuhë, si dhe ruajtjen, mirëmbajtjen dhe disponueshmërinë e të dhënave me ndihmën e kompjuterit. Ajo i rishikon nocionet profesionale në një fushë si të ndërlidhura, d.m.th. si pjesë të sistemit të nocionit. Kjo është arsyeja pse fjalorët profesionalë modernë sistemohen më shpesh nga nocioni superior në atë më të hollësishëm. Në këtë kuptim, ARNC (1998: 78) bën dallimin midis veprimtarisë terminologjike përshkruese dhe parashkruese, duke theksuar se veprimtaria përshkruese ka për qëllim të përshkruaj dhe të evidentoj terminologjinë që përdoret në moment të caktuar pa ndikuar në përdorimin e gjuhës, ndërkaq puna terminologjike parashkruese ose normative ka për qëllim përdorimin e njësuar të terminologjisë. HOFMAN (1985: 25) konsideron se qëllimi i punës terminologjike është ndikimi rregullator në marrëdhëniet midis sistemeve të nocionit dhe atij terminologjik, si dhe krijimi i ndërgjegjshëm i terminologjive. SHMIC (1998: 88) na kujton se edhe veprimtaria terminologjike është e standardizuar dhe për gjuhën gjermane rëndësi të veçantë kanë këto normat DIN: 2330 (Begriffe und Benennungen – Allgemeine Grundsätze[11] 1993), 2331 (Begriffssysteme und ihre Darstellung[12] 1980) dhe 2342-1 (Begriffe der Terminologielehre – Grundbegriffe[13] 1992). Në kontekstin ndërkombëtar të veprimtarisë terminologjike është e rëndësishme norma ISO 1087 (Terminology – Vocabulary [14] 1990).

11 Termat dhe nocionet - parime të përgjithshme (në maq. nga M.A.SH.)
12 Sistemi terminologjike dhe përfaqësimi i tyre (në maq. nga M.A.SH.)
13 Termat e shkencës së terminologjisë - termat bazë (në maq. nga M.A.SH.)
14 Terminologji - fjalor

Personat të cilët angazhohen profesionalisht me veprimtarinë terminologjike quhen **terminologë**. Sipas ARNC (1998: 77), terminologu paraqet person profesional i cili bën mbledhjen e fjalëve profesionale, sistematizimin dhe përpunimin e tyre në mënyrë që të lehtësojë punën e përkthyesve. Për dallim nga gjuha e përgjithshme, në gjuhën profesionale, përveç krijimit të fjalorëve, të bazave të të dhënave të terminologjisë dhe të fjalorëve profesionalë, ekziston nevoja për të gjetur terma për lëndë, procedura ose fenomene të reja në fushat profesionale. Pikërisht kjo është puna e terminologëve të cilët zakonisht punojnë për njerëzit që kanë arsim të lidhur me shkencën e gjuhës, shkencën e terminologjisë ose përkthimin, përkatësisht profile arsimore interpretuese. Sipas FABER/ RODRIGEZ (2012: 9), disa studiues konsiderojnë se termat nga një fushë e caktuar duhet të krijohen nga personat profesionistë të asaj fushe, dhe kështu interpretuesit e konferencave me tema të tilla si: e drejta kushtetuese, duhet të jenë juristë njohës të gjuhës së huaj, ku sipas mendimit tim nuk ka asnjë kuptim, vetëm nëse interpretuesi, përveç arsimimit si interpretues ka edhe njohuri juridike.

Pjesë e punës terminologjike është normimi, përkatësisht përkufizimi i normave për përgatitjen e fjalorëve dhe përmbledhjeve terminologjike. HOFMAN (1985: 131) konsideron se puna normative nuk nënkupton vetëm regjistrimin e termave ekzistuese, por gjithashtu se ajo është e përfshirë në mënyrë aktive në procesin e krijimit të termave të reja. SHTOLCE (1999: 40) konstaton se normimi mund të konsiderohet i vlefshëm vetëm nëse normat janë të vendosura nga një institucion me autoritet ndërkombëtar, normat e të cilit janë shënuar siç duhet. Ekzistojnë shumë institucione të normimit, mes tjerash Infoterm-i ndërkombëtar [15], institucioni i normëzimit të UNESCO-s - UNISIST [16] dhe Komisioni i Terminologjisë[17] i themeluar në vitin 1936 nga ISA, i cili konsiderohet si udhëheqës në përgatitjen e normave të parimeve terminologjike. Ekzistojnë gjithashtu institucione kombëtare të normimit, ndërsa për sa i përket terminologjisë së gjuhës

15 International Information Centre for Terminology
16 United Nations Information System in Science and Technology
17 ISA 37 Terminology

gjermane, do të përmend DIN [18] dhe Institutin Austriak të Normimit në Vjenë me bazën e saj të të dhënave të quajtur ÖNORMEN.[19] Terminologjitë kombëtare përgatisin edhe ASA, BSI, GOSSTANDART, RGW, ASMW dhe TGL, përfshirë normat AFNOR dhe DIN, si dhe rregullativat VDI. Përveç përpilimit të bazave terminologjike, detyrave të institucioneve të këtij lloji janë koordinimi i veprimtarive terminologjike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, mbledhja e publikimeve të terminologjisë, veçanërisht standardet dhe parimet, por edhe fjalorë profesionalë, shpërndarja e informacioneve të publikimeve ekzistuese dhe publikimeve të terminologjisë në përpunimin, informimin për kurset e terminologjisë, këshillimi i institucioneve tjera, veçanërisht në vendet në zhvillim, koordinimi i bazave terminologjike të të dhënave, planifikimi i punës terminologjike, përhapja e dijes mbi parimet dhe metodat terminologjike dhe organizimi i punëtorive, simpoziume dhe seminare për përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e terminologjisë (HOFMAN 1985: 29). Për qëllim të punës normative, SHTOLCE (1999: 106) konsideron optimizimin e komunikimit profesional, përjashtimin e keqkuptimeve, dhe kështu arritjen e një sigurie më të madhe në komunikimin midis profesionistëve.

Termi është element gjuhësor që emërton një lëndë, një procedurë apo një paraqitje të caktuar e cila është specifike për një fushë të caktuar profesionale. Termat rrjedhin nga nevoja për të emërtuar lëndë, procese dhe paraqitje të reja, para së gjithash në fushat shkencore dhe teknike. Që një fjalë të konsiderohet term, duhet të plotësojë disa kushte dhe veçori konceptuale, gjuhësore dhe statistikore. Termi përkufizohet si element, shenjë ose njësi gjuhësore që përmban në vete dy përbërës të ndërlidhur – përmbajtjen dhe rrëfimin (ARNC 1998: 78). Në DIN 2342 termi përkufizohet si „Ein Terminus ist als Element einer Terminologie die Einheit aus einem Begriff und seiner Benennung“,[20] (citat sipas ARNC etj. 2004: 37). FABER/ RODRIGEZ (2012: 11) përkufizojnë termat si njësi gjuhësore që mbartin kuptim

18 Deutsches Institut für Normung
19 www.austrian-standards.at
20 Termi si element i terminologjisë është një unitet i termit dhe emërtimit të tij. (në maq. nga M.A.SH.)

në kuadër të teksteve që përmbajnë njohuri të specializuara. ARNC/PIHT/MAJER (2004: 25) terma konsiderojnë vetëm fjalët profesionale, përmbajtja e të cilave është e përcaktuar me përkufizim, të udhëhequr nga përkufizimi i termit të ISO/DIS 1087 (1989: 40) "termi: designation of a defined concept in a special language by a linguistic expression."[21] HOFMAN (1990: 59) përkufizon termin si:

[...] ein elementares, zusammengesetztes oder komplexes Zeichen, das, wenn es in der konkreten wissenschaftlich-sachbezogenen Kommunikation auftritt, in seinem Signifikat einen Begriff verkörpert, der einem ganz bestimmten Gegenstandsbereich der Wissenschaft, der Technik und der kulturellen, administrativen oder politischen Tätigkeit angehört.[22]

RELKE (2005: 55) e quan: „Ein Fachwort ist die kleinste bedeutungstragende und zugleich frei verwendbare sprachliche Einheit, die innerhalb der Kommunikation eines bestimmten menschlichen Tätigkeitsbereichs gebraucht wird."[23] SHTOLCE (1999: 103) jep këtë përkufizimin për termin: „Der Terminus ist eine lexikalische Einheit, die einen Fachbegriff, d.h. das Abbild einer Klasse fachlicher Objekte im Bewußtsein, benennt, also dessen sprachliche Repräsentationsform."[24]

Termat nuk mund t'i barazojmë me njësitë leksikore të gjuhës së përgjithshme të cilat marrin kuptimin e tyre edhe në kontekstin e fjalisë, sepse ato paraqesin njësi mendimi që në gjuhën profesionale ruajnë kuptimin dhe shpeshherë janë të lidhura me rrethin e tyre. Si ilustrim do të përmend termin *sondë e sheshtë*, për të cilin nuk ka krahasim të mbiemrit të lidhur, pra nuk mund të thuhet *sondë më e sheshtë*. Termat mund të ndryshojnë nga njësitë leksikore të gjuhës së përgjithshme

21 Term: emërtimi i një termi të përcaktuar në gjuhë të veçantë me shprehje gjuhësore. (në maq. nga M.A.SH.)

22 [...] shenjë elementare, shenjë e përbërë ose komplekse që kur shfaqet në një lëndë të caktuar shkencore komunikimi me shenjuesin e tij është një term që i përket një fushe lëndore specifike të shkencës, teknikës dhe veprimtarisë kulturore, administrative ose politike. (në maq. nga M.A.SH.)

23 Fjala profesionale është njësia më e vogël gjuhësore që ka një kuptim dhe në të njëjtën kohë mund të përdoret lirisht dhe që përdoret në kuadër të komunikimit në një fushë të caktuar të veprimtarisë njerëzore. (në maq. nga M.A.SH.)

24 Termi është njësi leksikore që emërton term profesional, d.m.th. përshkrimi i një klase objektesh profesionale në vetëdije nënkupton formën e tyre përfaqësuese gjuhësore. (në maq. nga M.A.SH.)

përsa i përket formimit të formës së shumësit. Emri *kripë* nuk ka formë të shumësit, por termi *kripë* në shumës paraqitet si *kripëra*. Termi karakterizohet nga fakti se lidhet drejtpërdrejt me funksionin emërtues në procesin e kërkimit shkencor dhe teknik, për dallim nga nocioni që ka kuptim shtesë themelor, filozofik dhe ideologjik (CILIG 2005: 1831).

VOJTAK (2004: 371) thotë:

[…] dass für uns ein Terminus im ureigentlichen Sinn eine Zeicheneinheit darstellt, deren Ausdruck aufs engste und unauflösbar mit einem kognitiven Inhalt verknüpft ist, bei dem es sich immer um einen definierten wissenschaftlichen Begriff handelt.˝

Termat karakterizohen gjithashtu nga fakti se nuk kanë kuptim konotativ, përveç disa përjashtimeve, si p.sh. spam, dhe më të dukshmet janë ato terma që nuk ekzistojnë në gjuhën e përgjithshme, si p.sh sondë-lambda, edhe pse me hyrjen e gjuhëve profesionale në jetën e përditshme dhe zhvendosjen e kufirit që ndan gjuhën e përgjithshme nga gjuhët profesionale, njohuritë e specializuara zgjerohen dhe bëhen pjesë e njohurive të përgjithshme, dhe kështu termat humbasin përdorimin e tyre të kufizuar nga profesionistët e fushës së caktuar. Vërehet edhe efekti i kundërt, në të cilin gjuha e përgjithshme hyn në gjuhët profesionale, kur është e nevojshme të gjendet term i ri. Në atë rast, terminologët kërkojnë fjalë tashmë të njohura nga gjuha e zakonshme, të cilat fitojnë kuptim të ri. Shembuj të tillë janë: *dritarja*, *maska*, *platforma*, *miu*, të cilat shërbejnë në përkufizimin e nocioneve nga shkenca kompjuterike. Për shkak se termat përdoren vetëm në fushë të caktuar profesionale, polisemia çon në vështirësi në të kuptuarit tonë të tekstit profesional të folur ose të shkruar. Situata ndërlikohet kur ka polisemi në të njëjtën fushë profesionale, siç është termi *emision*, i cili mund t'i referohet si përmbajtjes ashtu edhe procesit të transmetimit të saj.

Pavarësisht nga përkufizimi, termi mbetet element kyç i hulumtimit terminologjik, dhe sipas SHTOLCE (1999: 35), termi është element qendror i shkencës së terminologjisë që nuk ekziston në mënyrë të pavarur, por është gjithmonë i lidhur sistematikisht me termat e tjerë.

Terminologjia mund të përkufizohet si sistem i nocionit dhe i emërtimit të një fushe profesionale që përfshin të gjitha shprehjet e zakonshme profesionale, praktikisht dhe teorikisht, si dhe merret me strukturimin e fjalëve dhe të fjalorëve, ndërkaq nuk i referohet vetëm termave dhe terminologjive të gjuhëve të specializuara. HOFMAN (1985: 158) konsideron terminologjinë si „Sie ist der ganz spezielle Wortschatz jeder Fachsprache."[25] dhe si „[…] Submenge der Lexik, die weitere Submengen in den einzelnen Fachsprachen hat."[26] (1985: 159). Në DIN 2342 terminologjia definohet: „Gesamtbestand der Begriffe und ihrer Benennungen in einem Fachgebiet."[27] (citat sipas KUNC 2008: 3).

Sipas SHMIT (1998: 4), terminologjia është shtylla e komunikimit profesional dhe shërben për renditjen, ruajtjen dhe transferimin e njohurive profesionale.

SHTOLCE (1999: 105) shpjegon terminologjinë në mënyrën vijuese:

Terminologie ist die Gesamtheit aller Termini als klar umrissenes Subsystem innerhalb des lexikalischen Gesamtsystems einer Sprache; sie integriert sich ihrerseits in (Sub-)Subsysteme: die Terminologien der einzelnen wissenschaftlichen und technischen Fachgebiete.[28]

Terminologjia mund të trajtohet si grup i të gjitha termave, si nënsistem i qartë i kufizuar brenda sistemit të përgjithshëm leksikor të një gjuhe, e cila, nga ana tjetër, është e ndarë në disa nënsisteme. Disa shkencëtarë terminologjinë e përkufizojnë edhe si inventar i termave të fushës së caktuar profesionale (ROXHERS 2005:

25 Përfaqëson fjalor krejtësisht të veçantë për çdo gjuhë profesionale (në maq. nga M.A.SH.)
26 […] nënsistem leksikor që ka edhe nënsisteme të tjera në gjuhët e veçanta profesionale. (në maq. nga M.A.SH.)
27 Vëllimi i përgjithshëm i termave dhe emërtuesit e tyre në një fushë profesionale. (në maq. nga M.A.SH.)
28 Terminologjia është shuma e të gjithë termave si një nënsistem i kufizuar qartë brenda sistemit të plotë leksikor të një gjuhe; ai nga ana e tij mbulon (nën) sistemet: terminologjitë e fushave individuale profesionale shkencore dhe teknike. (në maq. nga M.A.SH.)

1848). Kjo shkencë teorikisht dhe praktikisht merret me strukturimin e fjalëve dhe fjalorëve vetëm në terma dhe terminologji të gjuhëve profesionale me qëllimin kryesor për të përmirësuar efikasitetin e komunikimit profesional në fusha individuale, kryesisht shkencore dhe teknologjike, por kohët e fundit dhe më gjithëpërfshirëse. Duke çuar në lehtësimin e komunikimit profesional në mjedise njëgjuhëshe dhe shumëgjuhëshe, mundëson përmbushjen e një prej parakushteve kryesore për komunikim të suksesshëm: përveç njohurive gramatikore dhe ndërkulturore, njohuri të termave për të kuptuar kuptimin e mesazhit.

Termat si mjet i rëndësishëm shkencor, teknik dhe marrë në përgjithësi në gjithë mendimin profesional, duhet të kenë karakteristika të caktuara si:

a) Lidhje me fushën profesionale

Çdo term duhet të jetë në gjendje t'i referohet një fushe specifike të caktuar në të cilën përdoret.

b) Konkrete

Termi duhet të ketë lidhje sa më të përshtatshme me shprehjet profesionale të lëndëve, dukuri dhe procese në fushën përkatëse të veprimtarisë njerëzore.

c) Kuptueshmëria

Termi duhet të jetë i kuptueshëm lehtësisht për personat profesional që i takojnë një fushe të caktuar.

ç) Konciziteti/arsyeshmëria

Termi duhet të jetë sa më i shkurtër pa e humbur neutralitetin e tij estetik, ekspresiv dhe modal.

d) Mundësia për vendosje hierarkike

Sipas ROXHERS (2005: 1849), termi duhet të jetë në gjendje të vendoset në një pozicion të caktuar në një plan horizontal dhe vertikal duke treguar shkallën e detajeve nëpërmjet një lidhjeje logjike me termat e tjerë. Mund të jetë i mbirenditur

dhe nënrenditur, mund të përfaqësojë një pjesë ose një tërësi. Rrafshi horizontal tregon pozicionimin e termave kurse vertikalja tregon pozicionimin sipas hierarkisë së kuptimit (ARNC etj. 2004: 82). Në rrafshin horizontal vërehen sinonimet dhe polisemia, kurse në rrafshin vertikal lidhur me termat tjerë që kanë përmbajtje më pak ose më shumë.

dh) Ndërlidhja me kontekstin

Në të kaluarën mendohej që termi të ishte autonom, d.m.th. kudo që të vendosej, në çdo tekst, të ketë kuptimin e njëjtë. Sot kjo tezë konsiderohet e refuzuar, ndaj më shumë rëndësi i kushtohet pikërisht të kundërtës – marrëdhënies kontekstuale të termave.

e) Mundësia e përkufizimit

Një nga veçoritë më karakteristike të termave është përkufizimi i tyre. Duke marrë parasysh se nuk bëhet fjalë për fjalë të përgjithshme, çdo term duhet të përkufizohet që të sigurojë kuptimin e tij.

ë) Monosemia

Në shkencën e përgjithshme të terminologjisë, kjo karakteristikë do të qëndronte në vendin e parë sepse Visteri, si babai i shkencës së terminologjisë, ka mohuar fuqishëm shumëkuptimësinë e termave. Sot e dimë se polisemia është e pashmangshme kurse njëkuptimësia arrihet vetëm duke marrë parasysh kontekstin. ARNC (1998: 80) e llogaritë njëkuptimësinë si rast ideal për aspirimin e punës së terminologjisë.

f) Kuptimi i vetëm – mononimia

Kur u hodhën themelet e shkencës së terminologjisë, termat idealë zotëronin pikërisht këtë veçori. Domethënë, një term nënkupton një lëndë, fenomen ose proces dhe ajo lëndë, ai fenomen dhe proces mund të nënkuptohen vetëm nëpërmjet atij termi. Në kohën e tashme kjo është një veçori e dëshiruar, por është

shumë më pak e rëndësishme se në të kaluarën. HOFMAN (1985: 163) përmend vetitë e mëposhtme që të merret në konsideratë një njësi leksikore për termin: „[…] Fachbezogenheit, Begrifflichkeit, Exaktheit, Eindeutigkeit, Eineindeutigkeit, Selbstdeutigkeit, Knappheit, weitgehende und absolute ästhetische, expressive und modale Neutralität.“.[29] SHTOLCE (1999: 103) zgjeron karakteristikat e HOFMAN-it me: [...] Systemhaftigkeit, Kontextunabhängigkeit, Definiertheit u.a.“[30] Që një njësi leksikore të konsiderohet term, duhet të përkufizohet sipas. Për përkufizimet e përmbajtjes ARNC (1998: 81) sqaron:

[...] geht die Inhaltsdefinition von dem bekannten oder bereits definierten Oberbegriff aus und gibt die einschränkenden Merkmale an, die den zu definierenden Begriff spezifizieren und ihn von anderen Begriffen derselben Abstraktionsstufe unterscheiden.[31]

Shtrirja e termit përcaktohet duke theksuar nocionet e varura. ARNC-it (1998: 81) thotë: „Umfangsdefinitionen definieren einen Begriff durch Aufzählung aller seiner Unterbegriffe, die innerhalb des betreffenden Begriffssystems auf derselben Abstraktionsstufe stehen.“[32] Shembull nga përkufizimi ekstenzional i figurave të shahut do të ishte *figura të shahut janë mbreti, mbretëresha, torret, kali, oficeri/fili dhe ushtari*, kurse përkufizimi intensiv për motorin do të ishte: *gjenerator energjetik në mjetin motorik në të cilin energjia kimike nga karburanti shndërrohet në energji mekanike.*

Nevojat e reja për raportim dhe bashkëpunim në nivel global kërkojnë komunikim profesional shumëgjuhësh, i cili realizohet më së shumti nëpërmjet ndërmjetësuesve gjuhësorë. Ndryshe nga kompanitë e mëdha ndërkombëtare aktive, kompanitë e vogla shpesh nuk kanë përkthyes të brendshëm që të mund t'i

29 [...] lidhja profesionale, koncepti, saktësia, njëkuptimësia, biektivitet, rëndësia e vetvetes, konciziteti, neutraliteti estetik i gjerë dhe absolut, shprehës dhe modal. (në maq. nga M.A.SH)

30 [...] sistematik, pavarësi kontekstuale, përkufizim etj. (në maq. nga M.A.SH)

31 [...] përkufizimi i përmbajtjes fillon nga një term i njohur ose i përcaktuar tashmë dhe tregon veçoritë kufizuese që specifikojnë termin që do të përkufizohet dhe që e dallojnë atë nga termat e tjerë të së njëjtës shkallë abstraksioni. (në maq. nga M.A.SH.)

32 Përkufizimet e fushëveprimit përcaktojnë një term duke numëruar të gjithë termat e tij vartës që janë në të njëjtën shkallë abstraksioni brenda sistemit të termave të prekur. (në maq. nga M.A.SH)

trajnojnë ata në terminologji në fushën e tyre të punës. Prandaj, sektori privat, ai publik dhe organet administrative, interpretimin e saktë terminologjik ia besojnë interpretuesit të angazhuar nga jashtë. Duke marrë parasysh se interpretuesi i jashtëm nuk është e mundur të jetë i futur në detajet e procesit të punës dhe në fushën profesionale të klientit, ai është i detyruar paraprakisht të përgatitet për pjesën e terminologjisë për të cilën është angazhuar. Duke reflektuar zgjidhjet terminologjike, SANDRINI (2005: 36) thotë: „Terminologiearbeit und eine entsprechende terminologische Vorbereitung spielten beim Dolmetschen immer eine prominente Rolle [...]“[33]. Për fat të mirë, bazat e të dhënave të terminologjisë së huaj mund të përdoren si një burim i mirë termash, të cilat shpesh janë produkt i një kërkimi shumëvjeçar dhe për fat të mirë janë të disponueshme jo vetëm për një rreth të vogël kolegësh që merren me terminologji dhe që i kanë përpiluar ato, por edhe për persona të tjerë si p.sh. përkthyes, interpretues, redaktorë teknikë ose ekspertë ndërkombëtarë aktivë. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për fat të keq, nuk ka baza të mjaftueshme të të dhënave terminologjike me terma të përkufizuar dhe të verifikuar profesionalisht, kështu që interpretuesit shpesh detyrohen të konsultohen me ekspertë nga mjedisi i tyre ose të përdorin listë të fjalëve dhe fjalorë të përbërë nga oda dhe shoqata ekspertësh në fushë të caktuar. Në çdo rast, duhet marrë parasysh se lista e fjalëve, fjalorët dhe mendimi i ekspertëve mund të devijojnë nga termat e vendosur. Personalisht, rekomandoj leximin e temave të doktoraturës dhe të masterit për një temë të caktuar të hartuar në gjuhën burimore dhe të synuar si një mundësi për depërtim më të thellë në temën specifike profesionale.

Interpretuesi, i cili ndikohet nga disa faktorë, është i detyruar të zgjedhë terminologjinë, përkatësisht: grupin e synuar (pranuesit e interpretimit), kohën

33 Puna terminologjike dhe përgatitja e duhur terminologjike kanë luajtur gjithmonë një rol të rëndësishëm në interpretim [...] (në maq. nga M.A.SH)

në dispozicion të interpretuesit për të gjetur ekuivalencë të përshtatshme për përkthimi për termin në gjuhën origjinale dhe gatishmëria profesionale e interpretuesit për temën e caktuar.

a) Grupi i synuar

Porositësi i përkthimit nuk pret nga interpretuesi vetëm zbatim të përkryer të mjeteve gjuhësore, por edhe transmetim të përshtatshëm të synimit dhe të stilit të folësit, e që përfshinë veçoritë stilistikore dhe **terminologjike**. Në përmbushjen e këtyre kërkesave, interpretuesi është i detyruar të përshtatë deklaratën e tij gjuhësore me nivelin e njohurive profesionale të pranuesve dhe pavarësisht nga niveli i njohurive të tij profesionale, në rastet kur pranuesit janë persona që nuk janë ekspertë në një fushë e caktuar, është e këshillueshme të përdoren më shumë fjalë vendase sesa të huaja, të paktën në rastet kur ka mundësi zgjedhjeje. Për shembull, nëse interpretuesi interpreton në mënyrë konsekutive në seminar mbi pasojat e depresionit me përbërje të përzier të pranuesve në raport me ekspertizën e tyre, për shembull psikologë, mjekë, përfaqësues të OJQ-ve që ofrojnë "linja telefonike" për njerëzit në depresion, qytetarët e interesuar dhe përfaqësuesit e sindikatave në Maqedoni, është e parapëlqyeshme që interpretuesi të përdor term vendas (p.sh. vetëvrasje) në vend të një termi të huaj (p.sh. suicid) që të jetë i kuptueshëm për të gjithë pranuesit.

b) Koha

Sa i përket kohës që e ka interpretuesi në dispozicion për të gjetur term të përshtatshëm në gjuhën e synuar, duhet patjetër të bëhet dallim midis interpretimit konsekutiv dhe atij simultan. Interpretuesit konsekutivë janë më të përfshirë në komunikim dhe punojnë në kontekst më të gjerë, kurse termat mund të qartësohen edhe gjatë prezantimit të tekstit burimor, nëpërmjet të cili interpretuesi konsekutiv mund të marrë një pasqyrë më të qartë fillimisht për termin e panjohur dhe të dalë

me një ekuivalencë të duhur të përkthimit. Për më tepër, interpretuesi konsekutiv ka mundësi të shënoj gjatë marrjes së tekstit burimor dhe të kalojë më shumë kohë duke kërkuar në "bibliotekën e tij konjunktive" për gjetjen e termit të përshtatshëm në gjuhën e synuar. Interpretuesi simultan nuk i ka këto mundësi dhe mbështetet vetëm në kujtesën e tij afatshkurtër, kapaciteti i së cilës është i kufizuar. Për më tepër, koha e prodhimit të përkthimit është e kufizuar nga shpejtësia e përcaktuar nga folësi, mbi të cilën interpretuesi simultan nuk ka ndikim. Për shkak të lidhjes së tre opsioneve të interpretimit simultan (dëgjim, përpunim dhe produkti i përkthyer), përpunimi i një segmenti ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e përpunimit të segmenteve të tjera kurse mbingarkesa mund të çojë në gabime dhe lëshime nga teksti burimor.

Interpretuesi simultan ka vetëm disa sekonda që ta përpunojë segmentin, për atë shkak ai nuk ka kohë formulojë terma duke zbatuar parimet e fjalëformimit. Në segmentin dalës të gjuhës së synuar, interpretuesi do ta përdorë termin e parë që do ta përcaktojë në mënyrë konjunktive pothuajse njëkohësisht me analizën e segmentit hyrës.

Interpretuesi, gjatë zgjedhjes së termave, ballafaqohet me sfida të cilave duhet t'i kushtojë rëndësi, që mos të gabojë gjatë interpretimit. Përgatitja profesionale e interpretuesit parasheh edhe udhëheqjen e dysheve dhe asociacioneve të rrejshme në kombinimin e tyre gjuhësor.

a) Dyshja e rrejshme

Dyshe të rrejshme konsiderohen termat që kanë formë të njëjtë dhe shqiptim në dy gjuhë, por kuptim ndryshe ose pjesërisht të njëjtë. Kombinime të tilla gjuhësore nga gjuha gjermano-maqedonase janë *гелибтер* dhe *Geliebter, хохштаплер* dhe *Hochstapler, цитрон* dhe *Zitrone, цимер* dhe *Zimmer, либе* dhe *Liebe, конкурс* dhe *Konkurs.*

b) Asociacionet

Asociacionet paraqesin fjalë që i drejtohen fjalës tjetër. Gjatë shfrytëzimit të asociacioneve gjatë interpretimit, është e dëshirueshme të mundohemi të zbatojmë asociacione më të njohura, kurse jo ato terma shumë profesionale. Si për shembull, *mjet motorik më shumë ndërlidhet me automjet se sa me kamion*, edhe pse të dyja mjetet i referohet mjeteve motorike. Zgjedhja nuk mund të jetë asnjëherë e përkryer duke paramenduar se secili pranues ka asociacione të ndryshme. Termi *automjet* për dikë asocon në markë veturash, kurse dikush tjetër e ndërlidh me *ngasës, karburant, pjesë të automjeteve* ose *regjistrim.*

Kemi parë se terminologjia ka një rëndësi të madhe për të gjithë përkthyesit, por përdorimi i duhur i saj kërkon përgatitje të gjerë sidomos për interpretuesit. Do të ishte ideale që përkthyesit të specializohen në fusha të caktuara profesionale, të arsimohen në fushën përkatëse, përveç përkthyesve, të jenë ekspertë në një fushë të caktuar. Megjithatë, duhet të kuptojmë se për gjuhët më pak të njohura si maqedonishtja, specializimi do ta kufizonte shumë përkthyesin për sa i përket fushës së punës së tij, duke vënë në pikëpyetje ekzistencën e tij financiare.

Bibliografia

ARNTZ, Reiner (1998): „Terminologie der Terminologie“, in: Snell-Hornby, Mary/Kußmaul, Paul/Peter A. Schmitt (Hrsg.): *Handbuch Translation*. Tübingen: Stauffenburg, S. 77 – 82.

ANTZ, Reiner/PICHT, Heribert/ MAYER, Felix (2004): *Einführung in die Terminologiearbeit.* Hildesheim: Georg Ohms.

FABER, Pamela/Rodriques, Clara Ines Lopez (2012): „Terminology and Specialized Language“, in: Faber, Pamela (Ed.): A Cognitive Linguistics View of Terminology and Specialized Language. Berlin/Boston: Walter de Gruyter, p. 9 – 32.

FELBER, Helmut/Budin, Gerhard (1989): *Terminologie in Theorie und Praxis*. Tübingen: Gunter Narr.

HOFFMANN, Lothar (1985): *Kommunikationsmittel Fachsprache.* Tübingen: Gunter Narr Verlag.

HOFFMANN, Lothar (1990): *Empfehlung, Standard, Norm*, Leipzig: Verlag Enzyklopädie.

KUNZ, Martin (2008): *Normen zur Terminologie der Erschließungsarbeit und einige Definitionen*, Berlin: Deutsche Nationalbibliothek.

ROELCKE, Thorsten (2005): *Fachsprachen.* Berlin: Schmidt.

SCHMITT, Peter A. (1998): „Berufsbild", in: Snell-Hornby, Mary/Kußmaul, Paul/Peter A. Schmitt (Hrsg.): *Handbuch Translation*. Tübingen: Stauffenburg, S. 1 – 5.

Olger Brame

Çështje të shqipërimit të terminologjisë në shënimet gjuhësore të Aleksandër Xhuvanit

Abstrakt

Aleksandër Xhuvani mbetet një nga personalitetet e shquara të gjuhësisë shqiptare, me ndihmesa të çmuara në shkrimin, përpunimin dhe kodifikimin e gjuhës shqipe. Ai pasuroi gjuhën letrare kombëtare me fjalë e ndërtime të reja dhe përpunoi terminologjinë gjuhësore gramatikore. Xhuvani ndihmoi së tepërmi në veprimtarinë që nisi të shtjellohet në vendin tonë pas çlirimit në fushën e terminologjisë, si dhe drejtoi punën e bërë për terminologjinë shkollore. Një nga aspektet e rëndësishme të punës së tij lidhet me çështjet e shqipërimit të terminologjisë, kryesisht në fushën e leksikut të gjuhës letrare shqipe. Në punimin tonë do të sjellim në vëmendje këtë ndihmesë të profesor Xhuvanit, të evidentuar në shënimet dhe vërejtjet e tij gjuhësore në fushën e leksikografisë dhe leksikologjisë, si dhe shqyrtimin e disa çështjeve të rëndësishme gjuhësore që lidhen me terminologjinë si: shqipërimi, kuptimet e fjalëve në fjalor, zëvendësimi i fjalëve të huaja, neologjizmat etj., me qëllim pastrimin e leksikut nga termat e huaj dhe mundësinë e shqipërimit të tyre. Të gjitha këto vërejtje shkencore, i gjejmë në vëllimin II të veprës gjuhësore të këtij gjuhëtari, e cila ka shërbyer si burim hulumtimi për studimin në fjalë.

Fjalë çelës: *Aleksandër Xhuvani, terminologji, shqipërim, term i huaj, ndihmesë*

Hyrje

Gjuha shqipe mund të konsiderohet si një prej gjuhëve, të cilat terminologjinë gjuhësore e ka nga vetë brumi i saj. E gjitha kjo mund t'i atribuohet punës së palodhshme e përpjekjeve të hershme të rilindësve dhe pasuesve që nga Sami Frashëri e Konstandin Kristoforidhi, e deri te Aleksandër Xhuvani, e të tjerë pas tij. Në periudhën 1912-1944, duke u nisur sidomos nga nevojat e shkollës, për terminologjinë punuan studiues të gjuhës, specialistë e gjuhëtarë, ndër të cilët shquhen Aleksandër Xhuvani e Mati Logoreci.

Aleksandër Xhuvani është një nga figurat më të rëndësishme të arsimit, të gjuhësisë dhe të kulturës shqiptare. Ka qenë arsimtar, tekstolog, gjuhëtar, nëpunës dhe ministër i shtetit shqiptar. Ai gjithashtu mbështeti standardizimin e gjuhës shqipe në vitet pas pavarësisë së Shqipërisë. Është cilësuar si gjuhëtari shqiptar me merita të larta dhe njohësi më i mirë i visarit leksikor të shqipes. Me veprimtarinë e tij, Xhuvani, jo vetëm hapi rrugë të reja në studimet gjuhësore në të gjitha fushat e gjuhësisë e pedagogjisë, por mbetet personaliteti që la gjurmë në këto fusha, gjurmë të cilat merren si referencë nga studiuesit e mëvonshëm. Me ndihmesat në fushën e studimit dhe lëvrimit të shkencës së gjuhësisë, ai konsiderohet si pasues i Kristoforidhit. Profesor Xhuvani e përcakton gjuhën si *shenjën e gjallë të çdo populli dhe instrumentin më të çmuar për kulturën e tij*[1].

Ai e pasuroi gjuhën letrare kombëtare me fjalë e ndërtime të reja dhe përpunoi terminologjinë gjuhësore gramatikore, duke ndihmuar së tepërmi në veprimtarinë që nisi të shtjellohet në vendin tonë pas çlirimit në fushën e terminologjisë, si dhe drejtoi punën e bërë për terminologjinë shkollore. Tekstet e Xhuvanit kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në terminologjinë e gramatikës, sintaksës, të letërsisë, të pedagogjisë, të didaktikës e psikologjisë, duke bërë që termat e rinj të krijuar prej

1 Aleksandër Xhuvani (1980). *Pastërtia e gjuhës sonë në shtyp dhe në letërsi*. Në: "Vepra 1", Tiranë: fq. 110.

tij dhe vetë gjuha të ngrihej në një shkallë më të lartë shkencore[2].

Lidhur me ndihmesën e profesor Xhuvanit, Çabej do të theksonte faktin se interesat e një personaliteti si ai kanë qenë të shumanshme dhe veprimtaria e tij në këto fusha ka qenë e shumëfishtë duke përfshirë një mori degësh të dijesh, çka e bën atë dijetarin me të cilin nis periudha e mirëfilltë shkencore e gjuhësisë dhe e filologjisë shqiptare[3].

Mahir Domi, duke theksuar punën e vijueshme për pastërtinë e gjuhës, e rendit Xhuvanin krahas rilindësve për përpjekjet e bëra në këtë drejtim prej tij, por me një horizont më të gjerë, me vështrim të drejtë e me maturi më të madhe, duke e konsideruar ndoshta të vetmin, si asnjë gjuhëtar shqiptar, që bëri një punë kaq këmbëngulëse e të frytshme në drejtim të pastërtisë së gjuhës[4].

Lidhur me këtë argument, Shaban Demiraj thekson faktin tjetër se për çështjen e pastërtisë së gjuhës, Xhuvani ka mbajtur gjithmonë qëndrim të drejtë, duke mos qenë për një purizëm të tepruar, por për zëvendësimin e atyre fjalëve të huaja që mund të zëvendësoheshin me fjalë të shqipes popullore ose me fjalë të reja të krijuara sipas gjedheve fjalëformuese të shqipes dhe krahas kësaj duhet të bëhej një punë e madhe për pasurimin e shqipes me fjalë të reja, sidomos terma diturakë e shkencorë[5].

Puna e Aleksandër Xhuvanit në fushën e terminologjisë u mbështet mbi traditën e krijuar nga Kristoforidhi e Sami Frashëri. Siç thekson Lirak Dodbiba, ishte veprimtaria pedagogjike e profesor Xhuvanit në Shkollën Normale të Elbasanit, si mësimdhënës, hartues e redaktues tekstesh, si dhe anëtar në grupe e komisione pune, që ndikoi në një kontribut të veçantë në terminologjinë gramatikore dhe

2 Lirak Dodbiba (1980). Kontributi i Aleksandër Xhuvanit në terminologjinë shqipe. Në: "*Studime Filologjike*" 1980/1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f.111-115.

3 Eqrem Çabej (1980). Aleksandër Xhuvani dhe gjuhësia historike shqiptare. Në: "*Studime Filologjike*" 1980/1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f. 57-62.

4 Mahir Domi (1980). Aleksandër Xhuvani lëvrues dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe. Në: "*Studime Filologjike*" 1980/1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f. 29-41.

5 Shban Demiraj (1980). Aleksandër Xhuvani si vazhdues i veprës së K. Kristoforidhit. Në: "*Studime Filolo-gjike*" 1980/1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f. 63-67.

shkencat pedagogjike, duke u bërë i pari që përpunoi terminologjinë tërësore të shkencave pedagogjike të sferës shkollore[6].

Ndihmesa e profesor Xhuvanit në çështjet e terminologjisë

Terminologu Agron Duro thekson se procesi i shqipërimit në terminologji lidhet me një varg veçorish edhe në gjuhën e përgjithshme dhe karakteri i procesit të shqipërimit dhe reflekset e tij në terminologji varen e kushtëzohen nga këto veçori. Si të tilla ai përmend daljen e ngadaltë të termit të huaj nga gjuha, bashkëjetesën term-fjalë shqipe, përdorimin e njëkohshëm element i vjetër- element i ri etj.[7] Nga ana tjetër, Ferdinand Leka nënvizon faktin se terminologjia, si mjet i shprehjes dhe pasqyrimit të nocioneve shkencore dhe teknike, formohet në lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin e shkencës e të teknikës, me zhvillimin e kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit. Lidhjet e ngushta të sistemeve terminologjike me gjuhën letrare dalin në pah edhe nga mjetet gjuhësore që shfrytëzohen për krijimin e termave, por fakti që shqipja vazhdon të ketë marrëdhënie me gjuhë të tjera ndikon edhe në terminologji, kryesisht në shqipërimin e saj. Për këtë arsye prirja shkon drejt mënjanimit të çdo huazimi të panevojshëm dhe shfrytëzimin e mjeteve të brendshme të shqipes për krijimin e termave të rinj[8]. Ndërsa Aristotel Spiro thekson se përdorimi i huazimeve terminologjike e vendos problemin e terminologjisë gjuhësore si një marrëdhënie midis traditës së ngulitur kombëtare dhe teorive të reja gjuhësore, marrëdhënie e cila shfaqet e dyfishtë si një mësymje e gjuhës së huaj në sistemin e gjuhës pritëse, në rastin tonë të shqipes dhe si mësymje kulturore e një teorie të re, koncepteve të reja[9].

6 Lirak Dodbiba (1965). *Zhvillimi i terminologjisë shqipe nga Rilindja deri sot*. Në: "Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike". Tiranë: f. 183-191.

7 Për më tepër shih: Agron Duro (1995). Probleme të shqipërimit të terminologjisë në kohën tonë. Në: "*Studime filologjike" 1995/1-4*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f.83-85

8 Ferdinand Leka (1989). *Terminologjia tekniko-shkencore dhe gjuha e sotme letrare*. Në: Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f. 645-654.

9 Aristotel Spiro (2014). *Terminologjia gjuhësore: nga traditat kombëtare te komunikimi i njësuar ndërkombë-tar*. Në: Terminologjia në shkencat e ligjërimit, Elbasan, f. 221-229.

Një nga aspektet e rëndësishme të punës së Xhuvanit lidhet me pikërisht me çështjet e shqipërimit të terminologjisë, kryesisht në fushën e leksikut të gjuhës letrare shqipe.

Ne do të sjellim në vëmendje këtë ndihmesë të profesor Xhuvanit, të evidentuar në shënimet dhe vërejtjet e tij gjuhësore në fushën e leksikografisë dhe leksikologjisë, si dhe shqyrtimin e disa çështjeve të rëndësishme gjuhësore që lidhen me terminologjinë si: shqipërimi, kuptimet e fjalëve në fjalor, zëvendësimi i fjalëve të huaja, neologjizmat etj., me qëllim pastrimin e leksikut nga termat e huaj dhe mundësinë e shqipërimit të tyre. Të gjitha këto vërejtje shkencore, i gjejmë në vëllimin II[10] të veprës gjuhësore të këtij gjuhëtari, e cila ka shërbyer si burim hulumtimi për punimin në fjalë.

Në vërejtjet gjuhësore mbi Fjalorin e Shoqërisë "Bashkimi", së pari, Xhuvani vë në dukje faktin se ka një pjesë të madhe fjalësh, të cilat nuk mund të përdoren prej çdo njeriu për shkak se autorët e fjalorit janë kufizuar vetëm në përkthimin e këtyre fjalëve me fjalët italishte që i përkasin, pa i përcjellë këto me shembuj ashtu siç përdoren në gjuhë, në mënyrë që dikush që nuk i di këto fjalë në dialektin e vet apo nuk i ka dëgjuar prej ndokujt nuk i ka hasur nëpër libra, nuk mund t'i hyjnë në punë për t'i përdorur për nevojat e tij. Këtë konstatim Xhuvani e jep duke sjellë në vëmendje shumë shembuj me fjalë nga fjalori, duke i ballafaquar në të dy dialektet, duke nxjerrë edhe njëherë në pah rëndësinë e shqipërimit të tyre shoqëruar edhe me shembuj. Sipas tij, shembujt duhet të jenë të përshtatshëm e të qartë dhe mundësisht të merren prej prozës dhe poezisë popullore. Po në këtë linjë ai evidenton rëndësinë që ka zëvendësimi i fjalëve të huaja që janë përdorur në fjalor me gjegjësen në gjuhën shqipe. Lidhur me këtë ai shprehet se: *...fjalori ka një mungesë, sepse shumë fjalë që janë marrë si të shqipes në vend që të përcaktohen si fjalë të huaja. Këto fjalë do të ishte mirë të futeshin në fjalor, por të radhiteshin në një*

10 Aleksandër Xhuvani (1990). Vepra II. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

shtojcë të veçantë, duke u përqendruar në të mësuarit e njerëzve të fjalëve thjesht shqipe... Për ta argumentuar këtë ai sjell shembuj nga greqishtja, gjuha e arbëreshëve të Kalabrisë, nga turqishtja e arabishtja etj.[11].

Ndërkohë, në vërejtjet e tij lidhur me hartimin e një fjalori të shqipes, ai nënvizon disa elemente të domosdoshme që duhet të mbahen parasysh në hartimin e tij. Ndër këto vërejtje ai thekson përmbledhjen e të gjitha fjalëve të gjuhës shqipe të cilat janë të gjalla në gojën e popullit e që janë pronë e vërtetë e trashëguar e popullit. Fjalët e huaja të cilat nuk janë bërë ende pronë e shqipes, nuk i sheh të arsyeshme të përfshihen në fjalor, ashtu si edhe fjalët e huaja, të cilat mund të zëvendësohen me fjalë të tjera të shqipes. Lidhur me këtë ai nënvizon: *...A është qëllimi të bëjmë një fjalor të gjuhës shqipe? Atëherë ç'punë kanë aty brenda fjalët e huaja "abdikoj" e "absolutisht" të cilat nuk kanë hyrë ende në gjuhën e shkrimit? Jam i mendimit që në një fjalor shqip hyjnë vetëm ato fjalë të huaja, të cilat janë bërë të njohura në botën zyrtare e arsimore të Shqipërisë. E tillë mund të jetë fjala "administratë" e disa formime të saj me të cilat janë mësuar një pjesë e madhe e intelektualëve...*[12].

Edhe për fjalorët dygjuhësh, gjuhë e huaj-shqip, vërejtjet e tij gjuhësore flasin për një formim leksikologu e leksikografi, i cili di të trajtojë me profesionalizëm parimet e punës. Duke qëmtuar me kujdes punën e bërë në fjalorin e Cordignano-s, ai evidenton së pari ndryshimet apo gabimet e bëra lidhur me kuptimet e formave të fjalëve që ka bërë autori i fjalorit. Të gjitha këto ai i ilustron duke marrë shembuj konkretë të cilët i analizon me imtësi. Ai vëren se shumica e fjalëve janë marrë ashtu siç janë gjetur, pa specifikuar kuptimin e secilës me shembuj përkatës apo duke u dhënë kuptimin e gabuar nga italishtja në shqipe. Edhe shembujt ilustrues nuk duhet të jenë të trilluar, por të marrë nga goja e popullit. Për të gjithë argumentet që jep lidhur me këtë vërejtje ai jep ilustrimin konkret të kuptimit me fjalën e

11 Aleksandër Xhuvani (1990). *Vepra II*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f.22-25.
12 Po aty, f. 26-27.

duhur shqipe dhe shembullin përkatës të përdorimit në fjali. Rëndësia që ai i jep ilustrimit me shembuj në fjalor për të nxjerrë kuptimin e fjalës, evidentohet edhe në përcaktimin e tij kur thotë se: ... *një fjalor pa shembuj është një skelet i padobishëm dhe sidomos për gjuhën tonë, kur nuk ka dalë ende në shesh gjithë lënda e saj dhe shkrimtarët tanë të rinj nuk kujdesen të mbledhin materialin e gjuhës, por përkthejnë frazat e fjalët nga gjuhët e huaja dhe nuk qëmtojnë thesarin e gjuhës së tyre.. Për ato fjalë që autori i jep me shembuj, ai u ka shquar më mirë kuptimin e tyre*...[13]. Dodbiba thekson se pjesa më e madhe e termave te vetë Xhuvani janë neologjizma që i formon duke u nisur nga fjalët e gjuhës së folur popullore me ndërrimin e kuptimit të fjalëve duke u dhënë kuptim të ri teknik, me anë të prejardhjes, si dhe kompozimit[14]. Megjithatë ai vëren se si neologjizmat ashtu edhe shembujt e dhënë nga autori për t'i shpjeguar këto fjalë, i duken arbitrare, sepse ose ato përdoren vetëm nga një rreth shumë i ngushtë, ose prishim kuptimin e fjalës a frazës. Neologjizmat mund të përfshihen brenda një fjalori pasi të kenë fituar miratimin e përgjithshëm e të jenë bërë, sipas tij me "nënshtetësi" shqiptare e pasi janë futur në përdorim në gjuhë, mund të përdoren si terma të nevojshëm pasi të kalojnë nëpër një krehër të rreptë dhe të vëzhgohen mirë, nëse janë krijuar sipas rregullave të gjuhës[15].

Edhe në vështrimin kritik që i bën Fjalorit të Angelo Leotti-t ai sjell përsëri në vëmendje fjalët e huaja të shënuara si shqipe, për të shpjeguar fjalët nga italishtja, madje duke e quajtur edhe si të metë të madhe për faktin se këto fjalë nuk janë shënuar as me asteriks: ...*kjo më duket një e metë e madhe më fort në këtë vepër të Leottit ku janë përdorur fjalë të huaja pa masë, por edhe pa vend e pa dobi. Fjalori ka mjaft fjalë të huaja që sot ua kanë zënë vendin fjalëve të shqipes. Në raste të tilla nuk është puna se të huajt do t'i marrin si fjalë shqipe, por thelbi është se ato nuk kanë të bëjnë as me natyrën, as*

13 Aleksandër Xhuvani (1990). *Vepra II*. vep. e cit. fq. 43-44.
14 Lirak Dodbiba (1965). *Zhvillimi i terminologjisë shqipe nga Rilindja deri sot*. Në: "Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike". Tiranë: f. 183-191.
15 Aleksandër Xhuvani (1990). *Vepra II*. vep. e cit. fq.54.

me strukturën e shqipes, pra nuk janë shqip[16].

Përsa u takon shqipërimeve, ai analizon me shumë kujdes problematikat dhe delikatesën që duhet të mbajë parasysh një autor që realizon shqipërimin. Ai thekson se përkthimi duhet të realizohet vetëm duke u përshtatur me fjalë, forma e shembuj me gjuhën në të cilën përkthehet, pra duke e përshtatur lëndën. Kështu duhet të ndodhë edhe në shqipe, gjë që nuk është punë e lehtë. Kjo i jep vlerë një vepre, sipas tij, e nuk ja humbet vlerën sado e vjetër të jetë vepra, sepse ruhet origjinaliteti i saj në çdo gjuhë. E për të shqipëruar a përshtatur një përkthim, sipas Xhuvanit, duhet të gjesh fjalë e forma fjalësh që t'i përngjajnë origjinalit, por nga ana tjetër këto fjalë e forma fjalësh nuk duhet të shpiken, por të qëmtohen nga goja e popullit. Vetëm në këtë mënyrë nuk humbet origjinaliteti i veprës dhe të kuptuarit e saj nga lexuesi në gjuhën ku përshtatet.

Nëse lexon vërejtjet gjuhësore të Xhuvanit, del në pah një analizë e argumentuar kritike në drejtim të çështjeve gjuhësore, e sidomos përdorimit të shqipes së pastër nga elementi i huaj në fjalor, leksik e gramatikë. Xhuvani nuk shquhet për pikëpamje të skajshme puriste. Përkundrazi, ai nuk del as kundër fjalëve të huaja terma, duke nënvizuar se termat ndërkombëtarë që vijnë nga gjuhë të mëdha nuk duhet të zëvendësohen me fjalë të shqipes, por duhet t'i përdorim ashtu siç i përdorin edhe gjuhët e tjera. Ai thekson faktin se si në çdo gjuhë të botës, edhe në gjuhën shqipe leksiku nuk sajohet vetëm me pjesën themelore të trashëguar, por edhe me formime të reja të vetë gjuhës, ashtu sikurse edhe me fjalë të huaja të cilat bëhen pjesë e leksikut të gjuhës. Dukuria e huazimeve nuk është diçka që ka ndodhur vetëm në gjuhën shqipe, kjo është diçka e natyrshme. E rëndësishme sipas tij është që të kuptohet se ato elemente të huaja që janë bërë prej shekujsh pronë e pandarë e shqipes, është e vështirë, në mos e pamundur që t'i zëvendësosh me fjalë nga brumi i shqipes, e nëse bëhen përpjekje që të hiqet kjo pjesë e huazimeve

16 Po aty, f. 66.

që janë bërë pronë e gjuhës shqipe, sipas tij mund të quhet edhe shovinizëm. ...*ka shumë fjalë të huaja, më së shumti terma teknike që përdoren të njëjta pothuajse në të gjitha gjuhët, duke u bërë ndërkombëtare e ka prej tyre që nuk i krijojmë dot nga brumi i gjuhës sonë. Këto do t'i marrim nga gjuhët e huaja, por duke u dhënë trajtën sipas frymës e natyrës së gjuhës sonë*[17]. Siç thekson edhe Jani Thomai, ai nuk ishte purist i tepruar, madje ishte kundër një purizmi që do të varfëronte gjuhën, duke mos i përjashtuar mundësitë e një huazimi leksikor kur shqipja nuk e ka mundësinë dhe mjetet...[18] Më e vështirë qëndron puna në shqipërimin e terminologjisë në fushën e gramatikës. Duke ju referuar vetëm shkencës së gjuhësisë, fakti që edhe në gjendjen e sotme të gjuhës kemi në përdorim termat e Xhuvanit si: *zanore* e *bashkëtingëllore, i përngjitur, ndajfolje, parafjalë, pasthirrmë, gjini* e *lakim*, *numëror themelor* e *numëror rreshtor*, *shkallë pohore , krahasore* e *sipërore*; pjesën më të madhe të termave të sintaksës si: *fjali, fjali e thjeshtë, fjali e zgjeruar, fjali mungesore, gjymtyrë fjalie, kryefjalë, kallëzues, kundrinë, plotës , ndajshtim* etj., mund të konstatosh se sa largpamëse, e kujdesshme dhe profesionale ka qenë puna e tij në drejtim të terminologjisë në përgjithësi e asaj gjuhësore në veçanti, aq sa termat e krijuara prej tij kanë zënë vend në terminologjinë gjuhësore shqipe.

Përfundime

Siç është shprehur dhe Lirak Dodbiba, nismëtar i vetëdijshëm i terminologjisë sonë gjuhësore është Kristoforidhi dhe themelues i vërtetë i terminologjisë është Sami Frashëri, i cili me shkronjëtoren e vet na jep një terminologji pak a shumë të plotë, megjithëse fillestare. Vepra e tij u vazhdua nga një plejadë mësuesish si: Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Sotir Peci, Anton Xanoni, Justin Rrota,

17 Aleksandër Xhuvani (1956). *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Shkencave, Instituti i Historisë e Gjuhësisë f. 56.

18 Jani Thomai (1980). Aleksandër Xhuvani si leksikolog e leksikograf. Në: "*Studime Filologjike*" 1980/1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, f. 75-81.

Sevasti Qiriazi Dako, Gaspër Mikeli, Osman Myderrizi, Kostaq Cipo, Mahir Domi, por mes kësaj plejade shquhet puna e veteranit të mësuesve të shqipes, puna e Aleksandër Xhuvanit, i cili plotëson dhe njëson termat e morfologjisë dhe vë themelet e terminologjisë së sintaksës së sotme[19].

Duke mbajtur parasysh se sot gjuha shqipe konsiderohet si një gjuhë e hapur ndaj zhvillimeve në fusha të ndryshme, leksiku terminologjik, si pjesë e rëndësishme e leksikut aktiv të gjuhës, është ndoshta edhe pjesa më e synuar e këtij zhvillimi, duke mundësuar prurje të reja fjalësh e termash, ashtu si dhe huazime të ndryshme të cilat lidhen me këto zhvillime, të cilave gjuha shqipe duhet t'u përballëvihet sa më shumë dhe aty ku është e mundur me mjetet e saj, me format, mundësitë dhe rrugët e saj për të bërë të mundur një sistem të pastër e të pasur terminologjik. Shfrytëzimi pasurisë së shqipes, i mjeteve dhe mënyrave të saj, zëvendësimi i termave të huazuar atje ku nuk janë të nevojshme me terma të shqipes etj., krahas përdorimit të ndërkombëtarizmave, duhet të mbetet detyrë parësore në terminologji, duke realizuar atë që thekson edhe vetë Xhuvani se fjalët a termat ndërkombëtare që nuk i krijojmë dot nga brumi i gjuhës sonë do t'i marrim nga gjuhët e huaja, por duke u dhënë trajtën sipas frymës e natyrës së gjuhës sonë.

Bibliografia

Agron Duro (1995). Probleme të shqipërimit të terminologjisë në kohën tonë. Në: *"Studime filologjike" 1995/1-4*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Aleksandër Xhuvani (1956). *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Shkencave, Instituti i Historisë e Gjuhësisë.

19 Lirak Dodbiba (1965). *Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore shqipe nga Rilindja deri sot*. Në: Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, f.183-191.

Aleksandër Xhuvani (1980). *Pastërtia e gjuhës sonë në shtyp dhe në letërsi*. Në: "Vepra 1", Tiranë.

Aleksandër Xhuvani (1990). Vepra II. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Aristotel Spiro (2014). *Terminologjia gjuhësore: nga traditat kombëtare te komunikimi i njësuar ndërkombëtar*. Në: Terminologjia në shkencat e ligjërimit, Elbasan.

Eqrem Çabej (1980). Aleksandër Xhuvani dhe gjuhësia historike shqiptare. Në: "*Studime Filologjike*" 1980/1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Ferdinand Leka (1989). *Terminologjia tekniko-shkencore dhe gjuha e sotme letrare*. Në: Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Jani Thomai (1980). Aleksandër Xhuvani si leksikolog e leksikograf. Në: "*Studime Filologjike*" 1980/1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Lirak Dodbiba (1965). *Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore shqipe nga Rilindja deri sot*. Në: Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë.

Lirak Dodbiba (1980). Kontributi i Aleksandër Xhuvanit në terminologjinë shqipe. Në: "*Studime Filologjike*" 1980/1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Mahir Domi (1980). Aleksandër Xhuvani lëvrues dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe. Në: "*Studime Filologjike*" 1980/1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë-Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Shaban Demiraj (1980). Aleksandër Xhuvani si vazhdues i veprës së K. Kristoforidhit. Në: "*Studime Filologjike*" 1980/1. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë- Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

Teuta Sula

Terminologjia në klasifikimin lëndor të bibliotekës

Bibliotekat janë institucione të kulturës dhe dijes, pasuri kombëtare që gjithnjë e më tepër po i afrohen lexuesit përmes trajtave digjitale. Në këtë kontekst, të një raporti sa më të frytshëm të lexuesit/përdoruesit dhe fondeve të bibliotekës, *klasifikimi lëndor* merr rëndësi të posaçme. Struktura e termave lëndorë mbetet një nga hapësirat më intriguese profesionale, duke kaluar nga një term në tjetrin, po dhe duke ngjallur vazhdimisht kureshtje, që pikëtakojnë fusha të ndryshme të dijes. Për të arritur në klasifikimin e duhur terminologjik, specialisti i bibliotekës duhet të ketë kulturë të përgjithshme, të ketë intuitë gjuhësore, të jetë i kujdesshëm për termat,[1*] që bartin dhe përcjellin konotacione negative apo që ngjallin diskutime. Në këtë pikë, ai duhet të konsultohet me fjalorë të gjuhës shqipe, me fjalorë sinonimikë e terminologjikë, si dhe me monografi apo libra, që trajtojnë çështje të ndryshme të fushës tematike për të cilën bëhet fjalë, duke mundësuar zgjedhjen e termit përkatës.

Në këtë trajtesë do të shqyrtojmë, ndër të tjera, termat lëndorë *romë/ciganë*, që shënojnë një grup etnik të caktuar dhe termin gjeografik *Maqedonia e Veriut*. Duke u ndalur në shembujt që lidhen me këtë vend, do të ndeshim dhe trajtojmë edhe termat lëndorë që lidhen me Luftën e Parë dhe me Luftën e Dytë Botërore.

Përdorimi i një termi të gabuar (p.sh. *ciganë*) në vend të termit të unifikuar *(romë)*, e orienton lexuesin në lista fragmentare, për të njëjtin informacion të kërkuar (romët), duke e vënë në mëdyshje atë për kuptimet, nënkuptimet e ngjyresat e secilit term.

1 Vërejmë se në tri bibliotekat e hulumtuara përdoren terma të ndryshëm: *fjalë kyçe* - Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë; *subjekte*- Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe ajo e Kongresit Amerikan.

Përmes shqyrtimit të rasteve konkrete të klasifikimit lëndor, synojmë të ndreqim klasifikimet që cenojnë komunitete të caktuara dhe ato që lidhen me një vend a me një ngjarje historike. Gjithashtu, synojmë të theksojmë rolin e rëndësishëm të klasifikimit lëndor/termave lëndorë në marrëdhëniet e lexuesit me bibliotekën.

Le të vëzhgojmë, si është klasifikuar monografia e antropologes angleze, Judith Okely, me titullin *Ciganët shtegtarë (The traveller gypsies)* në tri biblioteka të tri vendeve të ndryshme: Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" dhe Biblioteka e Kongresit Amerikan në Uashington.

Së pari, në katalogun elektronik të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH), për komunitetin rom është përdorur termi/fjala kyçe: *ciganë*.



Së dyti, në katalogun e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", për këtë titull janë përdorur termat/subjektet:

Etnopsikologjia

Ciganët

Fjala *ciganë,* që del në krye të titullit, *Ciganët shtegtarë (The traveller gypsies),* u ka dhënë siguri specialistëve të dy bibliotekave që ta përdorin atë edhe si term lëndor, pa u konsultuar me burime të tjera në fushë të bibliotekës dhe në atë të studimeve të ndryshme për këtë komunitet, pra, pa u kujdesur për konotacionin negativ që mbart ky klasifikim.

Ndërkohë, gjatë kërkimeve të mëtejshme, vërejmë se, edhe pse autori i artikullit *Romët, një realitet i pamohueshëm edhe tek ne*[2**] përdor termin *romë*, klasifikatori i BKSH-së nuk ka treguar qasje kritike e madje as nuk është mëdyshur, teksa e ka klasifikuar shkrimin në fjalë me termin e gabuar *ciganë*, edhe pse gjegjësi i tij i saktë del qartësisht në titull.

Fjalët kyçe:

Komunitete

Ciganë

Shqipëri (Termat gjeografikë)

Hulumtimi në katalogun elektronik të BKSH-së, me termin lëndor/fjalën kyçe *ciganë*, na evidenton se janë klasifikuar një numër jo i vogël botimesh mbi komunitetin rom, si: artikuj në organe periodike, libra, madje edhe një disertacion. Nga një kërkim i dytë, tashmë, me anë të termit të saktë *romë*, na shfaqet një listë tjetër titujsh (botimesh) mbi këtë komunitet. Pra, për etnonimin *rom*, kjo bibliotekë përdor termat: *romë* dhe *ciganë.* Edhe në katalogun e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, për punimet mbi romët përdoret, përveç termit *ciganët* edhe termi *romët*.

Së treti, në katalogun e Bibliotekës së Kongresit, botimi *The traveller gypsies (Ciganët shtegtarë)* është klasifikuar me termin *romanies (romë):*

LC Subjects


Romanies--Great Britain.

Romanies--Great Britain--Social life and customs.

2 Shih artikullin e Alban Dacit: *Romët, një realitet i pamohueshëm edhe tek*. Në: Shekulli, 26 tetor 2010, fq. 20.

Romanies--Great Britain--Folklore.

Në standard, lista e emërtimeve lëndore të Bibliotekës së Kongresit (Library of Congress Subject Headings), del qartë termi që duhet përdorur:



Gypsum wallboard
USE Drywall
Gypsy . . .
USE *subject headings beginning with or qualified by the word* Romani *for topics related to the Romani people, e.g.* Art, Romani; Romani poetry
Gypsy-flower
USE Cynoglossum officianale
Gypsy geckos
USE Hemiphyllodactylus
Gypsy Holocaust
USE Romanies—Nazi persecution
Gypsy Joint Site (Mo.)
BT Missouri—Antiquities
Gypsy language
USE Romani language
Gypsy moth *(May Subd Geog)*
[QL561.L9 (Entomology)]
[SB945.G9 (Pest)]
UF Gipsy-moth *[Former heading]*
Lymantria dispar
Porthetria dispar
BT Lymantria
Gypsy Moth (Training plane)
USE Moth (Training plane)
Gypsy moths as laboratory animals *(May Subd Geog)*
[SF407.G95]
BT Laboratory animals
Gypsy music
USE Romanies—Music
Gypsy poetry

Gyro compass *(May Subd Geog)*
[TL589.2.C58 (Aeronautical instruments)]
[VK577 (Nautical instruments)]
UF Gyrocompass
Gyrostatic compass
BT Compass
Gyroscopes
Gyro horizon
USE Artificial horizons (Aeronautical instruments)
Gyro pilot
USE Automatic pilot (Airplanes)
Automatic pilot (Ships)
Gyro stabilizers
USE Gyrostabilizers
Gyro vertical (Instruments)
USE Artificial horizons (Aeronautical instruments)
Gyrocompass
USE Gyro compass
Gyrocotyle *(May Subd Geog)*
[QL391.P7]
BT Gyrocotylidae
Gyrocotylidae *(May Subd Geog)*
[QL391.P7]
BT Gyrocotylidea
NT Gyrocotyle
Gyrocotylidea *(May Subd Geog)*
[QL391.P7 (Zoology)]
BT Tapeworms
NT Gyrocotylidae
Gyrodeidae
USE Naticidae
Gyrodiidae

Gyrostabilizers
UF Gyro
BT Gyros
Gyrostachys c
USE Spira
Gyrostatic con
USE Gyro
Gyrostemonac
[QK495.
BT Caryo
Gyrothrix *(Ma*
[QK625.
UF Camp
BT Dema
Gyrotrons *(M*
[QC718.
[TK7871.
UF Cyclo
BT Micro
Gyroula, Hierc
USE Temp
Gyrus dentatu
USE Denta
Gyrus suprasy
USE Supra
G'yu-rtse Mou
USE Gñan
Gyula Fortress
USE Gyula
Gyula vár (Gy
This head
subdivision.

Po në këtë standard, gjejmë klasifikimet lëndore standarde të termit *gypsy* (anglisht), që i referohen fushave të ndryshme, si më poshtë:

Për termin	*Duhet përdorur:*
Gypsy poetry	Romani poetry
Gypsy Holocaust	Romanies—Nazi persecution
Gypsy language	Romani language
Gypsy music	Romanies—Music

Me të drejtë, përfaqësues të këtij komuniteti e më gjerë ngrenë zërin në medie, forume dhe institucione kombëtare e ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të tyre, duke filluar që nga përdorimi korrekt i termave *romë/ciganë*. Etnonimi *rom*

është vendosur nga vetë romët në Kongresin e Parë Botëror të Romëve, në Londër, më 1971, duke hedhur njëherësh poshtë terma të tjerë, të ngarkuar me konotacione negative, të përdorur për ta nga joromët. Çdo pasiguri e klasifikatorit gjen përgjigje në konsultime me artikuj e studime të ndryshme, që shqyrtojnë historinë, gjuhën, kulturën, traditat, doket dhe zakonet e romëve e që, ndër të tjera, e trajtojnë këtë komunitet si minoritet gjuhësor, që ka trashëguar e ruan identitetin e tij kudo ku jeton. Duke zëvendësuar në katalogët e bibliotekave termin *ciganë* me atë *romë*, jo vetëm që u ofrojmë lexuesve një gamë më të plotë publikimesh mbi këtë komunitet, por gjithashtu u ngulisim atyre, qoftë edhe vizualisht, përdorimin e termit të saktë.

Pasurimi i vijueshëm i *tezaurëve* - përfshirja e termave të rinj dhe/ose zëvendësimi i termave të mëparshëm, "të vjetër" me terma të përditësuar "të rinj" - vjen edhe në përgjigje të ngjarjeve historike apo të ndryshimeve gjeopolitike të një vendi ose rajoni të caktuar. Kështu, Biblioteka e Kongresit, së cilës i referohemi së pari, kur duhet të shtojmë një term të ri, për Luftën e Kosovës, 1998-1999, ka shtuar termat: *Lufta e Kosovës, 1998-1999* (Kosovo War, 1998-1999), *Ushtria Çlirimtare e Kosovës* (Ushtria Çlirimtare e Kosovës); për revoltat popullore në Lindjen e Mesme, 2010-, ka shtuar termin *Pranvera arabe, 2010-* (Arab Spring, 2010-); për situatën e pandemisë së COVID-19 ka hyrë termi *COVID-19* (COVID-19 (Disease); për termin gjeografik *Maqedoni*, të përdorur deri para vitit 2019, tashmë përdoret emri i ri i këtij vendi, *Maqedonia e Veriut* (North Macedonia).

Duke hulumtuar në katalogun e BKSH-së, me termin gjeografik *Maqedonia e Veriut*, për çudi, nuk na rezultoi asnjë regjistrim bibliografik. Përdoruesi nuk ka akses në asnjë botim mbi Maqedoninë e Veriut, pasi, për vendin fqinj, biblioteka përdor ende termin gjeografik *Maqedoni.*

Në analogji me rastin e mësipërm, të klasifikimit të gabuar të artikullit mbi

romët, edhe në këtë shembull, emri i Maqedonisë së Veriut haset që në titullin e monografisë së Qemal Muratit (*Eksplorime në hapësirat e shqipes: studime sociolinguistike, dialektologjike, onomastike, etnografike dhe folklorike në Maqedoninë e Veriut*, të botuar më 2020), por klasifikatori nuk e ka përditësuar termin, teksa në zonën e termave gjeografikë, përdor për këtë shtet emërtimin e "vjetër" *Maqedoni*.


LIBËR

Eksplorime në hapësirat e shqipes : studime sociolinguistike, dialektologjike, onomastike, etnografike dhe folklorike në Maqedoninë e Veriut / Qemal Murati ; red. Mentore Murati

Murati, Qemal

Përshkrimi | ISBD | MARC

Eksplorime në hapësirat e shqipes : studime sociolinguistike, dialektologjike, onomastike, etnografike dhe folklorike në Maqedoninë e Veriut / Qemal Murati ; red. Mentore Murati. - Prishtinë : Instituti Albanologjik, 2020 . - 976 f : me foto ; 24 cm.
ISBN 9789951240871

Fjalët kyçe:

Gjuha shqipe
Sociolinguistika
Dialektologjia
Etnologjia
Folklori
Antropologjia sociale

Termat gjeografikë:


Maqedoni

Siç dihet, Marrëveshja e Prespës (qershor 2018) zgjidhi përfundimisht çështjen e emrit të Republikës së Maqedonisë, duke e emërtuar atë Republika e Maqedonisë së Veriut. Në janar të 2019-ës, Kuvendi i Maqedonisë miratoi ndryshimet kushtetuese përkatëse dhe disa ditë më pas vendimi hyri në fuqi. Zgjidhja e çështjes së shumëdiskutuar të emrit të Maqedonisë, jo vetëm i dha fund një periudhe thuajse 30-vjeçare mosmarrëveshjesh mes Shkupit dhe Athinës, por hapi rrugën e anëtarësimit në NATO për Maqedoninë e Veriut, si dhe çeli negociatat për anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian. Gjithë ky kontekst do duhej t`i kishte tërhequr vëmendjen specialistit të bibliotekës - qoftë edhe përmes konsultimeve

të literaturës së kohëve të fundit ose medieve – për të reflektuar në përditësimin e klasifikimit.

Në fondet albano-balkanologjike të BKSH-së, krahas studimeve gjuhësore, bëjnë pjesë edhe studimet historike për Maqedoninë e Veriut. Më poshtë do të paraqesim dy syresh, të cilët mes klasifikimeve të tjerë lëndorë kanë edhe ato që lidhen me Luftën e Parë Botërore dhe Luftën e Dytë Botërore, por, për secilën ngjarje hasen tri terma lëndorë të ndryshëm.

Rasti i parë, *Un officier francais dans les Balkans, 1917-1925 (Një oficer francez në Ballkan)*, Vëll. I, *Albanie et Macédoine (Shqipëria dhe Maqedonia*, 2014*)*, Vëll. II, *Salonique au Danube*, 2016. Libri *Një oficer francez në Ballkan* i Andre Ordinit, bazohet në përvojën e periudhës tetë-vjeçare të qëndrimit të tij në Shqipëri (1917-1925). Ai përmban raporte, letërkëmbime të kolonelit, veprimtarinë e tij në përcaktimin e kufijve politikë të vendit tonë, si dhe mendimet e qëndrimet politike të autorit pas Luftës së Parë Botërore e të tjera të dhëna për kontekstin historiko-politik e jetën sociale të asaj periudhe.



Në vëllimin e parë dhe të dytë të botimit të mësipërm, na tërheqin vëmendjen termat klasifikues që lidhen me Luftën e Parë Botërore:

Lufta e Parë Botërore

Lufta e I Botërore,

Lufta Botërore, 1914-1918

E njëjta pakujdesi (përdorimi i tri termave të ndryshëm për Luftën e Dytë Botërore) del edhe në klasifikimin e librit *Shkupi dhe Kumanova nën pushtimin bullgar: (1941-1944): në dritën e dokumenteve shqiptare,* me autorë Sevdail Demiri dhe Skënder Asani, botuar më 2018.

Lufta e Dytë Botërore

Lufta e II Botërore

Lufta Botërore, 1939-1945


LIBËR

Shkupi dhe Kumanova nën pushtimin bullgar : (1941-1944) : në dritën e dokumentave shqiptar / Sevdail Demiri ; Skënder Asani ; rec. Naim Halimi ; rec. Qerim Lita

Demiri, Sevdail

Përshkrimi | ISBD | MARC

Shkupi dhe Kumanova nën pushtimin bullgar : (1941-1944) : në dritën e dokumentave shqiptar / Sevdail Demiri ; Skënder Asani ; rec. Naim Halimi ; rec. Qerim Lita. - Shkup : ITSHKSH, 2018 . - 232 f ; 24 cm. - (Biblioteka "Histori").
Pa ç., tir.500
ISBN 9786084653776


Fjalët kyçe:

Historia
Lufta Botërore, 1939-1945
Shqiptarë
Arkiva
Dokumente
Lufta e Dytë Botërore
Lufta e II Botërore

Termat gjeografikë:

Maqedoni
Shqipëri

Në lidhje me termat e lartshënuar, nuk ka vend për mëdyshje. Standardi, lista e emërtimeve lëndore të Bibliotekës së Kongresit (Subject Headings of Library of Congress), për këto ngjarje historike na referon përdorimin e termave World War, 1914-1918 (*Lufta Botërore, 1914-1918*) dhe World War, 1939-1945 (*Lufta Botërore, 1939-1945*) pa i numërtuar (I, II), por duke i shënjuar përmes viteve.



Nëse në standard do të kishim termin lëndor *Lufta I Botërore* dhe *Lufta II Botërore*, nuk do të duhej t'i përdornim këto terma me nyjën *-e-* përpara numrit romak (*Lufta e I Botërore* dhe *Lufta e II Botërore*), pasi nuk përputhet me rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe[3]*** Përdorimi i termave të duhur, të unifikuar edhe në kategoritë e trajtës dhe të numrit, bën që përdoruesi të ketë akses në një listë të vetme për subjektin që kërkon, duke i mundësuar atij informacion thuajse shterues mbi çështjen për të cilën është i interesuar.

Shembujt e mësipërm, si dhe të tjerë që mund të sillnim nën këtë këndvështrim, ravijëzojnë vlerën e klasifikimit në disa rrafshe. Nga njëra anë, brenda institucionit të

3 Shih: *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: Tiranë, 1973, f. 136, §68/gj.

bibliotekës, specialistët duhet të punojnë në mënyrë të unifikuar, duke u mbështetur në standarde, që bibliotekat të komunikojnë me njëra tjetrën, të shkëmbejnë informacione, të pasurojnë vazhdimisht, jo vetëm katalogët elektronikë, duke shkarkuar regjistrime bibliografike, por të shtojnë edhe tituj me vlerë në format digjital. Nga ana tjetër, shmangia e termave të gabuar në klasifikim, që prekin ndjeshmëri profesionale në fushë të bibliotekonomisë dhe shumë më tepër ato me karakter identitar, si në plan historiko-politik, etnik, fetar, kulturor, gjinor etj., ndikon në ngulitjen e normës nga ana e lexuesit, duke u bërë pjesë e formimit të tij. Aktorët e disiplinës së bibliotekës e të informacionit dhe lexuesit nuk janë të shkëputur nga njëri-tjetri, përkundrazi, ata janë në ndërveprim të vijueshëm. Siç dihet, një nga sfidat e institucioneve të kujtesës në kohën e globalizmit mbetet shkurtimi i distancës mes tyre, me synimin që lexuesit të shfletojnë faqe pafund botimesh të vlerëshme, jo vetëm të një biblioteke, por të një rrjeti bibliotekash, që zgjerohet çdo ditë e më shumë.

Teuta Toska

Fjalorët terminologjikë: pasuri për t'u vlerësuar apo traditë për t'u mënjanuar?

Abstrakt

Seria e fjalorëve terminologjikë, që botohej nga sektori i terminologjisë pranë Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, i Universitetit Shtetëror të Tiranës, më vonë pjesë e Akademisë së Shkencave, janë fryt i një përpjekjeje njerëzore, të institucionalizuar nga ana shkencore, e më shumë se 50 viteve. I pari ishte ai i terminologjisë së botanikës, i botuar në vitin 1963. Fjalori i fundit (deri tani) është "Fjalori i termave të bankës", i 32-ti në radhë, i botuar në vitin 2014. Fjalorët terminologjikë janë kryesisht të tipit krahasues, ku krahasohen fillimisht termat e shqipes me ata në rusisht, e pastaj, në fjalorët e tjerë, me gjuhët perëndimore, kryesisht frëngjisht, italisht e më pas gjermanisht e anglisht. Fjalorët e parë terminologjikë kishin si synim të ndihmonin shkollën, procesin mësimor, më pas edhe zhvillimin e vrullshëm ekonomik të kohës, ndërtimin e veprave të mëdha industriale, energjetike etj., dhe po aq universitetin e kërkimin shkencor aty. Me hapjen e shqipes pas viteve '90 të shekullit të kaluar, zhvillimin e madh në çdo sektor të jetës shoqërore, kulturore dhe shkencore, pasurimin e leksikut të saj specifik në mënyrë të padiktuar, cili është fati i këtij mundi shkencor të studiuesve më të mirë të shqipes dhe specialistëve më të mirë të fushave të shkencës e prodhimit? A janë mjete bazike të përkthimit dhe produktit shkencor apo shkenca ia ka nisur nga e para terminologjikisht ligjërimit të vet?

Në këtë studim, do të përpiqemi të japim një panoramë të gjendjes së përdorimit

të termave në një fushë të caktuar dhe raporteve që krijohet me traditën shkencore.

Në një paradite të fundit të gushtit, ndërsa dilja nga klinika e dentistit tim, pashë me kujdes listën e shërbimeve dhe të çmimeve përkatëse, dhe në radhën e parë lexova: "ekstrasion i dhëmbit". Ndjesia që pata ishte pakëz më e fortë nga ajo që ndieja nga goja e sapotraumatizuar, por ende gjysmë e mpirë. Bëhej fjalë për "heqje dhëmbi", një togfjalësh terminologjik i njohur prej të gjithëve, dhe isha e sigurt se të gjithë kanë parasysh atë proces që ka në mendje edhe dentisti. Sigurisht, gjuha e dentistit tim ishte ajo e shkollimit të tij dhe jo e njerëzve të cilëve ai u ofron shërbimin e vet.

Ekstrasion apo heqje? Mendova ta verifikoj termin e duhur te Fjalori i Termave të Stomatologjisë[1] cili ishte termi që duhej përdorur në shqip. Edhe ishte "heqj/e -a (e dhëmbit)"[2], së bashku me termat e tjerë gjegjës në frëngjisht, italisht e rusisht (extirpation, extracion; estirpazione etj.) Ky dualitet mes termit ndërkombëtar dhe atij në shqip, mes ndërkombëtarit që hyn i pari dhe sërish (ai është shmangur ca kohë nga përdorimi i termit në shqip dhe tenton të hyjë gjithnjë nga leximi i literaturave të huaja dhe shkëmbimit shkencor ndërkombëtar)[3] dhe atij të shqipes me gjasë më i përhapur, është një ndër çështjet më të mprehta sot, përveç nevojës së ngutshme për terma të rinj, në një realitet shkencor që zhvillohet pandërprerë dhe me shpejtësi të pazakontë. Lidhur ngushtë me këto çështje, një tjetër çështje e mprehtë është edhe qëndrimi që duhet mbajtur për terminologjinë e kodifikuar dhe të normëzuar nga institucionet shkencore shqiptare që nga viti 1963 e deri

1 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, sektori i terminologjisë, Terminologjia tekniko-shkencore, "Fjalor i termave të stomatologjisë", [30] Tiranë, 2003, shqip-frëngjisht-italisht-rusisht. Komisioni hartues – prof.dr. Foto Toti, prof.dr. Samedin Gjini, doc.Xhevdet Asllani; gjuhëtarë: prof.dr. Ferdinand Leka, dr. Vladimir Dervishi, dr. Veli Bici, redaktor prof.dr. Ferdinand Leka. 752 f.

2 Po aty, f.98.

3 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe – probleme e detyra", konferencë shkencore, Tiranë, 2009, Hëna Pasho, Agron Duro në artikullin "Terminologjia shqipe – probleme dhe detyra" shkruajnë: "Ç'dukuri vihen re sot në përdorimin e tyre [termave]? Janë rikthyer në përdorim termat e huaj që ishin mënjanuar e zëvendësuar me fjalë shqip" (f.37).

para pak vitesh.

Po flasim për serinë e fjalorëve terminologjikë, që botohej nga sektori i terminologjisë pranë Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë, i Universitetit Shtetëror të Tiranës, më vonë pjesë e Akademisë së Shkencave, fryt i një përpjekjeje njerëzore, të institucionalizuar nga ana shkencore, të më shumë se 50 viteve. I pari ishte ai i terminologjisë së botanikës, i botuar në vitin 1963. Fjalori i fundit (deri tani) është "Fjalori i termave të bankës", i 34-ti në radhë, i botuar në vitin 2013 (ndërsa i 32-ti i botuar në 2014).

Në vitin 1963 u botuan 12 fjalorët e parë, që u takonin fushave: të botanikës; të matematikës dhe të mekanikës teorike; të energjisë atomike; të termodinamikës, të optikës; të akustikës; të elektromagnetizmit; të mekanikës; të elektroteknikës; të kimisë; të gjeologjisë dhe të arkitekturës. Grupi i punës përfshinte gjuhëtarë dhe specialistë të fushave. Kaq rëndësi i ishte vënë përgatitjes së këtyre fjalorëve, sa pjesë e grupit të punës ishin gjuhëtarët më të mirë të asaj periudhe: A.Xhuvani, A.Kostallari, E.Çabej, L.Dodbiba, M.Domi, S.Riza. Pas vitit 1964 këta emra, me përjashtim të Lirak Dodbibës, ngadalë do të bëheshin mënjanë për të përfshirë në këtë grup pune leksikografë të specializuar në terminologji, pra, specialistë që do t'i kushtoheshin tani e më tej terminologjisë, si Ferdinand Leka, Anton Krajni, Veli Bici, Hëna Pasho, Sofika Morcka, Agron Duro etj. Emri i Lirak Dodbibës, terminologut të parë, do të mbetet si shtylla, boshti lidhës i institucionalizuar i kësaj ndërmarrjeje madhore shkencore. Ai do të jetë hartues dhe redaktor në 24 (nga 34) fjalorë terminologjikë. Shfaqja e emrit të tij ndër autorët edhe pas vitit të vdekjes së tij (1982) tregon se puna për përgatitjen e fjalorit përfundonte disa vite përpara botimit të tij. Nga planifikimi, përgatitja, hartimi deri në procesin e botimit kuptojmë se fjalësi kalonte nëpër syrin e mprehtë të një grupi profesionistësh: edhe gjuhëtarëve, edhe specialistëve, edhe disa redaktorëve.

Fjalorët terminologjikë institucionalë janë shumëgjuhësh, të tipit krahasues, ku krahasoheshin, fillimisht, termat e shqipes me ata në rusisht e frëngjisht, e pastaj, në fjalorët e tjerë, shtohen gjuhët në krahasim, me italishten e më pas me gjermanishten e anglishten. Në ndonjë rast edhe me latinishten. Fjalori terminologjik nuk ishte përkufizues[4] (shpjegues). Ky tip fjalori ende i mungon terminologjisë së shqipes, pra të asaj që është e institucionalizuar. Nëse e kemi në shqip, ai është kryesisht një përkthim ose tekst i hartuar nga specialistë të fushave, që shpjegojnë termat e profilit të tyre, por pa mbikëqyrjen e gjuhëtarëve dhe pa kritere të përcaktuara qartë.

Nëse i hedhim një sy listës së fjalorëve, të përmbajtjes së tyre, mund të bësh edhe historinë e shtetit shqiptar pas Luftës, të zhvillimit kulturor e shkencor në Shqipëri. Fjalori terminologjik shumëgjuhësh synonte të ndihmonte përkthimin e dijes shkencore në shqip (në një kohë që literatura vinte nga gjuha e huaj dhe përkthehej në shqip), depërtimin dhe përhapjen e saj, fillimisht, në shkollën shqiptare, më tej në shkencë dhe pastaj veprimtarinë prodhuese në Shqipëri. Terminologët H. Pasho dhe A. Duro shprehen: *"Me bindjen se hartimi i këtyre fjalorëve nuk ishte qëllim në vetvete, por duhej të ndihmonte praktikën, jo rastësisht u fillua me fushat që ishin lëndë mësimorë në shkollë"*[5].

Kështu, fjalorët e botuar shkonin të gjithë, më së pari, në shtëpinë botuese të librit shkollor sepse termi duhet të ishte pjesë e tekstit shkollor. Lidhja mes shkencës dhe shkollës ishte e fortë në këtë proces, i cili drejtohej nga aparati shtetëror. Qeveria, si ishte e natyrshme, përzgjidhte specialistët më të mirë në vend (përveç gjuhëtarëve të komisionit), dekanë, drejtues departamentesh, pra të nivelit universitar, jo vetëm për shkak se universiteti ishte institucioni shkencor më i lartë, por edhe se qëllimi ishte përfshirja në mësimdhënie (universitare) i sistemeve

4 H.Pasho, A.Duro, vep.cit. "Në punën për hartimin e fjalorëve terminologjikë duhet filluar një fazë tjetër, hartimi i fjalorëve me përkufizime" (f.39).

5 Po ata, po aty, f.24.

terminologjike të krijuara. Fjalorët shpërndaheshin gjerësisht në biblioteka, radio e televizion, shtypin e përditshëm, revistat shkencore edhe të natyrës divulgative (si në rastin e "Shkenca dhe jeta"). Seria e parë e fjalorëve (12 fjalorët e botuar në 1963) u botua edhe në Kosovë, duke iu shtuar gjuha serbokroate, pikërisht për një standardizim e përhapje sa më të madhe të dijes shkencore dhe njësim të terminologjisë, me qëllim shkëmbimin dhe komunikimin pa pengesë mes të njëjtit komunitet shkencor dhe kombëtar.

Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, nga 1963 e deri më sot, nuk kanë munguar edhe fjalorët terminologjikë jashtë institucionit shkencor[6], brenda dhe jashtë kufirit, kryesisht dygjuhësh (shqip e rusisht), por edhe shumëgjuhësh, që lidhen me fusha të caktuara me zhvillim më të spikatur dhe ku nevoja për terma e tejkalon sasinë e ofruar nga fjalori i standardizuar i institucionit.

Me ndryshimet politike e shoqërore pas viteve '90 të shekullit të kaluar, zhvillimin e madh në çdo sektor të jetës shoqërore, kulturore dhe shkencore, pasurimin e leksikut të saj specifik në mënyrë të padiktuar, cili është fati i këtij mundi shkencor të studiuesve më të mirë të shqipes dhe specialistëve më të mirë të fushave të shkencës e teknikës? A janë mjete bazike të përkthimit dhe produktit shkencor apo shkenca ia ka nisur ligjërimit të vet terminologjik nga e para? Emrat e përmendur më sipër mund të quhen terminologët e shqipes. Ata, më fort sesa leksikografë, do ta quanin veten terminografë. Me largimin e këtij brezi nga puna dhe daljen në pension, në institucionet shkencore shqiptare duket se nuk ka mbetur më asnjë i tillë. Por ka mbetur puna e tyre. A ka më vlerë sot ajo?

6 Përmendim këtu fjalorë të terminologjisë ushtarake, me autor kryesor Hasan Çipuri (autor dhe bashkautor në 20 të tillë), dhe ndarjeve të tjera brenda kësaj fushe; fjalorë të mikrobiologjisë (1980), të gjeografisë (2000), i informatikës (2005); të anatomisë së kafshëve shtëpiake (1989); të kulturës fizike e sporteve (1981); i termave të bibliotekës dhe të bibliografisë (1982); fjalor i bujqësisë (1978) etj. Për një listë më të gjerë të fjalorëve terminologjikë shih Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe – probleme e detyra", konferencë shkencore, Tiranë, 2009, f.275-294. Shtohen këtu edhe fjalorë të tjerë terminologjikë, të cilat nuk janë në listën e cituar më sipër, si: "Fjalor i estetikës", nga Tefik Çaushi; "Fjalor i pedagogjisë", Shefik Osmani, Tiranë 1983; "Fjalor i psikologjisë: terma dhe autorë", Sadik Lala, 2010 etj. Së fundi edhe "Fjalori i termave të urbanistikës", nga Eva Papamihali, si disertacion doktoral pranë departamentit të gjuhësisë në Universitetin e Elbasanit, viti 2021, udhëhequr nga Hëna Pasho.

Kjo pyetje më ka sfiduar gjithnjë dhe në 13 mars të vitit 2012 ne, si universitet, në Elbasan patëm dëshirën të mblidhemi për të hetuar dhe diskutuar për terminologjinë e shkencës së gjuhësisë. Metodologjitë e reja të përqafuara, përkthimet e literaturave të ndryshme, studimet në disiplina të reja gjuhësore dhe nevoja për njohjen dhe përqafimin e dijes bashkëkohore, kishte sjellë edhe një numër të madh termash të rinj dhe nevojën për ta diskutuar, kodifikuar e standardizuar përmbajtjen e tyre. Me bindjen se diskutimi i gjerë mes specialistëve, të paktën dëgjimi i termit dhe përkufizimi i tij ishte faza e parë për kodifikim, konferencën e organizuam në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës dhe me Universitetin e Prishtinës. Gjuhëtarët e ftuar diskutuan për çështje të ndryshme të terminologjisë në shkencat e ligjërimit (pra, duke dashur të diskutojmë edhe për ato disiplina që nuk studiojnë vetëm sistemin gjuhësor, por edhe përdorimin e gjuhës, aktet e ligjërimit, tekstin etj.).

Në atë konferencë u paraqita me një studim[7] që përpiqej të kuptonte dhe të maste ndryshimin që kishte pësuar shkenca e gjuhësisë duke përqasur dy fjalorët e gjuhësisë të botuar në kohë të ndryshme: i pari në vitin 1975[8], mbante numrin 17 në serinë e këtyre fjalorëve, dhe i dyti i takon vitit 2011[9], i hartuar nga prof.Shezai Rrokaj dhe i ndjeri prof.Xhani Belusho. Unë krahasova me atë rast fushat e reja të kërkimit gjuhësor (duke parë se si shfaqeshin në të dy fjalorët termi "gjuhësi", "gramatikë" dhe "morfemë") dhe, së dyti, organizimin e zërave (terma) apo të njësive hyrëse në paraqitjen e tyre në këta fjalorë.

Për të krijuar një ide më të qartë, po paraqesim numra (të cilët na ndihmojmë të matim më mirë shkallën e ndryshimit): «*Në 89 termat e shkronjës B, 49 terma janë*

7 Teuta Toska, "Terminologjia në shkencat e ligjërimit", artikulli "*Realitetet e reja studimore në shqipe dhe terminologjia: krahasimi mes dy fjalorëve të termave të gjuhësisë në shqipe*", "Rama graf", Elbasan, 2014, f.42-49.

8 USHT, IHGJ, sektori i terminologjisë, terminologjia tekniko-shkencore, "Fjalor i termave të gjuhësisë", [17] shqip-rusisht-frëngjisht-anglisht-gjermanisht-italisht, Tiranë, 1975. Komisioni i terminologjisë: prof.Androklli Kostallari, doc.Anastas Dodi, prof.Eqrem Çabej, Ferdinand Leka, bashkëp.i.vj.shk.Lirak Dodbiba, prof.Mahir Domi, bashkëp.i vj.shk. Spiro Floqi, Sofika Morcka, prof.Shaban Demiraj; Redaktorë: F.Leka, L.Dodbiba

9 G.Belluscio, Sh.Rrokaj, "Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë (shqip-italisht-frëngjisht-anglisht)", Arbëria, Tiranë, 2011.

të rinj. Nga 40 zërat [ose njësitë hyrëse] që janë edhe në fjalorin e parë, 11 terma vijnë me zgjerime konceptore, me lidhje konceptore terminologjike... Termi "bazë" shfaqet në 1975 vetëm me 13 togfjalësha terminologjikë, si: "bazë analogjie", "bazë e lehtë", "bazë e rëndë", "bazë rrënjore" etj., ndërkohë në Fjalorin e 2011-ës njësia shfaqet si bërthamë e 30 termave (togfjalësorë), nga të cilët 23 të rinj. Termi operacional "rregull" në fjalorin e vitit 1975 shfaqet vetëm në tri togje terminologjike: "rregull drejtshkrimore, fonetike, gramatikore", ndërsa në Fjalorin 2011 shfaqet me 78 togje, që u përkasin niveleve të ndryshme të analizës së sistemeve gjuhësore, që nga fonetika e deri te gramatika, pragmatika e gjuhësia e tekstit. Shkronja D ka 181 zëra terminologjikë: nga këto 106 terma janë të rinj. Nga termat tradicionalë (që shfaqen edhe te Fjalori i 1975-ës), 28 shfaqin përdorime të reja ose kanë krijuar togfjalësha të rinj terminologjikë...»[10].

Ndryshe nga gjuhësia, ku përditësimi i terminologjisë kryhet duke u mbështetur dhe vijuar mbi traditën, futja e termave të rinj bëhet pjesë e një diskutimi të gjerë në tribuna si kjo e sotmja, situata me shkenca dhe fusha të tjera të prodhimit është kaotike. Duke iu kthyer stomatologjisë[11], mund të vihet re gjerësisht shpërfillja e termit në shqipe dhe një bashkekzistencë e pazakontë e termit në shqip me atë të huaj: kështu gjen "kavitet oral" në vend të "zgavër gojore ose e gojës"; "gengiva" ose "gingiva" për "mishrat e dhëmbëve", terma të tjerë të huaj dhe të pavend në shqip, si "sedacion koshient" (pak më poshtë shkruan "sedacion i ndërgjegjshëm"), "relaksim"; "drenim i abseseve", "rezeksion apikal", "lezion" etj. Trysnia e shkencës në zhvillim, futja dhe përdorimi i një teknologjie që përmirësohet me shpejtësi të madhe, ndërkombëtarizimi i ofrimit të shërbimeve ka sjellë një sfidë të re për terminologjinë në këtë fushë që përmendëm, por edhe në fusha të tjera, që u përmendën edhe në këtë konferencë. Kjo trysni është tashmë edhe për institucionin/institucionet që punojnë me terminologjinë në nivel kombëtar.

10 Teuta Toska, artikull i cituar.

11 Hetimi është bërë në internet, me faqe që prezantojnë klinika të ndryshme dentare, si https://brianzadent.al/; https://www.isufidental.com/; https://www.imperialdentalcenter.al/ etj.

Serinë e fjalorëve terminologjikë nuk e zotëroj të plotë, kam 27 nga 34 prej tyre, të blerë në kohë në rrugët e kryeqytetit dhe qytetit tim. Seria ka përfunduar në rrugë, në duar të librashitësve shëtitës, që shesin gjithë çfarë ka mbetur nga bibliotekat private dhe publike që nuk duan të kenë më libra të tillë. Cili do të jetë fati i kësaj pasurie? Mbetet që institucioni shkencor që i prodhoi të kujdeset për pasurinë e vet, së pari duke e bërë të njohur. Mendoj se njohja e kësaj pasurie, përmes digjitalizimit të saj, ofrimit kështu një publiku sa më të gjerë, përditësimit të terminologjisë, do të jetë hapi i parë dhe më i rëndësishëm. Së dyti, janë këto tryeza diskutimesh që duhen nxitur dhe vijuar, ku mund të diskutohet për terminologjinë në fushën që ka kërkesa më të ngutshme. Bërja publike e mendimit dhe prodhimit shkencor të këtyre tryezave publikut është po aq e nevojshme. Zgjedhja e termit le të jetë në dorë të përdoruesit.

Bibliografia

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, "Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe – probleme e detyra", konferencë shkencore, Tiranë, 2009.

- "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", II, Tiranë, 1972.

- USHT, IHGJ, sektori i terminologjisë, Terminologjia tekniko-shkencore, "Fjalor i termave të gjuhësisë", shqip-rusisht-frëngjisht-anglisht-gjermanisht-italisht, Tiranë, 1975. Komisioni i terminologjisë: prof.A.Kostallari, doc.A.Dodi, prof.E.Çabej , F.Leka, Bashkëp.i.vj.shk.L.Dodbiba, prof.M.Domi, bashkëp.i vj.shk. S.Floqi, S.Morcka, prof.Sh.Demiraj; Redaktorë: F.Leka, L.Dodbiba.

- G.Belluscio, Sh.Rrokaj, "Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë (shqip-italisht-frëngjisht-anglisht)", Arbëria, Tiranë, 2011.

- Teuta Toska, “Terminologjia në shkencat e ligjërimit”, artikulli “Realitetet e reja studimore në shqipe dhe terminologjia: krahasimi mes dy fjalorëve të termave të gjuhësisë në shqipe”, “Rama graf”, Elbasan, 2014.

Xhafer Beqiraj

Disa probleme të terminologjisë në gramatikën e shqipes

Çështjet e rendit të terminologjisë janë një problem më vete në gjuhësinë shqiptare që kërkojnë një shqyrtim sistematik, sepse duhet të jenë në koherencë me zhvillimet e përgjithshme të gjuhësisë botërore. Gjatë zhvillimit historik të gramatologjisë shqiptare të bie në sy kujdes i veçantë që gramatikanë e studiues të shqipes i kanë kushtuar aspektit të terminologjisë, duke pasur parasysh se, pa terma të saktë nuk mund të jepen nocione (koncepte) të qarta. Siç dihet, interesimi për terminologjinë fillon që nga shekulli XIX, duke filluar me S. Frashërin, K. Kristoforidhin, A. Xhuvanin, I. D. Sheperin etj., mirëpo, në gjuhësinë shqiptare, interesimi për terminologjinë në mënyrë sistematike filloi në gjysmën e dytë të shekullit XX. Studiues që u morën me këtë fushë të dijes dhe e pasuruan atë në vijimësi, si në këtë periudhë e më pas, janë: K. Cipo, S. Riza, J. Rrota, S. Floqi, S. Prifti, E. Çabej, A. Kostallari, Sh. Demiraj, R. Memushaj, V. Memisha, Sh. Rrokaj etj.

Ndonëse shqipja ka bërë përparim edhe në këtë fushë të gjuhësisë, megjithatë çështja e terminologjisë mbetet edhe sot e kësaj dite e hapur për gjuhësinë shqiptare dhe herë-herë e shoqëruar me probleme, sepse, siç e kemi vënë në dukje edhe më herët, për shkak të mbylljes ndaj shkollave linguistike botërore për një gjysmë shekulli, gjuhësia shqiptare nuk arriti të përqafonte me kohë teoritë e reja bashkëkohore, që kanë sjellë qasje të reja ndaj kategorive gramatikore e bashkë me to kanë sjellë edhe terma të rinj. Kjo është njëra nga arsyet pse gjuhësia shqiptare mbeti më e varfër në këtë drejtim, krahasuar me zhvillimet bashkëkohore

europiane e më gjerë.

Megjithëse shqipja ka shënuar një përparim të dukshëm dekadat e fundit edhe në fushën e terminologjisë, ne, duke u nisur nga ajo që u tha më sipër dhe gjendja e sotme, shohim se në gramatikën e shqipes ka nevojë për pasurimin e saj me terma dhe koncepte të reja. Mirëpo, krahas pasurimit me terma të rinj, në gramatikën e shqipes vërehen edhe lajthitje e pasaktësi te disa terma që me të cilët operon ajo. Tani shtrohet pyetja: Ç'shohim të diskutueshme në gramatikën e sotme të shqipes në lëmin e terminologjisë?

Në *Gramatikën e gjuhës shqip* (vëll. 1, 2002) si edhe në gramatikat e tjera të botuara deri më sot nga autorë të ndryshëm, sipas nesh, ka probleme në përdorimin e disa termave. Për shembull, te kreu i 2-të, paragrafi 2.1.11, nënparagrafi c) me titull *Prejardhja parashteso-prapashtesore*, thuhet se "kemi prejardhje parashteso-prapashtesore kur një teme i ngjitet njëkohësisht një parashtesë e një prapashtesë, meqë të dyja këto morfema luajnë rolin e një morfeme fjalëformuese". Ky tip i prejardhjes është ashtu si thotë kjo gramatikë, mirëpo për këtë koncept mungon termi i saktë e i qartë, prandaj dalin ngatërrime e luhatje, për shkak se përzihen me këtë tip fjalëformimi edhe tipa të tjerë, si p.sh.: *përfundoj, përvetësoj, shfrytëzoj, zhdoganoj, shkripëzoj*[1] etj. Sikundërqë shihet, këto fjalë të prejardhura u takojnë dy tipave të prejardhjes. Fjalët e prejardhura (a) *zhdoganoj* [zh + dogan(ë) + o + j], *shkripëzoj* [sh + krip(ë) + ëzo + j] e të tjera si to, dallojnë nga fjalët (b) *përfundoj* [për + fund + o +j], *përvetësoj* [për + vet + ëso + j], *shfrytëzoj* [sh + fryt + ëzo + j] për sa i përket mënyrës së fjalëformimit, çka do të thotë se kemi ngatërrime, sepse këtu kemi dy tipa të fjalëformimit sipas prejardhjes: a) prejardhjen me parashtesë + një temë jo të parme që ndihet e formuar nga një prapashtesë dhe b) prejardhjen me parashtesa dhe prapashtesa njëherazi, të cilat të dyja së bashku formojnë një morfemë të vetme fjalëformuese.

1 ASHSH, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëll. 1, Tiranë, 2002, f. 68.

Në gramatikat e gjuhëve të tjera (në anglishte, gjermanishte etj.) përdoret termi cirkumfiks (circumfix) për dy morfema që së bashku formojnë një morfemë të vetme. Këtij termi të huaj i përgjigjet termi i shqipes "rrethshtesë", të cilin për herë të parë e vë në dukje Enver Hysa, pastaj M. Buxheli dhe ne në monografinë "Funksionet semantiko-sintaksore të mbiemrit në gjuhën shqipe"[2].

Nga këtu del se do të ishte më mirë të njihet si morfemë rrethshtesa dhe, si rrjedhojë, prejardhja e formuar nga parashtesat dhe prapashtesat njëkohësisht të zëvendësohet me termin "prejardhje me rrethshtesim". Termi "rrethshtesë" jep saktë konceptin për këtë tip morfeme, që te gramatika e sotme e shqipes nuk njihet fare, pastaj termi "prejardhje me rrethshtesim" e jep shumë më qartë e më saktë emërtimin e tipit të fjalëformimit të ashtuquajtur "prejardhje parashteso-prapashtesore" dhe në këtë mënyrë do të mënjanonim paqartësitë dhe lajthitjet, për sa i përket kësaj çështjeje në gramatikën tradicionale të shqipes.

Një çështje tjetër që e shohim si problem në lëmin e fjalëformimit është përdorimi i termit "sindajshtesë", shih *Gramatika e gjuhës shqipe*[3]. Aty thuhet se "për shkak të numrit relativisht të madh të kompozitave të formuara me to dhe të mundësisë për formime të reja, kuptimi i këtyre gjymtyrëve është bërë i ngjashëm herë më shumë e herë më pak me kuptimin përgjithësisht abstrakt të ndajshtesave (afikseve), prandaj ato quhen edhe si ndajshtesa (afiksoide)[4]. Sikundërse shihet, si ndajshtesa në këtë gramatikë quhen fjalët që kanë kuptim dhe kanë aftësi morfologjike-semantike, që bashkë me një temë tjetër të formojë një numër të kompozitave, si p.sh.: *gjsymëanalfabet, gjysmëkoloni, kryeqytet, vetëvendosje, vetëlëvizje, vetëshërbim* etj. Sipas gramatikës së shqipes (2002), arsyeja kryesore pse do të quhen sindajshtesa fjalët me kuptim të plotë semantik e morfolgjik është denduria e përdorimit të

2 Xhafer Beqiraj, *Funkisonet semantiko-sintaksore të mbimerit në gjuhën shqipe*, Mirgeeralb, Tiranë, 2016, f. 144-146.
3 ASHSH, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëll. 1, Tiranë, 2002, f. 73.
4 *Po aty*, vep. e cit., f. 73.

tyre në formimet e fjalëve të përbëra, duke lënë anash kështu aspektin semantik e leksikor të tyre.

Pak më poshtë, po në këtë krye të kësaj gramatike (2002), thuhet se "në rolin e sindajshtesave" paraqiten edhe një numër temash me burim nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja, që janë bërë ndërkombëtare, si: *areo-, auto-, biblio-, bio-, hidro-, deci-, kilo-, hekto-* etj. Dhe si tema të dyta: *-arki, -krat, -kraci, -grafi, -log, -logji, -metër, -morf* etj. Grupi i parë i këtyre temave del në krahun e majtë të kompozitës, kurse grupi i dytë në krahun e djathtë të saj, por që të dy grupet janë tema fjalëformuese dhe kanë kuptime të plota semantike. Tani na del një problem, sipas nesh, jo i vogël në lidhje me raportet trem – koncept, sepse t'u thuash temave me kuptim të plotë semantik sindajshtesa, pra, si morfema ndajshtesore, na duket jo i drejtë.

Çështja ndërlikohet në kreun e 3-të, ku, ndër të tjera, thuhet se "nga siparashtesat e shqipes do të përmendim *drejt-, gjithë-, gjysmë-, jashtë, plot-, shumë-, vetë-*"[5]. Pastaj, po këtu, konsiderohen siparashtesa temat prodhuese me burim të huaj *filo-, gjeo-, hidro-, mono-, poli-, pseudo-* etj., si p.sh.: filoamerikan, gjeoteknik, hidroelektrik, monosilabik, neokolonial, politeknik, pseudoshkencor etj., të cilat edhe pse vijnë nga gjuhë të huaja, ato ruajnë kuptimet e tyre semnatike edhe në shqipe.

Madje, në qoftë se shikojmë se ç'thotë *Fjalori i gjuhës shqipe* (Tiranë, 2006) për këto fjalë dhe çka thotë gramatika tradicionale e shqipes, del në shpërputhje të theksuar. Për fjalët *gjysmë, gjithë, shumë, vetë, -fish, ; filo-, gjeo-, hudro-* etj., fjalori i shqipes i jep si fjalëforma, respektivisht gjymtyrë të para të fjalëve të përbëra[6] që në përbërjen e kompozitës janë tema fjalëformuese, kurse gramatika i quan herë siparashtesa, herë sindajshtesa fjalët me kuptime semantike, si ato që janë me burim të shqipes, ashtu edhe ato që vijnë nga gjuhë të huaja.

Nga sa u vu në dukje më sipër, shihet se në gramatikën e shqipes (1, 2002), lidhur

5 Shih: *Gramatika* ..., 1, 2002, f. 187.
6 ASHSH, *Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë*, 2006, f. 272, 275, 359, 367, 853, 1065, 1173.

me këto koncepte ka ngatërrime, paqartësi e pasaktësi që e çorientojnë lexuesin. Siç shihet, i tërë problemi del te termat dhe raportet e tyre me konceptet. Nëse kemi ngatërrime në lidhjet e ndërsjella term – koncept, nuk ka qartësi as sistemi i morfologjisë leksikore, as sistemi i morfologjisë eptimore.

Për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi, ne jemi mbështetur në gramatikën DUDEN (2009, f. 658), ku trajtohet koncepti *konfiks* (Konfix). Konfiks quhen temat të cilat kanë kuptim semantik, por që nuk kanë mundësi të kenë kuptim të pavarur, d.m.th. si të vetme nuk mund të kryejnë funksionin e leksemës si çdo fjalë në fjalësin e një gjuhe. Pra, kuptimi i këtyre fjalëve konkretizohet vetëm brendapërbrenda fjalës së përbërë, e cila mund të dalë si temë, qoftë në anën e majtë, qoftë në anën e djathtë të kompozitës, si p.sh.: *gjysmëshekullor, automjet, trefish* etj. Si rrjedhojë, sikundërqë shihet, këto tema nuk janë as sindajshtesa, as siparashtesa, por, sipas disa studiuesish gjermanë, janë konfikse. Sipas tyre, konfikset (Konfix) janë tema të lidhura, të cilat së bashku me një temë prodhuese tjetër formojnë kompozita[7]. Pra, kuptimi i tyre konkretizohet në kuadrin e fjalës së përbërë ku del njëra nga temat fjalëformuese të kompozitës. Ky koncept për herë të parë ka filluar të përdoret nga disa studiues gjermanë në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar e këndej.

Ne nuk kemi arritur të gjejmë një emërtim adekuat për termin "konfiks", kështu që kemi parë si mundësi të zgjidhjes së kësaj çështjeje që t'i ndajmë temat e fjalëve në dy lloje: a) *tema të lira* dhe b) *tema të lidhura*. Këta dy terma të emërtuar me anë të sintagmave do të mënjanonin lajthitjet që sjellin termat "siparashtesë" dhe "sindajshtesë", të cilët nuk dalin të sakta për sa i përket emërtimeve të këtyre koncepteve. Nëse do të pranoheshin këta terma, atëherë do të krijohej një sistem i përngjashëm me dy konceptet e llojeve të rrënjave, të cilat ndahen në dy tipa: a) *rrënjë të lira* dhe b) *rrënjë të lidhura*.

Si rrënja e lirë që është bartëse e kuptimit leksikor themelor të fjalës, ashtu edhe

7 DUDEN, *Die Grammatik, Dudenverlag*, Mannheim – Wien, Zurich, 2009, f. 658.

tema e lirë ka aftësi të përfaqësojë në vetvete bërthamën leksikore të fjalës[8], edhe si e vetme ajo ka kuptim, p.sh.: *bashkautor [bashkë + autor], vetëvendosje [vetë + vendosje], i vetëkuptimshëm [i + vetë + kuptim +shëm]* etj. Një gjë e tillë nuk del te rrënja e lidhur dhe te tema e lidhur, të cilat kuptimin e tyre e realizojnë vetëm përbrenda fjalës së prejardhur dhe fjalës së përbërë, si p.sh.: a) *m-bath, z-bath [-bath], n-gri-j [-gri-], sh-kri-j [-kri-];* b) *dyvjeçare [*-vjeçare][9], pesëdhjetëvjeçar [*-vjeçar], trefish [*-fish], shumëfish [*-fish], dashamir [*dash(a)-], dashakeq [*dasha-], automjet [auto + mjet], termostat [termo + stat][10], politeknik [poli + teknik], monosilabik [mono + silabik]* etj.

Sikundër u pa më lart, për të hequr luhatjet e pasaktësitë për këto çështje te fjalëformimi, mendojmë se do të ishte mirë të operohet me tremat *temë e lirë* dhe *temë e lidhur.*

Temë e lirë është ajo fjalë, e cila kumtimin semanatik të saj e ruan, si kur është temë më vete, ashtu edhe kur merr pjesë në formimin e fjalëve të përbëra, ku del njëra nga temat fjalëformuese të kompozitës, psh.: *bashkë* [bashk(ë) + atdhetar], *shumë* [shumë + fish], *vetë* [vetë + besim], *drejt* [drejt + shkrim], *gjithë* [gjithë + popullor], *gjysmë*[11] [gjysmë + shekullor], zë [zë + ëmbël], *dorë* [dorë + heqje] etj.

Tema e lidhur është ajo fjalë, e cila kuptimin e saj e realizon kur del njëra nga temat fjalëformuese të fjalës së përbërë dhe së bashku me një temë tjetër formon kompozitën. Sipas nesh, termi "temë e lidhur" i përgjigjet më së miri emërtimit (konfiks) të temave fjalëformuese të kompozitave, si: **-fish, -vjeçar, poli-, mono-,**

8 ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe, Vëll. 1, Tiranë, 2002, f. 46-47.

9 Yllthi tregon se fjalëforma "vjeçar-e" (dhe të tjera si kjo) është temë e lidhur, sepse kuptimi i saj realizohet vetëm brendapërbrenda kompozitës, p.sh. *pesëvjeçar*. Në Fjalorin e gjuhës shqipe (2006) për fjalën "vjeçar" jepet ky shpjegim: "**-vjeç, -e** *fjalëform*. gjymtyrë e dytë e fjalëve të përbëra, që tregojnë moshën e dikujt e të diçkaje ose kohëzagjatjen e një periudhe etj., p.sh.: këshilla për **tetëmbëdhjetëvjeçarët**; bimë **dyvjeçare**, periudhë **disavjeçare** (shih: *Fjalor i gjuhës shqipe*, 2006, f. 1192). Sikundërqë shihet, fjalori i konsideron këto fjalëforma si tema prodhuese (tema fjalëformuese) të kompozitave, qoftë ato të burimit të shqipes, qoftë ato me burim nga gjuhët e huaja.

10 Kompozita "termostat" [*termo + *stat] përbëhet nga dy tema të lidhura (konfikse) që vijnë nga gjuha e huaj "*termo*" dhe "*stat*". Asnjëra nga këto dy tema nuk kanë kuptim jashtë kompozitës, pra, kuptimin e tyre e realizojnë brenda strukturës së fjalës së përbërë.

11 Fjalët *bashkë, shumë, vetë, drejt, gjithë, gjysmë* i quan fjalori i gjuhës shqipe tema fjalëformuese (fjalëforma) të fjalëve të përbëra, kurse në gramatikën e shqipes këto quhen herë si siparashtesa, herë si sindajshtesa. Kjo shpërputhje e gramatikës me fjalorin tregon paraqet një problem që do zgjidhje për të hequr ngatërrimet e paqartësitë.

termo-, gjeo-, aero-, hidro-, -grafi, -metër, bio-, auto, si p.sh.: *dhjetëfish, dhjetëvjeçar, aerodinamikë, hidrogjeologji, monografi, centimetër, biokimi, autograf* etj. Këto tema prodhuese (fjalëformuese), sipas mendimit tonë, nuk mund të jenë sindajshtesa ose siparashtesa, por *tema të lidhura*.

Në të përfunduar të kësaj kumtese shprehim mendimin tonë se gramatika jonë ka nevojë për teori dhe koncepte të reja gjuhësore bashkëkohore (si sintagmë, kokë leksikore, valencë etj.) dhe konceptet e vjetra (togfjalëshi etj.) duhet t'ua lëshojnë vendin dalëngadalë të rejave, dhe shqipja, ashtu si gjuhët e tjera simotra, të ecë drejt përparimit dhe rritës së saj.

Bibliografia

ASHSH, *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 2006.

ASHSH, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëll. 1, Tiranë, 2002.

Beci, B., *Gramatika e gjuhës shqipe*, EDFA, Tiranë, 2010.

Beqiraj, Xh., *Funkisonet semantiko-sintaksore të mbimerit në gjuhën shqipe*, Mirgeeralb, Tiranë, 2016.

Buxheli, L., *Formimi i foljeve në gjuhën e sotme shqipe*, ASHSH, Tiranë, 2008.

DUDEN, *Die Grammatik, Dudenverlag*, Mannheim – Wien, Zurich, 2009.

Dhrimo, A., Memushaj, R., *Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, Infbotues, Tiranë, 2011.

Hysa, E., *Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe*, Tiranë, SF, nr. 3, 1973.

Zeqirija Ibrahimi

Terminologjia profesionale ndërmjet njësimit dhe përkthimit

Abstrakt

Me mundësinë e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut janë hapur edhe një varg detyrash që kanë të bëjnë me përdorimin e saj të saktë dhe të drejtë.

Në këtë drejtim një ndër temat më të rëndësishme, që shtrohet si detyrë, është përdorimi i terminologjisë përkatëse profesionale. Por, kjo nuk është një detyrë edhe e lehtë. Përkundër ndihmës që ofrojnë fjalorët, të gjendur mes synimin për unifikim dhe prirjes për përdorimin e drejt të gjuhës standarde, gjithnjë krijohen situata të vështira përkthimore.

Kur kemi parasysh se përkthyesit gjithnjë janë të detyruar të udhëhiqen nga gjuha prej së cilës përkthejnë (në rastin tonë maqedonishtja) dhe, njëherazi, ta gjejnë termin e saktë të gjuhës standarde, që është në përdorim zyrtar edhe në Shqipëri, kjo bëhet një dilemë sfiduese: t'i mbetet besnik gjuhës burimore apo përdorimit të gjuhës shqipe. Fjala bie, në Maqedoninë e Veriut e kemi termin "Sluzhben vesnik", që është përkthyer si "Gazeta zyrtare", edhe pse ky emërtim në Shqipëri është "Fletorja zyrtare".

Këtu sigurisht ka shpjegime që kanë të bëjnë me historinë e gjuhës shqipe në kushte të kontaktit me gjuhët sllave, por në mundësinë e re, ne jemi edhe para një detyre të re.

Fjalë çelës: *terminologjia, fjalorët terminologjikë, gjuha e njësuar, përkthimi*

* * *

Para disa viteve, derisa e përgatisja artikullin "Gjuha shqipe mes zyrtarizmit dhe standardizimit", [1] duke i parashtruar detyrat që po na shfaqeshin me mundësinë e zyrtarizmit të gjuhës shqipe edhe në shtetin tonë, puna më shpinte drejt konstatimit se sa është e rëndësishme tema e zyrtarizmit, po aq do të jetë e vështirë edhe detyra e standardizimit. Dhe, kjo çështje çdo ditë e më shumë po bëhet aktuale në ditët tona.

Kështu, me mundësinë e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut,[2] janë hapur edhe një varg detyrash që kanë të bëjnë me përdorimin e saj të saktë dhe të drejtë. Në këtë drejtim, një ndër temat më të rëndësishme, që shtrohet si detyrë, është përdorimi i terminologjisë përkatëse profesionale. Por, kjo nuk është një detyrë edhe e lehtë. Sado që përdorimi i fjalorëve ndihmon mjaft për përdorimin e drejtë të termave, duke u gjendur ndërmjet synimit që terminologjia të jetë sa më e unifikuar me terminologjinë përkatëse të gjuhës standarde shqipe dhe shtrëngimit që ajo të përkthehet nga maqedonishtja, kjo është shndërruar në problem më vete, që para përkthyesve gjithnjë shfaqet si vështirësi.

Gjendja

Secila politikë gjuhësore i ka sfidat e saj. Kur në shtator të 1913-tës për herë të parë gjuha shqipe u bë zyrtare në Republikën e Shqipërisë, sigurisht që problemi i parë ishte se me çfarë standardi gjuhësor do të shkruhej shqipja, ndonëse atëbotë ende ishte temë edhe alfabeti. Dhe, procesi i standardizimit do të zgjaste gjysmë shekulli, ndërsa kodifikimi i terminologjisë është një temë që edhe sot rrjedhë.

Këso sfida ka pasur edhe Kosova, qoftë në kuadër të ish Jugosllavisë, kur ishte mundësuar përdorimi i shqipes në komunikimin zyrtar, por edhe sot. Siç dihet,

1 Shih: Zeqirija Ibrahimi, *Interlinearis*, ITSHKSH, Shkup, 2014, f. 21-31

2 Më 11 janar 2018 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për përdorimin e gjuhëve, që me shënimin e dhënë në kllapa "gjuha shqipe" nënkupton se ai i referohet gjuhës shqipe.

në ish Jugosllavi shqipja ishte e lidhur pandashmërisht me serbishten, ashtu siç ndodhë sot në Maqedoninë e Veriut, ku shqipja është e lidhur pandashmërisht me maqedonishten. Dhe, ashtu siç janë kodifikuar disa terma mbi bazën e serbishtes, të dallueshme nga shqipja standarde në Republikën e Shqipërisë (po kujtojmë këtu termin "Gazetë zyrtare" sipas "Služben vesnik" të serbishtes; në Shqipëri e kemi "Fletorja zyrtare), kjo prirje shfaqet sot edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kështu, megjithëse ligji i ri për përdorimin e gjuhëve e ka mundësuar që gjuha shqipe të përdoret në komunikim zyrtar në shumë institucione të shtetit, duke shënuar zgjerimin më të madh deri më tash, fakti që në Maqedoninë e Veriut as me këtë ligj nuk është ndryshuar modeli i politikës gjuhësore,[3] kjo ka lënë përsëri probleme e mundësi të ndryshme të interpretimit. Siç është e njohur, përdorimi i shqipes zyrtare në Maqedoninë e Veriut është i mundur vetëm krahas maqedonishtes. Kjo nënkupton se gjuha e vetme shtetërore ose kodi i vetëm i komunikimit të shtetit – edhe pas ndryshimeve ligjore – mbetet maqedonishtja, ndërsa shqipja është gjuhë e përkthyer. Duke e ditur se asnjë dokument nuk ka vlerë zyrtare nëse është vetëm shqip, kjo e imponon detyrën që shqipja të jetë gjuhë e përkthyer dhe e përshtatur më gjuhën themelore (maqedonishten). Prandaj përkthyesit gjithnjë janë të detyruar të udhëhiqen nga gjuha prej së cilës përkthejnë (në rastin tonë, maqedonishtja) dhe, njëherazi, ta gjejnë termin e saktë të gjuhës standarde, që është në përdorim zyrtar edhe në Shqipëri (ndoshta edhe në Kosovë). Kjo bëhet pastaj një dilemë sfiduese: t'i mbetesh besnik gjuhës burimore, shpesh edhe duke druajtur për shkak të peshës së fjalës si term, apo ta përdorësh termin e gjuhës standarde shqipe dhe ta ndjekësh praktikën terminologjike në Shqipëri?

Në kohën kur shumë institucione funksionojnë pa përkthyes, me profesorë

3 Maqedonia e Veriut vazhdon të mbetet shtet monolingual, që në mënyrë institucionale e aplikon shumëgjuhësinë, pra që e njeh të drejtën e përdorimit të gjuhëve të minoriteteve. Sipas këtij modeli, shqipja është gjuhë e minoritetit me të drejta të avancuara. Shih: Miquel Siguan, *Jezici u Europi,* "Školska knjiga", Zagreb, 2004, f. 56-57.

të gjuhës shqipe (jo përkthyes të specializuar) ose me përkthyes gjysmë të specializuar (të diplomuar për përkthyes, por pa praktikë dhe trajnime përkatëse), por edhe kur këto institucione përballen me mungesë të burimeve botuese dhe teknologjike, shfaqet rrezik i lartë që përkthimet në gjuhën shqipe të shprehin një gjendje heterogjene, ndërsa terminologjia të jetë e larmishme, madje me mundësi të mëdha edhe të gabimeve.

Një arsye tjetër se pse shfaqen këto probleme terminologjike në Maqedoninë e Veriut është edhe vetë organizimi shoqëror-politik i ndryshëm ose i dallueshëm nga organizimi shoqëroro-politik në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut e gjetiu. Kështu, derisa në Shqipëri është *Drejtoria e Rinisë dhe Sportit*, në Maqedoni të Veriut kjo është *Agjencia e të Rinjve dhe Sportit* (shpesh përkthehet sipas modelit të maqedonishtes *Agjencia për të Rinj dhe Sport*). Këto janë terma që, në një mënyrë, janë detyrimisht të dallueshëm nga përdorimi në Shqipëri. Emërtime të këtilla janë edhe *bashkia, prefektura, komuna* (në Maqedoninë e Veriut përdoren vetëm *qytet* dhe *komunë*), që përdoren për njësi të veçanta administrative e që janë përshkruar sipas ndarjes së njësive të qeverisjes lokale në shtetin përkatës. Prandaj në Maqedoninë e Veriut e kemi emërtimin *Qyteti i Shkupit* (nga Grad Skopje), ndërsa në Shqipëri e kemi *Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës*. Këto janë emërtime që kërkojnë jo vetëm kompetencë gjuhësore, por edhe njohuri themelore të fushës përkatëse.

Megjithatë, ka plot terma të tjerë që kanë ekuivalentë të tyre në gjuhën shqipe, që edhe mund të gjenden nëpër fjalorë terminologjikë, madje herë-herë edhe në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe,[4] por që nuk përkthehen saktë dhe kështu në përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe na shfaqet një gjendje heterogjene në tekstet e ndryshme të përkthyera nga përkthyes të ndryshëm, por që janë aq më shumë të dallueshme në kuptim terminologjik nga tekstet e tilla në Shqipëri e Kosovë.

4 Në FGJSSH ka rreth 13.000 fjalë që shërbejnë terma. Shih: Hëna Pasho, *Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe,* ASA, Tiranë, 2017, f. 41.

Në këtë mënyrë, në vend që shqipja jonë (e ndarë në disa shtete) të ketë frymë konvergjente dhe unifikuese, me përdorimin zyrtar të saj edhe në Maqedoninë e Veriut divergjenca gjuhësore shkon duke u rritur.

Kështu, për shembull, disa nga emërtimet e dokumenteve që përdoren në Shqipëri, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, përkatësisht nga Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë[5] në Maqedoninë e Veriut (maq: Uprava za vodenje na matiçni knigi), janë:

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile[6]	**Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë[7]**
Certifikatë familjare	Çertifikatë lindje
Certifikatë personale	Çertifikatë nga akti i martesës
Certifikatë nga akti i lindjes	Çertifikatë e vdekjes
Certifikatë nga akti i martesës	Çertifikatë ndërkombëtare e lindjes
Certifikatë nga akti i vdekjes	Çertifikatë ndërkombëtare nga akti i martesës
	Çertifikatë ndërkombëtare e vdekjes

Përveç dallimit terminologjik, siç mund të vërehet, kemi edhe devijime drejtshkrimore – është përdorur *çertifikatë* në vend të *certifikatë*. Dhe, nëse kjo ndodhë në institucionin themelor të evidencës amë, që është drejtoria e cila duhet ta prodhojë terminologjinë e saktë, mund të merret me mend se çfarë larmie kemi nëpër institucionet e tjera. Fjala bie, në ueb-faqen e Ministrisë së Jashtme të RMV-së gjetëm "Certifikatë nga Libri amë i të lindurve"[8], ku e kemi të saktë fjalën *certifikatë*, por jo edhe emërtimin e dokumentit që merret për ta regjistruar lindjen (*Certifikatë nga akti i lindjes*).

Shembuj të këtillë kemi plot, madje me një hulumtim të vogël mund të ilustrojmë

5 *Vodenje* është përkthyer si *udhëheqje*, edhe pse kuptimi themelor është *regjistrim/evidenc*ë.
6 Shih: https://akshi.gov.al/33-dokumentet-qe-nuk-kerkohen-me-ne-sportelet-shteterore/ (12.12.2021)
7 Shih: https://uvmk.gov.mk/sq/dokumente/ (12.12.2021)
8 Shih: https://www.mfa.gov.mk/sq/page/450/dokumentet-e-udh%C3%ABtimit (12.12.2021)

edhe plot raste të tjera të gjendjes heterogjene terminologjike. Kjo na bën të konstatojmë se përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe, përveç temës së përdorimit të drejtë të shqipes, pra të normës gjuhësore, që me gjithë devijimet e aty-këtushme, mund të pranohet, problem më vete mbetet norma terminologjike që mbetet një çështje që lë shumë për të dëshiruar. Në të vërtetë, ashtu siç thotë prof. Miço Samara, derisa për normën gjuhësore mjafton fjalori shpjegues (FGJSSH), Drejtshkrimi i gjuhës shqipe dhe Fjalori drejtshkrimor, për normëzimin terminologjik të fjalës nevojiten fjalorët terminologjikë.[9]

Prandaj, përdorimi i saktë i një termi nuk është çështje që zgjidhet duke i parë vetëm fjalorët dygjuhësh shqip-maqedonisht ose anasjelltas, por duhet të kihet parasysh edhe FGJSSH, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe e Fjalori drejtshkrimor, por në veçanti duhen parë fjalorët terminologjikë. Siç dihet tashmë, në gjuhën shqipe janë hartuar mbi 30 fjalorë terminologjikë, që kanë përfshirë diku mbi 60.000 terma.[10]

Ndonëse këta fjalorë nuk janë të mjaftueshëm, sepse terminologjia zaten është një fushë që nuk shteron kurrë, megjithatë ata janë një korpus i madh gjuhësor që flet për një lëvrim jo të vogël gjuhësor. Ajo që mungon në këtë rast, veçmas kur flasim në kontekst të Maqedonisë së Veriut, është se këta fjalorë mungojnë nga raftet e përkthyesve, madje edhe sikur diku të gjenden, është e pamundur që ata të jenë të dorë të të gjithë përkthyesve nëpër zyrat shtetërore ku zhvillohet përkthimi në gjuhën shqipe.

Përveç kësaj, kur dihet se terminologjia është një fushë që duhet njësuar, pastruar dhe zgjeruar e pasuruar në vazhdimësi,[11] vërejmë se institucionet shkencore të gjuhës shqipe në shtetet tona duhet të kenë një detyrim të lartë. Madje, për të qenë deri në fund korrektë, këtë detyrë nuk mund ta përmbushin vetë as ata institucione,

9 Shih: Miço Samara, *Leksiku politik e shoqëror në gjuhën shqipe,* ASHA, Tiranë, 2008, f. 187.
10 Hëna Pasho, vep. e cit, f. 10.
11 Po aty, f. 9.

sepse kjo kërkon fonde mbështetëse për hulumtim e regjistrim, por edhe fonde për mbështetje të veprimtarisë për ta avancuar përdorimin e teknologjisë në këtë funksion.

Disa nga detyrat e këtilla i ka përshkruar edhe prof. Jani Thomai në veprën "Studime për gjuhën shqipe I – Leksiku, fjala dhe leksikologjia",[12] ndërsa duke e pasur parasysh nevojën e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut, ne i kemi plotësuar këto detyra edhe me disa të tjera. Ka disa detyra që vlejnë në mënyrë specifike për institucionet e RMV-së, por shumica e tyre janë detyra që duhet t'i përmbushin bashkërisht edhe institucionet shkencore, arsimore dhe shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës. Detyrat e këtilla janë:

Rishikimi dhe plotësimi i fjalorëve terminologjikë që janë botuar deri më tani. Meqë fjalorët terminologjikë kanë filluar të botohen që nga vitet e '50-ta e deri në ditët tona, ndërsa terminologjia ndërkohë ka evoluar, specialistët e gjuhës dhe të fushave përkatëse terminologjike duhet t'i rishikojnë fjalorët terminologjikë, ata duhet pasuruar me termat e rinj dhe duhet gjetur mundësinë e botimit ose, së paku, të digjitalizimit të tyre.

Regjistrimi i termave të rinj, që futen në përdorim çdo ditë dhe kërkimi i ekuivalentëve të saktë në gjuhën shqipe. Këtë detyrë, më shumë se gjuhëtarët, duhet ta bëjnë specialistët e fushave gjegjëse.

Hartimi i fjalorëve shumëgjuhësh terminologjikë. Përveç me gjuhët më të rëndësishme botërore, për përkthyesit dhe nevojat shqipes në Maqedoninë e Veriut nevojiten fjalorë terminologjikë shqip-maqedonisht dhe anasjelltas.

Siç thotë prof. Thomai, duhet të kemi një komision kombëtar të terminologjisë, që e bën njësimin e terminologjisë. Detyra e tij do të ishte të bëjë vëzhgimin e termave dhe gjetjen e termit të saktë për nocionin përkatës.

12 Jani Thomai, *"Studime për gjuhën shqipe I – Leksiku, fjala dhe leksikologjia"*, ASHA, Tiranë, 2017, f. 432-433.

Hartimi i fjalorëve terminologjikë që mungojnë. Në planin gjithëkombëtar kjo është detyrë e të gjitha institucioneve arsimore dhe shkencore, ndërsa në Maqedoninë e Veriut na mbetet për detyrë që ta mbledhim terminologjinë e përgjithshme që është në përdorim zyrtar dhe ajo të përkthehet drejt në gjuhën shqipe. Ky korpus, qoftë në formë digjitale ose të shtypur, duhet të jenë në dorë në përkthyesve.

Krijimi i korpusit elektronik gjuhësor dhe terminologjik të gjuhës shqipe. Qeveritë e Republikës së Shqipërisë, Kosovës, por edhe ajo e Maqedonisë së Veriut, duhet të ndajnë buxhet të caktuar për krijimin e korpusit elektronik gjuhësor dhe terminologjik të gjuhës shqipe. Kjo do të nënkuptonte që të gjithë fjalorët e deritanishëm të shqipes dhe materialet e tjera të rëndësishme gjuhësore të përfshihen në një platformë digjitale. Kjo platformë do të duhej të mundësonte që, përmes mundësisë së kërkimit të fjalës, të mund ta gjejë fjalën përkatëse dhe ajo të dalë në shembuj të përdorimit (shprehje frazeologjike dhe terminologjike), ndërsa të kihet mundësi që aty të përkthehet edhe në gjuhë të tjera (edhe maqedonisht). Po ashtu, në atë platformë, fjalët terma duhet ta kenë edhe shpjegimin e tyre dhe saktësimin e përdorimit të drejtë. Në këtë mënyrë, përveç që do të kursehen shpenzimet për shtyp, por edhe hapësirat për vendosje të krejt atyre veprave, do të mundësohej që secili përkthyes, kudo që përkthen, të ketë mundësi që ta verifikojë termin përkatës para se ta përkthejë atë. Kjo detyrë është shndërruar në mision të institucioneve shkencore, arsimore e politike. Në Maqedoninë e Veriut kemi burime njerëzore dhe institucionale që mund ta bartin pjesën e tyre të përgjegjësisë, por kjo kërkon një buxhet relativisht të lartë që të mbulohet si detyrë. Por, duke e pasur parasysh se tashmë ekziston Agjencia për Zbatimin e Gjuhës,[13] si dhe Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve, ka mundësi reale që ato të

13 Emërtimi zyrtar është Agjencia për Zbatimin e Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

kërkojnë buxhet që do ta mbulojë përmbushjen e një projekti të tillë. Megjithatë, pa angazhimin dhe pjesën e punës shkencore të institucioneve të Shqipërisë dhe Kosovës, kjo detyrë bëhet shumë e vështirë.

Marrë në përgjithësi mund të konkludojmë se përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut luhatet mes njësimit dhe standardizimit. Në kohën kur para nesh shfaqet mundësia përdorimit zyrtar të shqipes, derisa flasim për terminologjinë, ne gjendemi mes dy tërheqjeve – përkthimi të termit duke e përkthyer atë ose përdorimit të termit duke e njësuar me termin përkatës në përdorim zyrtar në Republikën e Shqipërisë. Meqë kjo është një detyrë që nuk mund të ketë zgjidhje të menjëhershme dhe përmes një veprimi, ne i kemi radhitur disa nga detyrat që duhet të bëhen, duke shënuar edhe se kush janë institucionet që duhet ta ndërmarrin atë veprim.

Ne jemi të vetëdijshëm se këto probleme janë më të vogla në Shqipëri dhe në Kosovë, por në Maqedoninë e Veriut kjo është shndërruar në detyrë madhore shkencore dhe institucionale e shqiptarëve. E meqë shqiptarët në RMV nuk kanë mjaft kapacitete – as në kuptimin shkencor e as në atë institucional shtetëror – që këtë detyrë ta përmbushin vetë, kjo detyrë duhet të shihet si mision kombëtar për ta mbrojtur dhe kultivuar shqipen e përbashkët standarde.

Bibliografia

Ibrahimi Zeqirija, *Interlinearis*, ITSHKSH, Shkup, 2014

Pasho Hëna, *Probleme gjuhësore të terminologjisë në gjuhën shqipe,* ASA, Tiranë, 2017

Samara Miço, *Leksiku politik e shoqëror në gjuhën shqipe,* ASHA, Tiranë, 2008

Siguan Miquel, *Jezici u Europi*, "Školska knjiga", Zagreb, 2004

Thomai Jani, *"Studime për gjuhën shqipe I – Leksiku, fjala dhe leksikologjia"*, ASHA,

Tiranë, 2017

https://akshi.gov.al/33-dokumentet-qe-nuk-kerkohen-me-ne-sportelet-shteterore/

https://uvmk.gov.mk/sq/dokumente/

https://www.mfa.gov.mk/sq/page/450/dokumentet-e-udh%C3%ABtimit

SHTOJCË

Ali Pajaziti*

Odiseja e shqipes në RMV: 1946-2021

"Kufijtë e gjuhës time janë kufijtë e botës time."

Ludwig Wittgenstein

Hyrje

Sipas *Encyclopedia Britannica* (2021) gjuha paraqet një sistem të simboleve konvencionale të shpërfaqura gojarisht, përmes gjestikulacioneve ose shkrimit, nëpërmjet të cilave qeniet njerëzore, si anëtarë të një grupi social dhe si pjesëmarrës në kulturën e saj e shprehin vetveten. Gjuha është një indikator i dukshëm dhe i fuqishëm i identitetit, një nga elementet në bazë të të cilëve definohemi nga të tjerët (Deng, 1995: 1 në Fearon, 1999: 4), apo siç shprehet Taylor-i, një nga burimet e vetes-unit *(sources of the self)*. Ajo është kujtesë dhe informacion për mijëra vite të gjallërimit kulturor, është "thesar që e ndjek njeriun gjithandej" (thënie kineze), është "korridor për jetë" (Smith). Sipas "Ethnologue online", në vitin 1996 në botë kanë ekzistuar 6912 gjuhë, prej të cilave rreth 3000 kanë qenë të rrezikuara me zhdukje (UNESCO), kurse në vitin 2021 në botë përdoren 7139 gjuhë, prej të cilëve 40 % janë në rrezik, me më pak se 1000 folës. Neni 5 i Deklaratës Universale mbi Diversitetin Kulturor thekson se "të gjithë njerëzit mund të shprehin, krijojnë dhe të përhapin krijimet e tyre në gjuhën e përzgjedhur nga vetë ata, në veçanti në gjuhën amtare; të gjithë njerëzit duhet të gëzojnë të drejtën për arsimim dhe trajnim cilësor me respekt të plotë të identitetit kulturor". (Lenore & Lindsay, 2006: 2)

* Prof. Dr. Universiteti i Europës Juglindore, Shkup; Universiteti "Shën Klementi i Ohrit", Manastir.

Shqipja, diversitetet dhe RMV-ja

Gjuha shqipe, si një degë e veçantë e familjes indo-europiane të cilën e flasin më tepër se gjashtë milionë njerëz, në *Maqedonitë* historike, nga ajo osmane, e ASNOM-it (KAÇKM), e pavarësisë (1991), deri te e Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001 e më pas, ka përjetuar batica dhe zbatica, sfida të shumta që kanë të bëjnë me të drejtat themelore të qytetarit, të cilat nga regjimet e ndryshme shpesh janë shkelur deri në mënyrën më brutale. Si rrjedhim, përpjekja shqiptare për të mbajtur gjallë, për të kultivuar dhe krijuar shqip – shpesh paguar edhe me gjak - shënon një kontinuitet që arrin deri më sot. Para disa ditëve dritën e publikimit e pa edhe një vepër që merret me çështjen e shqipes nga një perspektivë tjetërfare, juridiko-kushtetuese, normative por edhe nga ajo sociologjike: Ylber Sela et.al, *Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019,* Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, Shkup, 2021, 184 fq.. Ky punim në fokus ka edhe vijën historike por edhe atë më të re, aktuale, pas 2001-shit dhe miratimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve të vitit 2019. Në këtë studim shkencor trajtohet statusi i gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut si një vend me shumë ngjyra kulturore, multikulturore, që përballet me problemin e menaxhimit të diversiteteve, që një kohë të gjatë ka jetuar nën ndikimin e dëshirës monoetnike, apo të ndërtimit të shtetit etnocentrik, nacional, të mishëruar në etnikumin apo bashkësinë më të madhe, atë maqedonase, lidershipi politik i së cilës që nga periudha jugosllave e deri në vitin 2001 përmes mekanizmave politikë, në këtë ose në atë mënyrë, ka shpërfillur ose ka ekskomunikuar kulturat tjera, përfshirë edhe dimensionin gjuhësor ose u ka dhënë atyre hapësirë minimale për eksponim, shpesh edhe duke i shtyrë të luftojnë për mbijetesë kulturore.

Vepra në fjalë përbëhet nga tre kapituj (I. "Rendet kushtetuese dhe të drejtat gjuhësore e kulturore të shqiptarëve ndër vite", II. "Të dhëna empirike mbi

realizimin e të drejtave gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve në periudhën 1946-2001", dhe III. "Statusi i gjuhës shqipe *de jure* dhe kontestimet kushtetuese të tij)", shoqëruar edhe me tre shtojca.

Odisejada e gjuhës shqipe në Maqedoni filloi me një koncept multietnik të "Kushtetutës për organizimin e ardhshëm shtetëror të Maqedonisë të vitit 1880" (neni 3), e panjohur deri sot për opinionin, që nisej nga parimi shumë kombe-një shtet, e ngjashme me frymën e shtetit demos të KAÇKM-së (ACHOM, 1944) që i njihte të drejtat kolektive, theksonte se sovraniteti i takon "popullit të Maqedonisë" (f. 17), që lejoi hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Dokumenti i vitit 1880 ishte i afërt me perspektivën e Marrëveshjes Kornizë që solli deetnizimin e shtetit, "Maqedoninë e Tretë" (e para 1944-1991, e dyta 1991-2001 dhe e treta 2001 e këndej), frymë dhe kulturën e tolerancës ndaj tjetrit, qasje më liberale ndaj jomaqedonases etnike. Një analist shqiptar thekson se përdorimi institucional i shqipes në Maqedoni daton nga viti 1941 (gusht-shtator) kur territore të caktuara të Banovinës së Vardarit të banuara me shqiptarë, ishin vënë nën juridiksionin e Italisë, gjegjësisht të qeverisë së Shefqet Verlacit (Nesimi, 2019: 183). Kushtetuta e vitit 1946 dallohej me përkufizim republikan të shtetit, por edhe me mossanksionim taksativ të përdorimit të gjuhës shqipe dhe të atyre të komuniteteve të tjera. Sipas autorëve të *Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019* kushtetuta e vitit 1963, të cilës i shtohet preambula, etnicizohet, stratifikon (shtresëzon) entitetet, thekson "aspiratën historike të popullit maqedonas për liri kombëtare dhe pavarësi shtetërore", duke i vënë në pozitë dytësore të tjerat, të cilave iu referohet si pakica kombëtare. Diskriminimi ishte evident edhe përkundër neneve 73 dhe 75 që shprehin nuanca fleksibiliteti për përdorimin e gjuhëve. Ndryshim pozitiv në Maqedoninë socialiste solli kushtetuta e vitit 1974 që e avancoi statusin kushtetues juridik të shqiptarëve dhe të turqve të cilët i cilësonte si subjekte konstituive bashkë

me maqedonasit (f. 32), duke i mbiquajtur si kombësi *(националности)* dhe duke i dhënë çdo kombësie të drejtën për të përdorur lirisht gjuhën e vet, për të zhvilluar kulturën e vet (neni 178). Qasja destrukive dhe ekskluziviste sërish do të shfaqet në skenë me gjallërimin e shovinizmit serb; në vitin 1989 ndodhi i ashtuquajturi "agresion kushtetues" (amendanmentet XXIV deri LV) kur u degraduan të drejtat kushtetuese të shqiptarëve, kur Republika Socialiste e Maqedonisë u definua si shtet vetëm i kombit maqedonas dhe kur gjuha maqedonase dhe alfabeti cirilik u bënë të vetmit në përdorim zyrtar në shtetin e zënë në gojë, "rërë e gjallë" kjo në të cilën establishmenti maqedonas do të thellohet me "gabimin e madh" (S. Andov) të kushtetutës së vitit 1991, që u miratua pa përkrahjen apo pa aprovimin shqiptar.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MKO): Ndryshime cilësore në përdorimin e shqipes

Akti i fundit (Kushtetuta e 1991-shit), që afirmonte *sovranitetin etnik,* do të jetë "uverturë" për kalimin në gjendjen e shoqërisë së tensionuar në baza etnike, ku dy etnitë më të mëdha, maqedonasit dhe shqiptarët do të kenë dialektikë, përplasje për shkak të diskriminimit dhe pakënaqësisë së shqiptarëve lidhur me statusin e tyre, klimë kjo që do të çojë deri te konflikti i vitit 2001, pas të cilit me ndërmjetësimin ndërkombëtar përmes MKO-së do të synohet krijimi i një Maqedonie te re, të hapur, multietnike, pa hierarki statusore të bashkësive që jetojnë në këtë nënqiell. Kjo frymë e demokracisë konsensuale, përmes Aneksit A, B dhe C solli ristrukturimin e shtetit, akomodimin e kërkesave themelore të palëve, ndonëse preambula, si "korridor i madh hyrës në kështjellën e kushtetutës" (f. 96), që popullin maqedonas e përkufizon si etnos (komb) kurse shqiptarët dhe të tjerët si pjesë të popujve dhe disa elemente të tjera si gjuha shqipe (as MKO nuk parasheh barazinë gjuhë maqedonase-gjuhë shqipe), himni dhe flamuri, mbeten

ende kontestuese dhe të hapura për diskutim dhe kritika.

Në hulumtimin *Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019* jepet edhe një pasqyrë e institucioneve arsimore dhe kulturore që kanë mbajtur barrën kryesore të gjuhës shqipe dhe "produkteve" të saj nga periudha e pasluftës deri në vitet e demokracisë dhe të tranzicionit: Flaka e Vëllazërimit, shkollat si "Liria" (Shkup, Tetovë), Zef Lush Marku, Kiril Pejçinoviq, Rexhep Voka, Hajdar Dushi, Fakulteti Pedagogjik, RTVM-shqip (gjuha shqipe për herë të parë është dëgjuar në radio më 1944-Radio Shkupi, kurse në televizion më 1967, TV Shkupi, kronika javore televizive), tre universitetet (USHT - 1994, UEJL-2001 dhe "Universiteti Nënë Tereza" -2016), Teatri Shqiptar (1950), ITSHKSH (2007), shoqatat kulturore artistike etj.

Autorët theksojnë se me ndryshimet kushtetuese të Marrëveshjes Kornizë mes tjerash u avancua përdorimi i gjuhës shqipe si në territorin e RMV-së ashtu edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, në njësitë e vetëqeverisjes lokale (shih amendamenti V, VI, VIII), ndonëse gjuha në fjalë është kategorizuar si gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve. Në këtë drejtim duhet përmendur edhe Ligjin e përdorimit të gjuhës të vitit 2008 (Ligji për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal) dhe 2011 që rregullonte përdorimin e shqipes në Kuvend, në komunikimin e qytetarëve me ministritë, te Avokati i Popullit, në librat e amzës, autoritetet policore, aktivitetet financiare, arsim, shkencë, kulturë etj. Në tekst konstatohet se gjuha shqipe është zyrtare në 5 rajone, në 26 komuna dhe në Qytetin e Shkupit. Pyetësorit që AZGJ e ka realizuar lidhur me statusin e shqipes mes viteve 1991-2019 i janë përgjigjur 17 komuna, por edhe ato me shumë mangësi (në disa pyetje nuk kanë dhënë fare përgjigje). Nga ky studim del se gjuha shqipe zyrtarizimin më të hershëm e ka parë në Komunën e Tetovës (1992), ndjekur nga ajo Tearcës

dhe Jegunovcës (1997) dhe e Dibrës (2003). Në RMV deri më 2019 qytetari shqiptar ka pasur të drejtën për komunikim me organet në gjuhën e vet, kurse shqipja ka qenë zyrtare me kapacitet të plotë në territorin e njësive të vetadministrimit lokal (Nesimi, 215). Ligji i Përdorimit të Gjuhëve i vitit 2019 (që ngërthen 25 nene), i kontestuar nga politikanë, profesorë universitarë, akademikë maqedonas, ish-presidenti Ivanov (veto-pezulluese), i shpallur në "Gazetën Zyrtare" të datës 14 janar 2019, i detyroi instiucionet ta zyrtarizojnë shqipen, ndërkohë duke ndërgjegjësuar edhe publikun lidhur me këtë segment, që sanksionon përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe alfabetet e tyre. Me nenin 18 është themeluar Agjencia e Zbatimit Gjuhës si person juridik, kompetent për standardizimin dhe përdorimin uniform të gjuhës që e flasin së paku 20% të qytetarëve të RMV-së. Me nenin 20 të këtij ligji krijohet edhe Inspektorati i Përdorimit të Gjuhëve në suaza të Ministrisë së Drejtësisë që mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, që mbron frymën kushtetuese në funksion të sigurimit të sundimit të së drejtës dhe të realizimit të lirive dhe të të drejtave të njeriut dhe qytetarit. Autorët theksojnë se zbatimi i plotë i këtij ligji është gurthemeli për ndërtimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike me karakter multietnik dhe shumëgjuhësor.

Gjendja në terren: Studim empirik

Ligji i vitit 2019 e avancon përdorimin e shqipes, por nuk e barazon atë me maqedonishten. Nga studimi empirik i realizuar nga AZGj-ja me 183 institucione është konstatuar një gjendje për të dëshiruar në aspekt të trajtimit të gjuhës shqipe: vetëm 48 institucione (26 %) janë përgjigjur edhe në gjuhën maqedonase edhe në atë shqipe, ndërsa 131 (72 %) vetëm në gjuhën maqedonase dhe 4 vetëm në gjuhën shqipe (2 %); 135 institucione (74 %) nuk kanë paraparë sektor dhe njësi të përkthimit nga gjuha shqipe dhe të lekturës, vetëm 76 institucione janë shprehur

se parashohin ndryshim në sistematizimin e vendeve të punës, 124 institucione (68 %) nuk kanë të punësuar asnjë përkthyes apo lektor; në buxhetin e vitit 2020 vetëm 43 institucione kishin paraparë mjete financiare për përkthyes dhe lektorë të rinj, vetëm 27 institucione (14.7 %) janë shprehur se kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së (63 syresh "nuk kanë nevojë")(f. 124-126). Mund të thuhet se "përpjekja" për përligjjen faktike të shqipes vazhdon, se Ligji për Përdorimin e Gjuhëve dhe AZGj-ja janë agjentë relevantë në avancimin e zbatimit të shqipes dhe të kulturës shqiptare në RMV, dhe se bashkëpunimi mes politikëbërësve, akademisë, OJQ-ve, qytetarëve, mund të çojë shumë përpara kultivimin dhe mbrojtjen e shqipes në këtë vend dhe shoqërisë post-etnike, shumëkulturore, shumidentitare. Agjenda e ardhshme duhet të jetë kalimi definitiv nga shifra "20%" te kategoria "gjuha shqipe". Në këtë drejtim duhet mobilizim kolektiv i të gjitha instancave, që evoluimi të arrijë pikën e duhur, te akceptimi transparent i gjuhës së bashkësisë së dytë për nga numri në këtë shoqëri. Shikuar sociologjikisht, averzionet duhet të mbeten në histori; mendjehapuria, respekti i tjetrit dhe tjetërsisë është e ardhmja e njeriut të shekullit XXI.

Konkluzion(e)

Sipas Emile Durkheimit, gjuha dhe mënyra e të shprehurit të njerëzve përcaktohen nga shoqëria në të cilën ata jetojnë (Pajaziti, 2009: 137); gjuha dhe dija formojnë bazën e fuqisë për ndërtimin shoqëror të realitetit (Jacoby, 2006: 292-297). *Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të viti 2019* paraqet një punim relevant shkencor, një dritare nga e cilat mund të shihet realiteti sociologjik dhe kulturologjik i Maqedonisë së Veriut dhe pozita e shqiptarëve dhe shqipes (por edhe të elementeve të tjera etnike-kulturore) në të brenda 65 viteve të fundit. Është një libër leximi për studentët dhe studiuesit e shkencave sociale,

në veçanti për juristët, gjuhëtarët, sociologët, politologët e shumë profile të tjera akademike e studimore, por edhe për lexuesit ordinerë që kërkojnë më tepër dije për relacionin gjuha-shoqëria dhe shteti-gjuha-bashkëjetesa. Në fund, do theksuar se AZGJ-ja paraqet një institucion relevant në kultivimin e identitetit gjuhësor dhe kulturor shqiptar në RMV, që me veprimtarinë e vet lë gjurmë të dukshme në historinë tonë moderne.

Bibliografia

CRYSTAL, D. (2021). 'Language", *Encyclopedia Britannica*, 17.10.2021.

FEARON, J. D. (1999). *What is identity (As we now use the word)?.* Stanford University.

GRENOBLE, L. A. & Whaley, L. J. (2006). *Saving Languages: An Introduction to Language Revitalization.* Cambridge University Press.

JACOBY, E. (2006). *Filozofët: Filozofët më të mëdhenj të kohërave. Tiranë:* Botimet Max.

NESIMI, M. (2019). *Shqiptarët e Maqedonisë dhe ardhmëria e shtetit*. Ministria e Kulturës e RMV-së, Tetovë.

PAJAZITI, A. (2009). *Fjalor i sociologjisë.* Shkup: Logos-A, UEJL.

SELA, Y. et.al (2021). *Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019.* Shkup: Agjencia e Zbatimit të Gjuhës.

https://www.sfu.ca/lovemotherearth/08classroom/papers/importance_of_language.pdf, 28.11.2021.

https://www.ethnologue.com/guides/how-many-languages, 19.12.2021.

Liljana Pandeva

Përkitazi me përmbledhjen

Paraqitja e kësaj përmbledhjeje kërkon analizë të thellë dhe të barabartë, siç janë në fakt edhe punimet e emrave eminentë të fushës së albanologjisë dhe të linguistikës në përgjithësi, gjithsesi të mbështetura me dëshmi shkencore, argumente, por edhe fakte historike.

Para së gjithash, do të doja të them se kjo përmbledhje paraqet vepër pune ekipore të të punësuarve në AZGj-në.

Nga Konferenca e mbajtur në dy ditë pune, dolën hiç më pak e hiç më shumë, por saktësisht njëzet punime shkencore.

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës, në pajtim me dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, më saktë të Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës, përmbledhjen e punimeve e botoi në tri gjuhë: në maqedonisht, në shqip dhe në anglisht. Para nesh janë, do të përsëris, këto tri botime, të mrekullueshme në dizajn, por edhe më të pasura në përmbajtje. Shpresoj dhe jam e sigurt se edhe nga kjo konferencë, vitin tjetër do të promovojmë një përmbledhje punimesh më të pasura, më cilësore dhe sasiore.

Por, t'i rikthehemi përmbledhjes aktuale, në të cilën si autorë punimesh paraqiten emra eminentë, profesorë dhe punonjës shkencorë nga më shumë universitete të vendit dhe më gjerë, nga Republika e Shqipërisë, nga Kosova, edhe nga Austria, pa pjesëmarrjen e të cilëve konferenca nuk do të arrinte qëllimin e vet – celebrimet në gjuhën amtare, me vështrim të veçantë ndaj zbatimit të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si gjuhë e dytë zyrtare.

Në atë kontekst janë edhe numri më i madh i punimeve, të cilët trajtojnë tema të lidhura me përdorimin institucional të gjuhës shqipe, nga aspekti diakronik

edhe nga ai sinkronik. Punimi i Bashkim Selmanit niset nga përpjekjet e para të bashkësisë shqiptare në administratën lokale për zbatimin e saj gjatë komunikimit të përditshëm me qytetarët, e deri përdorimi i saj në nivel qendror me miratimin e Ligjit të Zbatimit të Gjuhës, përmes një pasqyre historiko-juridike. Ngritja e vetëdijes publike, sipas tij, për përdorimin e gjuhës amtare është me rëndësi kryesore për "shoqërinë e qëndrueshme, siç është e jona". Punimi i përbashkët i Demush Bajramit dhe i Emin Azemit, gjithashtu, e thekson përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mosmarrëveshjet rreth zbatimit të saj, por edhe cenimin e ligjit të përdorimit të saj, duke e potencuar pikërisht tekstin e ligjit, sipas tyre, juridikisht nuk e përcakton atributin që duhet të posedojë gjuha kombëtare në raport me folësit e saj. Prej këtu, buron qëndrimi i tyre se, statusin gjuhësor nuk e zgjidhin linguistët dhe ekspertët e politikës gjuhësore, por politikanët dhe pushteti. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se nuk ka cenime gjatë përdorimit të gjuhës shqipe në sistemin juridik. Përkundrazi, në komunikimin juridik, saktësisht nëpër gjykata, kjo është e pashmangshme. Si shoqëri multietnike duhet të bëjmë përpjekje për të drejtat e barabarta në përdorimin e gjuhës së pakicave, për të cilën propozojnë plan aksionar nga ana e qeverisë, me të cilin do të rishqyrtohej zbatimi ligjor i gjuhës shqipe.

Emil Lafe dhe Jusuf Zejneli, problemet me të cilat ballafaqohet gjuha letrare shqipe në RMV në rrethanat e dygjuhësisë zyrtare, i quajnë sfida. Përmes një prizmi historik e vështrojnë zhvillimin dhe përdorimin e gjuhës shqipe nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore, në hapësirat e ish-Jugosllavisë, deri më sot, gjithsesi me vështrim të veçantë në zbatimin e saj në RMV, kështu që Lafe e thekson rolin e rëndësishëm që në këtë kontekst e merr dhe e ka AZGj-ja. Ndërsa, Zejneli më shumë fokusohet te ndryshimet kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në raport me statusin e gjuhës shqipe. Duke biseduar për statusin e gjuhës shqipe në

RMV, Lafja tregon për dy vështirësi që duhet të tejkalohen: ndikimi i të folurave lokale dhe ndikimi i gjuhës maqedonase mbi strukturat sintaksore dhe gjuha zyrtare e burokracisë. Duke theksuar se ndikimi i gjuhës maqedonase është edhe i kuptueshëm edhe i madh, sidomos te tekstet e përkthyera, por se ka mundësi që në hapat e para gjatë çrrënjosjes së tyre, duhet të veprojnë mediat elektronike edhe ato të shtypit. Në punimin me titull "Gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut – gjuha e njëzet përqindëshit", Haki Ymeri më shumë fokusohet te shkalla e diskriminimit të gjuhës shqipe, përmes një aspekti diakronik, që fillon në kohën e ish-shtetit socialist deri sot, kështu që përcaktimi i 20% të qytetarëve që e flasin atë gjuhë (vërejtja jonë: shqipja) është edhe i pasaktë edhe diskriminues, "duket qesharak dhe ofendues". Zejneli tregon për zbatimin praktik të gjuhës, parregullsitë, por edhe për atë se duhet të rritet roli i Inspektoratit të Gjuhëve, me çka, në ndonjë mënyrë do të zbatohen edhe dispozitat përkatëse ligjore.

Edhe Qemal Murati, përveç se teorikisht ndalet te gjuha amtare, jep shembuj të shkëlqyer nga përdorimi i përditshëm i gjuhës shqipe në jetën shoqërore, me vështrim të veçantë të frazeologjisë, ku si pjesë e shkencës së gjuhës është më specifike kur bëhet fjalë për përkthim nga njëra gjuhë në tjetrën.

Rami Memushaj në boshtin e punimit të tij i ka standardet e dyfishta të dygjuhësisë së Ballkanit, që gjithsesi nuk duhet të ekzistojnë as të qëndrojnë, përkatësisht, thotë se paradigma e asimilimit duhet të ndryshohet me paradigmën e bashkëjetesës së të dy etnikumeve kryesore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Ndërsa, Izer Maksuti, statusin e gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut e rishqyrton përmes prizmit të Tirolit Jugor dhe të Belgjikës, siç janë në rajonet kryesore të jetës shoqërore: shërbime publike, administrata publike, në gjykatat, në ushtri dhe në polici, në institucionet shëndetësore, përkatësisht

sipas modelit të politikës gjuhësore të Tirolit Jugor, që vlen si një nga më të përsosurat në Europë, me të drejtat absolute të përdorimit të gjuhës amtare të të gjitha bashkësive etnike, sidomos në gjuhën gjermane, italiane dhe ladine. Ndërsa shembulli i gjuhëve zyrtare në Belgjikë si shtet i tri gjuhëve është ndryshe: secili rajon ka vetëm një gjuhë zyrtare dhe kombëtare, me përjashtim të Brukselit si qendër kryesore administrative. Prej këtu, këto dy modele të politikës gjuhësore në Itali dhe në Belgjikë mund të merren si shembuj për zgjidhjen e konflikteve gjuhësore dhe ai nxjerr përfundim se me një politikë më të mirë, të barabartë gjuhësore, duke mbështetur dygjuhësinë, do të mundësohet bashkëjetesë më e qetë me njëri-tjetrin.

Për sfidat me të cilat ballafaqohet gjuha shqipe, flet edhe Mimoza Kore në punimin e saj. Me shembuj praktikë ajo tregon për gabimet që bëhen gjatë përkthimit, me përdorimin e papërshtatshëm të rasave, me të shkruarin e gabuar të emrave personalë, me përdorimin e konstruksioneve gjuhësore që nuk janë në pajtim me gramatikën shqiptare etj. Njëkohësisht, thekson se kjo është normale, nëse kihet parasysh distanca e maqedonishtes me shqipen nga pikëpamja linguistike dhe afërsinë e këtyre dy gjuhëve, nga aspekti territorial dhe sinkronik.

Për politikën gjuhësore në Tirolin Jugor, në punimin e saj flet edhe Klara Kranebiter, e cila vjen drejtpërdrejtë nga vendndodhja, përkatësisht nga Tiroli i Jugut, saktësisht nga Qendra Hulumtuese - EURAC në Bolzano. Përveç historikut të shkurtër për krahinën e Tirolit të Jugut dhe përdorimin e më shumë se një gjuhe kombëtare, në punimin e saj me mjaft shembuj plastikë njihemi me mënyrën e punës dhe me mbushjen e data-bazës me terminologjinë e të gjitha sferave shoqërore në tri gjuhë, që janë në përdorim të asaj krahine. Pikërisht veprimtaria terminologjike të EURAC-it është me interes të madh për ne, saktësisht për të punësuarit e AZGj-së si përkthyes dhe lektorë, për shkak se ballafaqohen me një

mungesë të madhe të zgjidhjeve terminologjike. Platforma Bistro e EURAC-ut i plotëson ato zbrazëtira në Tirolin e Jugut. Në punim janë dhënë, siç treguam, shembuj se si, me çfarë intensiteti dhe nga cilat krahina gjuhësore plotësohet përditë terminologjia e Tirolit të Jugut.

Me punimin e Kranebiterit lidhet edhe Zeqirija Ibrahimi, i cili bën krahasim mes politikës gjuhësore në RMV me politikat gjuhësore europiane. Si shembull i jep politikat gjuhësore të Mbretërisë së Spanjës, të Mbretërisë së Bashkuar, të Konfederatës së Zvicrës, të Republikës së Kroacisë dhe të Republikës së Kosovës.

Me punimet e mëparshme, shkurtimisht të përmendura, lidhet edhe punimi i Veronika Karevës, e cila flet për qasjen e të mësuarit, si mjet motivues për popullarizimin e gjuhës shqipe te nxënësit e rinj maqedonas dhe prindërit e tyre. Ajo bën analizë të shkaqeve të mosdijes, përkatësisht të mos mësimit të gjuhës së tjetrit, që zbatohet në rrethanën ku jetojmë dhe jep shembuj të mbështetura për tejkalimin e gjendjes së këtillë.

Të gjitha punimet në fakt janë "të nxitura" nga përkthimi i gjuhës shqipe në përgjithësi, si dhe të teksteve me terminologji administrative-juridike. Prandaj mund të lexojmë në punimin e Anila Omarit, e cila thotë se përkthimi përgjithësisht ndikon dyfishtë mbi gjuhën: e pasuron, por mund të ndikojë edhe mbi harresën e shprehjeve dhe konstruksioneve karakteristike natyrore, madje edhe t'i zëvendësojë me ato të huaja. Ajo thekson se përkthimi është arti i të shkruarit, që kërkon shumë dijeni nga fusha të ndryshme: të gjuhës, të gramatikës, të leksikut dhe të semantikës edhe nga fusha e kulturës. Për të marrë një përkthim të mirë, nevojitet përmirësim i vazhdueshëm i aftësive personale dhe i njohurive të mbledhura gjatë kohës. Në këtë temë, dhe më gjerë, duke përfshirë edhe redaktimin, ndalet edhe Asllan Hamiti. Në punimin e tij jep disa shembuj të përkthimeve të gabuara dhe si duhet të përkthehen ato saktë. Redaktimi, përkatësisht rregullimi gjuhësor,

paraqet nivel tjetër të shkencës së gjuhës, të cilit duhet t'i përkushtohet më shumë vëmendje, si edhe lekturës. Një përkthim që të jetë më i mirë, duhet t'i kalojë të gjitha këto faza, ku në përfundim, Asllan Hamiti tregon për nevojën e lektorëve të licencuar të gjuhës shqipe.

Duke folur për përkthimin, nuk mund të mos përmendim punimin e Ismail Hamitit, që ka të bëjë me përkthimin e lirë dhe të drejtpërdrejtë. Ku është kufiri? Përmes vështrimit historik, që nga Mbretëria Romake, ai me shembuj e përpunon këtë çështje, por edhe me teza teorike të përkthimit në shkencën e gjuhës.

Në atë kontekst është edhe punimi i Berton Sulejmanit për toponiminë shqiptare të tabelave të rrugëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përkatësisht si janë dhe si duhet të jenë të përkthyera në shqip. Në të vërtetë këtu bëhet fjalë për nuancat e përkthimit, për të cilat nevojitet përvojë e madhe gjatë procesit të përkthimit, por edhe njohja e gjuhës amtare dhe të asaj në të cilën bëhet përkthimi.

Na mbeten edhe katër punime të përfshira në këtë përmbledhje. Ato i kemi renditur në mënyrë ciklike në fushën e terminologjisë, edhe pse të gjitha punimet e përmbledhjes gërshetohen tematikisht, pothuajse, asnjë punim nuk kufizohet rreptësishtë rreth një teme të gjuhës, që në fakt s'është e mundshme kur bëhet fjalë për një shkencë komplekse siç është gjuha, e cila në vetvete paraqet një sistem.

Megjithatë, për shkak të pasqyrës më të qartë, është edhe kjo nënndarje fiktive e punimeve.

Prej këtu, punimi i Ajten Hajdari-Qamilit e trajton pikërisht terminologjinë administrative dhe përfshirjen e saj në fjalorët terminologjikë dhe përgjithësisht për nevojën e përpunimit të fjalorëve me terminologjinë administrative-juridike, që për momentin është dega më e përkthyer e gjuhës, në shqip nga maqedonisht, njëkohësisht, merren parasysh dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Si ndërlidhje e kësaj, është edhe punimi i Ismet Osmanit ku i përfshin problemet

e parashtruara të semantikës terminologjike në administratën publike, i cili në punimin e tij, ndalet te problemet e përkthimit nga maqedonishtja në shqipe, por në një nivel tjetër, në atë kuptimor, ku edhe një "gabim" i imët, mund ta "shkatërrojë" tërësisht nevojën e vërtetë të qytetarit gjatë realizimit të të drejtave të gjuhës së vet.

Besim Kabashi, gjithashtu flet për marrjen, përkatësisht për pasurimin e terminologjisë së gjuhës shqipe me ndërtimin e korpuseve paralele si mbështetje gjatë zhvillimit të punës për kontrollim dhe përcaktim të nocioneve të reja të një fushe.

Punimin e Dimitar Pandevit e lamë për në fund, sepse përmes vështrimit të studimeve linguistike të Olivera Jashar-Nastevës parashtron teorinë e multilingualizmit në linguistikën maqedonase, prej së cilës arrijmë te fillimet e përkthimit në shqipe nga maqedonishtja.

Shkurtimisht, thamë nja dy fjalë për çdo punim. Sigurisht, për interesin e kohës, nuk mundëm të themi gjithçka që duam dhe gjithçka që meritojnë, prandaj këtu, para nesh dhe para jush është Përmbledhja në maqedonisht, në shqipe dhe në anglishte, pa dyshim, secili sipas fushës së interesit të tij. Do ta gjejë atë që i nevojitet dhe do të pasurojë njohurinë, kështu që do ta shndërrojë në praktikë.

Kjo përmbledhje punimesh do t'i japë kontribut të padyshimtë zhvillimit të gjuhës shqipe dhe disiplinave gjuhësore në përgjithësi.

Mustafa Ibraimi

Recension për përmbledhjen e punimeve nga Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare me temë boshte "Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të ligjit të përdorimit të gjuhëve në RMV", mbajtur në Shkup (20-22.2.2020)

Botim me vlerë për dygjuhësinë në shtetet multikulturore

Edhe përkundër shumë dallimeve, njerëzit gjithmonë kanë qenë të prirur të komunikojnë nëpërmjet kufijve gjuhësorë dhe kulturorë. Për rolin e gjuhës në bashkësi të caktuara njerëzore ekzistojnë shumë dëshmi. Çdo gjuhë posedon karakteristikat e veta që e bëjnë të jetë më specifike në krahasim me gjuhët tjera të botës. Gjuhët, ashtu si qeniet tjera, lindin dhe vdesin, konfrontohen midis veti, ose shkatërrohen, disa dalin si fitues e disa si humbës, që varen nga shumë faktorë.

Ky takim shkencor imponoi pyetje të ndryshme, si: *Cilat janë raportet midis gjuhëve gjatë përkthimit, shtrirja e gjuhëve të mëdha në llogari të gjuhëve të vogla; vlerat simbolike dhe komunikative të gjuhëve; globalizimi dhe lokalizimi i gjuhëve në kontekst përkthimi, huazime, çështja e terminologjisë etj.*?

Shumë nga këto pyetje për tre ditë rresht u shqyrtuan në konferencën shkencore me titull "Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të ligjit të përdorimit të gjuhëve në RMV, organizuar nga AZGJ-ja, duke rezultuar me botimin e përmbledhjeve të konferencës. Studimet e botuara në këtë përmbledhje mund t'i ndajmë në disa fusha shkencore, edhe atë: studime që lidhen me terminologjinë, përkthimin, paralelet gjuhësore, onomastikën, politikat gjuhësore etj.

Ky libër paraqet një arritje të madhe për shumë fusha shkencore, midis tyre edhe

për përkthimologjinë. Në këtë përmbledhje punimesh, procesi i përkthimit zë një vend qendror. Dominon mendimi se përkthimi është një transferim që nuk ndodh vetëm ndërmjet dy gjuhëve, por ndërmjet dy kulturave, duke qenë se si gjuha burimore, ashtu edhe gjuha e synuar, janë të rrënjosura në situata komunikative në kulturat e tyre respektive. Nocioni i kulturës është thelbësor në shqyrtimin e ndërlikimeve gjatë procesit të përkthimit dhe pavarësisht se ekzistojnë debate mbi faktin nëse gjuha është pjesë e kulturës, dy nocionet e kulturës dhe gjuhës janë të pandashme. Kultura dhe kompetenca kulturore janë fenomene shumë komplekse që mund të ngrenë mjaft gracka për përkthyesin. Fjalët apo shprehjet e rrënjosura në një kulturë të caktuar, përbëjnë vështirësitë më të mëdha që mund të hasin përkthyesit, pasi shpeshherë është gati e pamundur për t'u përkthyer dhe ka pasur debate të vazhdueshme rreth teknikave, humbjeve apo kompensimeve në përkthimin e termave kulturorë.

Disa autorë trajtojnë tema që lidhen me shumëgjuhësinë, sidomos me përkthimin si faktor kryesor dhe shumë aktuale. Në Evropë dhe kontinentet e tjera me vëmendje të veçantë studiohen rastet e shumëgjuhësisë. Përkrah shumëgjuhësisë studiohet edhe shumëkulturalizmi, edhe pse, nga ky aspekt deri më tani shumë pak është punuar. Kohëve të fundit mbahen shumë takime dhe zhvillohen diskutime për dukurinë e shumëkulturalizmit. Nëse në Bashkimin Evropian një e treta e mjeteve harxhohen për përkthime dhe ka tendenca që kjo shifër të rritet në të ardhmen, kjo çështje sipas autorëve edhe në RMV duhet t'i jepet rëndësi gjuhëve kombëtare, gjuhëve për komunikim ndëretnik, gjuhëve për komunikim ndërkombëtar dhe global, thuhet midis tjerash në disa kumtesa.

Nevoja për të përkthyer termat teknikë me specifikat e tyre po rritet, së bashku me rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Nëse shikojmë zhvillimin e teorisë së përkthimit, mund të vërejmë se teoritë moderne sot e shohin përkthimin si një proces komunikimi që nuk përfshin vetëm zëvendësimin e fjalëve nga një gjuhë në tjetrën. Përkthehet në lidhje me mesazhin, kështu që konteksti dhe struktura e gjuhës në të cilën është përkthyer është

shumë e rëndësishme. Ky studim jep disa shembuj që mund të shërbejnë si udhërrëfyes gjatë përkthimit në një gjuhë tjetër e cila ka mënyrë tjetër të strukturimit.

Paralelet leksikore, jo vetëm mes shqipes dhe maqedonishtes, por edhe me gjuhët e tjera të Ballkanit janë bërë përmes një baze mjaft të gjerë dhe nëpër shumë shekuj. Si më kryesore paraqitet simbioza dhe interferenca shumëvjeçare gjuhësore. Ky nivel gjithnjë është pjesa më e hapur dhe më labile e një sistemi gjuhësor, andaj edhe huazimet gjejnë vend më të theksuar.

Në rrethana të tilla është gjendur gjuha shqipe dhe gjuhët sllave, si maqedonishtja, serbishtja etj. Këto paralele leksikore e frazeologjike paraqiten në të gjitha shtresat leksikore, si nga jeta materiale, ashtu edhe nga ajo shpirtërore. Sa i përket shkallës së produktivitetit të këtyre tipareve, secila gjuhë ka veçoritë e saj, megjithatë shqipja, siç dihet më tepër ofron me rumanishten, bullgarishten dhe maqedonishten, shumë pak me serbishten dhe turqishten. Këto analogji tipologjike të njësive frazeologjike, që dalin në të gjithë gjuhët e Ballkanit, veçanërisht në shqipen, maqedonishten dhe bullgarishten përbëjnë anën e brendshme, thelbësore të bashkësisë ballkanike në lëmin e frazeologjisë dhe këto studime që lidhen me çështjen e përkthimit të tyre kërkojnë edhe më tej një shqyrtim si në gjerësi, ashtu edhe në thellësi. Kjo imponon krijimin e fjalorëve terminologjik, frazeologjik, sinonimik e të tjerë në kontekst ballkanik.

Në këtë përmbledhje nuk kanë mbetur pa përfshirë as temat që lidhen me politikat gjuhësore, gjuhët zyrtare, mësimi i gjuhës shqipe etj. Trevat e përziera si një truall i gjuhëve në kontakt të përhershëm janë bilingual. Komunikimi i tillë ndërgjuhësor shpreh respektin e ndërsjellë dhe shton nevojën e obliguar për të mësuar gjuhën e njëri – tjetrit, gjuhët e mjedisit si imperativ i jetës së përbashkët. Përveç që duhet të zotërohen nga të gjitha palët, gjuhët duhet edhe të kultivohen, sepse ato janë pjesë e identitetit etnonacional, kurse identitet janë ngulitur thellë në vetëdijen e folësve. Shtetet evropiane shumë herët

e formuan identitetin e tyre në bazë të vlerave kulturore të rrënjosura thellë në gjuhë. Shtetet e reja të lindura nga nacionalizmi e rritën edhe më shumë numrin e gjuhëve zyrtare në Evropë. Qoftë ta arsyetojmë, qoftë edhe ta dënojmë këtë, bëhet fjalë për një nga karakteristikat më të theksuara të kontinentit të vjetër, që i jep botës edhe vlera kulturore. Këtë e mundëson edhe Karta e të drejtave të njeriut që është kusht për çdo pranim të ri në familjen evropiane, nëse i respekton gjuhët e nacionaliteteve.

Në këtë konferencë nuk u la anash edhe globalizmi si rend i ri botëror, i cili disi nuk lë hapësirë për shumëgjuhësinë. Të gjitha gjuhët e botës (përveç gjuhës angleze), janë vetëm dukuri antropologjike, të cilët ngadalë vdesin dhe zhduken. Për shembull, interneti sot kryesisht është në gjuhën angleze, dhe secili që do të shërbehet me atë duhet ta mësojë anglishten. Anglishtja është gjuha e konferencave ndërkombëtare dhe diplomatike, që do të thotë se globalizmi ka imponuar gjuhën e re të rendit botëror, që deri diku e shtrëngon dhe e lë anash gjuhën amtare.

Kumtesat e botuara në këtë përmbledhje, në njërën anë ngërthejnë probleme që janë me realitetin ku jetojmë dhe veprojmë, ndërsa nga ana vjetër kontribuojnë për një shoqëri të hapur dhe demokratike. Shoqërisë shumëkulturore dhe shumëgjuhësore i nevojitet një komunikim ndërgjuhësor, i cili duhet të shqyrtohet në aspektin gjuhësor, historik, social, kulturor, etnologjik, antropologjik, sociologjik si dhe atë arsimore – pedagogjike, që do të reflektojë parimin e pluralizmit kulturor në Maqedoni dhe do të konsiderohet si shoqëri e jo si shtet nacional. Në këtë aspekte kontributi shkencor i AZGJ - së është shumë i madh, sepse arrin t'i detektojë problemet dhe t'i paraqes në mënyrë të hapur. Urojmë që konferenca dhe botime të këtij niveli, të kemi dhe në të ardhmen.

Valter Memisha

Fjalim me rastin e promovimit të studimit "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të përdorimit të gjuhëve të vitit 2019"

Ndjehem i nderuar që marr pjesë në këtë ceremoni për promovimin e librit "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të përdorimit të gjuhëve të vitit 2019", hartuar nga Ylber Sela, Jusuf Zejneli, Jeton Shazivari, Argëtim Saliu, Valbona Hajretin dhe Llazo Matovski, dhe me këtë rast ju përshëndes në emrin e rektoratit dhe të gjithë punonjësve shkencorë të Akademisë së Studimeve Albanologjike.

Promovimi i një libri apo i një vepre shkencore ngaherë shënon ngjarje, për autorin, për institucionin a për një bashkësi të caktuar shkencore, intelektuale etj. Por promovimi i sotëm është shumë më tepër se kaq. Mesazhet që libri mbart, e kapërcejnë këtë qerthull adresimi, sepse ato kanë regjistruar histori, sendërtojnë punë, përpjekje, kurorëzim, ato i takojnë rrafshit mbarëkombëtar.

Përmes këtij libri, të hartuar nga specialistë të disa fushave, na vijnë të sintetizuara gjendja e shqipes në Republikën e Maqedonisë së Veriut pas Marrëveshjes së Ohrit, përpjekjet dhe lufta e pashembullt e forcave politike, të intelektualëve të përkushtuar, të mbarë popullit shqiptar në vendin tuaj për miratimin e Ligjit të përdorimit të gjuhëve, si dhe del në pah puna për zbatimin real, konkret të këtij ligji në tre vjetët e fundit.

Përdorimi zyrtar e ligjor i shqipes në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas këtij ligji, rrok të plotë komunikimin përmes saj në të ashtuquajturin komunikim administrativ, gjyqësor, shkencor, artistik, botimor etj. (në Kuvend,

në komunikim të qytetarëve me ministritë, në procedura gjyqësore në organet e pushtetit gjyqësor, e tek institucioni i avokatit të popullit në procedura administrative, në procesin zgjedhor, dokumentet personale, në evidenca amë, në autorizimet policore, veprimtaria radiodifuzive, në objekte infrastrukturore, gjatë aktiviteteve financiare dhe ekonomike, në arsim, shkencë, kulturë, në procesin e qasjes së lirë deri tek informatat me karakter publik dhe gjatë publikimit të akteve).

Të nderuar të pranishëm, përdorimi praktik i shqipes nënkupton se ajo duhet të vlerësohet si duhet. Patriarku i shqipes, akad. E. Çabej thotë se gjuha është thesar i një kombi, kurse për kombin shqiptar ajo është thesari i vetëm dhe më i çmuar. Ne vërejmë me kënaqësi dhe krenari se në këtë drejtim në Republikën e Maqedonisë së Veriut po punojnë universitetet shqiptare të ngritura në Shkup, Tetovë, Strugë (që dy-tri dekada më parë as që mund të ëndërroheshin), institucione të posaçme, shkollat në gjuhën shqipe etj.

Në këtë linjë, pas miratimit të Ligjit, para tre vjetësh u ngrit dhe Agjencia e Zbatimit të Gjuhëve, në varësi të drejtpërdrejtë nga Qeveria si dhe Inspektorati i Zbatimit të gjuhëve që varet nga Ministria e drejtësisë. Ne vërejmë me kënaqësi se të gjitha këto institucione po punojnë fuqishëm e përkushtueshëm për ngritjen e prestigjit të shqipes, për mirëfunksionimin saj në të gjitha hapësirat e mundshme e të duhura të përdorimit.

Zbatimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve është ngushtë i lidhur me procesin euro-integrues të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që me të drejtë është parë si gur themeli për ndërtimin e mëtejshëm të shoqërisë shumetnike dhe për sigurimin e së ardhmes së demokracisë në këtë republikë. Dihet se një nga përbërësit krucial të demokracisë është pranimi dhe respektimi i tjetrit i lirë së tjetrit e ndër ta, respekti etno-gjuhësor ndaj të tjerëve. Zbatimi konkret e me

përgjegjësi kombëtare i ligjit, në një mjedis dy- e shumëgjuhësh, pashmangshëm shpie në respektimin e vetë etnive apo popujve që jetojnë në vendin tuaj. Kështu fitojnë të gjithë.

Agjencia e Zbatimit të Gjuhëve, nën drejtimin kompetent e vizionar të prof. dr. Ylber Selës, ka shpërfaqur arritje të identifikuara, të mirëpritura e të vlerësuara, përmes punës së paorarshme e të palodhur për ngritjen e një institucioni frytdhënës, duke përzgjedhur punonjës me formim shumë të mirë e me dëshirë e përkushtim për punë, përmes organizmit të veprimtarive shkencore tashmë të institucionalizuara, përmes botimeve të shumta cilësore e tepër të dobishme për fushën që mbulon, përmes lidhjes së dhjetëra marrëveshjeve funksionale me institucione shtetërore, akademike, universitare, arsimore etj., brenda Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj, sidomos me Republikën e Shqipërisë dhe me atë të Kosovës, me organizma kombëtarë e ndërkombëtarë.

Të nderuar të pranishëm, veprimtaria e sotme përuruese e librit "Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të përdorimit të gjuhëve të vitit 2019", shënohet në ditën e mbylljes së punimeve të Kongresit të Manastirit, para 113 vjetësh. Ky kongres i ndihu bashkimit të shqiptarëve, i ndihu organizimit të veprimtarive dhe të veprimit kombëtar me synime të përbashkëta, pavarësisht pengesave të panumërta sidomos të fqinjëve me qëllime të theksuara shoviniste e aneksuese. Sot vërejmë se janë arritur shumë nga ato që u shtruan për zgjidhje në këtë ngjarje madhore të historisë sonë bashkëkohore. Dhe vetë përmbajtja e librit që po promovojmë këtu, në mjediset e Universitetit të Evropës Juglindore, përcjell mesazhin e drejtpërdrejtë të Kongresit se krahas gjithçkaje që është bërë, duhet ende shumë punë e, në radhë të parë, të shtohen hapësirat e bashkëpunimit tonë ndërinstitucional e ndërshtetëror.

Të nderuar të pranishëm, në këtë sallë në datë 30 shtator 2021 nga drejtori i

AZGj - së, prof. Ylber Sela, dhe rektori i ASA - së, prof. L. Përzhita u nënshkrua Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve tona, i cili bazohet në inicimin, mbështetjen, realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore; në mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive shkencore si konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm, puna praktike e studentëve; në shkëmbimin e përvojës për menaxhimin institucional, në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion; në koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta për nëpunësit administrativë e të bartësve të funksioneve të administratës publike, të cilët janë të detyruar në zbatimin e gjuhës shqipe në bazë të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Unë ripohoj, në emër të institucionit, se ndihma jonë do të jetë në shkallën më të lartë të mundshme. Bashkëpunimi kurdoherë është i ngarkuar me sukses e arritje. Koha po punon për ne.

Po i mbyll këtë fjalë përshëndetëse duke cituar dy vargje nga një poezi e një autori nga Shqipëra: *"Nëse zgjohesh vonë nga gjumi, / kupton se dita nuk është më jotja! / Popujt kanë fat edhe më të keq / nëse i ngjajnë detit në bunacë!"* Veprimtaria përuruese sot tregon edhe njëherë se tashmë shqiptarët e Maqedonisë së Veriut nuk janë në bunacë, përkundrazi, janë në udhëtimin që kërkon koha e kombi.

U mbledhshim nga herë në veprimtari të tilla domethënëse e kuptimplota!

Gëzuar Ditën kombëtare të Alfabetit!

Faleminderit!

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

81‘276.6(062)

811.18‘276.6(062)

KONFERENCA shkencore ndërkombëtare

Terminologjia dhe roli i saj për njohjen e gjuhës profesionale : kumtesat e konferencës / Konferenca shkencore ndërkombëtare ; [redaktor Ylber Sela ; përkthyes nga maqedonshtja në shqip Ermira Ajrullai, Monika Mitreva ; përkthyes nga anglishtja në shqip Fitore Shaqiri]. - Shkup : Agjencia e zbatimit te gjuhës e RMV-së, 2022. - 254 стр. ; 25

Дел од текстот преведен од мак. и англ. јазик. - Фусноти кон текстот. - Библиографија кон трудовите

ISBN 978-608-4915-13-3

а) Стручна терминологија -- Собири б) Албански јазик -- Терминологија -- Собири

COBISS.MK-ID 56284933

ISBN 978-608-4915-13-3